

Thomas Schrapel, Enriketa Pandelejmoni, Andi Pinari

Thirrja për liri

25 Vite të Lëvizjes Demokratike në Shqipëri

Tiranë, 2016

Thomas Schrapel

KAS – Tbilis

Gota është “gjysmë e mbushur” – Rruga e Shqipërisë nga izolimi drejt Evropës

Me rastin e 25-vjetorit të Lëvizjes demokratike

Nga pëshpëritësit e rrugëve tek rrëzuesit e monumenteve

Pa u vënë re nga “pjesa tjetër” e Evropës, në Janar të vitit 1990, shqiptarë të guximshëm u ngritën kundër plotfuqishmërisë së komunistëve. Ndërsa “në periferi” u dëgjuan edhe “pëshpëritësit e rrugëve”, të cilët shkëmbenin midis tyre informacione në lidhje me kohën dhe vendin e protestave. Por nuk ishte aspak rastësi që këto protesta i drejtoheshin shërbimit sekret të urreyer komunist “Sigurimi”. Përpara ndërtesës kryesore të tij në Shkodër protestonin protestuesit edhe pse e dinin, se në atë moment ata akoma vinin jetën e tyre në rrezik. Ata ndodheshin përballë një armiku të gjithëpushtetshëm, i cili ende zotëronte të gjitha instrumentet e mundshme të represionit dhe që ishte padyshim në gjendje t’i përdorte ato. Në Prill vijuan protestat në Kavajë. Pastaj pasuan protesta në qytete të ndryshme të Shqipërisë dhe më së fundi erdhi dhe protesta në verën e vitit 1990 në kryeqytet, në Tiranë. U pushtuan ambasadat dhe njerëzit përpiqeshin me të gjitha mënyrat që të merrnin kontakt me “botën e jashtme” perëndimore.

Papritur Shqipëria u bë pjesë e ngjarjeve dhe ndryshimeve që po mbanin në tension botën që prej një viti. Revolucioni pak a shumë “paqësor” kundër komunizmit në Evropë kishte mbërritur tashmë edhe në periferinë juglindore të kontinentit. Deri në atë moment Shqipëria ishte prej më shumë se katër dekadash vendi më i mbyllur dhe më i izoluar në Evropë dhe madje

në një mënyrë të tillë, sa pothuajse në perceptimin publik kishte rënë në harresë. E kush, përveç disa specialistëve dhe njohësve të brendshëm, dinte ndonjë gjë për çështjet e politikës së brendshme në kohën e komunizmit në Shqipëri? Punonjësit e organizatave humanitare ndërkombëtare u shokuan, kur në mars të vitit 1991 u hapën portat e kampeve të fundit të burgimit dhe u takuan me të mbijetuarit:

“Pamja me të cilën u ndeshëm, kur u hapën portat e kampeve dhe ne gjendeshim përballë të mbijetuarve, nuk mund të përshkruhet me fjalë – mbase mund të krahasohet me imagjinatën e ferrit dhe purgatorit të piktorëve holandezë të Rilindjes: trupa të thatë, paterica me një këmbë dhe primitive, gjymtyrë të prera dhe të pashëruara, plagë të hapura në krahë dhe duar, të verbër dhe me një sy, sy gjysëm të dalë jashtë, njerëz me zgjebe, tek të cilët parazitët rohiteshin në qafë si bletë, të shurdhër, paraplegjikë, për të cilët kujdeseshin bashkëvuajtësit dhe ushqeheshin prej tyre. Disa nga dëmtimet ishin pasoja të torturave ose sëmundjeve, të tjera nga vetë-gjymtimi. Fjetina me dritare të shpartalluara dhe krevate marinari, pothuajse pa dyshekë e batanije, një zonë jo e ndarë për rastet e rënda të tuberkulozit. Të gjitha këto pa kurrfarë kujdesi mjekësor. Uji i pijshëm vinte nga cisternat e mëdha dhe ishte aq i turbullt dhe i ndotur, sa vetëm etja e padurueshme mund të çonte në konsumimin e tij”.¹

Kampet e burgimit dhe të punës së detyruar për të burgosurit politikë si dhe internimi i të gjithë familjes ishin më se të zakonshme në Shqipërinë komuniste deri në vitin 1991. Dënimet drakoniane ishin pjesë e jetës së përditshme. Shumë shqiptarë u dënuan dhe për “shkeljen” më të vogël me burgim disa vjeçar, ku si rregull mjaftonin edhe thjeshtë akuzat, pa qenë nevoja që akuzuesit e vërtetë apo imagjinarë të ishin të detyruar të sillnin ndonjë provë. Shqipëria komuniste ishte vendi i lulëzimit të denoncimit. Shumë shqiptarë ranë pre e këtij sistemi represioni mbi bazën e proceseve thjesht administrative. Për të marrë një shembull, edhe për

¹ Nga raporti i një inspektimi të „Federatës Ndërkombëtare të Helsinkit për të Drejtat e Njeriut“ në Mars 1991, shiko: Anita Niegelhell, Gabriele Ponisch (botues) „Ne jemi akoma në zjar“ Raportime të ish të burgosurve politikë në Shqipërinë komuniste, Vjenë [Böhlau] 2001.

kritikën e bërë në publik në lidhje me cilësinë e bukës, që shitej vetëm në dyqanet shtetërore, klasifikoheshë si “armik i pushtetit”. Për “shtetin ligjor” në Shqipëri nuk kishte një nocion ekuivalent. Ministria e Drejtësisë e hoqi që në fillim të viteve '60 me argumentimin zyrtar, se socializmi nuk njeh asnjë lloj kriminaliteti. Ndërkohë që kampet e të burgosurve ishin plot. Ato përbënin një komponent të rëndësishëm të infrastrukturës së vendit. Projektet e mëdha industriale nuk do të ishin ngritur kurrë pa të burgosurit politikë. Megalomania politike e bashkuar me përndjekjen brutale dhe shfrytëzimi i atyre që mendonin ndryshe – kjo ishte esenca e regjimit stalinist në Shqipëri. Pushtetarët e regjimit komunist vepronin në Shqipëri në një hapësirë ku nuk kishte drejtësi.

Tirania në “hapësirën jo-shtetërore”

Përndjekjet politike dhe “spastrimet”, që me stilin, me parashtrimin e akuzave publike dhe në karakterin e tyre të kujtonin Bashkimin Sovjetik stalinist, në Shqipëri ishin pjesë e jetës normale të sundimtarëve komunistë deri në vitin 1990! Statuja mbidimensionale e Jozef Stalinit qëndroi deri në 12 Dhjetor 1990 në zemër të Tiranës dhe për dekada të tëra lëshonte një hije të gjatë dhe të errët mbi shoqërinë shqiptare. Në shumicën e vendeve të Evropës gjatë gati katër dekadave nën ndikimin e sundimit të Bashkimit Sovjetik kishte censura të qarta, që kishin lidhje me vdekjen e Jozef Stalin në vitin 1953. Format e represionit kundër “armiqve të pushtetit” ndryshonin, u bënë më të rafinuara dhe nuk aplikoheshin më aq hapur. Në Hungari, Poloni, Çekosllovakia dhe në RDGJ sundimtarët komunistë kishin gjithë e më tepër problemin e konfrontimit nga Perëndimi me çështjen e “Të drejtave të njeriut”. Me kalimin e kohës jo të gjitha por disa dhe me kalimin e kohës gjithnjë e më tepër krime të komunistëve ndaj atyre që mendonin ndryshe po bëheshin të njohura në perëndim. Në rastet kur përfaqësues të qeverive komuniste vizitonin perëndimin, ata – mbase shumë rrallë, por gjithsesi – konfrontoheshin herë

pas here me shembuj të shkeljes së të drejtave të njeriut në vendet e tyre dhe ishin të detyruar të reagonin. Të paktën ishte i njohur fakti i shumë të përndjekurve politikë në këto vende. Për disa prej tyre u bë e mundur që të lehtësoheshin kushtet e burgimit. Për disa të tjerë perëndimi pagoi para që të liroheshin nga burgu dhe zakonisht u transferuan në perëndim.

Ndryshe nga sa më sipër në Shqipëri nuk pati ndryshime të tilla. Diktatori Enver Hoxha e mbante veten mbas vdekjes së Jozef Stalinit si luftëtarin e vetëm dhe konsekuent kundër perëndimit. Jozef Salin ishte shembulli për Enver Hoxhën dhe para së gjithash diktatori shqiptar i referoheshe atij në ushtrimin brutal të pushtetit dhe represionit kundër armiqve ekzistentë dhe “të sajuar”. Madje ai shkoi edhe më tej. Dhe pikërisht nga fundi i viteve '50 jo vetëm imperialistët në perëndim, por edhe shumica e komunistëve në zonën e sundimit të Bashkimit Sovjetik u shpallën si “Revizionistë” dhe në këtë mënyrë edhe “armiq” të Shqipërisë.

Komunistët shqiptarë shkaktuan me vetëdije izolimin total të vendit të tyre. U eliminuan edhe ato pak tipare të një shteti të civilizuar. Brenda më shumë se 40 vjetësh, që zgjati regjimi komunist, nuk ndryshoi asgjë në gjendjen e të përndjekurve politikë në burgje dhe për të internuarit në kampet e punës së detyruar. Komunistët shqiptarë praktikuan atë që sot në kërkimin shkencor për stalinizmin klasifikohet si “Sundimi i dhunës në hapësirën jo-shtetërore”. Asnjë nga udhëheqësit komunistë shqiptarë të kohës nuk u konfrontua në perëndim me paraqitjen e shkeljes së të drejtave të njeriut. Vetëm kur Ramiz Alia, pasardhësi i Enver Hoxhës, në fund të dhjetorit të vitit 1989 mësoi për përfundimin e dhunshëm të diktatorit rumun Nicolae Ceausescu, nga frika e një fati të ngjashëm nënshkroi Marrëveshjen e Helsinkit për respektimin e të drejtave të njeriut!

Ky ndryshim cilësor në krahasim me vendet e tjera komuniste të Evropës duhet të merret parasysh, nëse bëhet fjalë për klasifikimin dhe vlerësimin e demonstratave dhe protestave të shqiptarëve në vitet 1990-1991.

Rrëzimi i statujës së Stalinit nga protestuesit më 11 Dhjetor 1990 u bë simboli i rënies përfundimtare të sistemit të regjimit komunist. Çfarë simbolike madhështore ka fotoja, që tregon Stalinin e rrëzuar për tokë, që duket sikur i puth këmbët njëri prej protestuesve.

Tirana dhe me të dhe i gjithë vendi mbizotëroheshin në vitet 1990-91 nga guximi i protestuesve, por edhe nga frika që ishte e pranishme kudo. Këtë mund ta përshkruajë mjaft mirë një episod. Kur në shkurtin e vitit 1991 u bë e ditur, se disa protestues dëshironin të rrëzonin statujën gjigante të diktatorit Enver Hoxha në qendër të Tiranës, televizioni shtetëror dërgoi disa ekipe filmimi për të fiksuar me kamera këtë moment. Kur erdhi momenti që simboli prej bronzi i Enver Hoxhës ishte pak përpara rrëzimit të tij, asnjë nga kamerat nuk e fiksoi këtë ngjarje, por të gjithë bënë filmime të njerëzve që ishin përreth. Askush nuk i besonte kësaj situatë, askush nuk donte ta filmonte rrëzimin e statujës, nga frika, se për këtë gjë mund të ndëshkoheshin. Dhe ndodhi që për këtë moment të madh të revolucionit shqiptar nuk ka filmime zyrtare, edhe pse kishte teknikë të mjaftueshme në terren. Ashtu si edhe në dramën antike, që pasohen nga loja satirike, ashtu ecën edhe orët në vazhdim. Pasardhësi i Enver Hoxhës, Ramiz Alia mori kontakt me drejtorin e televizionit shtetëror, i cili i konfirmoi, se nuk ekzistonin filmime zyrtare nga rënia e monumentit. Në këtë mënyrë lindi edhe ideja për ta rivendosur statujën përsëri fshehurazi gjatë natës! Por protestat kundër regjimit u bënë gjithnjë e më të fuqishme dhe vazhdonin të drejtoheshin kundër simboleve të regjimit komunist. As nuk mund të spekulohet se çfarë mund të kishte ndodhur nëse Ramiz Alia do të kishte ndjekur më tej idetë e tij absurde.

Shqipëria kthehet drejt Evropës

Më së shumti duhet të vlerësohet merita e protestuesve në Shqipëri. Ndryshe për shembull nga ish-RDGJ dhe të “revolucionit paqësor” që u zhvillua atje, në Shqipëri ishin studentët që luajtën një rol thelbësor, mbase dhe rolin më të rëndësishëm gjatë revolucionit kundër regjimit

komunist. Por ndërkohë që gjermanët negocionin për ribashkimin, shqiptarët ende ishin të izoluar nga bota e jashtme.

Që nga vera e vitit 1989 është vënë në pikëpyetje në mënyrë masive supremacia e komunistëve në vendet e tyre evropiane. Protestat masive në RDGJ, në Çekosllovakë, Hungari dhe Bullgari i drejtoheshin me një pikësypnim të qartë kundër supremacisë së vetme të partive komuniste në këto vende, pavarësisht se nën çfarë emri ato shfaqeshin. Në Poloni kjo supermaci u vu në pikëpyetje në mënyrë masive që fillim të viteve '80 të shekullit të XX dhe pikërisht nëpërmjet njerëzve, që sipas mësimave të qarta të ideologjisë në fakt duhet të ishin mbartësit e vërtetë të regjimit komunist: punëtorët. Është e vështirë që ngjarjet në Rumani të klasifikohen si pjesë e revolucionit “paqësor” në Evropë. Pamjet spektakolare të fundit të dhunshëm të diktatorit të atjeshëm në kohën e Krishtlindjeve të vitit 1989 u shpërndanë në të gjithë botën dhe krijuan përshtypjen e një përmbysjeje jo edhe aq “paqësore”.

Megjithatë edhe këtu sistemi i regjimit komunist u shkatërrua tek e fundit nga protestat e njerëzve të këtij vendi. E matur me faktin, se sa fort i ngulitur dukej deri atëherë pushteti i komunistëve, edhe sot, kur kanë kaluar më tepër se 25 vjet prej këtyre ngjarjeve, jemi akoma të habitur, se sa pak mbështetje dukej se u kishte mbetur në popull pushtetarëve komunistë. Për pothuajse gjatë pesë dekadave komunistët ishin përpjekur, që të krijonin njeriun e ri: me një shpëlarje truri pak a shumë ideologjike dhe me dhunë masive. Se sa viktima mund të ketë patur si pasojë e supermacisë së komunistëve në përgjithësi, nuk do të mund të gjendet më në mënyrë të plotë. Por ironia e hidhur e eksperimentit komunist bëhet e qartë në një dukuri tjetër: në iluzionet dhe dëshirat e protestuesve në Evropën Lindore dhe Juglindore për liri dhe shtet ligjor – vlerat e perëndimit, të “urryer” zyrtarisht deri në atë kohë. Edhe nëse komunistët u përpoqën me të gjitha mënyrat, që t’i mbanin njerëzit larg tyre dhe këtë për më shumë se 40 vjet, atyre u mbeti vetëm zhgënjimi në lidhje me një disfatë të plotë në këtë luftë për koka. “Njeriu i ri” nuk dëshironte gjë tjetër përveç lirisë dhe ishte i etur për vlerat e perëndimit.

Humbja e “luftës për koka”

Kurrkund tjetër në Evropë komunistët nuk ishin përpjekur me mjete aq brutale, që të mbanin të mbyllur dhe të izoluar nga bota e jashtme “armike” njerëzit që gjendeshin nën sundimin e tyre, sa në Shqipëri. Përndjekjet disa dhjetëra vjeçare të kundërshtarëve ekzistentë dhe imagjinarë të regjimit përbënin thelbin e ekzistencës së diktaturës komuniste në Shqipëri. Dënimet drakoniane për të gjithë ata, që nga këndvështrimi i komunistëve ishin në kundërshtim me idenë e “njeriut të ri”, si dhe masat absurde dhe gati groteske të marra për “mbrojtjen” e Shqipërisë komuniste mbetën në fund të fundit armë të gjymtuara kundra dëshirës së njerëzve për liri. “Kemi pritur 50 vjet për ju” shkruanin protestuesit në Tiranë në fillim të vitit 1991 në banderolat e tyre dhe nënkuptonin amerikanët dhe perëndimin! Njerëz tejet të guximshëm dhe të përmalluar për liri në Tiranë, Shkodër, Kavajë dhe në vende të tjera dolën në rrugë dhe i treguan gjoksin regjimit. Ata e kthyen Shqipërinë drejt Evropës.

Komunistët shqiptarë që në fillimet e tyre zhvilluan një luftë brutale kundër besimeve fetare. Veçanërisht klerikët katolikë, por më vonë edhe ata ortodoksë dhe myslimanë bënë pjesë tek viktimat e para të përndjekjeve politike. Natyrisht që në këtë rast ishte fjala edhe për arsye materiale. Por para së gjithash komunistët donin të fitonin “luftën për kokat”. Sundimin e synuar dhe zotërues mbi njerëzit e pengonin shtëpitë e lutjeve të të krishterëve dhe të myslimanëve. Pasi sundimtarët komunistë kishin eliminuar tashmë deri në atë kohë shumicën e personaliteteve fetare dhe kishin konfiskuar pronat e komuniteteve fetare, Shqipëria u shpall në vitin 1967 si vendi i parë “ateist” në botë. Më shumë se 2100 vende adhurimi të të gjitha feve ose u shkatërruan, ose u “tjetërsuan” dhe në këtë mënyrë u prishën. Një përndjekje e tillë brutale e besimeve fetare deri tek asgjësimi total i synuar ishte i pazakontë edhe për vetë rrethanat e komunizmit.

Për më tepër është mbresëlënës fakti se vendet e adhurimit, që nuk ekzistonin më si të tilla që prej vitit 1967, papritur u rimbushën plot në vitin 1990. Edhe kjo gjë simbolizon disfatën totale të ideologjisë komuniste, me gjithë metodat brutale për t'ju a diktuar atë njerëzve si steriologji.

Ngjarjet në Shqipëri në vitet 1990 dhe 1991 do të kishin vlerë të nguliteshin më fortë dhe në mënyrë më të qëndrueshme në kujtesën kolektive të “pjesë tjetër” të Evropës. Ndërkohë që në RFGJ, që ekzistonte ende zyrtarisht, diskutohej për ribashkimin me pjesën perëndimore të Gjermanisë dhe në këtë mënyrë edhe për integrimin e plotë në Evropën Perëndimore, protestuesit në Shqipëri ende e shikonin veten e tyre përballë një pushteti shtetëror me qëllime armiqësore. Jeta e përditshme e protestuese në Shqipëri karakterizohej prej shumë vitesh nga mangësitë në furnizim, radhët e përditshme me orë të tëra për marrjen e ushqimeve bazë dhe kjo ndodhte në një vend, që është i bekuar përse i përket furnizimit të popullatës. Në shumicën e vendeve komuniste të Evropës Qendrore dhe Lindore orientimi tek sjellja konsumatore e perëndimit përbënte në vitet '80 një nga arsyet për pakënaqësinë me rrethanat politike në vend.

Ndërsa në Shqipëri njerëzit “e thjeshtë” luftonin në këtë kohë thjesht për ekzistencën e tyre dhe për “mbijetesën” e përditshme. Përpara ndërtesës së “Sigurimit” në Shkodër dhe në sheshin kryesor në Tiranë përballë tyre qëndronin policë të armatosur gjer në dhëmbë – të gatshëm në çdo moment që të ndërhyjnë, çka dhe më pas e ndërmorën. Ashtu si edhe në Rumani, edhe në Shqipëri revolucionin në fakt nuk ishte paqësor, por në fund të fundit i suksesshëm.

Të para nga ky këndvështrim duhet të vlerësohen edhe zhvillimet që kanë ndodhur në Shqipëri që nga ajo kohë. Askush nuk do të pretendonte seriozisht që Shqipëria e vitit 2016 është një demokraci perfekte. Ka shumë kritikë për t'u bërë zhvillimeve të ndodhura gjatë 25 viteve të fundit në Shqipëri dhe konkretisht edhe kundrejt politikanëve përgjegjës. Megjithatë duhet të merret parasysh, se Shqipëria nuk mund të mbështetej në asnjë traditë demokratike, në kohën kur aktorët e lëvizjes demokratike në vitin 1990 por përpiqeshin të transformonin sistemin

politik në një sistem demokratik. Nuk kishte asnjë përvojë me parlamentin. Një ndarje e pushteteve ekzistonte po aq pak, sa edhe një sistem drejtësie i pavarur. E parë nga ky këndvështrim do të ishte gjithashtu e drejtë, që të shikohen me optimizëm zhvillimet e demokracisë së re shqiptare gjatë këtyre 25 viteve të fundit. Populli i vogël shqiptar sjell në Evropë përvojën e një diktature disa dhjetra vjeçare, veçanërisht agresive dhe brutale, si dhe mposhtjen e saj.

Artikujt e këtij vëllimi bazohen tek referatat e një konference shkencore të Fondacionit Konrad-Adenauer, që u zhvillua më 6 Nëntor 2015 në Tiranë. Në këtë mënyrë, në bashkëpunim me Fakultetin e Historisë të Universitetit të Tiranës, u përkujtua 25 vjetori i Lëvizjes demokratike në Shqipëri. Përveç kësaj konferenca u ofroi, para së gjithash studiuesve të rinj shqiptarë, mundësinë për t'i prezantuar kërkimet e tyre shkencore një publiku më të gjerë. Në këto artikuj tematizohen aspekte të ndryshme, por natyrisht jo të gjitha aspektet e temës “Komunizmi në Shqipëri”. Për më tepër grumbullimi i artikujve, tërësia e të cilave në krahasim me konferencën është zgjeruar, është menduar si një fillim dhe një inventar për një kërkim dhe publikim sistematik të kohës së komunizmit shqiptar. Ndoshta kushtet për një kërkim të tillë tashmë janë bërë shumë më të mira. Se çfarë roli do të luante për këtë hapja e pritshme e arkivave të ish shërbimit sekret “Sigurimi”, do ta tregojë koha në vitet e ardhshme. Për historianët, albanologët, por edhe për politologët hapet një diapazon i gjerë jo vetëm në lidhje me historinë e re shqiptare, por edhe për hulumtimin e komunizmit në përgjithësi. Kërkimi shkencor mbi komunizmin kryhet tashmë prej disa vitesh, kryesisht sipas vendeve specifike, duke qenë në këtë mënyrë shumë konkret. Gjithnjë e më tepër po bëhet e qartë se teoritë emocionale të historisë dhe politikës nuk na ndihmojnë më tej, kur bëhet fjalë për të kuptuar historinë e shekullit të XX.

Fondacioni Konrad-Adenauer dëshiron, që me anë të këtij vëllimi të nxisë më tej hulumtimin e mëtejshëm të historisë së re të Shqipërisë. Ajo ç'ka është formuluar në mënyrë lakonike dikur nga Winston Churchill se “Ballkani prodhon më shumë histori, se ç'mund të konsumojë”, duket

në rastin konkret të jetë një shprehje e gjetur edhe për Shqipërinë e vogël. Për historianët, politologët dhe njerëzit e interesuar për politikë ky mund të ishte një lëm i gjerë, ku ata mund të bëheshin aktivë, sepse ky vend ka prodhuar gjithmonë mjaftueshëm histori.

Konferenca u përgatit dhe u zhvillua me mbështetjen e pakursyer të Universitetit të Tiranës. Për këtë dëshiroj, që në emër të Fondacionit Konrad-Adenauer të falenderoj përzemërsisht, veçanërisht ish Dekanin e Fakultetit të Historisë dhe Filologjisë Prof. Dr. Shezai Rrokaj dhe Dekanen aktuale të po këtij fakulteti Prof. Dr. Valentina Duka. Të dy i kanë dhënë KAS që në fillim një mbështetje të madhe, prej së cilës ne kemi arritur shumë.

Falenderimi im i veçantë shkon për të dy lektoret Dr. Enriketa Pandelejmoni dhe Dr. Andi Pinari, të cilët jo vetëm morën pjesë si referues, por edhe që morën përsipër grumbullimin e manuskripteve, redaktimin e tyre dhe përgatitjen e të gjithë publikimit.

E gjithë zyra e KAS në Tiranë u angazhua me konferencën. Por një falenderim i veçantë i takon Znj. Zheni Korçari për angazhimin e saj për realizimin me sukses të konferencës dhe për mundësimin e këtij publikimi.

Tiflis, Mars 2016

Enriketa Pandelejmoni & Andi Pinari

Departamenti i Historisë (FHF UT)

Botimet e këtij vëllimi janë rezultat i konferencës shkencore «Thirrja për liri» 25 Vite të Lëvizjes Demokratike në Shqipëri, mbajtur në Tiranë, më 6 Nëntor, 2016 e organizuar nga Fondacioni Konrad Adenauer në Tiranë në bashkëpunim me Departamentin e Historisë së Fakultetit të Historisë dhe të Filologjisë, UT së. Idea e bashkëpunimit midis Fondacionit Konrad Adenauer në Shqipëri dhe Departamentit të Historisë pranë Fakultetit të Historisë dhe të Filologjisë erdhi si rezultat i përpjekjes për të përkujtuar 25 vjetorin e Lëvizjes Demokratike në Shqipëri dhe për të prezantuar studimet e fundit mbi komunizmin dhe tranzicionin të kryera nga studiuesë dhe historianët shqiptarë.

Në këto 25 vjet “demokraci” një nga problemet më të mëdha që është hasur në studimet të karakterit historik ka qenë hulumtimi shkencor i periudhës komuniste nga pozitat e një shkence të pa-ideologjizuar dhe objektive. Një mungesë tjetër ka qenë dhe përjashtimi nga hulumtimi shkencor i tematikave sociale dhe kulturore mbi periudhën e komunizmit. Kryesisht periudha komuniste është analizuar nga problematikat politike dhe fetare, por jo aq shumë nga aspektet e tjera. Deri më sot mbizotërojnë histori “elitare” kryesisht të personazheve kryesore politike të periudhës komuniste, një “histori nga lart poshtë”, ku janë përjashtuar fenomene dhe grupime të rëndësishme të jetës sociale, të jetës së përditshme, marrëdhënieve gjinore, të drejtave të njeriut, marrëdhënieve me jashtë apo botës së artit.

Për më tepër kjo konferencë ishte një përpjekje për të hedhur dritë dhe mbi problematikat aktuale të periudhës post-komuniste. Një tjetër qëllim ishte dhe ofrimi i qasjeve të reja të studiuesve të huaj mbi tematikën qëndrore të stalinizmit dhe impaktit të tij në Europën e Luftës së Ftohtë, si edhe aplikimi i kësaj ideologjie në variantin shqiptar gjatë periudhës së viteve 1945-1990. Qasjet e reja ndaj stalinizmit po tërheqin gjithmonë e më shumë vëmendjen e

studiuesve shqiptarë dhe elemente të ndryshëm të këtij sistemi po bëhen gjithmonë e më shpesh objekt studimi të monografive apo doktoraturave të reja në Shqipëri, por jo vetëm. Artikujt e këtij botimi janë grupuar në tre tematika qendrore: a) Stalinizmi dhe komunizmi në Shqipëri; b) Hulumtimet shqiptare mbi komunizmin dhe c) Shqipëria në tranzicion.

Tek grupi i parë i tematikave, historiani gjerman në Felix Schnell në keynote-n¹ e tij “Çfarë është Stalinizmi” trajton në vija të përgjithshme teoritë aktuale dhe gjendjen e literaturës shkencore mbi stalinizmin si dhe të këndvështrimeve të reja aktuale në kuadër të “*cultural turn*” mbi totalitarizmin apo stalinizmin në Bashkimin Sovjetik dhe ndikimin e tij në Europën Lindore pas Luftës së Dytë Botërore. Schnell analizon elementet e stalinizmit të aplikuara në Bashkimin Sovjetik gjatë viteve ‘30-të të shek. XX. Në fund të keynote-t Schnell konkludon se stalinizmi është aplikuar vetëm në Bashkimin Sovjetik në formën e tij të plotë. Ndersa çdo variant tjetër i këtij modeli totalitar nuk është i krahasueshëm me Stalinin dhe Bashkimin Sovjetik.

Studiuesi italian, Paolo Rago në artikullin e tij, “Linjat kryesore të komunizmit të Enver Hoxhës”, duke u bazuar në studimet multidisiplinore më të fundit mbi Shqipërinë komuniste të kryera nga studiues të ndryshëm të huaj dhe shqiptarë, paraqit një exposé të aplikimit të ideologjisë komuniste në Shqipëri. Sipas Rago-s figura kryesore dhe dominuese e aplikimit të kësaj ideologjie ishte lideri i Partisë Komuniste (më vonë të Punës), Enver Hoxha. Qasja e re që sjell Rago me këtë studim është trajtimi i periudhës nga një këndvështrim jo bardhë e zi, por duke prezantuar enverizmin në aspekte multidimensionale. Në përfundim Rago mendon se enverizmi u shfaq si një metodë komunikuese bindëse, për të bindur popullin për ta mbështetur në një “unitet të çeliktë” politikat e Partisë dhe të liderit të saj.

Në grupin e dytë janë përfshirë artikuj që trajtojnë komunizmin shqiptar në elementë të ndryshëm të tij. Veçantia e këtij grupi artikujsh qëndron në faktin se studiuesit e këtij grupi janë

¹ Artikulli i Felix Schnell është manuskripti i kumtesës që mbajti në ditën e konferencës.

të gjithë shqiptarë dhe me artikujt e tyre kanë sjellë këndvështrime të reja në trajtimin e tematikës së komunizmit, e cila deri më sot pak është cekur në studimet shqiptare.

Kështu, studiuesi Petrit Nathanaili ka analizuar tendencat kryesore të politikës së jashtme të shtetit komunist duke shpjeguar arsyet e orientimit lindor të aleancave strategjike të Shqipërisë. Këto aleanca, ndonëse me mjaft rëndësi për një shtet të vogël si Shqipëria, janë ndryshuar brenda një periudhe shumë të shkurtër kohe, gjë që dëshmon si për kërkimin e sigurisë tek një aletat i fuqishëm, ashtu edhe dobësinë ekonomike që çon edhe në varësi politike. Vitet kur një pjesë e elitës politike shqiptare mendoi se vendi mund të mbijetonte si një shtet i pavarur pa mbrojtjen e ndonjë fuqie të madhe pas prishjes me Kinën patën një kosto mjaft të lartë për Shqipërinë.

Studiuesja Sonila Boçi në artikullin e saj ka sjellë një qasje të re lidhur me presionet e Perëndimit mbi çështjen e respektimit të drejtave të njeriut nga shteti komunist shqiptar, sidomos pas nënshkrimit të Kartës së Helsinikut në vitin 1975. Megjithëse Shqipëria nuk e kishte nënshkruar këtë dokument, në fillim e viteve '80-të u vu re rritja e presionit ndërkombëtar ndaj të drejtave të njeriut në Shqipëri duke qenë se ishin lehtësuar procedurat për shqyrtimin e shkeljeve të të drejtave të njeriut në OKB. Ankesat e para ndaj Shqipërisë në OKB u iniciuan nga lobi grek në Sh.B.A dhe nëpërmjet disa letrave dërguar OKB-së në vitet 1982-83 ku veçohej shkelja e të drejtave ndaj minoriteti grek në Shqipëri. Qeveria shqiptare refuzoi për një kohë të gjatë të reagoonte dhe më në fund në 1989, nuk pranoi asnjë prej akuzave të ngritura prej saj, por u detyrua në vitin 1990 pas vizitës së të dërguarit të OKB-së Pérez de Cuéllar dhe ndryshimeve të mëdha në Evropën Lindore që të të ndryshonte Kodin Penal dhe Kodin e Procedurës Penale në përputhje me Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut.

Ndërsa studiuesi Gëzim Qëndro në artikullin e tij mbi Aurorën krypto-teologjike të trupit politik ofron një qasje post-strukturaliste të kuptimit të trupit politik në aktualitetin shqiptar përmes

krahasimit dhe analizës së dy pikturave, asaj të piktorit italian Caravaggio me titull, *Mosbesimi i Shën Thomait* (1603) me pikturën *Vizitë në Plagë* (2010), të piktorit shqiptar, Enkelejd Zonjës. Idea kryesore që Qëndro paraqet në artikullin e tij formësohet nëpërmjet përgjigjeve të pyetjeve të ndryshme që autori ngre në shkrim, si psh, a përbën vërtet paradoks zëvendësimi në tablo i Jezu Krishtit të ringjallur pas kryqëzimit me diktatorin komunist shqiptar Enver Hoxhën? A mund të ketë ndonjë aura teologjike trupi politik i Enver Hoxhës? Cili mund të jetë kuptimi i “ringjalljes” së tij në kohën e sotme? Kush mund të jetë roli i metafizikës së pranisë në statusin që ka marrë Enveri në këtë tablo?

Studiuesja Irida Vorpsi ka marrë në analizë situatën e krijuar në Shqipëri gjatë zbatimit të të ashtuquajturit “revolucionit kulturor”, një model i marrë nga aleati i fundit i komunistëve shqiptarë, Kina. Në fokus të kërkimit të saj janë vendosur masat e marra në raport me emancipimin e gruas shqiptare si shkollimi, punësimi, marrëdhëniet familjare, eliminimi i elementëve tradicionalë, ndarjet krahinore. Por krahas nismave emancipuese u vu re se grua shqiptare po vendosej gjithmonë e më shumë në qendër të kësaj spiraleje ideologjike duke synuar politizimin e çdo aspekti të jetës së saj duke reduktuar sferën private të jetës së gruas në një hiç dhe duke shtrirë ndikimin ideologjik të Partisë në kufijtë e të paimagjinueshmes.

Duke dashur të tregojë edhe një anë tjetër të shoqërisë shqiptare gjatë komunizmit, studiuesi Artan Puto ka trajtuar filmin shqiptar gjatë diktaturës komuniste. Ai ka prezanutuar një sërë karakteristikash të filmit duke sjellë edhe një periodizim në disa periudha, në varësi edhe të situatës politike të vendit. Ndikimi kryesor i kinemasë shqiptare vinte nga Bashkimi Sovjetik për një pjesë të mirë të periudhës dhe krahasimi mes dy kinemave asaj shqiptare me atë sovjetike pasqyron më së miri këtë realitet. Por pas prishjes me aleatët komunistë filmi shqiptar ndjek një rrugë të vetën të lidhur ngushtë me realizmin e ngurtë socialist të periudhës staliniste në arte dhe në kinema. Kinemaja shqiptare e kohës së komunizmit mbeti e mbërthyer pas

realizmit socialist anakronik, si një kujtesë se Shqipëria ishte muzeu i vetëm i gjallë stalinist në Evropë.

Një formë e artit pamor si karikatura është marrë në analizë nga studiuesi Andi Pinari, në harkun kohor të viteve 1965-70, të konsideruara si vitet e fillimi të revolucionit kulturor në Shqipëri. Nën ndikimin e përhershëm të propagandës politike, karikatura shqiptare, ndonëse përpiquej të bënte humor, ishte tërësisht në shërbim të regjimit. Vendin kryesor e zenë tematikat propagandiske kundër armiqëve të jashtëm dhe të brendshëm të Shqipërisë edhe në varësi të ngjarjeve të ditës. Por në kuadër të revolucionit kulturor ka edhe një numër të konsiderueshëm tematikash mbi problemet e brendshme si burokracia, pabarazia gjinore, servilizmi, abuzimi me detyrën, tema të cilat u trajtuan shumë më me humor dhe “dashamirësi” sesa temat mbi armiqët. Kjo zbutje kishte si qëllim të realizonte ndërgjegjësimin e shoqërisë shqiptare mbi dukuritë negative brenda saj me qëllim eliminimin e këtyre fenomenve nga vetë shoqëria.

Në grupin e fundit të tematikave janë përmbledhur artikuj të studiuesve shqiptarë mbi fenomene të tranzicionit, duke u fokusuar së pari në aspektet politike, si dhe në studimet e fundit mbi tekstet historike dhe historinë nacionale shqiptare.

Kështu studiuesi Afrim Krasniqi, më artikullin e tij mbi tranzicioni shqiptar reflekton problematikat kryesore të hasura në arenën politike në këto 25 vjet periudhë tranzicioni dhe përpjekjeje për konsolidimin e shtetit demokratik në Shqipëri. Sipas tij problemi kryesor me të cilin përballlet sot shteti e shoqëria shqiptare është sfida e maturimit demokratik, si dhe paqartësitë në vizionin për të ardhmen. Në rrethanat kur mungojnë strategjitë realiste afatgjata dhe vlerësimet konsensuale për to është e vështirë të programohet Shqipëria e pas 20-30 viteve.

Ndërsa Enriketa Pandelejmoni në artikullin e saj kontribuon me një analizë të përqasjeve të reja mbi historinë e Shqipërisë në tekstet historike universitare, duke u ndalur në analizën e saj tek teksti, “Historia e Popullit Shqiptar IV. Shqiptarët gjatë Luftës së Dytë Botërore dhe pas saj

1939-1990”, tekst i cili është kthyer në një manual mësimor për studentët/studentet që studiojnë në Universitetin e Tiranës histori apo që e kanë këtë historinë si lëndë me zgjedhje. Sipas Pandelejmonit në fillimet e tranzicionit shqiptar, për sa u përket rishikimit të teksteve shkollore, u synua spastrimi i tyre nga interpretimet marksiste të historisë. Por, për sa i përket metodologjisë, nuk ka një “paradigmatic shift”, pra, ndryshime në konceptualizimin, metodë, përfshirje ndërdisiplinore të këndvështrimeve dhe analizës historike.

Së fundmi ne si bashkëautorë të këtij vëllimi duam të shprehim një falenderim të veçantë për Fondacionin Konrad Adenauer në Shqipëri dhe ish drejtuesin e tij gjatë periudhës së zhvillimit të konferencës, zotin Dr. Thomas Schrapel dhe drejtorin aktual të fondacionit, Z. Walter Glos, të cilët ishin tepër të gatshëm për bashkëpunim midis fondacionit dhe Departamentit të Historisë të Fakultetit të Historisë dhe Filologjisë dhe njëkohësisht tepër energjikë në organizimin e disa takimeve për mirëmbajtjen e këtij eventit shkencor, por dhe për përgatitjen e këtij vëllimi me punimet e konferencës. Falenderimi i dytë i joni shkon dhe për Znj. Zheni Korçari, koordinatore e fondacioni mbi projektin e organizimit të konferencës, e cila me delikatesën dhe kujdesin e saj deri në detajet më të vogla, bëri që ky bashkëpunim të ishte i sukseshëm dhe i këndshëm.

Një tjetër falenderim shkon për Prof. Dr. Valentina Duka, dekanen e Fakultetit të Historisë dhe Filologjisë, e cila që në fillimet e konceptimit të eventit na nxiti për një bashkëpunim sa më të frytshëm e të sukseshëm në organizimin e kësaj konference.

Së fundmi, falenderojmë të gjithë kontribuesit e konferencës, si dhe autorët e artikujve të përzgjedhur për botim, pa të cilët ky event shkencor dhe ky botim nuk do të ishin bërë të mundur.

Tiranë Prill 2016

Felix Schnell

Universiteti i Essex

Çfarë ishte Stalinizimi?¹

Pa Stalin, s'ka stalinizëm. Mbase këtë fjali do të thoshte Jörg Baberowski, nëse do të mbante këtë referat. Në pamje të parë një thënie e tillë duket banale, por nuk është e tillë. Kjo fjali përmban implikime, që janë të rëndësishme për interpretimin e stalinizmit. Ajo e interpreton stalinizmin si një tirani, që e thënë në mënyrë të thjeshtë, lind nga problemet e perandorisë multi-etnike, por që nuk gjeti rastësisht gjenin e saj negativ tek Stalini. Stalini jo vetëm që provoi, që problemet mund të zgjidheshin duke ushtruar dhunë, por gjeti madje edhe kënaqësi në ushtrimin e saj.

Në përgjithësi së fundmi Stalini është vendosur vitet e fundit gjithnjë e më tepër në qendër të vëmendjes. Biografia e Stalinit nga Stephen Kotkin, vëllimi i parë i së cilës u botua kohët e fundit, është një shembull i mirë për këtë. Në një farë mënyre Kotkin e ka analizuar Stalinin duke e parë nga afër atë. Ai përpiket të kuptojë historinë sovjetike nga perspektiva e Stalinit. Në këtë mënyrë nderohet përsëri ideologjia, e cila ndikoi fuqishëm jo vetëm në këndvështrimin e Stalinit kundrejt botës, por edhe legjimitetin për veprimet e saj. Libri i Kotkin-it shfaqet si një aventurë e guximshme dhe gati revolucionare, nëse marrim parasysh, se përjasja e tij supozon një lloj simpatie sistematike, pa të cilën nuk është e mundur të kuptohet. Dhe një procedurë e tillë hermeneutike është e admirueshme duke marrë parasysh faktin, se strukturalizmi dhe historia shoqërore kanë dominuar kërkimet shkencore për stalinizmin gjatë viteve të fundit. Sipas mendimit tim kjo ka të bëjë pak me “cultural turn”. As Baberowski, as Kotkin nuk do ta

¹ Artikulli i Felix Schnell është manuskripti i kumtesës që mbajti në ditën e konferencës.

quanin veten e tyre historianë kulture – dhe unë besoj se kanë një arsye të fortë për këtë. Edhe vetë Sheila Fitzpatrick, emri i së cilës lidhet si emri i askujt tjetër me revizionizmin dhe historinë shoqërore, në librin e saj të fundit ka bërë një kthesë të habitshme për të: “Ekipi i Stalinit” përqendrohej në qarqet më të ngushta të pushtetit, jo vetëm, por para së gjithash tek byroja politike. Këtu Stalini duket më pak si një despot si tek Baberowski ose si një diktator si tek Kotkin. Fitzpatrick tregon më tepër portretin e një “team leader”, i cili në fakt drejton, por nga ana tjetër drejtohet nga ekipi i tij dhe për këtë arsye duhet ta mbajë byronë politike jashtë rrethit të terrorit. Tek e fundit edhe në librin e Fitzpatrick, Stalini bëhet figurë qendrore. Dhe në fakt nuk duhet të harrojmë, se ajo (Sheila Fitzpatrick) prej disa dekadash ka mbrojtur një interpretim, që i vendoste forcat lëvizëse të stalinizmit si në shoqërinë sovjetike, ashtu edhe në qendrën politike, në mos më tepër tek kjo e fundit. “Stalinizmi nga poshtë”, kështu mund të përmblihet në mënyrë polemike ky drejtim.

Së fundmi dëshiroj të përmend edhe Oleg Khlevniuk, cili kohët e fundit ka paraqitur një biografi për Stalinin, por që nuk përbën ndonjë kthesë. Duke filluar që nga vitet nëntëdhjetë Khlevniuk ka shtjelluar më tej tezën e tij për Stalinin si Khoziain ose “Master of the house”, siç është përkthyer ky term në anglisht. Shkurtimisht: momentalisht Stalini po qëndron aq shumë në qendër të interpretimeve prestigjioze të stalinizmit, sa kurrë ndonjëherë më parë. Pra mund të themi: kulti i individit ka ardhur më së fundi edhe në shkencën e historiografisë? S’ka stalinizëm pa Stalin?

Një arsye për këto zhvillime mund të gjendet tek e tashmja dhe e shkuara më e afërt. Historia pyet gjithnjë duke u nisur nga e tashmja. Dhe ajo ç’ka ne mund të vërejmë prej më shumë se dhjetë vitet e fundit, që është zhvilluar në Rusi është diçka pothuajse e ngjashme me një kult të udhëheqësit dhe një diktaturë post-moderne. Dhe nën regjimin e Putinit, Stalini ka filluar të nderohet në mënyra të ndryshme. Por nuk do të preferoja të thellohesha më tej në këtë pikë, por thjesht ta ngre si një çështje.

Arsyeja e më e rëndësishme është padyshim i ashtuquajti “Revolucioni arkivor” i viteve nëntëdhjetë. Hapja e shumicës së arkivave ruse për kërkimet shkencore perëndimore, por edhe për ato ruse solli me vetë një bum absolut të kërkimit shkencor për stalinizmin. Por jo vetëm kjo. Aksesit tek dokumentet sovjetike, dhe jo vetëm jashtë Moskës si deri tani, ka bërë të mundur që kërkimi i përgjithshëm shkencor të vendoset mbi një bazë më të gjerë. Në këtë mënyrë u krijua mundësia për të thelluar më tej studimet e historisë shoqërore, ndërkohë që ato të historisë kulturore u bënë kryesisht të mundura vetëm nëpërmjet revolucionit arkivor. Por para së gjithash këndvështrimi shkencor mund të shtrohet tani edhe mbi provincën sovjetike, periferinë perandorake dhe jetën e përditshme sovjetike. Që prej viteve nëntëdhjetë është mundësuar një shumëllojshmëri e kërkimit shkencor, që deri në atë kohë ne e njihnim vetëm për shoqëritë dhe kulturat perëndimore. Në këtë mënyrë “u zbuluan” kultura fshatare në Bashkimin Sovjetik, por edhe karakteri i saj perandorak dhe multi-etnik dhe shumë gjëra të tjera. Bashkimi Sovjetik post-stalinist filloi të shihet me një këndvështrim tjetër, veçanërisht epoka e Krushovit. Që prej kolapsit të Bashkimit Sovjetik në një farë mënyre arriti të ndryshojë edhe këndvështrimi mbi perandorinë e së keqes dhe në disa këndvështrime ka pasur dhe zhvendosje të vlerësimeve: nëse për një kohë të caktuar stalinizmi ishte kuintesenca e regjimit bolshevik, sot ekziston një tendencë e caktuar për ta klasifikuar atë si një epokë të veçantë të historisë sovjetike. Revolucioni arkivor në përgjithësi nuk ka sjellë shumë surpriza: ai ka mundësuar kërkime shkencore më të gjera dhe më intensive dhe ka hapur perspektiva të reja. Ne e njohim sot bashkimin Sovjetik më mirë se para tridhjetë vjetësh, por fotografia jonë për të nuk është revolucionarizuar, ne nuk shohim sot një Bashkim Sovjetik tërësisht tjetër, për më tepër shumë gjëra janë konfirmuar, për të cilat më parë mund të spekulohesh vetëm mbi një bazë solide. Sipas mendimit tim kjo gjë vlen në tërësi edhe për stalinizmin. Risetë mbështeten gjerësisht tek përdorimi i ideve dhe modeleve të reja, dhe më pak në gjetjet arkivore mbresëlënëse. Një përjashtim thelbësor në lidhje me të e parqet diçka, që nënkuptohet me shifrën “00447”. Pesë shifra që i njeh gjithkush, i cili është marrë me historinë e stalinizmit. Pesë shifra që

përfaqësojnë një sërë urdhrash, që i paraqitën arkivat në vitet nëntëdhjetë dhe të cilat për më tepër: nuk sollën ndonjë gjë të re revolucionare, por më së shumti konfirmuan supozimet, që ishin shprehur më parë. Këto urdhra, jo vetëm ato me shifrat 00447, por edhe ato me numrat 00485 dhe të tjera, si për shembull urdhrat e citimeve për dekulakizimin prej vitit 1930, kohë në të cilën terrori ishte i organizuar dhe komanduar shumë më fuqishëm nga qendra, shumë më tepër nga çfarë ishte supozuar nga disa revizionistë. Këto dhe disa dokumente të tjera tregojnë edhe se Stalini ka ushtruar ndikim direkt mbi masat e terrorit dhe madje mbi torturat e të burgosurve të veçantë. Në përgjithësi gjetjet e arkivave konfirmojnë gjerësisht, atë çfarë kishte ndërmarrë Sovjetologjia e mbështetur tek teoria e totalitarizmit: Terrori dhe represioni në Bashkimin Sovjetik dhe veçanërisht në stalinizëm janë procese të komanduara dhe të kontrolluar gjerësisht nga sipër, që dilnin nga zyra e Stalinit dhe u zbatuan nga NKVD, pjesërisht në mënyrë burokratike. Së fundmi edhe studimet e David Shearer dhe Paul Hagenlohn në lidhje me policinë sekrete sovjetike kanë konfirmuar këtë paraqitje. Që zbatimi i urdhrave të terrorit në terren çonte herë pas here në situata kaotike, kjo gjë nuk ndryshon gjë në lidhje me këtë fakt.

Por ne nuk kemi thjesht të bëjmë me një kthim në modelet e vjetra të interpretimit dhe teoria e totalitarizmit nuk feston ngritjen e saj të gëzueshme. Në rast se pamja revizioniste e një drejtimi politik mund të ketë pësuar edhe gërvishtje – shumë gjëra, të nxjerra në pah nga Sheila Fitzpatrick dhe revizionistë të tjerë, mund të integrohen patjetër në një pamje të re të përgjithshme. Por edhe duket e qartë se: përgjigja e pyetjeve të mëdha mbi stalinizmin nuk mund të bëhet pa Stalinin. Me sa duket nuk është aspak rastësi, që sistemi politik për të cilin po flasim këtu, mban emrin e udhëheqësit – në kundërshtim me sistemet sunduese të Hitlerit dhe Musolinit. Kjo nuk do të thotë, që këta dy të fundit mund të shkëmbeheshin me njëri-tjetrin, por si në Gjermaninë e nacional-socialistëve, ashtu edhe në Italinë fashiste shoqëria dhe forcat shoqërore luanin një rol më të madh se në stalinizëm. Studimet e Michael Wildt në lidhje me

“komunitetin popullor” ose dhe në lidhje me “Gjeneratën e të pakushtëzuarit” japin dëshmi në lidhje me rastin gjerman. Mbase fillimisht mjafton të kemi parasysh, se në kundërshtim me të ashtuquajturën “Perandori e tretë”, terrori në Bashkimin Sovjetik nuk duhej të fshihej kurrë.

Por le t’i kthehemi pyetjes fillestare: Çfarë ishte stalinizmi? Për këtë, në kërkimin shkencor, ka disa përgjigje, të cilat shpesh nuk mund të sillen në një emërues apo në një nocion të thjeshtë. Më poshtë unë do të përpiqem të jap një përgjigje dhe para së gjithash të pyes, se çfarë ka ndryshuar në fakt gjatë kohës, e cila zakonisht identifikohet me stalinizmin: nga fundi i viteve njëzet deri në vitin 1953. Nocioni i diktaturës fillimisht këtu nuk na ndihmon më tej, sepse diktatura ishte sundimi i bolshevikëve që prej fillimit të tyre. Ajo çfarë ka ndryshuar, ka qenë rrethana, që diktatura e partisë u shndërrua në një diktaturë personale të Stalinit, të cilit tek e fundit i ishte nënshtruar edhe partia. Krahassimi midis Leninit dhe Stalinit siç dihet i ndan shpirtrat nga njëri-tjetri, pjesërisht edhe në historiografi. Për këtë fillimisht duhet të themi se përcaktimi për Leninin si “Diktator” është i pasaktë, edhe pse shumë njerëz dhe madje shkencëtarë e kanë quajtur atë herë pas here si të tillë. Zyrtarisht Lenini ishte anëtar i byrosë politike dhe nuk kishte asnjë post tjetër zyrtar. Por fakt është se Lenini kryesisht e kishte partinë nën kontroll nëpërmjet autoritetit të tij të madh dhe mund ta sillte gjithmonë në kursin e tij, qoftë kjo në çështjen e ardhjes në pushtet në vitin 1917, në vitin 1918, kur Lenini vendosi paqen Brest-Litowski kundër rezistencës masive brenda partisë, ose së fundmi në vitin 1921, kur bëhej fjalë për futjen e “politikës së re ekonomike”. Para së gjithash në dy rastet e fundit, Lenini duhej të përballej me akuzën se ai po shiste apo po tradhtonte revolucionin. Lenini duhej të fliste që të arrinte qëllimin e tij dhe ai fitonte në këto diskutime, sepse ai kishte argumentet më të mira, por para së gjithash edhe sepse ai gjithmonë kërcënonte me tërheqjen e tij të mundshme. Por shumica e bolshevikëve nuk mund ta imagjinonin një parti pa Leninin, edhe kur ata ishin të një mendimi tjetër. Interesant është edhe fakti, se ata që flisnin kundër Leninit, nuk duhet të kishin frikë më pas nga pasojat negative. Si rregull ata nuk humbnin madje as postet, por qëndronin

në pozicionit që kishin dhe Lenini vazhdonte të bashkëpunonte më tej me ta. Por kjo gjë ndryshoi në kohën e Stalinit, i cili në të vërtetë largonte çdo kundërshtar nga pozicioni i tij, e nxirrte nga partia dhe në vitet tridhjetë, në fund e vriste. Stalini u bë, ishte i pari, mbase dhe diktatori i fundit i bashkimit Sovjetik dhe ai e zgjeroi dominimin e tij deri në një regjim despotik personal absolut. Për ironi të fatit Lenini krijoi bazën: duke e bërë Stalinin Sekretar të Përgjithshëm të partisë, një pozicion, që Stalini diti ta shfrytëzoj në mënyrë mjeshtërore; por më tepër mbase nëpërmjet ndalimit të fraksioneve, që ai miratoi në kongresin e 10-të të Partisë së Bolshevikëve, në të njëjtin vit me Politikën e Re Ekonomike. Në atë kohë Lenini e kishte synimin tek e ashtuquajtura “Opozita e punëtorëve”, e cila në një farë mënyre pretendonte, që të përfaqësonte interesat e vërteta proletare dhe revolucionare – ndryshe nga Lenini, që faktikisht fliste për një fuqizim të shtetit në regjimin e luftës civile. Lenini u kthye kundra një platforme, që vinte në dyshim veprimet e vërteta revolucionare. Fakti për të patur mendime të ndryshme ishte njëra anë, por përçarja e partisë, ishte diçka tjetër. Por me sa duket për atë nuk ishte e qartë, se ndalimi i fraksioneve do të mbyllte në të ardhmen çdo lloj diskutimi brenda partisë. Sepse çdo mendim i ndryshëm nga linja e partisë në të ardhmen do të interpretohej si një përpjekje për formimin e fraksioneve dhe përçarjen e partisë – pikërisht kjo ishte taktika e Stalinit gjatë ngritjes së tij në vitet njëzet. Duhet mbajtur parasysh se Lenini ndaloi formimin e fraksioneve, por jo diskutimet brenda partisë, por kjo e fundit vetëm sepse ai mund të ishte i sigurt, se gjithmonë do të dominonte mendimi i tij. E parë në këtë mënyrë, edhe nën udhëheqjen e Leninit nuk kishte një debat me të vërtetë të hapur brenda partisë. Por ai i vendosi atij instrumentet, të cilat gjeorgjiani mund t’i përdorte mbas vdekjes së Leninit. Lenini i bëri pa vetëdije gati rrugën Stalinit. Dhe ka edhe shumë më tepër për të thënë për Leninin, që shpesh harrohet ose anashkalohet. Nuk ishte Stalini që solli dhunën në praktikën revolucionare të bolshevikëve. Edhe në këtë këndvështrim ai shfrytëzoi dhe përforcoi vetëm atë që kishte mbjellë Lenini. Lenini nuk la asnjë dyshim, që filozofia e tij politike mund të sillte në emëruesin e thjeshtë: “Kto kogo” – ose në shqip dhe e perifrazuar: varet se “kush kë” vret të parin:

revolucionarët armiqtë e tyre, apo e anasjellta. Puçi i tetorit u pasua nga arrestime dhe pushkatime të kundërshtarëve politikë ose të personave, për të cilët Lenini dhe bolshevikët supozonin, se ata do të silleshin si armiq kundër puçistëve. Gjithashtu është mjaft e njohur se një nga masat e para të atyre që erdhën në pushtet ishte krijimi i një organi për terrorin revolucionar: Komisioni i Jashtëzakonshëm për Luftën ndaj Kundërrevolucionarëve, Spekulimit dhe Sabotazhit, e ashtuquajtura “Tscheka-ÇEKA” nën drejtimin e Feliks Dzerzhinski. Shumë kohë përpara se sa një kundërrevolucion të ngrinte kokën si organizatë ose si një lëvizje, bolshevikët ndërhynin pa mëshirë. Pikërisht në Petrograd dhe Moskë, ÇEKA kërcënonte pothuajse e pakontrolluar nën udhëheqjen e elitës së dikurshme të perandorisë cariste – në provincë Lenini dhe Dzerzhinskii i linin gjërat të ecnin sipas rastit. Këtu ishin thjesht kriminelë të liruar nga burgjet, të cilët si Çekistë të vetëshpallur bënë gjueti mbi gjithçka, që zotëronte para apo sende me vlerë. Në këto raste rrallë ishte fjala për revolucion. Për sa kohë që vdekja merrte njeriun e duhur, Lenini nuk kishte ndonjë kundërshtim. Komisari i popullit për Drejtësi, revolucionari socialist Steinberg, që protestonte kundër kësaj dhe i propozoi Leninit me sarkazëm, që këtij autoriteti t’ia ndryshonte emrin në “Komisariati i popullit për shfarosje”, mori nga Lenini përgjigjen: se pikërisht aty ai shikonte kuptimin e këtij autoriteti. “Terrori i kuq” mbas atentatit mbi Leninin në vitin 1918 mori krahë dhe terrorizoi gjatë gjithë luftës civile. Askush nuk e di saktësisht, se sa viktima bëri ky terror. Por ajo çfarë dimë me siguri është se Lenini nuk bënte kompromis me trajtimin e armiqve të revolucionit dhe se ai ishte dakord me principin e ÇEKA-s: se jo vepra konkrete e një njeriu është përcaktuese për fatin e tij, por përkatësia e tij klasore - dhe mbështeste praktikën që lidhej me të, për sa kohë që Rusia revolucionare nuk ishte në luftë, apo në luftë civile. Në këtë këndvështrim Stalini ishte një Leninist i praktikuar. Tek kjo temë do kthehemi më pas. Për Leninin njerëzit kishin kuptim vetëm në shumës, në të kundërtën, si individë ose si fate të veçanta, për të nuk kishin kuptim. Dhe ai ishte mjaft i paskrupullt, që t’i mbyste në gjak kryengritjet në Kronstadt dhe në Tambov, që të ngrinte armët kundër atyre, në emrin e të cilëve ishte kryer revolucioni. Dhe si përfundim

dhe diçka për Leninin: ai, i cili ka folur dhe ka shkruar gjithmonë për fundin e shtetit, nxiti fuqishëm shpalosjen e shtetit sovjetik, një lloj “shteti garnizon”, në të cilin nuk kishte më liri revolucionare. Mund të thuhet se: ai nuk kishte zgjidhje tjetër. Bolshevikët nuk mund të kishin mbijetuar ndryshe. Po, kjo mund të jetë vërtet kështu, por në të kundërt do të thotë vetëm se në revolucionin bolshevik nuk ka gjë për të zbukuruar apo për të idealizuar. E megjithatë një gjë mund të thuhet: Lenini qëndroi një pragmatist deri në fund. Dhuna dhe terrori nuk ishin qëllim në vetvete për të: kur përfundoi kërcënimi direkt për shtetin sovjetik në vitin 1921, ai e urdhëroi Dzerzhinski dhe u kujdes, që nga ÇEKA të bëhej GPU e më pas OGPU – një polici e fshehtë në varësinë e këshillit të komisarëve të popullit, e cila u profesionalizua në vitet njëzet dhe do të zhvendosej nga vrasja në mbikëqyrje. Mbas shtatë vitesh luftë, revolucion, luftë civile dhe uri, Lenini i përcaktoi vendit të tij një kohë të rëndësishme qetësie. Por Lenini la pas shumë çështje të pazgjidhura. Revolucioni kishte mbetur i kufizuar në qytete, kishte kapitulluar para fshatit. Perandoria e bolshevikëve ishte një arkipelag i kuq në një oqean me tradita fshatare. Lufta civile kishte lënë pas një parti të mësuar me dhunë, që e kishte arritur me luftë fitoren në luftën civile, por që tani duhet të dilte pas ekspertëve, pa të cilët do të ishte i pamundur rindërtimi i vendit. Dhe Lenini, që ishte ndoshta një lloj “Udhëheqësi”, po kurrë një diktator i vërtetë, i kishte krijuar ndoshta pa dashur bazat për një diktaturë. Ndër të tjera ai la pas një parti, që ishte mësuar me një figurë udhëheqësi, me dikë, që përcaktonte kursin ose që fliste fjalë vendimtare në diskutime. Mund të ketë të ngjarë që Leninit kjo gjë iu bë e qartë gjatë muajve të tij të fundit, ose ambientit të tij rrethues, para së gjithash gruas së tij Nadezhda Krupskaja. Kushdo që do ta ketë hartuar testamentin e tij të famshëm, që fliste për mënjanimin e Stalinit dhe për nevojën për ta larguar atë nga detyra e Sekretarit të përgjithshëm – kjo ishte shpata e Demokleut, që varej në vitet që pasuan mbi kokën e Stalinit. Por në mënyrë paradoksale ky testament jo vetëm që nuk e ka dëmtuar, por ndoshta edhe e ka ndihmuar atë në një këndvështrim afatgjatë. Ky testament e ka vendosur atë mbas vdekjes së Leninit nën një presion të vazhdueshëm, që të largohet nga qendra e pushtetit. Ka të ngjarë që mënyra pa kompromis

që Stalini vazhdoi të praktikonte më tej për të përforcuar pozicionin e tij personal, mund të justifikohet me kërcënimin me të cilin ai u ndesh në mesin e viteve njëzet. Mbase mund të shkojmë edhe më tej e të themi se Stalini e pa veten e tij në një gjendje të jashtëzakonshme permanente, nga e cila ai besonte se mund të çlirohej vetëm nëpërmjet sulmeve ndaj konkurrentëve të tij. Dhe mbase ishte testamenti që e detyroi atë hiqte dorë nga solidariteti me udhëheqësin tjetër të bolshevikëve. Tek e fundit Stalini përmbushte një vakum që u krijua nga vdekja e Leninit. Por ai e mbushi atë në një mënyrë tjetër. Stalini nuk ishte një guru i një sekti politik. Stalini u kthye në një sundues të vetëm dhe ai mbështetej më pak tek partia, të cilën ai e dobësoi nga fuqia dhe më vonë u bë edhe vetë objektiv i terrorit, por më tepër mbështetej tek shteti sovjetik. Por gjithsesi nuk duhet të harrojmë, që Stalini ishte jo vetëm një marksist i formuar, por edhe një njohës i shkëlqyer i veprave të Leninit. Marksizëm-Leninizmi ishte një krijesë e Stalinit dhe Stalini në diskursin e bolshevikëve mori në një farë mënyre rolin e një komentatori të jashtëm të plotfuqishëm, i cili vendoste në fund në lidhje me interpretimin e duhur të mësimave të Leninit. Mbas vdekjes së Stalinit ky pozicion nuk mund të merrej nga dikush tjetër – dhe kjo sipas Anatoly Yurchak ishte arsyeja kryesore për ngrirjen ideologjike në socializmin e mëvonshëm.

Tipari më dallues i stalinizmit sipas mendimit tim është gjendja e jashtëzakonshme permanente, në të cilën e vendosi Stalini vendin e tij që prej fundit të viteve njëzet. Sundimi mori formën e fushatës dhe objektivat ambiciozë, që ishin lidhur me të, e bënë të pashmangshme dhunën si mjet për arritjen e këtyre objektivave. Dhuna nuk ishte diçka e re për bolshevikët, por nën regjimin e Stalinit ajo mori një dimension të ri. Ajo u bë instrumenti qendror i bolshevikëve. Në çdo moment që ata hasnin në rezistencë, ata e goditnin atë me dhunë. Nën regjimin e Stalini nuk kishte më kompromise. Fushata e parë e stalinizmit, kolektivizimi i bujqësisë sovjetike, ishte jo vetëm një transformim me dhunë i fshatit dhe i botës fshatare, por mund të kuptohet edhe si një rikthim i luftës civile. Bolshevikët vazhduan më tej aty ku kishin dështuar në fillim

të viteve njëzet. Bolshevikët i kishin mundur të gjithë kundërshtarët e tyre në luftën civile, por komunizmi luftarak, me anë të cilit duhej të revolucionarizohej fshati sovjetik, kishte dështuar. Bolshevikët u detyruan të bënin një kompromis të dhimbshëm. Një gjë e tillë nuk do të ndodhte më nën regjimin e Stalinit. Në Dhjetor të vitit 1929 Stalini shpalli “Eliminimin e kulakëve si klasë” dhe në fillimi të vitit 1933 lëshoi urdhrin për të ashtuquajturin “Dekulakizim”. Këta kulakë u ndanë në tre klasa, shumica e tyre u internuan dhe pjesërisht u pushkatuan. Ky ishte “urdhri i parë i kuotimit”, që më pas u pasua edhe nga urdhra të tjerë. Një pjesë e caktuar e popullit duhej të përndiqej si “Kulakë” – gjithsej pothuajse dy milion njerëz. Kjo u bë pa marrë parasysh pyetjen, nëse bëhej fjalë vërtet për “armiq” të rendit sovjetik, apo thjesht fshatarë të pasur, që shfrytëzonin të tjerët. Për aq sa dimë ne, në fund të viteve njëzet, pothuajse nuk kishte më kulakë në fshat, por shumica e fshatarëve ishte kundër futjes së kooperativave. Nëse në fillim bolshevikët përpiqeshin ende t’i arrinin qëllimet e tyre nëpërmjet propagandës, ata shumë shpejt filluan që t’i detyronin fshatarët me zor të futeshin në kooperativa. Por fshatarët filluan të bënin rezistencë. Në mars të vitit 1920 bolshevikët humbën kontrollin në shumë pjesë të Ukrainës. Artikulli i famshëm në gazetë i Stalinit në lidhje me “marrjen e mendëve nga sukseset” kishte dhënë ndikimin e vete për këtë rezistencë. U desh të vinte vera deri sa gjendja u mor përsëri nën kontroll. Si rrjedhojë bolshevikët vazhduan dhunën në mënyrë sistematike dhe konfiskonin drithërat e fshatarëve nëpërmjet blerjeve. Blerja me dhunë e drithërave solli më tej si pasojë një mangësi dramatike në furnizim në të gjithë vendin dhe në vitet 1932-33 solli së fundmi edhe të ashtuquajturën “uri të madhe”, nga e cila gjetën vdekjen miliona njerëz në Ukrainë. Për këtë ka një debat të vazhdueshëm, nëse në këtë rast bëhet fjalë për një gjenocid ndaj popullit ukrainas – përkrah diasporës ukrainase në Amerikën e Veriut kjo tezë e “Holodomor” mbrohet para së gjithash edhe nga Norman Naimark dhe Timothy Snyder. Por shumë pjesë të kërkimit shkencor e shikojnë në mënyrë skeptike. Edhe në rajone të tjera bolshevikët vepruan në mënyrë të ngjashme dhe pa marrë parasysh asgjë duke shkaktuar gjithashtu katastrofa urie në popullin rus. Gjithsesi numri më i madh i viktimave u shënuar në

Kazakistan, që humbi një të tretën e popullsisë. Në shumë këndvështrime kolektivizimi ishte një dështim. Humbja e jetës së njerëzve, kafshëve dhe fuqisë prodhuese ishte e madhe dhe bujqësia sovjetike nuk do të rimëkëmbej më përsëri nga kjo goditje. Por në fund Stalini dhe bolshevikët mundën t’ia dalin. Më së fundi ata e mposhtën dhe fshatin. Që në kohën e kolektivizimit mund të vihej re diçka, që kishte rëndësi për më vonë dhe do të bëhej një tipar dallues i stalinizmit: konkurrenca midis udhëheqësve të ndryshëm rajonalë, që synonin të arrinin fillim objektivat pjesërisht jo realistë. Kolektivizmi ishte në një farë mënyre edhe ora e lindjes së Gulag-ut, sepse ai prodhoi valën e parë të madhe të punës së detyruar, me ndihmën e së cilës do të lidheshin edhe zonat me popullsi me numër të ulët në Veri të Bashkimit Sovjetik. Tek e fundit kolektivizimi ishte edhe një triumf personal i Stalinit. Ai kishte ruajtur qetësinë edhe gjatë periudhave të vështira dhe kishte mbajtur fort kursin e tij. Ajo ishte për të edhe prova e parë e madhe dhe përcaktuese si udhëheqës i bolshevikëve. Stalini po dukej gjithnjë e më shumë i domosdoshëm. Ai u bë aq i domosdoshëm, sa anëtarët e tjerë të Byrosë politike në Verën e vitit 1941, mbas sulmit gjerman, shkuan tek banesa private e Stalinit dhe kërkuan udhëheqësin – dhe kjo, edhe sepse tek e fundit ishte gabimi i Stalinit që çoi aty, sa që sulmi në Qershor 1941 e gjeti Bashkimin Sovjetik tërësisht të papërgatitur. Por le t’i kthehemi fillimit të viteve tridhjetë. Mësimet që nxori Stalini nga kolektivizimi, mund të interpretoheshin në mënyrë të tillë, që fushatat dhe gjendja e jashtëzakonshme permanente ishin më të përshtatshme për të siguruar pozicionin e tij të pushtetit. Shoferi nuk mund të hidhet nga makina në lëvizje, në rast se nuk duam të shkaktojmë ndonjë aksident. Sa më shumë që të jetë sistemi nën stres dhe të jetë në lëvizje, aq më i rëndësishëm është udhëheqja e vendosur. Por megjithatë nuk duhet të anashkalojmë: kolektivizimi, lufta kundër fshatarëve ose e thënë ndryshe: Shumica e popullsisë përbënin një rrezik të madh për bolshevikët. E parë në retrospektivë fitorja e bolshevikëve nuk shkaktoi habi, por askush nuk mund ta dinte atëherë. Nuk kishte shembuj historikë për kolektivizmin dhe nuk kishte aleatë të jashtëm, ku mund të mbështeteshin. Bashkimi Sovjetik mbase nuk ishte vendi i kërcënuar nga kapitalizmi ndërkombëtar, siç e shikonin apo dëshironin

ta shikonin disa. Por Bashkimi Sovjetik qëndronte i vetëm. Por për bolshevikët nuk ekzistonte opsioni i rënies. Stalini rrezikoi gjatë kolektivizimit shumë gjëra: pozicionin e tij, ndoshta edhe sundimin e bolshevikëve dhe revolucionin socialist në përgjithësi. Me këtë dua të them se ky ishte një tipar tjetër dallues i stalinizmit. Sociologu gjerman, Ulrich Beck, ka publikuar para disa vitesh një libër, që shkaktoi vëmendje të madhe dhe u bë shkak për shumë diskutime: “Shoqëria e riskut”. Në këtë libër bëhet fjalë për fenomenin, që vendet kryesore të industrializuara që prej Luftës së Dytë Botërore gjithnjë e më tepër dhe në mënyrë sistematike fusin dhe përdorin teknika, pasojat e të cilave nuk është menduar deri në fund – por madje mund të thuhet se ato janë neglizhuar sistematikisht. Arsyeja për këtë është një element i njohur nga teoria e lojës: nëse nuk e di, se çfarë bëjnë të tjerët, është më mirë të fusësh një teknologji të rrezikshme, edhe nëse nuk je në gjendje t’i vlerësosh pasojat. Në stalinizëm shikojmë diçka të ngjashme. Në një farë mënyre ishte një strategji e rrezikut, që nuk lejonte të dështojë dhe për këtë arsye përmbante përdorimin masiv të dhunës. Bolshevikët operonin me fushatat e tyre në territore të panjohura më parë. Dhe, nëpërmjet fushatave të tilla, sistemi stalinist e shfaqte veten e tij në situata të jashtëzakonshme, në përgjithësi permanente. Sipas mendimit tim kjo është një veçori e stalinizmit, një lloj tipari dallues unik. Më vonë do të flas edhe për shtetet satelitore të vendeve të Evropës Lindore, por tani dëshiroj të theksoj edhe diçka tjetër. Asnjë regjim tjetër komunist nuk e pa veten e tij në një situatë të krahasueshme – as edhe komunistët kinezë, të cilët, siç e dimë të gjithë, nga shumë këndvështrime kanë mësuar nga bolshevikët dhe u mbështetën në eksperiencat e tyre. Prandaj stalinizmi sipas mendimit tim është i jashtëzakonshëm. Prandaj është problematike përdorimi i këtij nocioni në raste të tjera.

Mbas kolektivizimit Stalini ndërmoi hapin e fundit vendimtar, për të çimentuar sundimin e tij, por edhe për të vendosur mbi një bazë të fortë praktikën e sundimit sovjetik: reforma e NKVD. Në vitin 1934 shërbimi sekret (OGPU) dhe Ministria e brendshme (NKVD) u bashkuan në një autoritet super të fuqishëm. Ato mbajtën emrin e Ministrisë së brendshme, por që tani

praktikisht ishte nën kontrollin e policisë sekrete sovjetike. NKVD-ja e re kontrollonte jo vetëm të gjitha organet ekzekutive, por përmbledhte edhe administrimin shtetëror të kampeve të quajtura “Gulag”. Sistemi i punës së detyruar ishte zhvilluar vazhdimisht që në fillim të viteve tridhjetë. Si fillim e nisi me vendbanimet e veçanta në Veriun e largët, nga mesi i viteve tridhjetë u shtuan edhe komplekset e kampeve, që strukturonin rajone të tëra. Me futjen e kolektivizimit bolshevikët në një farë mënyre kishin futur përsëri varësinë, ndërsa me Gulag nga ana tjetër kishin futur një formë të re të skllavërisë. NKVD-ja nuk ishte vetëm një aparat represioni, por edhe një lloj agjencie për zhvillimin ekonomik: Magadan, Noril’sk ose Workuta ishin krijesat e saj, që nuk do të kishte qenë e mundur të krijoheshin pa punën e detyruar. Gulag është një nga ato fusha, për të cilat dimë më shumë se më parë, që prej revolucionit arkivor – në përgjithësi historia e tyre në përfundim mund të shkruhet mbi baza solide vetëm mbas viteve nëntëdhjetë. Numri i banorëve të kampeve dhe i vend-banuesve të veçantë ndryshonte, por që prej mesit të viteve tridhjetë në këtë sistem janë gjendur afërsisht rreth katër milion njerëz. Duke qenë se shpesh bëhen krahasime midis sistemeve të kampeve sovjetike dhe të nacional-socialistëve, me këtë rast duhet të theksohet qartë, se Gulagët në radhë të parë nuk shërbenin për të vrarë njerëz. Për më tepër kishin si qëllim që të vinin në dispozicion fuqi punëtore të lirë dhe të disponueshme për projektet e mëdha sovjetike. Në të njëjtën kohë ndodhi pa marrë parasysh humbjet: kush nuk mund ta mbante dot ritmin e punës, futej në grupin e racionit të kufizuar dhe herët a vonë merrte fund. Jeta e njerëzve kishte pak rëndësi në Bashkimin Sovjetik të Stalinit. Por në këtë këndvështrim – dhe këtë dëshiroj ta nënvizoj – logjika e Stalinit nuk ndryshonte në thelb nga ajo e Leninit. Vdekshmëria në Gulag ishte e lartë, por ajo ndryshonte shumë nga njëri vend në tjetrin dhe në kohë të ndryshme. Përveç kësaj indiferenca e sistemit binte edhe mbi njerëzit jashtë Gulag-ut. Ky sistem gjigant i kampeve zhvillonte një uri të vazhdueshme, ku gjithmonë kishte viktime të reja. Këto njohuri na hedhin një dritë tjetër mbi fushatat e ndryshme të terrorit të viteve tridhjetë. Në rast se Gulag-u filloi në fillimet e viteve njëzet në Solowki si instrument për mënjanimin e armiqve, në këtë mënyrë mund të krijohet përshtypja, se në vitet tridhjetë

gjithnjë e më tepër u sajuan kategori të reja të armiqve, për të ushqyer mostrën Gulag. Vetë dekulakizimi në këtë këndvështrim është interpretuar si masë, që merrej, jo vetëm për të mënjanuar armiqtë, por në të njëjtën kohë edhe për të prodhuar punëtorë të punës së detyruar. Por siç ndodh shpesh në histori, mbase nuk është nevoja që të vendosësh për një shkak ose për një motiv. Gulag-ët dhe fushatat e terrorit plotësonin njëri-tjetrin dhe qëndronin në një ndërrvarësi reciproke.

Kjo gjë bëhet veçanërisht e qartë në fushatën që u ndërmor në vitet 1934 deri 1936 në qendrat urbane të Bashkimit Sovjetik dhe ndër të tjera drejtohej kundër të ashtuquajturave “elementë socialë”. Nga fshati terroi u zhvendos në qytet. Kjo ishte fushata e parë e madhe e NKVD-së së re, që kishte si qëllim, që të “pastronte” qytetet nga njerëzit, që ishin larguar nga vendbanimet e veçanta, por edhe për ata, që nuk kishin një punësim të rregullt. Njerëzit a arrestuar gjatë reprezaljeve të NKVD-së si rregull u internuan menjëherë. Këtu u ndeshën qëllime të ndryshme: mënjanimi i armiqve potencialë të rendit sovjetik, por edhe të atyre që nuk shërbenin nga këndvështrimi ekonomik. Kjo e fundit nuk ishte aspak një gjetje staliniste – e ashtuquajtura “grupi i të varfërve”, internimin e lypësve dhe të endacakëve e gjejmë edhe në shumicën e vendeve të Evropës Qendrore dhe Perëndimore deri në shekullin e nëntëmbëdhjetë. Por metoda staliniste i tejkaloi shembujt e mëparshëm në mënyrë sasiore dhe në këndvështrim të egoizmit me të cilën është zbatuar. Nga këndvështrimi autokritik qytetet u bënë më të sigurt, të çliruar nga ana ekonomike dhe tek e fundit fitoheshin më shumë punonjës të punës së detyruar. Fushatës së terrorit në qytete nga viti 1934 deri në vitin 1936 nuk mund t’i heqim një logjikë të sistemit. Por nga ana tjetër nuk duhet të harrojmë, se Bashkimi Sovjetik i fillimit të viteve tridhjetë karakterizohej nga kaosi social, që nuk shqetësonte vetëm Stalinin. Vendosja me dhunë e rregullit në shoqëri ishte, para së gjithash mbas kolektivizimit, në krye të axhendës. Kjo dallohet edhe në faktin, se vitet nga 1934 deri 1936 ishte ajo periudhë, gjatë së cilës drejtësia sovjetike mundi të marrë deri diku seriozisht parimin e të ashtuquajturës “ligjshmëria

socialiste”. Në këtë kohë NKVD-ja e re pati kohën e saj të provës dhe e zgjidhi përfundimisht partinë si qendër politike. Stalini e kishte përdorur partinë për ngritjen e tij, por e kishte dobësuar më pas atë në mënyrë sistematike që prej fundit të viteve njëzet. Forumet e partisë u bënë të pakuptimta, në mënyrë që ato të ishin të afta të vepronin, Komiteti qendror mbledhej gjithnjë e më rrallë, kongreset e partisë zhvilloheshin në distanca gjithnjë e më të mëdha. Dobësimi i partisë i përgjigjej vlerësimit paralel të NKVD-së. Në vitet tridhjetë Stalini sundonte nëpërmjet një partie, që nuk kishte më gjë për të thënë dhe një shtet, që e kishte qendrën e tij të vërtetë tek Ministria e Brendshme.

Që me vrasjen e Kirov-it në vitin 1934 dhuna e NKVD-së filloi të drejtohej edhe kundër partisë, por vetëm nga mesi i viteve tridhjetë ky proces fitoi shpejtësi dhe gjerësi. Terrori në parti, që kulmet e dukshme i pati gjatë proceseve publike dhe që çoi në eliminimin fizik të gardës së vjetër të partisë, ishte një proces, që përfundoi pothuajse në shkatërrimin e të gjithë aparatit. Gati tre nga katër anëtarët e Komitetit qendror, që ishin mbledhur në Plenumin e shkurt-marsit, u vranë gjatë muajve pasardhës. Organizata të tëra partie në provinca u asgjësuan tërësisht. Tek baza e partisë ky terror zvogëlohej, por ai zemëronte deri në qelizën më të vogël të partisë. Terrori në parti u shoqërua prej vitit 1937 nga një fushatë terrori, që vendoste në hije gjithçka që ekzistonte deri në atë moment. Cilësia e re e “terrorit të madh” dallohet qartë para së gjithash në kategorinë e saj qendrore: tek “armiku i popullit”. Deri në atë moment armiq të superfuqisë sovjetike në radhë të parë ishin përkufizuar sipas kriterit të klasave. “Ishët” si emërtim i shkurtër për pjesëtarët e elitës së dikurshme cariste, “gardistët e bardhë”, “Petlurovcy” ose “Machnovcy”, me të cilët nënkuptoheshin pjesëtarët grupeve nacionaliste dhe anarkiste, ose tek e fundit edhe “kulakët” si një klasë shfrytëzuese e fshatarësisë. Nëse këto kategori kishin kuptim në shoqërinë sovjetik ose jo – ato së paku hoqën një kriter racional, që ishte gjetur në “terrorin e kuq”: Përkatësia klasore. Por kategoria e “armikut të popullit” nuk rezervohet as para proletariatit, ajo ishte pa kufi dhe bënte, që pa përjashtim çdo kush mund të ishte armik i

popullit. Rreth 800.000 njerëz u vranë direkt gjatë kohës së “terrorit të madh”, qindra mijëra të tjerë e internuan në kampe. Mund të thuhet se kategoria e armiqve të popullit reagoi mbi këtë gjendje, që në Bashkimin Sovjetik të viteve tridhjetë nuk kishte më armiq klasikë të klasës, në vend të tyre kishte më tepër armiq të maskuar dhe të fshehur, që bënë fshehurazi “punë sabotuese”. Megjithatë kategoria e armiqve të popullit i ofronte shumë njerëzve edhe mundësinë, që të asgjësonin armiq personalë nëpërmjet denoncimeve, të eliminonin konkurrentët ose thjesht të përforconin pozicionet e tyre, apartamentet dhe pasurinë. Revizionistët nga kjo kanë nxjerrë përfundimin, se terrori në përgjithësi ka qenë një proces nga poshtë. Rastet që u ofroheshin qytetarëve të thjeshtë sovjetikë e bënë terrorin po aq të madh, si dhe dëshmitë e detyruara nga torturat e burgjeve të NKVD-së, të cilat prodhonin gjithnjë e më tepër të dyshuar dhe anëtarë të supozuar të grupeve konspirative. NKVD-ja nën drejtimin e Yezhov-it në fakt nuk bëri gjë tjetër, veçse zbuloi gjithnjë e më shumë armiq të supozuar dhe i bënte të padëmshëm: sepse ishte detyra e saj dhe se gjithçka tjetër do të provokonte pyetjen, në mos kishte armiq edhe tek vetë NKVD-ja. Si edhe gjatë kolektivizimit, pati një konkurrencë të paparë të plotësimin dhe tejkalimin e kuotave: “Terror by Quota” titullohet një libër i Paul Gregory, që shpjegon këtë mekanizëm sipas teorisë së lojës. Mbas shkatërrimit të partisë pasoi shkatërrimi i trupës së oficerëve. Heroi i luftës civile Tukatschewski ishte tani viktima më e njohur e kësaj fushate speciale – edhe këtu u vranë pothuajse 80% e gjeneralëve të Ushtrisë së kuqe. Terrori nuk u kursye edhe kundër vetë NKVD-së. Shumë “çeksitë“, që kishin shërbyer prej vitesh, por edhe disa të ardhur të rinj u pushkatuan nga viti 1937 deri në vitin 1939. Ndërsa në vitin 1938 pati një rënie të treguesve të prodhimit në industri dhe industrializimi filloi të paralizohej në të gjithë vendin, Stalini e përfundoi “Terrorin e madh” pothuajse duke shtypur butonin.

Pyetja në lidhje me rëndësinë e “Terrorit të madh” është trajtuar gjithmonë nga historianët. Shumë irracional duket fakti, që dhuna dhe terrori në Bashkimin Sovjetik është shfaqur

pikërisht në atë kohë, kur pozicioni i Stalinit si diktator ishte gjerësisht i siguruar dhe në përgjithësi as që nuk bëhej fjalë, që Bashkimi Sovjetik të ishte i kërcënuar nga armiq të brendshëm të panumërt. Dhe çfarë mund të bëhet me një gjendje, që në një situatë kur lufta në Evropë ishte gjithnjë e më e mundur, të vriteshin oficerët më të aftë? Që të vriteshin në masë inxhinierë dhe teknikë, që nevojiteshin shumë për ndërtimin dhe funksionimin e industrisë? Getty dhe Naumov kanë parashtruar tezën, se Stalini dhe udhëheqja e bolshevikëve kishin merak, se mos humbnin zgjedhjet e sovjetikëve, që ishin paralajmëruar nëpërmjet Kushtetutës së vitit 1936. Ata dëshironin të çliroheshin nga një normalizim politik i të gjithë kundërshtarëve politikë. Por a është e imagjinueshme, që Stalini të kishte frikë nga një disfatë në zgjedhje? Joerg Baberowski është i mendimit, se Stalini kishte bërë dhunën pjesë të normalitetit dhe ai në fund të viteve tridhjetë dëshironte të çaktivizonte “një herë e përgjithmonë” çdo kërcënim të mundshëm të pozicionit të tij. Terrori i madh në një farë mënyre ishte dëshmia për pushtetin e tij pothuajse të pakufizuar, që nuk mund të dëshmohej në mënyrë tjetër, veçse nëpërmjet vrasjeve masive. Fushatat, gjendja e jashtëzakonshme permanente dhe dhuna ishin bërë racionaliteti i Stalinit dhe i sistemit. Vetëm kur kërcënohej në përgjithësi jetëgjatësia e sistemit, Stalini bënte një tërheqje të vogël. Por nuk duhet të harrojmë, se Terrori i madh nuk ishte aspak fundi i terrorit në Bashkimin Sovjetik dhe as i Gulagut. Pikërisht në vitin 1938, ndërkohë që edhe shumë miq të NKVD-së kishin humbur jetën e tyre, filloi i ashtuquajti “Operacion kombëtar”. Terrori u bë përsëri më konkret, tani mori dhe një objektiv të përcaktuar etnik. Qindra mijëra polakë, gjermanë, lituanëzë, estonezë, letonezë, ukrainas dhe të tjerë u deportuan deri në vitin 1941. Në këtë rast mund të flasim edhe për “spastrim etnik”, që kishte nisur para fillimit të sulmeve gjermane në zonat perëndimore të pushtuara të Bashkimit Sovjetik. Edhe gjatë luftës kjo u vazhduar më tej – në këtë kohë ajo përfshiu edhe tatarët, çeçenët dhe igushët. Stalini, kështu mund të thuhet, mund të ndjehej i sigurt, për sa kohë që NKVD-ja kërkonte armiq, i gjente ata dhe i asgjësonte. Michael Ellman ka sjellë një herë në diskutim fenomenin psikologjik të “pasqyrimin”: Stalini projektonte tiparet e personalitetit të tij tek të tjerët dhe në

këtë mënyrë ai shikonte tek të tjerët, çfarë dhe si ishte ai vetë. Dhe natyrisht që ai e dinte, se sa fatkeqësi dhe dhimbje kishte sjellë ai tek miliona njerëz. Ai preferonte ta justifikonte këtë në mënyrë “marksiste”, por mund të hamendësohet në mënyrë racionale, se ai kishte krijuar po aq armiq, sa dhe kishte asgjësuar. Dhe në një farë mënyre kjo vlente edhe për vetë sistemin në tërësi, që i nxiste njerëzit në mënyrë çnjerëzore, por nuk u ofronte atyre asnjë shpërblim material. Në një situatë të tillë dhuna mund të duket si e pashmangshme.

Kur Ushtria e Kuqe pushtoi gjysmën e Evropës nga fundi i Luftës së Dytë Botërore, ajo solli me vete edhe sundimin sovjetik në Evropën Qendrore dhe Lindore. Anne Applebaume e ka përshkruar së fundmi këtë proces në një mënyrë shumë impresionuese. Sunduesit e ardhshëm të këtyre shteteve satelitore ishin shkolluar dhe formuar në Bashkimin Sovjetik. Në këtë kuptim të thjeshtë ata, ashtu si edhe policët e ardhshëm të policisë sekrete të këtyre shteteve ishin “stalinistë”. Megjithatë mua më duket e gabuar, që të quhet “stalinizëm” gjithçka që u krijua mbas Luftës së Dytë Botërore nga Deti Balltik deri në Ballkan. Këto krijesa “staliniste” qeverisën me ndihmën e ekspertëve sovjetikë të NKVD-së dhe ata përdorën pjesërisht represionet brutale, për të fuqizuar kontrollin e tyre mbi shoqëritë përkatëse. Por ndryshe nga bolshevikët e viteve njëzet dhe tridhjetë ato gjendeshin në një situatë të privilegjuar. Ata kishin mbështetje nga jashtë dhe e dinin, që socializmi funksiononte. Ata nuk kishin nevojë të bënin luftë kundër popullit të tyre, vendin që zotëronin, nuk kishin nevojë ta pushtonin. Atë tashmë e kishte bërë për ta Ushtria e kuqe. Pa dashur t’i banalizoj regjimet e krijuara në Evropën Qendrore dhe Lindore, besoj se duhet të konstatojmë, se ato në krahasim me shembullin e bolshevikëve mund të konsiderohen pothuajse të padëmshëm. Numri i të vdekurve të shkaktuar prej tyre dhe dhuna që ata ushtruan, nuk mund të krahasohet me dimensionet sovjetike. Më tepër e krahasueshme mua më duket diçka, të cilën e ka trajtuar Stephen Kotkin në librin e tij “Magnetic Mountain” dhe që e quante “civilizimi stalinist”: një gjendje, në të cilën në publik mund të flitej vetëm sipas rregullave të diskursit komunist dhe gjithçka tjetër ishte e destinuar

për dhomat e vogla private. Dhe nëse shikojmë së fundmi se në sa mënyra të shumëllojshme regjimet komuniste në Evropën Lindore dhe Qëndore janë ndikuar nga veçoritë e tyre kulturore – Diktatura SED teknokrate e RDGJ-së, Polonia komuniste nëpërmjet ndikimit të pathyeshëm të Kishës katolike dhe shumë më tepër – nuk mund të themi, se atje mund të ketë ndodhur edhe diçka e krahasueshme si në Bashkimin Sovjetik, ku bolshevikët u morën njerëzve traditën dhe iu imponuan atyre me dhunë një mënyrë të re jetese.

Monumentet dhe portretet e Stalinit nuk bëjnë stalinizëm, aq më pak polici sekrete të plotfuqishme dhe censurë, që bëjnë pjesë tek instrumentet edhe të diktaturave të tjera. Stalinizmi, sipas mendimit tim është një strategji rreziku, krijimi i diçkaje moderne negative ose të errët, që bazohet në shkatërrimin e traditave dhe kockat e miliona njerëzve. Në këtë këndvështrim askush nuk mund të krahasohet dot me Stalinin dhe Bashkimin Sovjetik – dhe një gjë e tillë nuk duhet të kuptohet si kompliment.

Paolo Rago

Universiteti "Marin Barleti"

Linjat kryesore të komunizmit të Enver Hoxhës

Para se të filloj ta shpalos kumtesën time, "Linjat kryesore të komunizmit të Enver Hoxhës", më duket e rradhës të bëj një hyrje të domosdoshme, e cila mund të përmbliidhet në faktin që vetë kumtesa nuk do t'i sosë të gjitha aspektet e çekura në titull. Faktikisht, për të shqyrtuar më së miri argumentin e sipërpërmendur, do të kishte nevojë për një studim më të hollësishëm të politikës totalitare të zbatuar me vendosmëri në çdo aspekt të jetës së brendshme të vendit, si dhe për marrëdhëniet ndërkombëtare të mbajtura nga Shqipëria qysh nga përfundimi i Luftës së Dytë Botërore. Kështu që, duke mos pasur në dispozicion kohën e nevojshme për t'i analizuar të gjitha faktet dhe elementet që karakterizuan një periudhë pothuajse pesëdhjetëvjeçare të historisë shqiptare, ndërhyrja ime do të ketë parasysh vetëm ato pika kryesore, që përshkruajnë në mënyrë më të pakundërshtueshme veçoritë e një regjimi të bazuar te kulti i theksuar i individit dhe te asgjësimi i lirisë vetjake, në të gjitha aspektet e tyre.

Pëveç kësaj, jam më se i sigurt që Enver Hoxha duhet trajtuar, për mirë apo për keq, si një nga personalitetet më të rëndësishme që zunë vend në skenën politike të vendit, që nga koha e shpalljes së pavarësisë së Shqipërisë. Me sapo thashë, nuk dua në asnjë mënyrë të shpreh ndonjë gjykim pozitiv për figurën e diktatorit dhe, aq më pak, të bëhem pré e ndonjëfarë malli, i cili për arsye objektive, as që nuk më takon fare. E megjithatë, cilido qoftë gjykimi për njeriun dhe politikanin Enver Hoxha, do të ishte gabim të mos i jepej rëndësi ndryshimit rrënjësor që pësoi Shqipëria pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore. Atë kohë vendi mori një dukje më moderne dhe hyri në marrëdhënie më të shumta me botën e jashtme, më shumë nga ç'kishte ndodhur deri atëherë.

Lidhur me këtë, studiuesja italiane Emanuela Fabretti shkruan: “Regjimi i Hoxhës, në përpjekjen për të vendosur një kohezion të brendshëm që do të sillte ndërtimin e një shteti kombëtar (nëpërmjet frymës së ndezur nacionaliste), solli gjithësesi një zgjerim të pushtetit shtetëror, një përmirësim në drejtim të një homogjeniteti shoqëror dhe krijoi një sistem *welfare*-i minimal për të gjithë. Gjithashtu, u shënuan përparime në sektorin e arsimit dhe shëndetësisë, si dhe në emancipimin e gruas, e nevojshme për sistemin prodhues”¹ (Fabretti, 1997: 193). Pra, në dyzet e pesë vjet diktaturë u bë i mundur, për herë të parë në historinë shqiptare, formimi i një shteti që, sado i dhunshëm dhe çnjerëzor, që në gjendje të dallohej për një subjektivitet të ravijëzuar.

Ndër hapat më kuptimplotë të ndërmarrë gjatë atyre viteve, vlen të kujtojmë zhdukjen e latifondeve dhe shfuqizimin progresiv të pronës private që u pasua nga kolektivizimi i bujqësisë, e organizuar në kooperativa shtetërore. Lidhur me këtë, historiani shqiptar Kristo Frashëri rendit një varg suksesesh të arritura nga regjimi komunist: “zhdukja brenda një dhjetëvjeçari e analfabetizmit, ndërtimi i shkollave tetëvjeçare në çdo rreth, hapja e shkollave të mesme. Elektrifikimi i plotë i vendit duke filluar nga viti 1972 [...] hapja e spitaleve [...] dhënia e një ndihme mjekësore falas, zhdukja e malaries dhe e sifilizit, zhvillimi i arteve dhe sportit, bonifikimi i tokave dhe tharja e kënetave, ndërtimi i komplekseve industriale dhe hekurudhave” (Frashëri 1996: 51-52). Të tilla suksese u arritën objektivisht, edhe pse duhet kujtuar që në çastin e ardhjes së komunistëve në pushtet niveli social-ekonomik i Shqipërisë, për shkak të prapambetjes së thellë ekonomike dhe kulturore, ishte i pakrahasueshëm me cilindo vend tjetër të Evropës. Ndërkaq, nuk duhet marrë si fyes vëzhgimi që rezultatet e arritura nga qeveria e Hoxhës, ndoshta, do të ishin arritur edhe nën çdo regjim tjetër. Ajo që nuk mund të kundërshtohet është niveli minimal i cilësisë i thujtë të shërbimeve të ofruara. Edhe pse quheshin të mjaftueshme për standardet e zakonshme të shoqërisë shqiptare, ato gjithësesi zor

¹ Nuk duhet harruar që pavarësisht nga përvoja e ndërprerë dhe e pjesshme e mbretit Zog, shqiptarët kurrë më parë nuk kishin jetuar në një shtet unitar të centralizuar.

se mund të krahasoheshin me nivelet e arritura si në botën perëndimore, ashtu dhe në vendet e ish-Evropës lindore. Duke pasur parasysh kushtet e përgjithshme në të cilat ndodhej vendi në fund të vitit 1944, përmirësimet e arritura në disa sektorë mund të gjykoreshin me peshë². Gjithsesi, përse u përket kushteve të jetesës në tërësi dhe sidomos për shijen e hidhur që regjimi i la mbarë bashkësisë kombëtare, rezultatet përfundimtare lënë për të dëshiruar.

Si ka qenë e mundur lindja e ngulitja e një diktature të tillë në Shqipëri? Disa intelektualë, shqiptarë ose jo të tillë, duke hulumtuar mbi zanafillën e komunizmit shqiptar, kanë pyetur veten se si, vallë, ai ka patur një zhvillim kaq të vrullshëm, aq sa mund të gjenden fare pak pika krahasimi me përvojat e ngjashme. Piro Misha përcakton qartë disa veçori të komunizmit shqiptar: “Në fakt, komunizmi shqiptar përbënte një hibridizim të çuditshëm mes dëshirës për modernizimin e shoqërisë shqiptare, retorikës marksiste-leniniste, metodave brutale staliniste, radikalizmit kinez dhe mendësive e shprehive të botës konservatore e të prapambetur katundare shqiptare” (Misha 2008: 97). Projekti politik i konceptuar nga Partia e Punës, në përfundim të luftës së dytë botërore, shpërfaq ngjashmëri të padiskutueshme me ato të partive komuniste që erdhën në pushtet në Evropën lindore, gjithësesi duke u dalluar nga disa veçori, ndër të cilat bën pjesë edhe rrënjësia në radhët e popullsisë. Një teori e parashtruar nga sociologu shqiptar Artan Fuga, edhe pse ngërthen në vetvete një karakter të përgjithshëm interpretues, shpjegon një nga shkaqet e suksesit të regjimit komunist në Shqipëri: “Logjika e një pushteti totalitar ose autoritar [...] është gjithashtu mjaft e pranishme në disa tradita kulturore që ekzistojnë në gjirin e shoqërisë shqiptare. Pikërisht në këto tradita kulturore u mbështet pushteti totalitar, për t’u përligjiur si i tillë për një kohë të gjatë. Kështu, modeli stalinist i pushtetit politik nuk qe diçka

² E shohim me vend të sjellim këtu atë që shkruan profesori Stavrianos lidhur me banesat e fshatarëve në fillim të luftës së dytë botërore: “Banesat më të thjeshta fshatare përbëheshin nga një dhomë e vetme me vatër në mes, të ndërtuar me mure guri, druri apo qerpiçi. Ndërtimet ndryshonin nga njëra zonë në tjetrën: në veri mbizotëronin shtëpitë kulla me mure të trasha rrethuese ndërsa në jug shtëpitë ishin më të ndriçuara dhe me shumë dritare. Përbri mureve qenë ndërtuar shtroje dhe shtretër të vegjël dhe një tavan i ulët poshtë çatisë me pjerrësi shërbente si papafingo, ku shpesh ngjiteshe me shkallë druri të thjeshtë”, (Stavrianos, L. S. 2000).

që u vendos thjesht me dhunë, ai gjeti gjithashtu disa struktura kulturore të gatshme që i dhanë mundësi të mos flakej tutje që në hapat e parë” (Fuga 2004: 86).

Me të tilla vëzhgime lidhet reflektimi i italianit Alberto Gasparini kur pohon: “komunizmi i zbatuar në Shqipëri bëhet një rrugë shqiptare drejt komunizmit, pasi: 1) përvetëson strukturën e ngurtësuar të bashkësisë tradicionale duke futur njëfarë doze industrializimi të udhëhequr nga lart, që e zëvendëson traditën e të parëve me autoritetin laiko-fetar të partisë dhe të ‘njeriut të ri’ socialist; 2) bazohet dhe riinterpreteton vlerat e traditës që sheh në bashkësinë e vet shtrirjen maksimale të së vërtetës; dhe 3) zbraz nga përmbajtjet nevojën për të pasur kontakte me jashtë” (Gasparini 1997: 10).

Opinionin e studiuesve të lartpërmendur mund të gjejmë një pikë të përbashkët në faktin që komunizmi shqiptar nuk ishte një dukuri thjesht e importuar, jashtë kombit apo pa asnjë lidhje me kulturën e vendit. Përkundrazi, është afërmendsh të hamendësosh që ai ka pasur një bazë të fortë mbështetëse, të rrënjosur thellë në ndërgjegjen shqiptare. Thënë më shkoqur, nuk tingëllon e çuditshme ta hamendësosh lindjen e regjimit dhe zhvillimin e tij të mëtejshëm, si një riinterpretim të autoritetit tradicional të frymëzuar nga Kanuni nëpërmjet zbatimit të modeleve të lashta të përvetësuar nga ideologjia marksiste e përpunuar në kontekstin ballkanik. Sjellja despotike e ngulitur në botëkuptimin e ligjit zakonor fiton, në vitet e diktaturës, një përparësi të padiskutueshme, në dëm të vlerave të tjera pozitive që vërehen në të, që nuk asgjësohen por më shumë lihen pasdore duke u dhënë përparësi atyre që konsiderohen më të duhurat në ato rrethana kohore.

Është sërish Alberto Gasparini që kujton një aspekt të mëtejshëm: “Shqipëria që mori në dorëzim komunizmin e Enver Hoxhës ishte një vend [...] tradicional, me një mijë bashkësi thuajse të pavarura dhe të drejtuara nga krerë dhe nga bejlerë, edhe ata jo të lidhur pas pushtetit qendror shqiptar apo të huaj, qoftë ai serb apo turk [...] Shqipëria mbart si trashëgimi historike

thërrmim të çifligjeve, që mbaheshin në këmbë nga kode vlerash, sisteme shoqërore thellësisht tradicionale, të ndara nga njëri-tjetri dhe të sigurta që ishin mbartëse të “së vërtetës” së mirëfilltë, të cilën pa dyshim nuk e mbart askush tjetër. Është një substrat historik që legjitimon ideologjikisht thërrmimin e skajshëm të pushtetit në grupe shoqërore, grupe politike, zona gjeografike” (Gasparini 1997: 9).

Pas ardhjes në pushtet, komunizmit iu desh të ballafaqohet me këtë realitet shkërrmoqjeje, të kapërcyeshëm në një logjikë anti-demokratike dhe diktatoriale, ku u mbështet Partia e Punës, vetëm falë imponimit të një autoriteti sipëror, absolutizues dhe totalitar. Pikërisht kjo ishte rruga që u ndoq, edhe pse fillimisht regjimit iu desh të përballet me kundërpërgjigjen e vendosur të opozitës, që më pas u asgjësua. Një ndihmë të qenësishme në këtë rrugë konsolidimi të pushtetit i dha edhe njohja e thellë, nga ana e klasës drejtuese, e psikologjisë dhe mënyrës së të menduarit të shtetasve të vet. Kjo u dha mundësi strukturave të partisë-shtet që të ngrenë një sistem sa të koklavitur aq edhe dredharak, të pajisur me një aparat kontrolli dhe shtypjeje të kudondodhur, që arriti të hedhë rrënjët e veta në vend, pikërisht sepse u mboll në një terren të përshtatshëm.

Duke kaluar tani te përshkrimi i figurës dhe veprës së Enver Hoxhës, duhet thënë këtu se qysh pas fundit të luftës së dytë botërore mendimi nacionalist, i përforcuar e i shëndoshur gjatë regjimit të mbretit Zog, u ripërpunua në mënyrë origjinale dhe u vu në shërbim të ngritjes së ngrehinës ideologjike, në shumë aspekte të jashtëzakonshme, të arkitektuar nga vetë diktatori. Atë dhe zot i padiskutueshëm i vendit, prej vitit 1944 deri në vdekjen e tij më 1985, falë përqendrimit të gjithë pushteteve të shtetit dhe partisë u arrit që miti i krijuar rreth personit të tij, ngushtësisht i lidhur me atë të partisë të udhëhequr prej tij, të rritej mjeshtërisht, duke ushqyer një kult mbytës individi, si një mjet për të shtrënguar radhët e një popullsie që zor se mund të bëhej bashkë. Historianja ruse Nina Smirnova shprehet kështu lidhur me diktatorin shqiptar: “Nuk ka dyshim që Hoxha që mbërthyer nga etja për pushtet, e cila, në kalimin e viteve, u shndërrua në një mani të sëmurë madhështie. Ai e ndiente veten gjysmëperëndi dhe e

luajti me talent këtë rol, duke krijuar rreth vetes një mjedis të përshtatshëm. Atij iu ngritën monumente që në të gjallë dhe bustet e portretet e tij të shumëfishuara në mbarë vendin, mund t'i hasje edhe atje, ku s'e prisje" (Smirnova 2004: 405).

Duke i forcuar përfundimisht pozitat, pas një faze shumë të shkurtër pluralizmi nistor, që shpejt ia la vendin largimit të dhunshëm të të gjithë kundërshtarëve politikë, Hoxha hodhi bazat e një pushteti sa despotik aq edhe absolut, nëpërmjet krijimit të një klime dyshimi dhe mosbesimi të përhapur në tërë shtresat shoqërore të vendit, si dhe nëpërmjet dhunës së vazhdueshme, që arriti deri në asgjësim fizik, viktimë e së cilës ranë jo vetëm kundërshtarët e shpallur por edhe ata të mundshëm apo që hamendësosheshin si të tillë, jo rrallë edhe shokë besnikë të partisë. Shkrimtari dhe analisti Fatos Lubonja, një ndër të përndjekurit më të njohur nga regjimi komunist, hedh dritë mbi disa elemente të kulturës tradicionale shqiptare, që mund të merren si tipar i karakterit kombëtar. Këtij tipari Lubonja i vesh logjikat e sundimit të kundërshtarëve, të thelluara më tej me ushtrimin e pushtetit. Ai pohon: "Mungesa e [vlerave morale] bëri që marrëveshjet e arritura ndërmjet grupeve, klaneve apo partive shpesh të katandiseshin në grindje, urrejtje dhe mosmarrëveshje, duke e diktuar vullnetin mbi tjetrin me forcë, në një kthim mbrapa tek arketipi i vjetër i qeverisjes që nxorri krye nga psikologjia sunduese e patriarkatit, ku më i madhi dhe më i forti sundonte mbi më të dobtin. Kjo formë sundimi përfshin nënshtrimin dhe shkatërrimin e rivalëve, duke mbjellë frikë nëpërmjet përdorimit të dhunës, duke bërë koka turku, intriga dhe prapaskena. Duke huazuar gjuhën e Evropës perëndimore mbi këtë çështje, po e përkufizojmë si një shtet që mbahet nga personaliteti më tepër se nga e drejta" (Lubonja 1997: 55). Nëpërmjet shpalosjes së bujshme të cilësive vetjake, që s'viheshin në dyshim, të përziera me një ideologji totalitare, njeriu i fortë i Shqipërisë së re "vendoste për gjithçka dhe fjala e tij ishte ligj për të gjithë" (Instituti i Historisë 1994: 217).

Bir i një familjeje tregtarësh në gjendje të mirë, ai u lind në Gjirokastrë, në jug të Shqipërisë, në vitin 1908. Në vitin 1930 u shpërngul në Montpellier të Francës për të kryer studimet

universitare, që s'i përfundoi asnjëherë, derisa vendosi të kthehej në atdhe ku deri në vitin 1939 punoi si mësues në qytetin jug-lindor të Korçës. Në vitin 1941 që ndër anëtarët e parë të Partisë Komuniste shqiptare dhe në vitin 1943 u zgjodh sekretar i saj i përgjithshëm, falë mbështetjes së eksponentëve të Partisë “motër” jugosllave. Po atë vit u emërua shef i shtabit të përgjithshëm të ushtrisë nacional-çlirimtare dhe një vit më vonë u bë komandant i përgjithshëm ushtarak dhe kryetar i komitetit antifashist, që pak kohë më vonë u shndërrua në qeveri të përkohshme, duke përqendruar në duart e tij kontrollin politik dhe ushtarak, si dhe funksionin më të lartë shtetëror të asaj kohe. Në vitin 1946 u emërua formalisht kryetar i Këshillit të Ministrave dhe Ministër i Jashtëm, detyra që i mbajti përkatësisht deri në vitin 1954 dhe 1953. Më pas nuk mbajti më poste ekzekutive, por deri në vdekje ruajti atë të Sekretarit të Parë të Partisë së Punës, funksion që i jepte mundësi të ushtronte kontroll të padiskutueshëm mbi tërë aparatin e partisë-shtet. Që në kohën e Luftës së Dytë Botërore u bë ideator i tërë vendimeve politike të vendit, si përsa i përket politikës së jashtme, ashtu dhe asaj të brendshme.

Hoxha ishte mjaft i vetëdijshëm për pozicionin me pak peshë të Shqipërisë në arenën ndërkombëtare. Duke qenë në varësinë e ndihmave të shpërndara gjatë luftës nga Aleatët perëndimorë, me kalimin e kohës ai u lidh përherë e më ngushtë me politikën e jugosllavit Tito. Ky i fundit mbështeti rezistencën e brishtë vendase nëpërmjet organizimit të forcave partizane dhe mbështetjes në formimin dhe konsolidimin e Partisë Komuniste vendase dhe, në përfundim të luftës, i dha një ndihmë konkrete ekonomisë së porsalindur. Gjithësesi, Hoxha e kuptoi shumë shpejt që vëmendja e fqinjit shumë më të fuqishëm ushqente pikësynime të caktuara dhe ekzistonte rreziku i gllabërimit të Shqipërisë nga Beogradi. Problemi kryesor që duhet të zgjidhte diktatori shqiptar ishte zgjedhja ndërmjet përqafimit vdekjeprurës me republikën fqinje, dhe ruajtjes së pavarësisë. Ishte fjala për një çështje mbijetese. Dukej sheshit që zgjidhja e parë do të sillte pa dyshim një zhvillim ekonomik e shoqëror dhe për pasojë përmirësimin e kushteve të mjerueshme të popullsisë. Gjithësesi, kjo do të thoshte kundërvënie ndaj

përpyjekjeve serioze për asimilim. Edhe pse iu desh të përballej me një kundërshtim të brendshëm, vërtet të shkurtër në kohë por mjaft këmbëngulës, nga ana e fraksionit pro-jugosllav, Hoxha zgjodhi pavarësinë, duke e përligjur me ruajtjen e identitetit kombëtar, të cilën arriti ta sigurojë falë kushteve të diktura prej luftës së ftohtë dhe prej miqësisë personale me Stalinin, gjë me të cilën ai mburrej (Montanelli 1993: 106).

Preteksti i prishjes së “miqësisë vëllazërore” u shpreh qartë në akuzat e ashpra për revizionizëm politik që i lëshoi udhëheqjes së Beogradit pas vendimit jugosllav për të mos u integruar në bllokun sovjetik. Në vijim të këtyre ngjarjeve, aleanca mes dy fqinjëve u prish prerazi, dhe qeveria shqiptare filloi të forcojë marrëdhëniet me Bashkimin Sovjetik, marrëdhënie që u ndërpre në vitin 1960, pas akuzave që iu bënë Moskës se kishte braktisur rrugën e Stalinit, duke ndjekur, me kursin e ri të zgjedhur nga Hrushovi, pikësynime imperialiste. Aleati tjetër dhe i fundit ishte Kina e Maos, me të cilën Shqipëria mbajti marrëdhënie deri në vitin 1978. Prishja me Pekinin ndodhi kur Partia Komuniste kineze nisi të ndjekë një politikë shtendosjeje me Shtetet e Bashkuara, duke e akuzuar Kinën si social-imperialiste³.

Përsa i takon politikës së brendshme, pasi shtiu në dorë pushtetin me dhunë, në përfundim të luftës, duke hequr qafe kundërshtarët jo komunistë (sidomos ata që bënë pjesë në Ballin Kombëtar)⁴, diktatori zbatoi një politikë me frymë kryekëput staliniste. Çdo lloj kundërvënie u asgjësua gradualisht por pareshtur, nëpërmjet vrasjeve, burgosjeve, torturave dhe internimeve. Objektivat që qeveria i vuri vetes ishin të shumta: ecja me hapa të përshpejtuar e këmbëngulës drejt industrializimit të vendit që deri më atëherë nuk ekzistonte, kolektivizimi i tokës dhe

³ Është sërish Montanelli që e sintetizon politikën e jashtme të ndjekur nga Hoxha në thujtje pesëdhjetë vjet pushtet: “U afrua me Stalinin që të mbrohej nga Titoja që i kërcënohej në kufi. Por kur Hrushovi e hodhi poshtë Stalinin, ai hodhi poshtë Hrushovin dhe zgjodhi si mbrojtës Maon, që pak mund të bënte për ta mbrojtur; pastaj edhe atë e hodhi poshtë.”, (Montanelli, I. 1993: 107).

⁴ Qenë të shumta shkaqet që shkaktuan prishjen ndërmjet dy formacioneve politike, armike të betuara mes tyre. Një arsye e ndarjes së thellë ishte përplasja lidhur me çështjen kombëtare dhe sistemimin e ardhshëm të tokave shqiptare në përfundim të luftës. Enis Sulstarova shkruan: “Balli Kombëtar kërkonte të ruante bashkimin e Shqipërisë me Kosovën e Çamërinë pas luftës, edhe nëse kjo do të thoshte një luftë tjetër kundër Jugosllavisë dhe Greqisë, por Partia Komuniste Shqiptare në radhë të parë dëshironte bashkëpunimin me organizatat çlirimtare jugosllave dhe greke kundër pushtuesve italianë dhe germanë”, (Sulstarova 2003).

krijimi i ekonomisë së planifikuar si kundërvënie ndaj tregut të lirë. Në vitin 1967, duke e gjykuar si një rrezik vdekjeprurës praninë e besimeve të ndryshme fetare dhe duke imituar dhe tejkaluar Kinën e Maos, Hoxha urdhëroi mbylljen e tërë vendeve të kultit dhe e përforcoi përndjekjen, që kishte filluar në fund të luftës, kundrejt përfaqësuesve të fesë. Kjo masë u pasua nga shpallja, në vitin 1976, e kushtetutës së re ku futej –i vetmi rast në botë– ateizmi i shtetit. Vetëm prej vitit 1981, për shkak të sëmundjes që sa vinte e rëndohej, Hoxha filloi të tërhiqej nga jeta publike, duke ia besuar dora-dorës përgjegjësinë shtetërore Ramiz Alisë, që i zuri vendin pas vdekjes.

Pavarësisht nga mizoria e shfaqur nga regjimi i ashpër politik, diktatori ia doli mbanë, të paktën njëzetëvjeçarin e parë, të gëzojë një miratim të gjerë dhe të padiskutueshëm popullor. Qenë të shumta shkaqet që lejuan rrënjosjen e këtij sistemi, “një përzierje e marksizëm-leninizmit fanatik [...] e stalinizmit [...] e maoizmit [...] si dhe e nacionalizmit të fuqishëm” (Fabretti 1997: 189). Megjithatë, në radhë të parë, duhet renditur ideali i pashuar i pavarësisë kombëtare, besim absolut i shumë udhëheqësve komunistë, si dhe i një pjese të mirë të popullsisë, e cila në kohën e luftës u kishte siguruar vullnetarisht brigadave partizane mbështetjen në luftën kundër pushtuesve nazi-fashistë. Lidhur me idealet e pavarësisë të kultivuara nga përgjegjësit politikë komunistë, historiani italian Stefano Bianchini vë në dukje: “Uniteti dhe pavarësia e Shtetit u bënë [...] një faktor i qëndrueshëm ‘vazhdimësie’ në politikën e Hoxhës. Një qasje e tillë iu diktua edhe historiografisë vendase, e karakterizuar nga shtrembërime dhe shpesh nga lartësimi i shpirtit të pavarur të popullit shqiptar, të gatshëm të luftonte ‘pa u lodhur’ kundër tërë pushtuesve, përfshi dhe turqit osmanë” (Bianchini 1993: 108).

Dëshira për pavarësi u ushqye në mënyra të ndryshme: si me shkëputjen e përshkallëzuar nga ato vende me të cilët Shqipëria kishte gjithësesi marrëdhënie, ashtu dhe me mbylljen ndaj çdo lloj ndihmese kulturore që vinte nga jashtë kornizës së ngurtë ideologjike marksiste-leniniste, të cilën vetëm Hoxha dhe askush tjetër ishte i autorizuar ta interpretonte. Diktatori vazhdoi në

rugën e zhvillimit të vetëdijes nacionaliste, duke luajtur pa rezervë kartën e mbrojtjes së territorit dhe duke ushqyer frikën hysterike nga pushtimet e huaja që jo vetëm mund të ndodhnin por ishin edhe në prag. Duke shfrytëzuar këtë perceptim tensioni të vazhdueshëm, i bëhej thirrje ndërgjegjes së qytetarëve, duke kërkuar vigjilencë dhe kujdes ndaj çdo shenje rreziku të jashtëm dhe të brendshëm. Gjithësesi, duket qartë që arsyeja kryesore në mbështetje të kësaj lufte ishte forcimi i pushtetit vetjak dhe, në një synim afatgjatë, ruajtja e rendit të vendosur.

Por nuk është pa rëndësi të kujtojmë që mjerimi shekullor, prapambetja dhe izolimi u përdorën për ta paraqitur regjimin si shpëtimtar dhe bartës të shpresës për masat e gjera të fshtarëve, që s'kishin tjetër synim veç përmirësimit konkret të kushteve të jetesës. Shpresat për një mirëqenie më të madhe që u ngjallën në shtresat e gjera të popullsisë siguruan miratimin popullor, i përforcuar nga zgjidhjet energjike dhe në shumë pikëpamje përtëritëse, ndaj alternativave të paraqitura për të përmbushur nevojat e kahershme për drejtësi. Duke u kthyer në pikë referimi për mijëra burra e gra, regjimi mishëroi premtimin për ndërtimin e një shoqërie të re mbi bazat e barazisë, pa kufizime dhe mjerim moral, të çliruar nga padronët e çdo lloji, djep të “njeriut të ri” revolucionar, shprehje më të përsosur të socializmit, në të cilin “shfrytëzimi nuk ekzistonte dhe kultura kombëtare përshkohej nga ideologjia revolucionare marksiste-leniniste dhe ishte e çliruar nga çdo gjë antipopullore, antikombëtare, obskurantiste” (Sulstarova 2003: 68). Enver Hoxha, falë aftësisë së padiskutueshme komunikuese, fitoi besimin e popullit, që, nga ana e vet, nuk gëzonte kurrfarë kuti krahasues me botën e jashtme.

Kombinimi i kujdesshëm dhe i përpiktë i tërë këtyre elementeve i dha mundësi diktatorit të krijojë parakushtet e nevojshme për të vënë në jetë shndërrimet e thella shoqërore. Ato synonin që brenda pak kohe ta kthenin Shqipërinë nga një gjendje mesjetare në një vend modern. Duke bashkëlidhur pa ndonjë kundërshti të dukshme komunizmin me nacionalizmin, revolucionin dhe traditën, Enver Hoxha hodhi gjithashtu bazat e autoritetit të tij personal të padiskutueshëm, duke ndërtuar një shtet sipas imazhit dhe ngjashmërisë me të. Ai u mbështet në shumë shtylla:

mitet e rimarra nga etërit e Rilindjes dhe të rimodeluara sipas nevojës, idealet e reja të filozofisë komuniste, por edhe rizbulimi dhe përpunimi rishtas i vlerave tradicionale. Për të përmbushur qëllimin e tij, diktatori përdori argumenta të ndryshëm. Me të mbaruar konflikti, u ushqye qëllimisht miti i luftës antifashiste dhe i suksesit të qëndresës së arritur, falë angazhimit thjesht dhe vetëm të partizanëve komunistë të udhëhequr nga ai vetë drejt fitores përfundimtare.

Lidhur me sa më sipër, dihet që në periudhën e kapitullimit italian Gjermania erdhi pas ushtrisë italiane, duke e pushtuar me trupat e saj Shqipërinë. Rajhu nuk shfaqti ndonjëherë interes karshi vendit, por u përpoq të arrijë dy rezultate thelbësore nëpërmjet qeverisë kukull: ruajtjen nga humbjet të trupave të veta dhe kontrollin mbi portet dhe qytetet kryesore. Pa e nënvlerësuar rolin e rezistencës, duket qartë që “partizanët u shkaktuan gjermanëve dëme shumë të kufizuara. Ata rrallë arritën të mbanin pozicione të qëndrueshme [...] Zonat më të mëdha, që kontrolloheshin nga partizanët në fund të vitit 1944 ishin në përgjithësi zona ku gjermanët nuk kishin interesa” (Fischer 2011: 141).

Në të kundërt të së vërtetës historike, pra, retorika komuniste u bëri jehonë të gjerë të tilla ngjarjeve, duke përhapur imazhin e partizanit heroik dhe fitimtar, luftëtarit të paaepur për çlirimin e vendit të tij, dhe duke e përcaktuar këtë luftë “për çlirim kombëtar”. Kësisoj, lindja e mitit të partizanit u rrit e u zmadhua, duke u përfshirë me dhe pa vend në librat shkollorë, u trajtua në kinema dhe teatër, me qëllim që të shërbente si faktor bashkues për çështjen kombëtare. Në përpunimin ideologjik të kërkuar nga vetë diktatori dhe i propozuar për konsum të brendshëm: “Kulti i partizanit arriti përmasa rrëqethëse [...] Përvoja shqiptare e kohës së luftës [...] u bë pika e vetme orientuese e ekzistencës së Shqipërisë për gjysëm shekullin e ardhshëm” (Fischer 2011: 142).

Duke qenë Lufta Nacionalçlirimtare një nga themelet mbi të cilët u ngrit regjimi komunist, në shumë raste Enver Hoxha nënvizoi rolin që luajti Partia e Punës gjatë muajve të qëndresës. Në

një nga fjalimet e shumta ai pohonte: “Partia e Punës së Shqipërisë u formua dhe u hodh në një luftë të tmerrshme kundër fashizmit që nuk e kishte parë ndonjëherë njerëzimi. Ishin në balancë fatet e popullit tonë dhe vetëm një parti marksiste-leniniste, si Partia jonë, mund t’i shpëtonte ato, siç i shpëtoi. Pra, Partia jonë ishte shpata e mprehtë, e ndritur, e pathyeshme dhe e papërkulur në dorën e klasës punëtore dhe të popullit shqiptar. Dhe kjo shpatë u bë e tillë pasi u mbryjt me marksizëm-leninizmin dhe u kalit në luftë [...] Kështu, nën udhëheqjen e Partisë, u fitua Lufta Nacionalçlirimtare, u krye Revolucioni ynë Popullor, po ndërtohet sot me sukses socializmi” (Hoxha 1982: 31-32).

Në lartësimin e kësaj epopeje u la krejt në hije roli që luajtën grupet politike me frymëzim demokratik, të cilat gjithashtu kishin dhënë ndihmesën e tyre gjatë viteve të pushtimit. Me të drejtë Jean-Paul Champseix thekson që “Regjimi komunist [...] është bazuar mitologjikisht në çlirimin e vendit” (Champseix 1996: 59) rol që hagiografia e mëpasshme (trajtimi i tij si një shenjtor) – ia veshi veprimtarisë së Enver Hoxhës.

Pikërisht nëpërmjet krijimit të një aureole heroike rreth figurës së tij prej komandanti legjendar të qëndresës, rol që shpalosej në varësi të rrethanave të ndryshme dhe që lartësohej nëpërmjet përdorimit finok të propagandës, Hoxha arriti të ushqejë një kult të mirëfilltë të individit, falë të cilit ai merrte mbi vete karakteristika thuajse hyjnore. Brenda pak kohe ai u bë në përfytyrimin kolektiv e vetmja pikë referimi, çlirimtari i Shqipërisë, “udhëheqësi i mbarë popullit shqiptar dhe mësuesi më i dashur” në unitet të pandashëm me partinë dhe popullin⁵, shpërndarës i plotfuqishëm i së mirës dhe së keqes.

Lidhur me kultin e individit të zhvilluar rreth figurës së Enver Hoxhës, Sulstarova shkruan: “Ai u bë personifikimi i Shqipërisë socialiste [...] Atij i kushtoheshin këngë popullore [...] bustet e përmendoret e tij stolisnin sheshet e qyteteve, ndërtesat qeveritare, madje edhe shtëpitë e

⁵ Lindja dhe zhvillimi i këtyre miteve nuk ndoqi një rrjedhë të shkallëzuar por një proces i tillë pësoi një përsheptim në rritje nga çasti që Shqipëria prishi marrëdhëniet me BRSS, shih Lubonja 1999: 147).

qytetarëve. Mendimi i tij përshkonte të gjitha veprimtaritë shoqërore [...] Studimet shkencore të çdo fushe citonin fjalët e tij dhe ai vetë ishte kritiku kryesor i artit të realizmit socialist. [...] Përmasat e kultit të individit të Hoxhës u shkallëzuan mbas vdekjes së tij duke marrë trajta hyjnore [...] Muzeu i Enver Hoxhës [...] kishte formën e një piramide, gjë që përsëri të kujtonte mjetin me anë të cilit faraonët shkonin në qiell. Ndërsa monumenti i tij lartësohej në sheshin Skënderbej dhe e nxirrte në hije monumentin e heroit kombëtar; miti i Enverit ishte tashmë kryemiti i Shqipërisë socialiste” (Sulstarova 2003: 95-96). Të tilla pohimeve dëshiroj t’u shtoj një shënimin tim personal. Gjatë viteve të para të tranzicionit shumë familje fshatare që banonin në zonat qendrore dhe veriore të vendit, dhe që i kam vizituar personalisht, vazhdonin të mbanin në mes të dhomës kryesore të banesave një fotografi-portret me përmasa të mëdha të Enver Hoxhës, të rrethuar me lule artificiale dhe me shirita të zinj zie, në kujtim të vdekjes së tij.

Lidhur me ngrehinën e menduar nga diktatori dhe doktrinën e farkëtuar nga regjimi, anglezi Aleks Standish (*Alex Standish*) përdor shprehjen “ideologji thuajse fetare”, kur shkruan që “Enver Hoxha ndërgjegjshëmrisht e zbuloi këtë mungesë të miteve kombëtare dhe e shfrytëzoi atë duke punuar për krijimin e një skeleti të ri, të fuqishëm të ndërgjegjes kombëtare për atë kohë, ‘shqiptarizmen’. Në procesin e ndërtimit të mitit të tij vetjak, Hoxha sinkretizoi historinë shqiptare duke seleksionuar ato figura historike të cilat [...] do të siguronin mbështetje për qëllimet e tij. Kështu një ideologji pothuajse fetare u zhvillua rreth figurës qendrore të Themeluesit të Shqipërisë së Re” (Standish 2011: 63). Një shprehje e tillë mishëron më së miri çka konceptohet, aq sa mund të barazohet me një fe laike.

Që në fillim udhëheqja komuniste ishte e vetëdijshme se nuk do të mjaftonte thjesht ushtrimi i pushtetit, qoftë edhe nëpërmjet përdorimit të dhunës, por nevoja e lypte që ndërgjegjja e njerëzve të brumosej nëpërmjet përdorimit të argumenteve, që duhet të ishin aq bindëse gati sa një frymë fetare. Enver Hoxha ishte i vetmi që kishte tagrin të përpunonte ideologjinë zyrtare

të Partisë, të përkufizuar në mënyrë të thjeshtëzuar si enverizëm⁶, përfaqësuese të një interpretimi kryekëput të lirë të doktrinë komuniste me ndikim nacionalist. Filozofia që qëndron në themel të saj bazohej në faktin që ndërmjet masave, të udhëhequra nga partia, dhe udhëheqjes, të lindte një komunikim frytdhënës, i frymëzuar dhe i udhëhequr nga themeluesi, duke u mbajtur për këtë rol mesianik që ngërthente si “mishërim i fjalës së shenjtë marksiste-leniniste në Shqipëri” (Champseix 2000: 81).

Gjithashtu, sipas interpretimit të autorizuar të klasës drejtuese, me qëllim që të shmangen gabimet e vendeve të socializmit real, qarkullimi i mendimit nuk duhet të ndodhte vetëm në një kah, me një fjalë, vetëm nga lart-poshtë, por edhe anasjelltas. Pra, nuk ishte vetëm partia nëpërmjet sekretarit të përgjithshëm që përcaktonte vijën udhëheqëse, duke i bërë kështu masat të vetëdijshme për detyrat dhe detyrimet e tyre, por ishte vetë populli që u shprehte udhëheqësve dhe përgjegjësit më të lartë kërkesat dhe pritshmëritë e tij, në përputhje me parullën e njohur: “Ç’do populli bën Partia, dhe ç’thotë Partia bën populli”. Përhapja e doktrinë enveriste dhe kalimi i informacioneve ndërmjet popullit, partisë dhe udhëheqësit të saj, fitonte në këtë mënyrë një karakter vazhdimësie të pandërprerë dhe një efektshmëri të padiskutueshme.

Por nëse vëzhgohet me vëmendje leksiku i përdorur për të përshkruar unitetin e pandashëm ndërmjet Enver Hoxhës, popullit dhe partisë (*Enver–popull–parti*), s’ka se si të mos bjerë në sy përdorimi i një shprehjeje trinie, të ngjashme –me gjasa jo krejt rastësore– me nocionin e Trinisë së krishterë (Atë-Bir-Shpirt i Shenjtë). Me qëllim që ta bënte më të përvetësueshme doktrinën socialiste për masat e fshatarëve analfabetë, sidomos për ata të fesë së krishterë, që pa dyshim ishin krejt të zhveshur nga parimet marksiste por jo krejt të paditur në kulturën fetare, përdorimi

⁶ Duke rimarrë përkufizimet skematike lidhur me ideologjitë totalitare të ideuara nga filozofi francez Claude Lefort, Sulstarova e përcakton enverizmin si një mendim totalitar mbi bazën e vëzhgimeve që vijnë: “1. Enverizmi është ideologji e një partie që pretendonte se ishte e ndryshme nga partitë tradicionale dhe se përfaqësonte tërë shoqërinë. 2. Enverizmi ishte i konsideruar me sferën e ligjit dhe atë të detyrës dhe rregullonte të gjitha aktivitetet e shoqërisë. 3. Enverizmi pretendonte të ishte organi i vetëm për shqiptimin e realiteteve si të tillë. 4. Enverizmi e shpjegonte përvojën sipas nevojave të tij, por nuk mund të sfidohej nga përvoja” (Sulstarova, 2003)

i figurës së trinisë nuk u shpërfill nga Partia. Qëllimi ishte që në opinionin publik të arrihej uniteti i tërë popullit rreth udhëheqjes, duke u shkrirë e bërë një me themeluesin e saj. Duke pasur parasysh të tilla parakushte, krahasimi me Trininë e Shenjtë nuk tingëllon i pavend.

Duke mbaruar këto mendime të shkurtra, nuk më duket e pavend të them se të paktën në një fazë fillestare, enverizmi u shfaq si një metodë komunikuese bindëse, duke e zbuluar veten si një ndërmjetës të nevojshëm për të arritur unitetin e lakmuar ndërmjet popullit dhe kreut, unitet që duhet të ishte “i çeliktë”. E shpallur si e vërteta më e madhe që rridhte nga zbatimi shkencor i mendimit të dy ideologëve më të mëdhenj të socializmit, Marks dhe Lenin, enverizmi u përhap gjerësisht nga Byroja politike e Partisë, strukturë e kontrolluar nga diktatori dhe nën udhëheqjen e tij, e vetmja që ishte e autorizuar të zotëronte “monopolin e interpretimit të marksizëm-leninizmit” (Sulstarova 2003: 63).

Bibliografia:

Bianchini, S. (1993) *Sarajevo le radici dell'odio. Identità e destino dei popoli balcanici*, Roma: Edizioni Associate.

Champseix, E. dhe Champseix, J. P. (2000) *Shqipëria ose logjika e dëshpërimit*, Tirana: Elena Gjika.

Champseix, J. P. (1996) ‘Communisme et tradition: un syncrétisme dévastateur’, Albanie utopie. Huis clos dans les Balkans.

Fabretti E. (1997) ‘Le particolarità del comunismo di Hoxha’, *Futuribili*, n. 2-3, 183-193.

Fischer, B. J. (1999) ‘Perceptimi dhe realiteti mbi aftësitë ushtarake të Shqipërisë në shekullin e njëzetë’, *Përpyjekja*, n. 15-16, 136-142.

Frashëri, K. (1996) ‘A l’assaut du pouvoir’, Albanie utopie. Huis clos dans les Balkans.

Fuga, A. (2004) Shtigje drejt guvës së gjarprit, Tiranë, Ora botime.

Gasparini, A. (1997) 'Albania tutta d'un pezzo, in mille pezzi...e dopo?', *Futuribili*, n. 2-3, 7-15.

Hoxha, E. 'Revolucionarizimi i mëtejshëm i partisë dhe i pushtetit', *Vepra*, v. 35.

Lubonja, F. (1997) 'Il vuoto della storia e la caduta delle piramidi' *Futuribili*, n. 2-3, 53-66.

Lubonja, F. (1999) 'Midis lavdisë së një bote virtuale dhe mjerimit të një bote reale', *Përpjekja*, n. 15-16, 143-151.

Misha, P. (2008) *Arratisja nga burgjet e historisë. Ç'do të thotë sot të jesh shqiptar*, Tiranë: Toena.

Montanelli, I. (1993) 'Necrologio di un tiranno', *Albania Viaggi d'autore. Touring Club Italiano*, n. 8, Touring editore.

Smirnova, N. (2004) *Historia e Shqipërisë përgjatë shekullit XX*, Tiranë: Ideart.

Standish, A. M. J. (1999) 'Roli i Enver Hoxhës në zhvillimin e miteve socialiste shqiptare' *Përpjekja*, n. 15-16.

Stavrianos, L. S. (2000) *The Balkans since 1453*, New York: New York University Press.

Sulstarova, E. (2003) *Ligjërimi nacionalist në Shqipëri*, Tirana: Afërdita.

Instituti i Historisë (1994) *Historia e popullit shqiptar*, Tirana: SHBLSH.

Aleancat lindore, zgjedhje strategjike e Shqipërisë në Luftën e Ftohtë

Politika e jashtme e Shqipërisë gjatë Luftës së Ftohtë dallohet për ndryshime të bujshme dhe kthesa të forta. Nga viti 1944 deri në 1978, Shqipëria mbajti lidhje të forta me tre partnerë të mëdhenj lindorë: Jugosllavinë, Bashkimin Sovjetik dhe Kinën, që ishin dhe aleatët strategjikë të Shqipërisë në kërkim të sigurisë dhe ruajtjes së pavarësisë së saj. Përgjithësisht për çdo shtet dhe aq më tepër për një fuqi të vogël, ndryshimi i aleancave brenda një periudhe kohe relativisht të shkurtër është një dukuri e rrallë. Një riorientim kaq i shpeshtë i aleancave ndërkombëtare për një vend të vogël si Shqipëria dëshmon përpjekjet e saj për të ruajtur pavarësinë dhe integritetin territorial. Mbijetesa dhe shqetësimi për sigurinë kombëtare ka qenë pikësnyimi kryesor e tradicional i shtetit shqiptar që nga themelimi. Në dallim nga këto dy elementë, në kushtet e luftës së ftohtë, regjimi politik shqiptar theksoi edhe një tjetër: shkëputjen nga marrëdhëniet e varësisë. Të tre këto elementë lidhen ngushtë me pozitën gjeopolitike të Shqipërisë. Shqipëria nuk ka qenë ndonjëherë një shtet i zhvilluar nga ana ekonomike dhe varësia e saj nga ndihma e huaj e bënë atë të prekshme ndaj presioneve dhe ndërhyrjeve në punët e brendshme. Nga aleancat me Italinë (1925-39), me Jugosllavinë (1944-1948) dhe me BS (1949-61), Shqipëria, si vend i vogël dhe i pazhvilluar, nxori një mësim të dhimbshëm: dobësia ekonomike të çon në varësi politike. Dilema midis një statusi varësie dhe mbrojtja e interesave kombëtare, që njësoheshin me regjimin politik dhe leader-in, ka luajtur rol përcaktues edhe në marrëdhëniet e Shqipërisë me Kinën (1961-1978).

Faktorët përcaktues në pozitën e Shqipërisë gjatë luftës së ftohtë

Me formimin e shtetit të pavarur shqiptar (1912-13), kjo pozitë përcaktohej nga dy çështje themelore: problemi i kufijve të Shqipërisë dhe politika e fuqive të mëdha dhe e fqinjëve ballkanikë ndaj saj. Kufijtë politikë të Shqipërisë u përcaktuan për herë të parë prej komisioneve ndërkombëtare të krijuara nga Konferenca e Londrës (1913). Vendimet e kësaj konference shërbyen për të afirmuar pavarësinë e shtetit shqiptar në planin ndërkombëtar. Si pasojë e debateve të gjata dhe të ashpra, Shqipëria u pranua në Lidhjen e Kombeve (1920), por kufijtë e saj ende nuk ishin përcaktuar në terren. Deri më 1925 çështja e kufijve mbeti objekt konflikt midis Shqipërisë dhe Greqisë e Jugosllavisë nga një anë, që nuk pranonin vendimet ndërkombëtare dhe nga ana tjetër, mes këtyre dy të fundit dhe fuqive të mëdha.

Pas Luftës II Botërore politika e fqinjëve dhe ajo e fuqive të mëdha ndaj Shqipërisë, në shumë aspekte ngjasonte me qëndrimin e mbajtur prej tyre në vitet 1913-1925. Pas 1945, në skenën ndërkombëtare shfaqet një faktor të ri, BRSS. Rusia deri në 1914 kishte pasur një politikë aktive në Ballkan, por si pasojë e revolucionit bolshevik humbi rolin si fuqi e madhe dhe nuk mori pjesë në Konferencën e Paqes në Paris (1919). Ndërsa në 1945 kemi një rikthim të Rusisë sovjetike në pozita force në qendër të Evropës dhe me epërsi dominuese në Ballkan.

Në aspektin strategjik politika ndërkombëtare ndaj Shqipërisë përcaktohej nga faktorë që lidheshin me kapacitetin e Italisë, Jugosllavisë dhe Greqisë për të kontrolluar bregdetin shqiptar dhe daljen në bregun juglindor të Adriatikut. Kjo i jepte Shqipërisë një pozicion të veçantë strategjik, ku veçanërisht Vlora me gjirin e saj dhe ishulli i Sazanit, ka shërbyer si një pikë për strategjinë ushtarake detare. Ky ishull i vogël konsiderohej nga diplomatët italianë si *Gjibraltari i Adriatikut* (Quaroni 1956: 85-86). Interesi për Kanalin e Otrantos është i natyrës strategjike. Historikisht fuqi të ndryshme janë përpjekur të zotërojnë të dy brigjet e kanalit dhe këtë buron dhe rëndësia e ishullit të Sazanit në hyrje të kanalit. Kjo pozitë e veçantë ka bërë që J. Amery,

oficer britanik i SOE, i dërguar me mision në Shqipëri gjatë Luftës II Botërore, të vlerësonte se “Vlora dhe ishulli i Sazanit kontrollojnë ngushticën e Otrantos, një rrugë-kalimi detare e rëndësishme, porta e Adriatikut” (Bethell 1984: 22).

Për Britaninë dhe ShBA, Shqipëria megjithëse vendi më i vogël në Ballkan, ishte e rëndësishme për arsye të pozitës së saj strategjike në hyrje të Adriatikut. Shefi i Misionit Ushtarak Britanik në Tiranë, theksonte se ajo “përfaqësonte një kartë të dorës së parë në lojën e aleatëve dhe të rusëve në Mesdhe”.¹ ShBA dhe Britania nga ana e tyre e vëzhgonin me shqetësim politikën sovjetike, e cila synonte krijimin e një blloku të veçantë në Evropën qendrore dhe lindore. Ky bllok afirmonte autoritetin e BS nga rajoni i Danubit deri në Adriatik dhe si pasojë vinte nën presion të fortë pozitat britanike në Mesdheun Lindor. BS më 1945 me rolin e tij si protektor i Jugosllavisë mbështeste politikën jugosllave që favorizonte avancimin e tij drejt Mesdheut. Sipas gjykimit të *Council on Foreign Relations* në Washington, “Rusia sovjetike dhe Jugosllavia duke kontrolluar Durrësin dhe Vlorën do të mund të fitonin pika të forta mbështetje që Rusia cariste dhe aleatja e saj Serbia ishin përpjekur t’i siguronin pa sukses para Luftës I Botërore” (Campbell 1947: 155-156).

Përballë kësaj perspektive anglo-amerikanët u bënë më të vendosur për të forcuar pozitat e tyre në Itali, Greqi dhe Turqi. Rivaliteti ndjehej fort në bregdetin lindor të Adriatikut, nga Vlora deri në Trieste, çështje kjo e ndjeshme e cila nga amerikanët shihej si “një sprovë force mes lindjes dhe perëndimit”. Në se sovjetikët do të fitonin, “ndikimi i ShBA dhe pozita e atyre që shikonin nga Amerika dhe jo nga Moska, jo vetëm në Itali por edhe në Francë e kudo, do të pësoni një goditje të pandreqshme”. Nga ana tjetër, amerikanët gjykonin se meqenëse “BS i kishte premtuar mbështetje Titos për çështjen e Triestes dhe në se premtimi nuk do të mbahej, e tërë ngrehina me regjimet kukulla në Evropën lindore do të tronditej” (Campbell 1947: 122-123).

¹Archives du Ministère des Affaires Etrangères, Paris (AMAE), Tirana, 23.10.1945, volume 9, Série : Europe 1944-1960, sous série : Albanie 1944-1949.

Pas Luftës së II Botërore gjendja në Ballkan ngjason me atë çka kish ndodhur fill pas Luftës së I Botërore dhe atë që kish paraprirë Kongresit të Berlinit (1878). Përparimi i fuqive sllave në Ballkan, që në atë kohë mbështetej tek pansllavizmi e ortodoksia, në 1945 mbështetej tek frontet antifashiste e popullore, të drejtuara nga komunistët. Shqipëria duke mos qenë as sllave dhe as ortodokse, sipas G. Picot, ambasadorit francez në Tiranë, “përfaqëson sot në Ballkan për Perëndimin, si dikur Mali Zi, pikën më të përparuar të valës ruse, ortodokse e pan-sllave, por gjithashtu e kryesisht, antifashiste përballë Italisë dhe Greqisë”.²

Kjo veçori e pozitës gjeopolitike të Shqipërisë, konfirmohet edhe nga analiza e J. Jacobs-it, shefi i misionit civil amerikan në Tiranë. Në “Raportin për njohjen e Qeverisë shqiptare” dërguar Departamentit të Shtetit (gusht 1945), ai vëren se Shqipëria ka qenë dhe është një vend takimi i Lindjes dhe Perëndimit, i sllavëve dhe Evropës Perëndimore. “Meqenëse populli shqiptar është një popull i vogël, ai duhej të përballej me fqinjët e tij më të fortë në një luftë të pabarabartë, gjë që e ka bërë atë të përshtatet dhe të jetë miqësor me të gjithë, por në të njëjtën kohë edhe mosbesues ndaj të gjithëve”. Ky motiv thekson Jacobs, “shpjegon dhe nënvizon marrëdhëniet e tij me turqit gjatë sundimit të tyre të gjatë dhe më pas, si dhe tani, me Jugosllavinë, Greqinë dhe Italinë” (Fischer 2012: 122).

Lidhja e Shqipërisë pas Jugosllavisë dhe "Commonwealth-it" sovjetik

Ngjashmëria midis regjimit politik të formuar pas L. II. B. në Tiranë dhe në Beograd ishte e madhe për shkak të luftës partizane në të dy vendet kundër një armiku të përbashkët. Pushtimi fashist dhe lufta solli në pushtet në të dy vendet frontet nacional-çlirimtare të dominuar nga komunistët, gjë që krijoi lidhje të forta në marrëdhëniet mes Shqipërisë dhe Jugosllavisë dhe midis këtyre të dyjave dhe BRSS. PK jugosllave ushtronte një tutelë të fortë ideologjike dhe politike mbi PK shqiptare. Marrëdhëniet e shqiptarëve me Moskën mbaheshin nëpërmjet

² AMAE, Télégramme n° 43 de George Picot, Tirana, 28.04.1946, vol. 10, Série: Europe, s/s Albanie.

jugosllavëve të cilët të ardhmen e Shqipërisë ia kishin prezantuar Stalinit si një shtet autonom brenda Federatës jugosllave (Kaba, Çeku 2011: 24). Në këtë aspekt, siç shkruan dhe një nga drejtuesit jugosllavë të kohës, “angazhimi më i madh personal i Titos u shfaq në ngulmimin e tij për ta shkëputur Shqipërinë nga ndikimi sovjetik dhe për t’ia bashkangjitur Jugosllavisë” (Gjilas 2005: 35).

Jugosllavia si edhe BS mbanin qëndrim në përkrahje të problemeve ndërkombëtare të Shqipërisë, e cila ju ishte atyre mirënjohëse sepse e kishin nxjerrë nga izolimi dhe pasiguria. Në Ballkan, Shqipëria ishte përfshirë në një lloj rivaliteti ndërmjet Jugosllavisë dhe Greqisë dhe, nëpërmjet tyre, mes fuqive të mëdha. Pakënaqësia e qeverisë shqiptare ndaj anglo-amerikanëve rritej si rezultat i vendimit të Këshillit të Sigurimit (janar 1946) për të shtyrë anëtarësimin e Shqipërisë në OKB. Sipas gjykimit të ambasadorit francez, "duket tepër ironike për t’u njohur satelitëve të Boshtit të drejtën për të qenë pjesë e OKB dhe t’i mohojnë Shqipërisë të drejtën për t’u pranuar, e cila ka meritën se është çliruar vetë". Ky hezitim vinte për shkak se pranimi i Shqipërisë mendohej se do të sillte më shumë vota për bllokun lindor të dominuar nga BS. Kjo ishte një politikë shumë e diskutueshme që e lidhte Shqipërinë me orbitën sovjetike dhe justifikonte sulmet e saj kundër vendeve që ishin kundër pranimi të saj në OKB.

Jugosllavia, e para që njohu qeverinë Hoxha (28.04.1945), ishte bërë zëdhënësja e Shqipërisë në OKB dhe kishte kërkuar pranimin e saj në këtë organizatë. Iniciativa jugosllave merrte karakterin e një manovre kundër Greqisë duke dalë kështu kundër pretendimeve greke për Epirin e Veriut. Në pranverën e vitit 1946, incidente në kufirin greko-shqiptar u bënë më të shpeshta dhe qeveria jugosllave mori iniciativën për të nënshkruar një marrëveshje për ndihmë me qeverinë shqiptare. Diplomatët francezë në Beograd e Tiranë, mendonin se *Traktati i Miqësisë dhe Ndihmës Reciproke* mes Shqipërisë dhe Jugosllavisë (Tiranë, 9.07.1946), shënonte “një rreshtim të politikës shqiptare pas politikës së bllokut sllav të përfaqësuar nga

Jugosllavia”. Për qeverinë shqiptare traktati shërbente si “instrumenti i parë diplomatik në rrugën e bashkimit drejt formimit të një blloku oriental”.³

Bashkëpunimi ekonomik mes dy shteteve ishte gjithashtu shumë i ngushtë. Marrëveshja për koordinimin e planeve ekonomike, krijimin e një bashkimi doganor dhe paritetin e monedhave (Beograd, 27.11.1946), ishte një model i bashkimit doganor, monetar dhe ekonomik mes palëve. Për nga rëndësia e saj, kjo marrëveshje është në të njëjtën linjë si pakti i miqësisë dhe ndihmës reciproke. Kjo "ndihmë" jugosllave, e frymëzuar nga “konsiderata politike dhe një ideologji e përbashkët, thekson dukshëm varësinë e Shqipërisë nga Jugosllavia. Me këto marrëveshjeve varësia e Shqipërisë ndaj Jugosllavisë është e plotë”⁴, vinte në dukje ambasadori francez.

Interesi jugosllav për Shqipërinë justifikohet jo vetëm nga motive ekonomike dhe politike, por sidomos gjeopolitike. Ky aspekt analizohet në një raport sekret të atasheut ushtarak francez (prill 1947). Në sytë e fuqive perëndimore, dukej qartë se Jugosllavia luante me Shqipërinë, të njëjtën lojë që BRSS luante me Jugosllavinë. “Demokracitë popullore janë mbivendosur brenda njëra-tjetrës, si *matrioshkat*, më e madhja e kukullave ruse, ajo që mban gjithë të tjerat, është Bashkimi Sovjetik. Prandaj është e drejtë që të mendojmë se nën maskën e përkatësisë së të njëjtës bashkësi të popujve, paktet e asistencës, nënshkruar mes fuqive të pabarabarta, si në rastin e marrëdhënieve mes Moskës dhe Beogradi ashtu dhe në rastin e marrëdhënieve mes Beogradit dhe Tiranës, të çojnë në një lloj kolonializmi”.⁵ Më 1947 shohim një rreshtim të plotë të Shqipërisë pas Jugosllavisë. Ky vend i vogël - sipas mendimit të diplomatëve francezë në Evropën Lindore- është bërë një protektorat jugosllav.

³AMAE, Télégramme n° 716-717 de Jean Payart, Belgrade, 11.07.1946, vol. 14; Télégramme n° 77/EU de George Picot, Tirana, 11.07.1946, p. 34, vol. 14, Série: Europe, s/s Albanie.

⁴AMAE, Télégramme n° 226/EU de George Menant, Tirana, le 3.09. 1947, Série: Europe, s/s Albanie.

⁵AMAE, Télégramme n° 289 / EU de J. Payart, Belgrade, le 3.05. 1947, Série: Europe, s/s Albanie.

Në vjeshtën e 1947 prestigji i Jugosllavisë kishte arritur kulmin. Shumë marrëveshje të nënshkruara midis vendeve të Evropës Lindore dhe Juglindore dëshmonin për një rrjet lidhjesh, që kishte filluar të ndërtohej nën shtysën dhe kujdestarinë e BS. Epiqendra e këtij "Commonwealth-i" me rreth 300 milion njerëz, ishte Jugosllavia, e cila konsiderohej si aleati numër një i BS. Jugosllavia kërkonte të realizonte një politike të veçantë dhe autoritare kryesisht drejt shteteve të Ballkanit. Kjo synonte realizimin e një projekti për krijimin e federatës ballkanike, fillimisht me Bullgarinë dhe Shqipërinë, gjë që ngjalli pakënaqësinë e BS. Projekti i federatës ballkanike ose edhe më gjerë një konfederate danubiane, i promovuar nga Tito, tejkalonte mjaft politikat e Stalinit, i cili nuk mund të pranonte krijimin e një federate shtetesh që do të nxiste lojën e forcave centrifugale për të fituar autonomi nga Moska. Sipas ambasadori francez në Beograd dhe homologu i tij britanik në Moskë arritën në përfundimin se: "Nuk ka dyshim se zbatimi i një formule federale - me ose pa Poloninë dhe Çekosllovakinë - mund të çonte në copëtimin e bllokut të shteteve lindore". Ky ishte një rrezik që Stalini nuk mund ta nënvlerësonte.

Prishja mes Moskës-Beogradit dhe dënimi i Jugosllavisë nga *Byroja Informative* (28.06.1948) përmbysën situatën gjeopolitike në Ballkan. Sistemi sovjetik këtu u shemb. Pasoja e parë e skizmës jugosllave është likuidimi i luftës civile në Greqi, e cila kthehet plotësisht nga perëndimi. Pasoja e dytë është afrimi i ngadalshëm, por i qëndrueshëm i Jugosllavisë me Perëndimin. Të gjitha këto ngjarje shënuan evolucionin e situatës ndërkombëtare në Ballkan dhe ndryshuan balancën e pushtetit midis dy kampeve në rajon. Perëndimi rimori iniciativën për të rivendosur pjesërisht gjendjen e cila ishte komprometuar rrezikshëm nga iniciativat sovjetike që synonin zgjerimin e zonës së ndikimit sovjetik përtej asaj që parashikonte marrëveshja e Moskës (10.11.1944) për përqindjet *Churchill & Stalin*.

Lidhja e Shqipërisë pas Jugosllavisë në vitet 1944-48, një "*aleancë e çuditshme*" për nga natyra, përfaqësonte një devijim nga politika e jashtme tradicionale shqiptare për sigurinë e pavarësisë

së vendit. Strategjia e kësaj politike imponon aleanca mbrojtëse me një fuqi të madhe sa më të largët dhe jo me një vend fqinj me pretendime aneksioniste. Marrëdhënie miqësore midis Shqipërisë dhe Jugosllavisë ose Greqisë, dhe aq më pak aleanca mes tyre ishin të pamundura për shkak të zgjerimeve dhe pretendimeve territoriale të fqinjëve të Shqipërisë. Rrethanat e paevitueshme gjeopolitike dhe veçanërisht pas 1945, *Lufta e Ftohtë* si një konflikt kryesisht ideologjik, e bënë “Shqipërinë një nga pikat kryesore ku të dy palët ndeshen mbi një terren të zakonshëm politik – që nesër mund të jetë ushtarak” (Fischer 2012:129). Në këto kushte mbijetesa e një vendi të vogël dhe të dobët si Shqipëria do të varej shumë nga faktorë të jashtëm që lidheshin me përplasjet e interesave të fuqive të mëdha dhe reflektimi i tyre në konfliktet rajonale në Ballkanin.

Konflikti Tito-Stalin më 1948 ishte një rast i mirë për ta çliruar Enver Hoxhën nga tutela e Beogradit dhe Shqipërinë nga dominimi jugosllav, duke garantuar kështu qëndrimin e tij në pushtet. Çështja e marrëdhënieve me Jugosllavinë ka pasur një rol përcaktues mbi kursin e politikës së jashtme shqiptare pas v. 1948. Qëndrimet e aleatëve të ardhshëm të Shqipërisë –B. Sovjetik dhe Kina–ndaj Jugosllavisë shërbyen për regjimin e Tiranës, si një barometër për marrëdhëniet e tyre me Shqipërinë. Kjo për arsye se pavarësisht nga evolucioni i situatës ndërkombëtare, Hoxha vazhdoi ta shihte Jugosllavinë si kërcënim serioz për regjimin politik dhe pavarësinë e vendit, të cilin ai e identifikonte me pushtetin dhe rolin e tij personal në drejtimin e vendit.

Aleanca e Tiranës me Moskën shënoi ngritjen e statusit të Shqipërisë nga një protektorat jugosllav në një *dominion* sovjetik, ku lidhjet me Kremlinin, si qendra e *Commonwealth-it* sovjetik, tashmë mbaheshin direkt pa ndërmjetësinë e Beogradit. Prishja e marrëdhënieve sovjeto–jugosllave e rriti mjaft vlerën e Shqipërisë për BS. Nëpërmjet Shqipërisë, Moska ushtronte presion politik dhe ushtarak mbi regjimin e Titos. Rasti i Shqipërisë si një vend gjysmë kolonial në raportet e saj me Jugosllavinë, justifikonte kritikën e Informbyrosë për

politikat shoviniste të Jugosllavisë ndaj një vendi të vogël dhe devijimet ideologjike të regjimit titist. Çuditërisht të njëjtat kritika bëheshin edhe nga Tito ndaj politikës sovjetike në raport me Jugosllavinë, të cilat u bënë publike në letër-këmbimin midis udhëheqësve jugosllavë dhe atyre sovjetikë për mosmarrëveshjet mes dy vendeve që dolën hapur në mars-maj 1948.⁶

Konflikti midis BS dhe Jugosllavisë dëshmon marrëdhëniet asimetrike dhe raportet e varësisë që ekzistonin në gjirin e *Commonwealth-it* sovjetik, të cilat do të bëhen burim konfliktesh midis dominioneve sovjetike dhe kupolës drejtuese në Moskë. Gjatë drejtimit nga Hrushovi (1953-1964), BS ja doli të ruante *status quo* në Evropën perëndimore dhe qendrore, por problemet reale u ndeshën në marrëdhëniet e tij me qeveritë socialiste të Evropës Lindore. Më gjithë këto vështirësi vendi i vetëm evropian-lindor që shkëput plotësisht nga BS në këtë kohë ishte Shqipëria, e cila u bë një avant-post i Kinës në perëndim. Sigurisht që ky ndryshim fronti nuk pati ndonjë ndikim real mbi pushtetin sovjetik në Ballkan, por PKSh tani ishte një mjet i përshtatshëm me anë të të cilit kinezët mund t'i drejtoheshin Evropës, një çështje kjo me rëndësi të madhe përderisa dy fuqitë më të mëdha komuniste kishin mosmarrëveshje (Jelavich 1974: 405, 409).

Marrëdhëniet sovjetiko – shqiptare ishin asimetrike dhe karakterizoheshin nga varësia ekonomike, ushtarake dhe në politikën e jashtme të Shqipërisë nga BS. Veçanërisht për BS rëndësi të madhe kishte pozita strategjike e Shqipërisë në Adriatik dhe bazat e saj detare kishin vlerë për strategjinë ushtarake sovjetike në Ballkan dhe më gjerë në Mesdhe. Kjo rëndësi e veçantë ishte theksuar nga N. Hrushovi në takim me E. Hoxhën (Moskë, prill 1957), se “Shqipëria ishte bazë me rëndësi të madhe strategjike për mbrojtjen e kampit”, ndërsa ministri sovjetik i mbrojtjes gjenerali Zhukov, i kishte shprehur atij vlerësimin “se për Flotën e Detit të Zi një pengesë e madhe ishin Dardanelet, Bosfori dhe ishujt e shumtë të Greqisë”. Hoxha, duke

⁶ Arkivi Qendror Shtetëror, Komiteti Qendror i PPSH, Fondi 14/Dosja 3, viti 1948. (më pas AQSH, F.14...)

përfituar nga këto gjykime të udhëheqjes së lartë sovjetike, pas kthimit nga vizita në Moskë, nxitoi të prezantonte përpara Byrosë Politike të PPSH idenë që “mbrojtja e Shqipërisë të konsiderohej si mbrojtje e çdo pike të BS dhe nëse Sevastopoli është i rëndësishëm, Vlora të bëhej kështjellë para Sevastopolit”. Nga kjo, përfundonte Enver Hoxha, “ne nuk kemi humbje dhe BS do t’i vijë shumë mirë nga një kërkesë e tillë”.⁷ Pikërisht këtë moment e shfrytëzoi Enver Hoxha për të propozuar që Baza e Vlorës, së bashku me ishullin e Sazanit, të ishte e nivelit të lartë dhe të bëhej bazë e Traktatit të Varshavës.⁸ Me anë të kësaj iniciative, Enver Hoxha afishonte veten si lideri më besnik ndaj BS-së dhe bllokut komunist.

Shqipëria, si edhe në rastin e aleancës me Jugosllavinë, mbetej e varur nga ndihma e huaj. Në aleancën me BS, Shqipëria kishte një nivel më të lartë përfitimesh në interesat ekonomike e ushtarake nga pala sovjetike. “Ushtria shqiptare gati tërësisht mbahej me financimet sovjetike, uniforma, ushqime, armatime, municione dhe të gjitha falas”, shkruan Hrushovi në kujtimet e tij. (Hrushov 2004: 136) Si anëtare e Traktatit të Varshavës, Shqipëria formalisht ndjehej e sigurt, por praktikisht e cënueshme për shkak të izolimit territorial me pjesëtarët e paktit, fakt që komplikonte dhënien e ndihmës ushtarake në rast nevojë. Në politikën e brendshme pavarësia e Tiranës ishte relativisht më e madhe, pasi Moska kishte prioritetet globale dhe nuk dëshironte të rrezikonte me ndërhyrje brutale larg kufijve të bllokut sovjetik. Ky ishte një ndryshim jo i vogël në krahasim me hijen e rëndë mbytëse të Jugosllavisë titiste.

Pas vdekjes së Stalinit (1953), në marrëdhëniet ndërkombëtare në Evropë udhëheqja e re sovjetike synonte të ulte tensionet me Perëndimin, por në Ballkan ajo kishte edhe një objektiv tjetër të rëndësishëm të politikës së saj të jashtme— normalizimin e marrëdhënieve me

⁷ Arkivi Qendror i Forcave të Armatosura, Fondi Sekretariati, Dosja 271, viti 1957.

⁸ Midis Shqipërisë dhe BS u nënshkruan për këtë qëllim dy protokolle përkatës, më 12 shtator 1957 dhe më 3 prill 1959, ku parashikohej vendosja e 12 nëndetësve me specialistë sovjetikë, ndonëse ata do të mbanin uniformat e ushtrisë shqiptare dhe mjetet detare do të kishin flamurin shqiptar, pasi logjistika dhe personeli shqiptar, nuk ishin ende të përgatitur. Ky status dualist i bazës ushtarake detare të Vlorës do behet më 1961 objekt konflikti midis Shqipërisë dhe BS.

Jugosllavinë. Afrimi sovjeto-jugosllav dhe përmirësimi i marrëdhënieve Moskë-Beograd, u perceptua nga udhëheqja shqiptare si një kërcënim serioz për pavarësinë e vendit. Me vizitën e Hrushovit në Beograd (27.05. - 2.06. 1955), që solli pajtimin me Jugosllavinë, e cila shikohej si armiku kryesor nga Tirana, BS injoroi interesat politike të Shqipërisë. Dominimi jugosllav në vitet 1944-1948, i kujtonte qeverisë shqiptare se afrimi Moskë-Beograd mund të bëhej jo vetëm në dëm të interesave të Shqipërisë, por edhe të vetë regjimit të Hoxhës. Nën presionin e Hrushovit, në një mbledhje të byrosë politike të Komitetit Qendror të PPSH-s (27.05.1955), Enver Hoxha theksonte se ishte i “gatshëm” që të përmirësonte marrëdhëniet me shtetin fqinj, por ai shtoi se Tito dhe Partia Komuniste Jugosllave janë përpjekur të rrezikojnë sovranitetin e R. P. Shqiptare si dhe udhëheqjen marksiste-leniniste të saj. Ato, shprehet Hoxha, “kërkonin të okuponin Shqipërinë me forca të armatosura, të shkëpusnin vendin tonë nga Bashkimi Sovjetik dhe të krijonin edhe provokacione ndërkombëtare”.⁹

Mosmarrëveshjet ideologjike mes Tiranës dhe Moskës u shfaqën pas fjalimit sekret të Hrushovit në Kongresin XX të PKBS (shkurt 1956), ku dënohej Stalini. Hoxha nuk pranoi të bëhej pjesë e fushatës kundër diktatorit sovjetik pasi kjo rrezikonte pozitën e tij dhe të bashkëpunëtorëve të tij. Duke mbrojtur Stalinin, Hoxha mbronte regjimin e tij dhe metodat diktatoriale të qeverisjes së vendit. Në përputhje me kursin e tij të destalinizimit Hrushovi nuk miratonte metodat diktatoriale të qeverisjes së Hoxhës, të cilat ranë fort në sy gjatë punimeve të Konferencës së Partisë së Tiranës (prill 1956) ku pati kundërshtime të hapura ndaj “kultit të individit” dhe u kërkua që politika e PPSH të analizohej sipas orientimeve të Kongresit të XX të PK të BS. Për politikën e jashtme sovjetike më shumë interes kishte Jugosllavia se sa Shqipëria. Ndërkohë që sovjetikët prishnin marrëdhëniet me Shqipërinë, ata afroheshin me Jugosllavinë (Löwenthal 1964: 301). Krahas konfliktit për bazën ushtarake detare në Vlorë (mars-maj 1961), i cili rezultoi me largimin e ushtarakëve sovjetikë nga baza dhe përjashtimin

⁹ AQSH, F. 14 / Byroja Politike, Dosja 16, viti 1955.

de facto të Shqipërisë nga Traktati i Varshavës, pesha e faktorit jugosllav në marrëdhëniet sovjeto-shqiptare, bindën elitën drejtuese shqiptare se për të mbrojtur sigurinë e Shqipërisë nuk mund të mbështetej të Bashkimi Sovjetik. Të njëjtin perceptim do të kishin drejtuesit shqiptarë edhe në dy dekada më pas, kur Kina do të afrohej me Jugosllavinë dhe Tito do të pritej me nderime në Pekin (gusht-shtator 1977).

Lindja dhe perëndimi i një lidhje të skajshme

Shqipëria, si të gjitha fuqitë e vogla, kërkonte një aleat të madh, mundësisht sa më larg, që të mund të garantonte sigurinë e saj nga fqinjë më të fuqishëm, por që nuk do të përbënte rrezik për pavarësinë e saj. Në kushtet e Luftës së Ftohtë dhe pas prishjes së marrëdhënieve me BS, kjo pozitë bëhej më delikate për një vend të vogël si Shqipëria, e ndrydhur mes dy blloqeve. Kina e kishte të pamundur të mbronte Shqipërinë për shkak të largësisë dhe mungesës së mjeteve të përshtatshme ushtarake. Por Kina mund t'i siguronte Shqipërisë një mbështetje të dobishme politike nga jashtë dhe për më tepër po për shkak të largësisë, ajo nuk përbënte edhe ndonjë kërcënim serioz për pavarësinë e Shqipërisë. Kina kështu plotësonte më së miri kërkesat themelore për një lidhje të ngushtë aleance me Shqipërinë (Biberaj 2014: 47).

Për shumë çështje me rëndësi, ekonomike apo ideologjike, qëndrimet e Tiranës përkonin me ato të Pekinit. Kina ishte në gjendje dhe e gatshme të ndihmonte Shqipërinë dhe të plotësonte kërkesat ekonomike dhe të shmangte kështu pengesat në procesin e industrializimit të saj. Shqipëria dhe Kina ishin dy vendet më të skajshme të bllokut sovjetik, jo vetëm nga ana gjeografike, por dhe nga përmasat e tyre dhe fuqia. Për këtë arsye marrëdhëniet mes tyre kanë qenë mjaft asimetrike dhe të pazakonta. Marrëdhëniet shqiptaro-kineze (1949-1978), u përcaktuan nga faktorë të ndryshëm, gjeopolitikë, ekonomikë, ideologjikë, qëndrueshmëria e regjimit politik si dhe roli i udhëheqjes. Ato kanë kaluar nëpër tre faza të ndryshme; në fazën e

parë të tyre 1949-1959, për shkak të kontekstit ndërkombëtar, Kina dhe Shqipëria i dhanë përparësi sigurisë kombëtare dhe qëndrueshmërisë së regjimit politik.

Regjimet komuniste në Kinë, si edhe në Shqipëri, ishin ashpërsisht anti-perëndimorë dhe më e rëndësishmja anti-jugosllavë. Hrushovi ishte kritikuar nga kinezët për afrimin e tij me Titon dhe, “revizionizmin” jugosllav kinezët e konsideronin njëloj si shqiptarët, të rrezikshëm për bllokun komunist. Por faktori kryesor për krijimin e lidhjeve të ngushta mes Pekinit dhe Tiranës ishte ftohja e marrëdhënieve të tyre me Moskën. Konflikti politik mes Kinës e BS përkoj me prishjen e marrëdhënieve sovjeta-shqiptare (1960-61). Me realizimin e procesit të destalinizimit, mes kinezëve e sovjetikëve filluan mosmarrëveshjet për shumë çështje politike, ideologjike, ushtarake dhe kufitare. Në konfliktin sovjeta-kinez, Shqipëria mbajti anën e Kinës për shumë arsye politike dhe ideologjike. Drejtuesit shqiptarë dhe ata kinezë kishin pikëpamje të ngjashme lidhur me procesin e destalinizimit, pasi Mao Ce Duni nuk mund të rrezikonte kultin e tij të individit për shkaqe të pozitive të brendshme politike të Hrushovit. Shqipëria dhe Kina nuk ishin dakord edhe me çështjet kryesore të politikës së jashtme të BS si p.sh. me bashkekzistencën paqësore me Perëndimin. Një detantë me Perëndimin dhe Jugosllavinë shihej nga Hoxha, si një kërcënim ndaj regjimit të tij dhe politikës së ashpër, të cilat mund të justifikoheshin më mirë në rrethanat e tensioneve ndërkombëtare. Këto çështje përbënin një shqetësim madhor për elitat drejtuese si në Tiranë dhe Pekin, pasi ishin të lidhura ngushtë me stabilitetin e regjimit dhe pushtetin e tyre personal.

Në fazën e dytë të marrëdhënieve shqiptaro-kineze (1961-1969), u theksua tej mase roli i pavarësisë kombëtare në kushtet e detantës dhe veçanërisht të bashkëpunimit sovjeta-amerikan. Shqipëria dhe Kina i dhanë diplomacisë së tyre një frymë radikale dhe virulente, që drejtohej kundër “hegjemonisë së dyfishtë sovjeta-amerikane”. Për Shqipërinë dhe Kinën, dy shtete me dominim të fortë ideologjike, kjo shprehte një përzierje të çuditshme mesianizmi revolucionar me realpolitikën. Kjo politikë e skajshme arriti kulmin në momentin e *Revolucionit Kulturor*.

Shqipëria u ndikua nga ky revolucion dhe imitoi disa politika të kinezëve: si parimi i mbështetjes në forcat e veta, heqja e gradave në ushtri dhe pjesëmarrja e kuadrove në punë prodhuese. Por këto politika përputheshin edhe me pikësynimet e PPSH në pushtet. Megjithatë, ndikimi i Kinës mbi politikat e brendshme të Shqipërisë ka qenë mjaft i kufizuar. Mendimit të Mao Ce Dunit nuk ju dha asnjëherë përparësi ndaj mendimit të Enver Hoxhës, i vetmi burim për nismat politike dhe zbatimin e tyre.

Pekini ishte i interesuar kryesisht për solidaritetin ndërkombëtar me Shqipërinë. Kina vlerësonte aleancën miqësore me Shqipërinë dhe i përgjigjej kërkesave të saj ekonomike. Shqipëria nxori përfitime të mëdha nga ndihma ekonomike kineze, transferimi i armëve, specializimi i kuadrove, në këmbim të lidhjeve të solidaritetit me Kinën. Këto lidhje u vënë përpara një sprove të vështirë me pushtimin e Çekoslovakisë nga BS (gusht 1968), i cili alarmoi udhëheqjen shqiptare. Propozimi i kryeministrit kinez Çu En Lai (shtator-tetor 1968), se e vetmja mënyrë që Shqipëria të përballonte një sulm të mundshëm nga BS, ishte një aleancë ushtarake me Jugosllavinë dhe Rumaninë, vuri në dilemë drejtuesit në Tiranë (Biberaj 2014: 86).

Në këto rrethana objektivat gjeopolitike në Tiranë dhe Pekini u rivlerësuan, gjë që ndikoi në shfaqjen e divergjencave ideologjike dhe mosmarrëveshjeve politike mes tyre. Kjo shënon dhe fazën e tretë atë të dobësimit e tendosjes së lidhjeve shqiptaro-kineze (1971-1978). Drejtuesit shqiptarë filluan të kuptojnë se mbështetja për mbrojtje vetëm te Kina e largët dhe e dobët ushtarakisht nuk ishte garanci e mjaftueshme për sigurinë e vendit, pavarësisht se ministri i jashtëm kinez Chen Yi kishte paralajmëruar “se provokacionet dhe qëllimet turbulluese të imperialistëve, revizionistëve jugosllavë dhe reaksionarë të vendeve të ndryshme ndaj Shqipërisë do të dështonin me turp” (Dutt 1966: 127). Në Tiranë mendohej se Pekini ishte i interesuar më tepër për mbështetjen e qëllimeve politike të Kinës në Ballkan se sa për sigurinë

e Shqipërisë. Në këto kushte, më mirë për drejtuesit shqiptarë do të ishte të mos e lidhnin veten pas planeve kineze.

Në fillim të viteve '70 politika e jashtme kineze pësoi ndryshime të thella. Kina hoqi dorë nga qëndrimet e skajshme të *Revolucionit Kulturor*, i cili nxori në shesh prapambetjen, dhe izolimin diplomatik. Duke nxjerrë mësim nga izolimi ndërkombëtar i viteve '60-të, Kina përfundimisht u orientua nga një politikë me prioritet modernizimin e vendit, që natyrisht do shoqërohej edhe me një hapje me botën e jashtme. Që në vitet 1969-1971, Pekini vendosi t'i përgjigjej propozimeve amerikane, "pasi ishte bërë nevojë strategjike rifillimi i kontakteve me ShBA" (Kissinger 2013: 236) dhe u angazhua në një proces detante dhe normalizimi marrëdhëniesh me ShBA, Japoninë, Komunitetin Evropian dhe vende të ndryshme pro-perëndimore të Botës së Tretë.

Kjo politikë favorizoi pranimin e RPK në OKB, e realizuar me miratimin nga Asambleja e Përgjithshme e OKB, në 25 tetor 1971, të rezolutës së paraqitur nga Shqipëria. Rivendosja e të drejtave të ligjshme të RPK në OKB, nxiti shtetet kryesore evropiane-perëndimore të normalizonin marrëdhëniet e tyre me Pekinin. Diplomacia shqiptare me përkushtim profesional u bë zëdhënësja kryesore e të drejtave të ligjshme të Kinës në OKB. Kjo mundësoi hapjen e Kinës me botën dhe Perëndimin, ndonëse vetë Shqipëria, në mënyrë paradoksale, vazhonte të qëndronte e mbyllur ndaj Perëndimit. Ky moment i rëndësishëm përkoi me ftohjen e marrëdhënieve mes dy vendeve. Në Evropën Lindore, gjatë viteve '70, Kina u afrua me të gjithë shtetet socialiste që ruanin ende një minimum pavarësie ndaj BS (Joyaux 1983: 101). Qeveria kineze vendosi emërimin e një ambasadori në Beograd (qershor 1970), ku që prej vitit 1958, ajo përfaqësohej nga një i ngarkuar me punë. Afrimi kino-jugosllav krijoi shqetësime në Tiranë, ku me shumë gjasa bëhej analogji me afrimin sovjetik-jugosllav të 1955, që përfundoi me prishjen sovjeta-shqiptare.

Në të kundërtën, marrëdhëniet e Kinës me Shqipërinë, i vetmi aleat evropian-lindor i viteve '60, filluan të përkeqësohen gradualisht. Këto marrëdhënie tashmë ishin tronditur seriozisht nga vizita e presidentit Nikson në Pekin (shkurt 1972) dhe afrimi mes Kinës dhe ShBA. “Kjo vizitë është nga të paktat raste kur një vizitë shtetërore shkakton ndryshim themelor të çështjeve ndërkombëtare” (Kissinger 2013: 291). Drejtuesit shqiptarë nuk e kishin pritur aspak mirë përmbysjen e thellë të kursit në politikën e jashtme kineze dhe dënimin e “Bandës së të Katërve” (tetor 1976). Një nga drejtuesit më të flaktë të këtij grupi radikal, Çjan Çin, duke folur në emër të kryetarit Mao, kishte shpërndarë në mars 1975 në ambasadat kineze nëpër botë, një dokument ku thuhej se qëllimi i politikës së jashtme kineze ishte “fitorja e komunizmit në botë dhe nxitja e revolucionit në vendet e Botës së Tretë, si një revolucion me etapa” (Ladany 1988: 375). Kjo vijë ngjasonte me atë të E. Hoxhës, që do bëhej publike pak më vonë. Divergjencat mes dy vendeve dolën hapur me kritikën që ju bë “teorisë së tre botëve” në kryeartikullin e *Zërit të Popullit* (7.07.1977), titulluar “Teoria dhe praktika e revolucionit.” Një vit më vonë, ditë më ditë (7.07.1978), qeveria kineze njoftonte Tiranën se ndërpriste të gjitha ndihmat ekonomike dhe ushtarake për Shqipërinë dhe tërhiqte gjithë specialistët kinezë që punonin në Shqipëri.

Prishja e aleancës me Kinën krijoi për Shqipërinë një situatë krejt të pazakontë. Ishte hera e parë në historinë e tij të re, që shteti shqiptar mbetej pa një protektor të huaj dhe pa mbështetje ekonomike. Kjo shprehte bindjen e një pjese të elitës politike shqiptare se vendi mund të mbijetonte si një shtet i pavarur pa mbrojtjen e ndonjë fuqie të madhe. Kostoja e kësaj zgjedhje afat-shkurtër, për Shqipërinë ishte mjaft e lartë. Zhvillimi dhe modernizimi i vendit u sakrifikuan për hir të pavarësisë dhe prestigjit ndërkombëtar. Por jo për shumë kohë!

Bibliografia

Archives du Ministère des Affaires Etrangères, Paris.

Arkivi Qendror i Forcave të Armatosura, Fondi Sekretariati, Tiranë.

Arkivi Qendror Shtetëror, Komiteti Qendror i PPSH, Fondi 14, Tiranë.

Arkivat Qendrore Ruse, Shqipëria dhe Kosova në Arkivat Ruse 1946-1962, Botimi nga Kaba.

H, Çeku. E, (2011), Shtëpia Bot. Brezi 81, Prishtinë.

Bethell, N. (1984) *The Great Betrayal: The Untold Story of Kim Philby's Biggest Coup*, London: Hodder & Stoughton.

Biberaj, E. (2014) *Shqipëria dhe Kina, Një aleancë e pabarabartë*, AIIS, Tiranë.

Campbell, J. C. (1947) *The United States in World Affairs: 1945 -1947*, New York and London: Harper & Brothers.

Dutt, V. P. (1966) *China and the World, An Analysis of Communist China's Foreign Policy*, FREDERICK A. PRAEGER, *Publishers*, New York – Washington.

Fischer, B. (2012) *Shqipëria 1943-1945: Një vështrim përmes dokumenteve perëndimore*, Tirane: AIIS.

Gjilas, M. (2006) *Si e njoha Josif Broz Titon, Shtëpia Botuese "55"*, Tiranë.

Hrushov, N. (2004) *Unë nuk jam gjykatës, Kujtime*, Tiranë: Ombra GVG.

Jelavich, B. (1974) *St. Petersburg and Moscow, Tsarist and Soviet Foreign Policy, 1814-1974*, Indiana University Press, Bloomington – London.

Joyaux, F. (1983) *La politique extérieure de la Chine populaire*, Paris, Presses Universitaires de France.

Kissinger, H. (2013) *Për Kinën*, Tiranë: Botimet TOENA.

Ladany, L. (1988) *The Communist Party of China and Marxism 1921-1985*, C. Hurst & Company, London.

Löwenthal, R. (1964) *Khrouchtchev et la désagrégation du bloc communiste*, Paris, Calmann-Lévy.

Quaroni, P. (1956) Valigia diplomatica, Milano: GARZANTI.

Fillimi i fundit: presioni i Perëndimit për të drejtat e njeriut në Shqipëri

Në ligjërimin publik të sotëm jemi mësuar t'i referohemi më së shumti Lëvizjes Studentore, kur analizojmë dhe përkujtojmë rënien e regjimit komunist, aq sa ndonjëherë duket sikur gjithçka filloi dhe mbaroi atje. Pa dashur në asnjë mënyrë të ul rëndësinë e kësaj Lëvizjeje, mendoj se në vërtetë, shembja e regjimit komunist në Shqipëri ishte një proces që kishte filluar shumë më herët dhe në këtë proces, shqiptarët nuk ishin aktorët e vetëm. Qëllimi i këtij prezantimi është të analizojë një prej faktorëve që ndikoi në dorëzimin e regjimit: presionin e Perëndimit për të hequr dorë nga një prej shtyllave ku mbështetej ai: në mohimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut dhe represionin ndaj qytetarëve të Shqipërisë.

Mohimi i të drejtave të njeriut në Shqipërinë komuniste është tashmë një realitet i njohur nga të gjithë. Shqipëria përjetoi një regjim stalinian, i cili jo vetëm nuk njohu të ashtuquajturin “socializëm me fytyrë njeriu” (Hodos 2000: 255-256), që njohën shtetet e tjera të Lindjes Komuniste, por përkundrazi arriti në absurditete të tilla si: mohimi tërësor i besimeve, mohimi pothuajse i plotë i pronës private, futjes së konceptit të ridënimit për të burgosurit politikë, duke e bërë kalvarin e tyre të pambarim. Në kushtet kur elita intelektuale e trashëguar nga periudha para Luftës së Dytë Botërore ose u eliminua fizikisht, ose u marginalizua; kur elita e re intelektuale jetonte në një izolim të skajshëm ndërkombëtar dhe shtypej me egërsi për shenjën më të vogël të tendencave për të dalë jashtë “shinave” ideologjike të partisë-shtet, do të ishte e vështirë të pritej (ashtu sikurse dhe nuk ndodhi) një lëvizje mirëfilli disidente në Shqipërinë e atyre viteve.

Deri nga mesi i viteve '70 edhe nga Perëndimi ishte e pamundur t'i bëhej presion qeverisë shqiptare, apo aq më pak të ndërkombëtarizohej çështja e shkeljes së të drejtave dhe lirive të njeriut. Parimisht organizatat ndërkombëtare si Kombet e Bashkuara kishin pranuar si parim bazë të tyre mbrojtjen e këtyre të drejtave, por aktet e miratuara prej tyre nuk kishin forcë detyruese juridike, duke qenë se aktet kishin formën e deklaratave (pra ato shpallnin të drejtat, por nuk vendosnin sanksione në rast shkeljeje të tyre).^{1*} Nga ana tjetër, parimi i mbrojtjes së të drejtave dhe lirive të njeriut binte ndesh me një tjetër parim të pranuar ndërkombëtarisht, atë të ruajtjes së sovranitetit të shteteve dhe mosndërhyrjes në punët e tij të brendshme. Deri në fillim të viteve '80-të, qeveria shqiptare kishte refuzuar në mënyrë të vazhdueshme t'i përgjigjej akuzave të bëra nga individë, grupe apo organizata në lidhje me shkeljen e të drejtave të njeriut në Shqipëri, të cilat në të shumtën e rasteve i bëheshin të ditura me anë të Sekretariatit të Përgjithshëm të OKB-së. Formula ishte e gatshme dhe e njëjtë për të gjitha rastet: këto konsideroheshin shpifje dhe ndërhyrje në punët e brendshme të shtetit.

Situata ndryshoi në mes të viteve '70-të dhe kjo i atribuohet, para së gjithave, nënshkrimit të Kartës së Helsinkit (25 gusht 1975), "shporta e tretë" e të cilës fliste për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut. Në pamje të parë, duket pak absurde që një Konferencë, në të cilën Shqipëria nuk ishte pjesëmarrëse dhe, si pasojë, nuk njohu asnjë nga vendimet e saj të kishte ndonjë efekt në politikën e brendshme të vendit. Konferenca, në vetvete, nuk ndryshoi asgjë për jetën e përditshme në Shqipëri, përkundrazi gjatë viteve 1973-1975 kur ajo zhvillonte punimet, regjimi vazhdonte me ashpërsi politikën e tij të represionit, duke shtypur egërsisht

¹ Human Rights Here and Now, celebrating Universal Declaration of Human Rights, edited by Nancy Flowers, appendix 3, A Human Right Glossary, në: http://www1.umn.edu/humanrts/edumat/hreduseries/hereandnow/Part-5/6_glossary.htm, vizituar më 14.01.2016.

*Konventat për aspekte të caktuara të të drejtave të njeriut si: kundër torturës dhe gjenocidit, për të drejtat e gruas i takojnë viteve '60-të dhe ratifikimi i tyre nga shtetet anëtare të OKB mori shumë kohë.

revoltën e burgut të Spaçit, arrestuar dhe dënuar tre grupe “armiqësore”: të kulturës, ekonomisë dhe ushtrisë dhe një sërë dënimesh të tjera.

Ajo që ndryshoi dhe që nuk mund të mos kishte ndikim edhe në Shqipëri ishte koniunktura ndërkombëtare në lidhje me këtë çështje. Parimi i mosndërhyrjes në punët e brendshme dhe sovranitetit absolut të shteteve, u bë më relativ sa i takon fushës së të drejtave dhe lirive të njeriut. Lindja komuniste për herë të parë pas Luftës së Dytë Botërore filloi të fliste për të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, ndërsa organizmat ndërkombëtare, përfshirë dhe OKB përmirësuan dhe i bënë me efektive procedurat për njoftimet e grupeve dhe shteteve të ndryshme sa i takon shkeljes së të drejtave të njeriut*. Kjo i hapi rrugë rritjes së presionit të Perëndimit ndaj Tiranës zyrtare sa i takon kësaj çështjeje. Është me vend të theksojmë se sa i takon ndikimit të KSBE për mbrojtjen e të drejtave të njeriut në Bllokun Komunist ka disa mendime që jo gjithmonë konvertojnë. Studiuesi Pol Johnson mendon se krijimin e Komiteteve të të Drejtave të Njeriut, një detyrim që buronte nga Karta e Helsinkit, shtetet komuniste të Lindjes e përdorën si një metodë të lehtë për të evidencuar dhe eliminuar disidentët (Xhonson 2000: 250). Autorë të tjerë, përkundrazi mendojnë se “Konferenca e Sigurimit Evropian luajti kështu një rol të rëndësishëm të dyfishtë: në fazat e saj përgatitore ajo moderoi qëndrimin sovjetik në Evropë dhe, më pas, ajo shpejtoi përmbysjen e perandorisë sovjetike” (Kissinger 1999: 760). Zhvillimet historike i japin të drejtë Kissinger, pasi vendimet e Konferencës shërbyen si truall mbështetës për lëvizjet disidente që lindën në vendet ish-komuniste, të tilla si: Karta 77 në Çekosllovakia, apo Lëvizja Solidarnos në Poloni (Kaba 2012: 153-154).

Gjithsesi rruga për ta bërë qeverinë shqiptare të bënte ndonjë kthesë të ndrojtur dhe të gjente rrugën e bashkëpunimi me organizmat ndërkombëtarë dhe në fushën e të drejtave të njeriut

*Më 6 mars 1974, me anë të Rezolutës 2 (XXX) të Komisionit të të Drejtave të Njeriut, të aprovuar nga Komisioni Ekonomik dhe Social me vendimin e tij 15 (LVI) i krijua grupi për shqyrtimin e shkeljeve flagrante të të drejtave të njeriut. Ky grup përbëhej nga 5 anëtarë të KDNJ, të cilët ishin në nivel ekspertësh. Anëtarët gjeografikisht ndaheshin: Azia, Afrika, Amerika Latine, Evropa Lindore dhe ajo Perëndimore dhe shtete të tjera.

ishite e gjatë dhe shumë e vështirë. Si rregull, Ministria e Jashtme e Shqipërisë i injoronte në mënyrë këmbëngulëse njoftimet që i vinin kryesisht nga OKB. Kështu bëri ajo dhe me raportin e Amnesty International të vitit 1977, i cili e akuzonte për shkeljen e lirisë së besimit dhe të ndërgjegjes në Shqipëri. Duke iu referuar dënimit me vdekje të klerikut 74-vjeçar, Dom Shtjefën Kurti (1974), letra akuzonte qeverinë shqiptare për dënim dhe keqtrajtim të klerikëve për shkak të besimit të tyre.² Të njëjtin fat pësoi edhe një tjetër raport dërguar OKB-së më 1981 nga “Komiteti Shqipëria e Lirë” i cili ngrinte akuza të forta kundër Tiranës zyrtare, e cila, sipas letrën, po ushtron gjenocid mbi popullsinë shqiptare duke e shndërruar vendin “në një burg të madh, ku 7 % e popullsisë trajton pjesën tjetër si qytetarë të dorës së dytë”.³

Presioni ndaj vendit të vetëm të Evropës, i cili nuk kishte nënshkruar Kartën e Helsinkit u shtua në fillim të viteve '80 dhe iniciatorët u bënë për ironi të fatit, qarqet vorio-epirote në SHBA. Duke përfituar nga përmirësimi i procedurave për shqyrtimin e ankesave për shkeljen e të drejtave të njeriut në OKB, ato dërguan gjatë viteve 1982-1983, disa raporte duke arritur t'i tërhiqnin vëmendjen Komisionit të të Drejtave të Njeriut për atë, që ata e konsideronin shkeljen e të drejtave të njeriut ndaj minoritetit grek në Shqipëri. Letrat kishin karakter të theksuar nacionalist dhe nuk mungonin t'i bënin jehonë edhe pretendimeve tradicionale greke ndaj Shqipërisë.⁴ Pavarësisht nga kjo, letrat përmbanin dëshmitë e disa të arratisurve të vonë nga Shqipëria dhe të vërtetën tronditëse: qeveria shqiptare ishte fajtores për shkeljen e të paktën 12 neneve të Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut dhe dispozitave respektive të Konventave të ndryshme ndërkombëtare.⁵

²AMPJ, V. 1977, D. 878, fl. 1, Letër e Amnesty International dërguar qeverisë shqiptare.

³AMPJ, V. 1981, D. 1114, fl. 3, Raport i komitetit “Shqipëria e Lirë”, paraqitur në Komisionit e të Drejtave të Njeriut të OKB-së.

⁴AMPJ, V. 1983-1986, D. 803, fl. 1, Kreu i Misionit shqiptar pranë OKB, Justin Papajorgji për Ministrinë e Punëve të Jashtme, 7 tetor 1984.

⁵Po aty, fl. 90-98.

Si edhe më herët, MPJ të Shqipërisë mendoi ta injoronte gjithë procesin dhe vendosi të mos i përgjigjej komisionit për të Drejtat e Njeriut dhe të mjaftohej vetëm me një notë drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së, më frazën standarde shpifje nga qarqe antishqiptare.⁶ Por, Tirana zyrtare u gjend përballë një procesi që tashmë kishte marrë rrugë dhe nuk do të ishte më në dorën e saj të ndalej. Komisioni i të Drejtave të Njeriut në Gjenevë e diskutoi problemin në sesionit e tij të 40-të. Shumica e diskutimeve të shteteve anëtarë të Komisionit të të Drejtave të Njeriut tejkaluan çështjen e të drejtave të minoritetit grek në Shqipëri dhe tërhoqën vëmendjen se këto shkelje kanë karakter të përgjithshëm dhe përfshinin të gjithë qytetarët shqiptarë.⁷ Qeveria shqiptare mbeti e zhgënjyer kur u njoh me procesverbalin e bisedimeve. Atje edhe përfaqësuesit e shteteve perëndimore të cilat i konsideronte mike, si p.sh Austria, kishin dënuar sjelljen e qeverisë shqiptare.⁸ Rezoluta e këtij komisioni e 5 marsit 1984 shpallte se çështja e të drejtave të njeriut në Shqipëri kërkonte sqarime të mëtejshme dhe nxiste qeverinë shqiptare të jepte observimet e saj me shpresën se kështu shqyrtimi do të përfundonte brenda sesionit të 41 të Komisionit të të drejtave të njeriut që do të mbahej vitin e ardhshëm.

Paralelisht me OKB edhe Komisioni i Jashtëm i Senatit Amerikan kishte zhvilluar në seancë dëgjimore në lidhje me të drejtat e njeriut në Shqipëri edhe kjo e iniciuar mesa duket nga lobi grek, pasi në të gjithë dëshmitarët e thirrur ishin me origjinë greke, përveç Nikolas Pano, i cili paraqiti një raport të shkruar, por nuk ishte vetë prezent në seancë. Ai i bëri të ditura mendimet e tij për situatën e të drejtave të njeriut në Shqipëri, por edhe arsyet e mungesës në seancën dëgjimore në një artikull të botuar në gazetën Liria e Bostonit, më 1 mars 1984 (Pano 1984: 3). Pavarësisht njëanshmërisë në zgjedhjen e dëshmitarëve, rezultati ishte miratimi i një raporti në të cilën dënohej qeveria shqiptare për shkelje dhe dhunim të të drejtave dhe lirive themelore të

⁶AMPJ, V. 1984, D. 804/4, fl. 91, Informacion i misionit të Përhershëm të RPSSH pranë OKB për Ministrinë e Punëve të Jashtme, 27 maj 1985.

⁷Po aty, fl. 93.

⁸Po aty, fl. 95.

njeriut.⁹ Departamenti amerikan i Shtetit bëri një deklaratë në mbështetje të raportit, duke e kthyer presionin ndaj qeverisë shqiptare për çështjen e të drejtave të njeriut në një linjë zyrtare të SHBA-ve.

Shqyrtimi i kësaj çështjeje si në organizmat e OKB, ashtu dhe të SHBA nxiti organizata të tjera të paraqisnin dëshmitë dhe studimet e tyre në lidhje me këtë çështje. Kështu p.sh., Amnesty International paraqiti një studim të gjatë me një shtojcë dokumentesh e dëshmish prej 57 faqesh, në të cilën flitej për të burgosurit politikë në Shqipëri, për kushtet e vështira në burgjet shqiptare, për përdorimin e dhunës ndaj të pandehurve gjatë hetuesisë dhe për Sigurimin e Shtetit, i cili kontrollonte deri edhe jetët private të individëve në Shqipëri¹⁰. Po kështu Konferenca e peshkopëve katolikë kanadezë paraqiti një studim të hartuar nga Gjon Sinistra, profesor në Universitetin e San Franciskos i cili fliste për mohimin e të drejtës së lirisë së besimit dhe të ndërgjegjes në Shqipëri dhe dhunën që shteti komunist kishte ushtruar ndaj institucioneve fetare dhe vazhdonte të ushtronte ndaj të gjithë atyre që praktikonin ritet fetare.

Kalimi i debatit nga një çështje e shkeljes së drejtave të njeriut të minoriteteve, në një debat ndërkombëtar mbi situatën e të drejtave të njeriut në Shqipëri e gjeti disi papërgatitur qeverinë shqiptare. Veçanërisht pas vendimit të Komisionit për të Drejtat e Njeriut për ta mbajtur të hapur çështjen e situatës së të drejtave të njeriut në Shqipëri, u bë e qartë edhe për Tiranën zyrtare se kësaj shtate nuk mund t'i ikej aq lehtë sa në të kaluarën. Më 23 prill 1984, zëvendës ministri i Jashtëm, Sokrat Plaka i dërgoi një radiogram Misionit të Përhershëm shqiptar pranë OKB në të cilën shkruan: “duke marrë parasysh mprehtësinë që ka marrë problemi i të drejtave të njeriut, merrni masa që të përgatisni një material të hollësishëm ... duke dhënë dhe mendimin tuaj mbi ecurinë e tij në të ardhmen dhe masat që duhet të merren nga ana jonë”.¹¹ Propozimi i

⁹AMPJ, V. 1984, D. 1037/8, Raport i Dhomës të Përfaqësuesve dhe Komisionit të Jashtëm të Senatit të SHBA, shkurt 1984.

¹⁰AMPJ, V. 1984, D. 1037/10, Raporti për Shqipërinë i Amnesty International, viti 1984.

¹¹AMPJ, V. 1984-1986, D. 803, fl. 74, Radiogram e Sokrat Plakës për Misionin e Përhershëm shqiptar në New York, 23 prill 1984.

menjëhershëm i Misionit shqiptar ishte injorimi i rezolutën si një veprim arbitrar “të bazuar në shpifje dhe trillime të elementeve reaksionarë dhe shovinistë”¹². Por pas kontakteve që pati me diplomatë të tjerë, qëndrimi i Misionit ndryshoi dhe ai u detyrua t’i njoftonte qendrës se çështja do të ishte e vështirë të mbyllej.

Ministria e Jashtme filloi të përgatitej kështu edhe për një përshkallëzim të situatës. Një grup i përbërë prej juristësh e diplomatësh u ngrit për të përgatitur një relacion që të përgënjeshtronte akuzat e ngritura. Grupit iu përcaktuan tezat bazë ku do të mbështetej materiali zyrtar shqiptar, i cili i përgjigjej në përgjithësi çështjes së të drejtave të minoriteteve në Shqipëri dhe përpiqej të anashkalonte çështjet e tjera të ngritura në lidhje me zbatimin e të drejtave të njeriut në përgjithësi.¹³

Gjithashtu, MPJ u përpoq të shfrytëzonte dhe koniunkturën politike të kohës. Përfaqësuesit diplomatikë shqiptarë u porositën të merrnin kontakt me autoritet në vendet ku ishin akredituar, të ndara këto sipas nivelit të zhvillimit të marrëdhënieve, dhe të përpiqeshin t’i nxisnin ato për të votuar kundër mbajtjes në rend të ditës të së këtij problemi. Por, të gjitha përpjekjet rezultuan të pafrytshme. Më 1 maj 1985 Komisioni i të drejtave të njeriut e diskutoi sërish këtë çështje, duke miratuar një rezolutë të re, e cila ishte më e rreptë në ton dhe në përmbajtje se ajo e një viti më parë. Nëse rezoluta e vitit 1984 fliste për një analizë të mëtejshme të gjendjes së të drejtave të njeriut në Shqipëri, tjetra kërkonte që çështja të shqyrtohej në mënyrë më thelbësore.¹⁴ Duket qartë se situata ndërkombëtare nuk fliste tashmë në favor të qeverisë shqiptare. E vetmja votë kundër rezolutës ishte e përfaqësuesit të Kubës, ndërsa pjesa më e madhe e shteteve të Evropës Lindore abstenuan.

¹²AMPJ, V. 1984-1985-1986, D. 803/4, fl. 4, Informacion i Misionit shqiptar pranë OKB për MPJ, në lidhje me rezolutën e Komisionit të të Drejtave të Njeriut në Gjenevë, 22 mars 1984.

¹³AMPJ, V. 1984-1986, D. 804, fl. 59-63, Informacion i MPJ për masat që duhet të merren mbi çështjen e të drejtave të njeriut, 6 korrik 1984.

¹⁴Po aty, fl. 84.

Vdekja e Enver Hoxhës ishte një motiv më shumë për Perëndimin për të shtuar presionet në mos për një ndryshim të regjimit, për një zbutje të sjelljes së tij ndaj qytetarëve. Nga ana tjetër, edhe zhvillimet në lindjen komuniste nuk po i vinin “në ndihmë” qeverisë shqiptare. Lëvizjet disidente në Poloni e Çekosllavaki, por edhe reformat e Gorbaçovit në BS po tregonin se soliditeti i regjimeve komuniste në Lindje kishte filluar në gërryhej. Tashmë edhe një tjetër organizëm ndërkombëtar, Parlamenti Evropian shtoi presionin ndaj qeverisë shqiptare. Situata e të drejtave të njeriut në Shqipëri u shqyrtua nga ky organizëm në shkurt dhe në prill 1985 dhe u arrit në konkluzionin se kishte “kufizime ekstreme të të drejtave të njeriut dhe lirive themelore për shkak të metodave staliniane të qeverisë”.¹⁵

Situatës ndërkombëtare i shtoheshin dhe vështirësitë e brendshme. Stanjacioni ekonomik i filluar që prej viteve '70-të tashmë ishte përkeqësuar dhe vendi po përballej me një krizë të vërtetë ekonomike për të cilat drejtuesi i ri i PPSH, Ramiz Alia duhet të merrte masa të menjëhershme. Pavarësisht deklarimeve të tij për “vazhdim të veprës së Enver Hoxhës”, nevojat kërkonin ndryshime të menjëhershme. Ndonëse jo në mënyrë të shprehur, regjimi e pa veten të detyruar të rishikonte shumë nga politikat e tij, por këto, në këtë fazë, nuk preknin asnjë nga problematikat e të drejtave të njeriut.

Qeveria shqiptare vendosi sërish të mos bashkëpunonte me Komisionin e të Drejtave të Njeriut për t'u përgjigjur pyetjeve të shtruara prej tij. Por gjithsesi një hap shumë i vogël u ndërmor. Mesa duket R. Alia kërkoi t'i jepte Perëndimit disa sinjale se gjërat në Shqipëri po përmirësoheshin, por pa prekur thelbin e regjimit. Kështu, Presidiumi i Kuvendit Popullor të RPSSH me miratim të BP të KQ të PPSH shpalli një amnisti me rastin e 11 janarit 1986, 40-vjetorit të shpalljes së RPSH. Sigurisht që një vendim i tillë ishte një rektifikim, i cili nuk mund ta kënaqte Perëndimin. Amnesty International, Komisioni i të Drejtave të Njeriut të OKB dhe

¹⁵AMPJ, V. 1985, D. 980, fl. 163, Pays signataires de l'Acte final d'Helsinki et Albanie.

Parlamenti Evropian po botonin dëshmi gjithnjë e më të shumta mbi dhunën që regjimi ushtronte ndaj qytetarëve të vet dhe ta kritikonin qeverinë shqiptare për refuzimin e saj të vazhdueshëm për të bashkëpunuar së paku me edhe me organizmat e OKB-së, anëtare e së cilës ishte që prej 1955.

Ndërsa Shqipëria refuzonte më kokëfortësi të bashkëpunonte me organizmat ndërkombëtarë dhe t'i konsideronte shkeljet e të drejtave të njeriut në Shqipëri si një situatë të paqenë, gjuha në rezolutat e Komisionit për të Drejtat e Njeriut të OKB vinte vit pas viti duke u ashpërsuar. Më 2 mars 1988, Komisioni i të Drejtave të Njeriut miratoi një rezolutë aspak dashamirëse ndaj Shqipërisë, në të cilën shprehej indinjata për mungesën e bashkëpunimit nga ana e qeverisë shqiptare dhe vendosi që çështja t'i kalojë për shqyrtim Komisionit Ekonomik dhe Social. Vetëm më 10 maj të 1989, Tirana zyrtare pati thyerjen e parë, kjo edhe për shkak të reformave të ndërmarra nga Alia. Ajo paraqiti një raport mbi të drejtat e njeriut në Shqipëri, i cili nuk pranonte asnjë nga akuzat e bëra nga të gjitha organizatat që merreshin me mbrojtjen e të drejtave të njeriut në Perëndim. Në të kundërtën, raport përmbante shprehje patetike për barazinë e shtetasve shqiptarë dhe se si në Shqipëri shteti i garantonte të gjithë shtetasve të drejtat e tyre. Raporti i qeverisë shqiptare së bashku me të gjitha dokumentet e tjera që dispononte Komisioni për të Drejtat e Njeriut do të shqyrtoheshin në sesionin e janar-marsit 1990, në seancë plenare.

Rënia e Murit të Berlinit ishte një ogur i mirë për shqiptarët, të cilët shpresonin ndryshime të sistemit politik në vend. Presionit të OKB, Senatit të SHBA dhe Parlamentit Evropian në fushën e të drejtave të njeriut iu shtua dhe presioni ekonomik. Nga fundi i viteve '80-të, shtetet perëndimore si Franca, RFGJ, Italia refuzonin në mënyrë të vazhdueshme eksportet shqiptare për shkak të cilësisë së dobët të tyre. Shtetet e Evropës Perëndimore, me pretekste të ndryshme

po vononin lidhjen e marrëveshjeve dhe kontratave për vitin 1990.¹⁶ Qeveria shqiptare po e ndiente veten përballë një bllokade të vërtetë ekonomike, nga e cila e kishte të pamundur të dilte nëse nuk ndryshonte në mënyrë të ndjeshme kursin.¹⁷

Por, ndërkohë Muri i Berlinit ishte rrëzuar, revolucionet demokratike kishin përfshirë të gjithë Lindjen komuniste. Në Shkodër, Tiranë e, më pas, në Kavajë kishin filluar të ndjeheshin shenjat e para të lëvizjeve antikomuniste, të cilat edhe pse të mbajtura në heshtje nga censura e regjimit kishin mundur të bënin jehonë në Perëndim. Rezoluta e miratuar më 6 mars 1990, ndonëse përshëndet faktin se qeveria shqiptare për herë të parë bashkëpunoi me Komisionin, thekson se Shqipëria nuk iu përgjigj akuzave specifike të paraqitura nga ai. Tashmë Komisioni i të Drejtave të Njeriut i kërkon Tiranës “të japë informacione për mënyrën konkrete se si masat ligjore dhe kushtetuese janë në përputhje me dispozitat e Deklaratës Universale të të drejtave të Njeriut”. Madje, Komisioni i kërkon Sekretarit të Përgjithshëm, Perez De Kuelar ta mbajë parasysht këtë rezolutë gjatë vizitës të planifikuar në Shqipëri në maj 1990.

Nevoja për ndryshime u shndërrua edhe në një thirrje të brendshme të shqiptarëve. Që pas ngjarjeve të Shkodrës ai i kërkoi Enver Halilit, sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Ministrave që të krijonte një grup pune për të parë mundësinë e ndryshimeve në Kodin Penal dhe në atë të Procedurës Penale. Në mbledhjen e Sekretariatit të KQ të PPSH të 26 marsit 1990, Alia do t`u drejtohej kolegëve të tij “Armiqtë tanë duan përmbysje të pushtetit popullor, pra është vënë në shenjë liria dhe pavarësia e atdheut tonë. Edhe çështja e të drejtave të njeriut dhe të demokracisë, borgjezia po i përdor si instrumente për të goditur lirinë dhe pavarësinë kombëtare”¹⁸. Ai ftonë anëtarët e tjerë të Byrosë Politike që të pranorin disa lëshime në mënyrë që të ruanin shtyllat kryesore regjimit: “çështja e lirisë dhe e pavarësisë kombëtare, çështja e

¹⁶AQSH, F. 14/AP org. udh., V. 1990, D. 1, fl. 25, Nga fjala e Ramiz Alisë në Plenumit IX të KQ të PPSH, 22 janar 1990.

¹⁷Po aty.

¹⁸AQSH, F. 14/AP, org.udh, V. 1990, D. 46, fl. 47, Nga procesverbali i mbledhjes së Sekretariatit të KQ të PPSH, 26 dhe 19 mars 1990.

rolit udhëheqës të Partisë, çështja e pushtetit popullit dhe e pronës shoqërore”. Para vizitës së Perez De Kuelarit në Shqipëri, Kuvendi Popullor miratoi draftin e ndryshimeve në Kodin Penal dhe në atë të Procedurës Penale, të propozuara nga Plenumi i KQ të PPSH i prillit 1990. U anulua neni 55 i Kodit Penal mbi agjitacionin dhe propagandën. U ndryshuan 24 nene që parashikonin dënime me vdekje. U anulua neni që e konsideronte kalimin e paligjshëm të kufirit, tradhti ndaj atdheut. Tashmë kjo do të konsiderohej dhe ndëshkohej si shkelje administrative. U miratua ligji për dhënien e pasaportave për shtetasit shqiptare. U rikrijua Ministria e Drejtësisë, sistemi i avokaturës etj. Ndërsa gjatë vizitës së Perez de Kuelarit në Shqipëri, Ramiz Alia parashitroi kërkesën për të qenë pjesë e Konferencës së Helsinkit (Alia 2010: 335), të cilën deri në atë moment e kishin refuzuar me vendosmëri.

Ndryshimet ishin sigurisht të pamjaftueshme për të përmirësuar situatën. Burgjet ende ishin plot me të burgosur politikë, sistemi i internim-dëbimeve ende ishte në fuqi dhe Sigurimi i Shtetit ende vazhdonte të përndiqte njerëzit edhe në privatësinë e tyre. Ato ishin thjesht një dëshmi që regjimi po dorëzohej dhe në të vërtetë pas çdo presioni të brendshëm apo të jashtëm, ai detyrohej të bënte lëshimin e radhës. Gjithsesi mbetet fakti se dorëzimi i regjimit nuk erdhi si një ndërgjegjësim dhe reflektim i shqiptarëve për mungesën e të drejtave nën diktaturë. Një masë e konsiderueshme e tyre nuk kishin dëgjuar kurrë për demokracinë liberale apo të drejtat dhe liritë themelore të njeriut.

Bibliografia

Dokumente

Arkivi Qendror i Shtetit (AQSH)

AQSH, F. 14/AP org. udh., V. 1990, D. 1

AQSH, F. 14/AP, org.udh, V. 1990, D. 46

Arkivi i Ministrisë së Jashtme (AMPJ)

AMPJ, V. 1977, D. 878

AMPJ, V. 1981, D. 1114

AMPJ, V. 1983-1986, D. 803

AMPJ, V. 1984, D. 804/4

AMPJ, V. 1984, D. 1037/8

AMPJ, V. 1984, D. 1037/10

AMPJ, V. 1984-1986, D. 803

AMPJ, V. 1984-1985-1986, D. 803/4

AMPJ, V. 1984-1986, D. 804

AMPJ, V. 1985, D. 980

Literaturë

Alia, R. (2010) Jeta ime, kujtime, Tiranë, Toena.

Hodos, G. H. (2000) Insknimet, proceset e spastrimeve staliniane në Evropën Lindore, 1948-1954, Tiranë: Amfioni&Zeti.

Human Rights Here and Now, celebrating Universal Declaration of Human Rights, edited by Nancy Flowers, appendix 3, A Human Right Glossary, në:

http://www1.umn.edu/humanrts/edumat/hreduseries/hereandnow/Part-5/6_glossary.htm

(vizituar më 14.01.2016).

Kaba, H. (2012) “Konferenca e Sigurimit dhe Bashkëpunimit Evropian (KSBE): një shans i humbur për Shqipërinë”, Studime Historike, nr. 1-2. f. 153-170.

Kissinger, H. (1999) Diplomacia, Tiranë: Shtëpia Botuese e Lidhjes së Shkrimtarëve.

Pano, N. C. (1984) "Human Rights in Albania", Liria, Boston. Mass.

Xhonson, P. (2000) Kohët moderne vëll. 2, Tiranë, Apollonia.

Gëzim Qëndro

Universiteti Polis

Aura teologjike teologjike e trupit politik

Sidoqoftë, një gjë është e sigurt [...] trupi njerëzor është aktori kryesor i të gjitha utopive.

Michel Foucault

Një vepër e hapur thotë Umberto Eco është “një « fushë mundësish», nëse do të përdorim një koncept veçanërisht zbulues të kulturës bashkëkohore: konceptin e “fushës” të huazuar nga fizika i cili përmban një vegim të ripërtëritë të marrëdhënieve klasike (njëkuptimëshe dhe të pakthyeshme) të shkakut dhe pasojës, i cili zëvendësohet nga një sistem forcash ndërsjellëse, një konstelacion ngjarjesh, një dinamizëm strukturash [...] (Eco 2003: 29-30).

Një fushë të tillë mundësish duket se e gjejmë edhe në tablonë *Vizitë në plagë* të Enkelejd Zonjës (fig. 1) e cila të befason pikërisht me shtresëzimet e shumëfishta kuptimore të subjektit dhe dinamizmin e strukturave që shoqërohen nga loja metagjuhësore tipike postmoderne, ironia dhe paradoksi. Në historinë e pikturës shqiptare janë të pakta tablo të tilla të ngarkuara me simbole dhe idhuj, paradigma dhe fantazma të historisë.

Fig. 1: Vizitë në plagë




© Enkelejd Zonja: 2010

Edhe nëse nuk e njih veprën e Caravaggios *Shën Thomai mosbesues* (fig.2) mjafton vetëm shenja në brinjën e Enverit e lënë nga shtiza e ndonjë Longinusi¹ modern, për të kuptuar se ai po sillet sikur të ishte ringjallur vërtet pas ndonjë kryqëzimi hipotetik. Ai u është shfaqur papritur, si njëfarë shajnie befasuese tre shqiptarëve gati tridhjetë vjet pas vdekjes, duke u

¹ Longinus: me këtë emër njihet, sidomos gjatë Mesjetës, centurioni romak që goditi me ushtë brinjën e Krishtit të vdekur prej nga rrodhi gjaku i Tij. Në traditën e krishterë besohet se më pas Longinusi nga pagan u pagëzua i krishterë pasi shpalli më parë bindjen se Ai (Krishti) ishte vërtet biri i Zotit. Sot pranohet si njëri nga shenjtoret e Kishës.

kërkuar (ashtu si Krishti Shën Thomait) “të mos jenë mosbesues, por besues”² se është ringjallur vërtet.

Fig. 2: Shën Thomai mosbesues



© Schloss Sanssouci: Potsdam

Pastaj përpara tablosë së varur në mur zbulojmë me çudi praninë e një burri të ulur me shpinë nga tabloja, që rri krejt shpërfillës ndaj vizitorëve që sillen rrotull tij dhe shpejt vërejmë se nga pamja dhe veshja ngjan krejt me “Shën Thomain” që shihet në tablo duke vënë gishtin tregues në plagën e Enverit (fig.3). Cili është dhe ç’kuptim ka edhe paraqitja e tij në tablo, edhe qëndrimi ulur para saj? Po ai djali mospërfillës me flokët punk që mban një Coca-Cola në dorë mos është vetë autori? Ç’lidhje ka me subjektin biblik ai burri i thinjur që kalamendet si i

² Gjoni 20:27-28:

përhëtur aty në fund pa marrë vesh ç'po ndodh? Ç'domethënie ka prania e tyre në tablo? Këto dhe plot pyetje të tjera na gëlojnë në kokë ndërsa qëndrojmë përpara kësaj tabloje befasuese. Përballja e detyruar me historinë dhe imperativi për të dhënë doemos një gjykim na ndërgjegjëson se ndodhemi përpara një vepre politikisht provokuese dhe ideologjikisht (të paktën në fillim) të pakuptimtë.

Fig

3:



© Enkelejd Zonja: 2010

Pastaj habisë së fillimit ia lë vendin një dell shpotitës: hëm, edhe këtë kishim mangët, të shihnim në vendin e Krishtit Enver Hoxhën, Zotmohuesin më të famshëm të historisë së shqiptarëve,

hartuesin e kushtetutës së parë ateiste! Ndërkohë që shumica e shqiptarëve e mendojnë në Ferr, ai u shfaqet si i zgjedhuri i parajsës ku, pas kësaj epifanie të fundit do të ngjitet përgjithmonë atje lart mes të lumnuemve vend që e meritojnë pas një jete të panjollë të shënuar nga mirësia dhe mëshira e krishterë.

Nuk janë të paktë ata që përpara kësaj tabloje mund të mendojnë se liria artistike duhet ta ketë një cak, pasi kjo pikturë acaron shumëkënd. Besimtarët, për shembull. Kush e pa hapësirën e bulevardit *Dëshmorët e Kombit* të mbushur me portretet e klerikëve të pushkatuar nga regjimi i tij ateist, pa përmendur të burgosurit, të internuarit që vuajtën asokohe dënime të ndryshme për shkak të besimit, e kupton se kjo tablo nuk duhet shfaqur në publik pasi është një pakujdesi, thjesht një trill artistësh. Piktori duhej ta kishte menduar dy herë përpara se ta tregonte Enverin në një rol që historia nuk ia njeh aspak.

Të pezmatuar ndihen me siguri edhe adhuruesit fanatikë të Komandantit. Ç’punë ka idhulli i tyre, kampion i njohur i ateizmit, me subjektin e një rrëfenje biblike, të cilën ata, si komunistë të bindur, e shohin si trillim të shkruar bukur dhe aq, ku mbase tek – tuk gjen shkëndija urtësie, por të vërteta, asnjë. Ndërsa fenë, mbështetur në besimin e patundur në vërtetësinë e marksizëm-leninizmit fitimtar dhe mësimeve të Partisë dhe shokut Enver e shohin si përçuese të obskurantizmit mesjetar dhe përligjëse të shfrytëzimit shekullor klasor. Për ta institucionet fetare ishin rrjeti që shpërndante haptas “opium për popullin” dhe si të tilla meritonin të mbylleshin.

Të tjerët, shumica mospërfillëse, ateistë apo gnostikë, pjesë e traditës liberale që e shohin njohjen e Biblës si pjesë të formimit të tyre kulturor, në përballje me tablonë fillimisht zbavitën, Pa shih ku i ka vajtur mendja, Enveri i ringjallur pas kryqëzimit! E megjithatë, prapëseprapë, ndërsa kundrojmë tablonë na shoqëron njëfarë sikleti. Në rastin më të mirë na duket një trill,

një shaka, madje pa kripë që ideatori i ciklonit antifetar të 1967-ës, përndjekësi i klerit dhe shkatërruesi i institucioneve fetare të luajë role të cilat sa ishte gjallë nuk i luajti kurrë.

Por pasi ndërmendim të gjitha këto ndjejmë se tabloja kokëfortësisht refuzon luksin e shpjegimeve të thjeshta. Ajo na sfidon haptas të përballemi me paradoksin dhe lojën e saj metagjuhësore ose të largohemi. A thua subjekti i pazakontë i tablosë të ketë ndonjë arsye më të thellë? Kureshtar e pyeta Enkelejdin se si mbërriti te ky subjekt kaq i pazakontë. (Për të njëjtën arsye Sokrati dymijë e pesëqind vjet më parë u drejtoi piktorëve athinas të njëjtën pyetje). Edhe Enkelejdi, ndonëse nuk ngriti supet si kolegët e tij të lashtë, s'arriti të japë ndonjë përgjigje bindëse. Vendndodhja paradokohe e studios së tij pranë vilës së Enverit apo dhurimi nga dikush i një katalogu me vepra të Caravaggios vështirë se mund të pranohen si arsye të qenësishme dhe në fund u binda se i kisha kërkuar diçka të pamundur. Problemi nuk qëndronte te piktori, por te kureshtja ime e pavend. Tek e fundit, përse duhej ta dinte, madje, si mund ta dinte autori nga ç'thellësi të errëta të nënvetëdijes së tij ish ngjitur deri në sipërfaqen e vetëdijes subjekti i asaj tabloje?

Statusi i autorit

Por siç ndodh me çdo koncept postmodern i cili qëllimisht mbështetet dhe nxit paqëndrueshmërinë dhe dykuptimësinë, situata e sotme paraqitet disi e turbullt pasi shohim se konceptet që sulmojnë pozicionin e privilegjuar të artistit, dëmtojnë njëkohësisht edhe shkaqet që shpejtojnë zhdukjen e tij. Siç thotë Foucault-ja: një letër private mund të ketë nënshkrues, por jo autor, një kontratë ka një garantues, por jo një autor. Koncepti poststrukturalist i autorit del se është një mënyrë e veçantë ekzistence, qarkullimi dhe ridimensionimi të diskureve të një shoqërie të caktuar. Pikërisht këtë status propozon Enkelejdi me mënyrën e konceptimit dhe realizimit të tablosë së tij; një ndërlojë shenjuesish të organizuar më tepër në varësi të natyrës

së të shenjuarve (Krishtit dhe Enver Hoxhës), ndërkohë që përmbajtjen e le të hapur për lexime të shumëfishta.

Edhe statusi i Caravaggio-s si autor mund të shihet si organizues diskuresh të mëparshme. Tabloja *Shën Thomai mosbesues* jo vetëm përmban një ndër subjektet më të njohura të pikturës kishtare që lidhet me një traditë fetare të lashtë, por edhe formalisht bën pjesë në kodin formal dhe estetik të periudhës barok që dallohet nga Rilindja e lartë.³ Vepra e Caravaggios mund të quhet transdiskursive në kuptimin që mund të shërbejë si lëndë për produkte të tjera artistike, veti që mund ta ketë pothuaj çdo vepër e shquar arti apo tekst. Caravaggio është një ndër shumë raste të tjerë artistësh të famshëm nga lëmi të ndryshme arti. Këta artistë (së bashku me shumë dijetarë, shkencëtarë, filozofë, shkrimtarë) quhen themelues të diskursivitetit, pra, të praktikës së krijimit të diskurseve duke u nisur nga diskurse të mëparshme.

Me këtë tablo Enkelejdi propozon një model tjetër: autori nuk është burim i pashtershëm diskursesh që mbushin veprën, por krejt e kundërta; është një farë parimi funksional që riorganizon diskurse të mëparshme të përfshira brenda koordinatave të qarta hapësinore dhe kohore të një kulture të caktuar. Është ky proces përjashtimi dhe afrimi, prerjeje dhe ngjitime, kufizimi dhe lejimi, shpërbërjeje dhe ribashkimi që përbën në këtë rast thelbin e statusit të autorit postmodern.

Vepra e hapur

³ Me këtë term njihet periudha e cila arriti maja të panjohura më parë në artet pamore të Rilindjes italiane e cila kish filluar në shekullin XIII me personalitete të njohura si Petrarka, Dante dhe Bocaccio. Zakonisht ajo përcaktohet nga dy ngjarje: njëra artistike; pikturimi nga Leonardo da Vinci i Darkës së fundit (1490) dhe fundi i saj shënohet nga një ngjarje politike: me plaçkitjen e Romës në 1527 nga trupat e mbretit Charles V. Kjo periudhë u sundua nga personalitetet e tre artistëve gjenialë Michelangelo-s, Leonardo-s dhe Rafaello-s. Sot termi Rilindje e lartë shihet me dyshim nga historianët e artit sepse e përkufizon një periudhë të tërë vetëm duke u nisur nga disa artistë dhe disa vepra të famshme.

Tabloja e Caravaggio-s të cilës është mbështetur Enkelejdi, ekziston njëkohësisht si imazh në formën e saj origjinale, siç e konceptoi autori, pra, e “mbyllur” në përsosmërinë e saj si organizëm i kalibruar, e aftë të prodhojë në inteligjencën dhe ndjeshmërinë e shikuesit një konstelacion stimulues estetik dhe emocional. “Mbyllja” e saj lidhet edhe me faktin se ajo përmban vlerat morale, etike, fetare, politike të një territori dhe epoke të caktuar, të Kundëreformës katolike, përgjigjes që Selia e Shenjtë i dha asokohe humbjes së shumë territoreve dikur katolike që përqaftuan idetë e Ulrih Zvinglit dhe Martin Luterit.

Ndërhyrja e Enkelejdut “e hap” veprën e Caravaggios nga ana semantike duke e kontekstualizuar me personazhe dhe situata historike kurrkund të ngjashme dhe të largëta me subjektin biblik. Si shumë artistë bashkëkohorë që e shohin paqëndrueshmërinë dhe dykuptimësinë si vlerë strukturuese, Enkelejdi arrin me to deri në kufijtë e paradoksit ku rol përcaktues merr dialektika midis formës së mbyllur të veprës së Caravaggios, e cila funksionon si strukturë e vetëmjaftueshme semantike, dhe hapjes kuptimore që kryen piktori shqiptar i cili, duke çliruar subjektin, krijon hapësirën e mjaftueshme për qasje mirëfilli hermeneutike. Kjo e kthen tablonë e tij në ndërlojë shenjash të organizuara që nuk synojnë shënjimin dhe mbylljen semantike të përmbajtjes, por rravimin e natyrës së shënjesve. Tabloja-tekst shpaloset si lojë që shkon përtej përpjekjes së zbulimit të ndonjë subjekti të “fshehur” në tablonë e Caravaggios, por të krijimit të hapësirës ku subjekti rrëfyes (artisti) nëpërduket, shfaqet haptas ose fshihet vazhdimisht. Dykuptimësia dhe paqëndrueshmëria e konceptimit bën që diskuri i krijuar nga Enkelejdi të endet në hapësirën pragnore midis të shenjtës dhe profanes, të ndaluarës dhe të lejuarës, konformizmit dhe blasfemisë.

Dykuptimësia dhe paradoksi

Këto qasje ofrojnë më tepër mundësi interpretimi pasi lindin nga përvoja që tejkalojnë të zakonshmen, që sfidojnë njohuri dhe koncepte të fosilizuara që prej kohësh jemi mësuar t'i pranojmë si të mirëqena dhe të padiskutueshme. Në kategoritë e personave që përmendëm më lart (besimtarët fetarë, nostalgjikët e diktatorit) i mbështetin qëndrimet e tyre mbi të vërteta absolute. Dhe siç e thamë, gjykime të tilla nuk vlejnë për këtë tablo, aq më tepër kur kuptojmë se ideologjitë sunduese na ndihmojnë pak ose aspak të kuptojmë imazhe të tilla. Kjo tablo shfaq dyshimin tipik poststrukturalist rreth mundësisë së të vërtetës, të pamundësisë së metafizikës së pranisë, të dekonstruktimit të tekstit dhe paqëndrueshmërisë së kuptimit. Prandaj piktura *Vizitë në plagë* kërkon një kod tjetër leximi sepse me paradoksin që përmban na fton jo të dimë më shumë, por të dimë ndryshe, pra, sfidon jo dijen dhe njohuritë tona, por mënyrat tona të të kuptuarit dhe të menduarit. Si çdo tekst tipik poststrukturalist imazhi në fjalë fsheh brenda vetes konflikte mes zërash të ndryshëm autorialë të cilët zakonisht përkufizohen si nëntekste. Hapësira topologjike e kësaj vepre është një territor i lakmuar nga shumë mëtues, në kuptimin se ajo që shfaqet në sipërfaqe nuk mund të kuptohet pa iu referuar fshehjeve dhe kontekstualizimeve të kuptimit që përpiqen njëkohësisht të shënjojnë domethënien e veprës duke e bërë tablonë të ngjajë me një hipertekst, pra, një tekst i krijuar nga tekste të tjerë.

Paradoksi, dykuptimësia dhe paqëndrueshmëria kuptimore e tekstit-tablo na mundësojnë lojën e lirë të mendimit, përqendrimin në përvojat tona të papërsëritshme vetjake, vetëdijesimin se konceptet dhe modelet e fosilizuara kulturore janë një formë erudite e padijes që na pengon të pranojmë dhe të hapemi ndaj asaj që nuk dimë.

Në këtë tablo piktori propozon një marrëdhënie risuese të artistit bashkëkohor me veprën, autoritetin, të vërtetën dhe me procesin e realizimit të saj, duke prishur kontratën e mëparshme të auctor-it-Zot. Kontrata e re me parametra poststrukturalistë vendos rregulla të tjera duke përmbysur hierarkinë mes autorit dhe shikuesit, subjektit dhe autorit dhe këtij të fundit me autoritetin, ideologjinë, politikën, historinë etj. Kjo kontratë përmban disa elemente të asaj që

Heidegger-i e quan *duktus*, pra, prodhim, riprodhim, induksion, reduktim, riformulim dhe ripropozim. Tiparet dalluese të këtyre marrëdhënieve janë uniteti dhe shpërbërja e veprës, tensioni mes modelit dhe paradigmës, përzjerja e qëllim të koordinatave kohore dhe vendore duke sjellë eklipsin e konceptit të gjenezës *ex-nihilo* të veprës së artit dhe të autorit-Zot. Këtyre qëllimeve u shërben mendoj, trajtimi si vepër e hapur i tablosë së famshme të piktorit të barokut italian Caravaggio me titull *Shën Thomai mosbesues* (fig.2).

Analiza që po paraqesim këtu ndjek hullinë e kërkimeve të paraqitura pjesërisht në librin *Le Surréalisme socialiste* (Qëndro 2014), ku ideja qendrore lidhet me prirjen e dukshme të regjimit totalitar shqiptar për të përdorur në mekanizmin legjitimues të pushtetit politik metarrëfime, përfshirë këtu edhe teologjinë politike mesjetare siç është rasti i tablosë që do të analizojmë. Ky misticizëm politik, i nxjerrë jashtë qerthullit të kulturës politike mesjetare ngjan në shikim të parë i habitshëm kur e gjejmë të transplantuar në realitetin politik të shekullit të njëzetë nga një pushtet që krenohej me trashëgiminë laike dhe ateiste të Revolucionit francez, të Iluminizmit dhe Revolucionit bolshevik.

Ideja qendrore e këtij shkrimi mund të shprehet si më poshtë: a përbën vërtet paradoks subjekti i kësaj tabloje apo mund të gjenden arsye që përligjin zëvendësimin e Jezu Krishtit të ringjallur pas kryqëzimit me Enver Hoxhën? A mund të ketë ndonjë aura teologjike trupi politik i Enver Hoxhës? Cili mund të jetë kuptimi i “ringjalljes” së tij në kohën e sotme? Kush mund të jetë roli i metafizikës së pranisë në statusin që ka marrë Enveri në këtë tablo?

Po ashtu, elementin kyç të analizës tonë, metafizikën e pranisë do ta shqyrtojmë përmes krahasimit të subjektit, skemës kompozicionale dhe variablave pamorë të tablosë së famshme të piktorit të shquar italian Caravaggio me titull *Mosbesimi i shën Thomait* e vitit 1603 me ato të tablosë së Enkelejd Zonjës me titull *Vizitë në plagë* e vitit 2010 ku do të ndjekim gjurmët e pranisë së kësaj metafizike si në njërin, ashtu edhe në tjetrin subjekt.

Struktura kryesore e këtij studimi mbështetet në heterotopinë e krijuar prej tre hapësirave (reale dhe utopike) e cila përbën një element të qenësishëm të metafizikës së pranisë për të cilën folëm më lart. Por pa harruar që edhe teksti që po i propozojmë lexuesit megjithë strukturën e tij të kalibruar për të dhënë një mendim të qartë, duhet parë si tekst i hapur që mund t'i nënshtrohet në çdo rast nga kushdo procesit të dekonstruktimit. Do të ishte gabim që duke u përpjekur të dekonstruktojmë një vepër të hapur të krijojmë një tekst të mbyllur refraktar ndaj çdo përpjekjeje për ta vazhduar apo ndryshuar.

Hapësira heterotopike

Një risi tjetër e veprës së propozuar nga Enkelejdi është karakteri i veçantë i hapësirave që ajo përmbledh. Leximi i vëmendshëm i saj zbulon praninë e heterotopisë⁴ dhe heterokronisë cila, siç shpjegon Foucault-ja, si tipar thelbësor i epokës sonë karakterizohet nga ndërveprimi dhe bashkëekzistenca e njëkohshme e hapësirave dhe regjistrave kohorë të papërputhshëm me njëri-tjetrin brenda regjimesh hapësinorë dhe kohorë sa realë, aq edhe numenalë. Analiza e tablosë do të mbështetet pikërisht në diskutimin e thurimës dhe shtresëzimeve kuptimore që krijojnë marrëdhëniet mes personazheve (subjectum) dhe subjektit të tablosë. Siç e theksuam më lart, ndarja në këto tri hapësira do të jetë struktura kryesore e këtij teksti.

E para është hapësira utopike e tablosë. U-toposi krijohet jo vetëm ngaqë personazhet paraqiten aty ku nuk janë vërtet (hapësira utopike e rrafshit topologjik të tablosë që përcakton korniza), por edhe sepse rrëfen “takimin” midis një të vdekuri dhe tre të gjallëve, një situatë që nuk ka

⁴ Heterotopia është koncept i propozuar nga filozofi poststrukturalist francez Michel Foucault i cili e sheh hapësirën si thelbësisht heterogjene. Tjetërsia e hapësirës ndërtohet nga mbivendosja apo pranëvendosja e hapësirave që u përkasin regjistrave të ndryshëm. Si shembuj klasikë heterotopie Foucault përmend pasqyrën, varrezat, kinemanë etj.

gjasa të ndodhë në realitetin fizik ku jetojmë. Cilësia metafizike e hapësirës së errët që rrethon personazhet përpiqet të theksojë pikërisht këtë fakt.

Hapësira e dytë krijohet nga prania në hapësirën reale të sallës së ekspozimit të njërit prej personazheve të tablosë; “Shën Thomait” (babai i autorit të tablosë) i cili i veshur njëlloj si në tablo, qëndron ulur me shpinën kthyer nga tabloja i zhytur në mendime. Hapësira e muzeut ku qëndron personazhi, sipas Foucault-së, përmban njëfarë heterokronie “përjetësuese” sepse heterotopitë janë të afta të krijojnë regjistra të ndryshëm kohorë krahas kohës së tashme. Hapësira e dytë karakterizohet pikërisht nga ndërthurja e heterotopisë (pranëvendosjes së disa regjistrave hapësinorë) me heterokroninë (bashkëekzistencën e disa regjistrave kohorë).

Vështrimi i piktorit i hedhur diku jashtë hapësirës utopike të tablosë na shpie në një hapësirë tjetër ku, me sa duket, po ndodh diçka e padukshme për ne. Komunikimi i piktorit me dikë jashtë tablosë është po ashtu, një zgjidhje e parapëlqyer nga artistët e barokut. Të njëjtën taktikë artistike gjejmë në vendosjen e një personazhi të tablosë përpara saj, çka të kujton përpjekjen e personazheve të tablove të kësaj periudhe për të komunikuar me dikë jashtë rrafshit topologjik të tablosë duke përmbysur shpesh marrëdhënien shikues - i shikuar. Një organizim i tillë heterotopik hapësinor u bën jehonë fjalëve të Foucault-së që thotë se: “...jetojmë në epokën e të njëkohësisë, në epokën e mbivendosjes...” (Foucault 1994: 748).

Hapësira utopike e tablosë

Dyshim apo besim?

Subjekti biblik i tablosë së Caravaggios është shumë i njohur: Thomai, dishepulli i vetëm që mungonte kur Krishti i ringjallur iu shfaq dishepujve të ligështuar dhe të trembur pas ekzekutimit të tij, shprehu hapur mosbesimin rreth mundësisë që mrekullia e ringjalljes të kishte ndodhur vërtet. Sipas Gjonit, të vetmit nga ungjillorët që e përmend këtë episod, tetë ditë më

vonë Krishti iu shfaq sërish dishepujve të cilët pasi i përshëndeti me shprehjen e njohur *Paqja qoftë me ju*, u kthye nga Thomai dhe i tha: “Vëre gishtin këtu dhe shiko duart e mia; shtrije edhe dorën dhe vëre në brinjën time; dhe mos ji mosbesues, por besues!”⁵ Ky është pikërisht momenti që ka zgjedhur për të paraqitur në kompozimin e tij mjeshtri italian. Pa asnjë mëdyshje, pa shpjegime apo shfajësime shën Thomai tha me një shpërthim të habitshëm besimi: “Zoti im dhe Perëndia ime!”⁶, ndonëse në traditën ekzegjetike të Kishës ky moment është vënë në dyshim nga disa autorë të krishterë. Për shumë të tjerë asnjë dishepull nuk ka bërë një deklaratë kaq të sinqertë dhe të fuqishme besimi duke e quajtur Krishtin “Zoti dhe Perëndia ime!” Siç del qartë edhe nga titulli i tablosë së Caravaggios, kumti kryesor i tablosë është mosbesimi i shndërruar si me magji në besim, çka e bëri Jezuin të shqiptojë fjalët e famshme “Ti besove sepse më pe, por bekuar qofshin ata që besojnë pa më parë.”⁷

Çka na shtyn të mendojmë se titulli i tablosë së Caravaggio-s fare mirë mund të ishte *Besimi i shën Thomait*, pasi reagimi i tij, kalimi nga mosbesues në besues ishte arsyeja e vërtetë e porosisë së tablosë në kulmin e Antireformës katolike. Historia e treguar nga Gjoni, e cila nuk gjendet në Ungjijtë e quajtur sinoptikë⁸ është mjaft e njohur edhe sepse u interpretua gjerësisht gjatë traditës ekzegjetike, sidomos në kohën e Kundërreformës katolike, ndërsa paraqitja ikonografike e këtij episodi të famshëm daton qysh nga shekujt e parë të krishtërimit.

Përshtatjet e tilla, ku bën pjesë edhe tabloja e Enkelejdut, tregojnë për vitalitetin e modelit dhe subjektit të sunduar nga mëdyshja besim apo dyshim. Detyra e studiuesve është të interpretojnë proceset e pritjes dhe përcjelljes duke u përpjekur të kuptojnë produktin kulturor që përftohet

⁵ Gjoni 20:27-28:

⁶ Ungjijtë e Mateut, Markut dhe Lukës quhen Ungjij sinoptikë sepse përmbajnë të njëjtat histori dhe janë parë nga e njëjta pikëpamje çka, i lidh me kuptimin e termit sinoptikos, pra, ngjajnë jo vetëm në përmbajtje por, në njëfarë mase, edhe në renditjen e fjalëve. Ndryshe nga Gjoni, ungjilli i të cilit ndryshon prej tyre.

⁷ Gjoni 20:27-28:

kësisoj. Enkelejdi hap një traditë ekzegjetike në artet pamore e cila më parë nuk na ofron ndonjë shembull pararendës kaq domethënës.

Në tablonë e tij Zonja përdor thujtë të njëjtën skemë kompozicionale dhe të njëjtën retorikë gjestesh të pikturës së famshme. Hapësira e kësaj tabloje, po ashtu si ajo e mjeshtrit italian, është një vend simbolik ku s'mund të hyjë apo dalë asnjë qenie njerëzore, një hapësirë metafizike dhe topologjike e errët dhe e pafundme, një çarje, një humbellë prej nga është zbrazur e gjithë koha lineare, ku qeniet njerëzore ftohen të hyjnë vetëm për të adhuruar apo komunikuar me qenie të një realiteti sipëran.

Mirëfilli si në një epifani, në sfondin e errët shfaqen figurat e katër burrave të ndriçuar nga drita e fortë, tipike për Caravaggio-n. Në skajin e majtë shihet Enver Hoxha, monarku absolut i Shqipërisë (në vendin e Jezuit) i paraqitur me të njëjtin qëndrim si Krishti i ringjallur në pozicion tre të katërtat, me pardesynë e zbërthyer, kravatën e kuqe të hedhur pas supit të djathtë dhe me këmbësorë të shkopsitur dhe të ngritur për t'u treguar "dishepujve" plagën e brinjës. "Shën Thomai" po afron me kujdes dhe plot drojë gishtin tregues pranë brinjës së Udhëheqësit i cili, njëllë si Krishti në tablo i ka mbërthyer me dorën e majtë kyçin e "dishepullit" mosbesues.

Në anën e djathtë të tablosë shohim tre personazhe realë: shën Thomai është zëvendësuar nga babai i artistit (të cilin më poshtë do ta quajmë *Mosbesuesi*), djali i ri në qëndrim profil në planin e dytë me flokët në stilin punk është vetë artisti (të cilin do ta quajmë *Piktori*), ndërsa personazhin e thinjur pas "shën Thomait," banorin e lagjes së piktorit që sheh skenën pa kuptuar se ç'po ndodh do ta quajmë (i Përhënuri).

Enveri nuk ka zbehtësinë e një të ringjalluri si Jezusi i cili me veshjen e bardhë ngjan me një filozof të lashtë. Ish-diktatori duket shumë i rëndomtë me pardesynë e hapur dhe rrobat e zbërthyer për të treguar plagën e ushtës. Imazhi i Udhëheqësit në këtë situatë kaq degraduese do të kthehej në makthin e çdo censori gjatë viteve të mbretërimit të Hoxhës.

Jezusi, me qëndrimin e trupit delikat paksa femëror, flokët e gjatë të kapur pas veshit, me qafën e përkulur dhe me kokën në hije nuk na lejon të shohim emocionet që shoqërojnë gjestin duke u dalluar nga apostujt me trupa muskulozë prej njerëzish të thjeshtë të popullit.

Ndërsa Enveri po sillet sikur nuk do ta shohë gjestin e Mosbesuesit dhe ndonëse i ka mbërthyer dorën e djathtë njëloj si Jezusi, qëndron disi sfidues ndaj «apostullit» rebel. Por nëse Caravaggio ka përdorur skema kompozicionale tipike barok për të formuar linja energjie, diagonale të ndryshme, trekëndësha dhe figura të tjera gjeometrike me saktësi matematikore të cilat natyrisht përkthehen si organizim formal i orkestruar më së miri që të përcjellë sa më mirë kumtin e dëshiruar nga porositësi, Kisha katolike, në tablonë e Enkelejdut gjejmë vullnetin për të dhënë kumtin e dëshiruar përmes shpërbërjes së kësaj strukture kompozicionale dhe ruajtjes vetëm të atyre elementeve që ndihmojnë kontekstualizimin e subjektit. Asgjësimi i kohezionit formal dhe doktrinor që do të përkthehej në kohezion social dhe etik e bën takimin e personazheve të duket qysh në fillim i dështuar.

Në tablonë e piktorit shqiptar gjejmë zakonin e përhapur midis artistëve të barokut për të mos i vendosur personazhet në kufinjtë kohorë të ngjarjes biblike, por të riprodhojnë mjediset, veshjet e kohës dhe territorit ku jetonin vetë artistët. Autori është përpjekur të përcjellë me korrektësi retorikën e lëvizjeve dhe sjelljes teatrale tipike për personazhet e tablove barok ku nuk mungon dëshira për ta befasuar shikuesin, apo emocionuar përmes trajtimit të kujdesshëm të sipërfaqeve dhe teksturave duke dhënë me përpikëri materialet apo mishin njerëzor, të pëlhurave duke përdorur ndër të tjera edhe efektet dramatike të dritës. Me intuitë piktori shqiptar i ka dhënë rëndësi të veçantë paraqitjes sa më bindëse të mishit njerëzor duke theksuar praninë e trupave organikë të personazheve.

Le të shtrojmë pyetjen kryesore: cila mund të jetë mbështetja logjike e zëvendësimit të Jezu Krishtit të tablosë së Caravaggios me Enver Hoxhën, një orvatje në shumë kuptime i pamundur?

Pas shqyrtimit të disa kornizave kontekstuale dhe teorike duket se lidhja midis tyre mund të krijohet përmes teorisë së njohur në historinë e jurisprudencës si Mbreti me dy trupa, mirëfilli një paradigmë e depërtimit të teologjisë politike mesjetare në diskursin politik të regjimeve totalitare të shekullit të njëzetë. Është e pamundur të tregosh me siguri se cilat ishin metodat dhe praktikrat përmes cilave disa aksioma të teologjisë politike të Mesjetës së vonë *mutatis mutandis* arritën të infiltrohen në mekanizmin legjitimues të pushtetit totalitar të shekullit të kaluar. Shfaqja e entuziazmit të turmave që brohorasin të ekzaltuar udhëheqësit karizmatikë të regjimeve totalitare, të shtyn të bësh pyetjen se mbi çfarë racionaliteti u ngrit pushteti i tyre i padiskutueshëm, statusi prej gjysmë-hyjnish këtyre udhëheqësve të dalë nga hiçi, si arritën të pajtojnë (sidomos regjimet e ngritura mbi marksizëm-leninizmin) besimin dhe dogmën zyrtare materialiste dhe ateiste me praktika tipike për teologjinë politike mesjetare. Vlen të ndalemi edhe në pyetjen se si arritën të fitojnë përkrahjen e popullit (për një kohë të caktuar), dhe si shumica e popullit të tyre ra pre e këtyre dogmave të frikshme ndonëse praktikrat legjitimuese të këtyre regjimeve sfidonin hapur në shumë raste themelin e arsyes njerëzore. Teoria *Dy trupat e mbretit* mund të na shërbejë si parim njëjtësues që lehtëson si mbledhjen dhe përzgjedhjen e fakteve, ashtu edhe nxjerrjen e përfundimeve të dobishme.

Teoria Dy trupat e mbretit

Kjo teori e ka zanafillën në një *cause célèbre* që lidhej me dukatin e Lankasterit të cilin mbretërit anglezë të dinastisë së Tudorëve e kishin patur gjithmonë pronë private, por jo të Kurorës. Kjo pronë ishte kërkuar edhe herë të tjera, për të qenë të saktë – në vitin e katërt të sundimit të mbretëreshës Elisabetë. Pasardhësi i saj Eduardi VI i cili nuk e kish mbushur ende moshën ngriti me këmbëngulje mëtime për disa toka të dukatit. Të ndodhur përpara kërkesës së prerë për të gjetur një marifet ligjor që i mundësonte mbretit t'i shtinte në dorë, juristët e

dinastisë së Tudorëve studiuan ndër të tjera edhe teksteve të koncileve të hershme të Kishës. Pas shumë kërkimesh gjetën diçka që u dha në dorë një argument bindës i cili përligjte juridikisht kërkesën e mbretit. Sipas tyre, meqë Krishti ka dy trupa, një hyjnor dhe një biologjik, edhe mbreti në momentin e shugurimit ka po ashtu, dy trupa. Në fund të debateve dhe diskutimeve juristët e monarkisë të mbledhur në Sergeant Inn vendosën përfundimishit se: “Mbreti ka dy trupa, një trup natyror dhe një trup politik. Trupi natyror është i vdekshëm, u nënshtrohet sëmundjeve që vijnë nga natyra apo aksidenti, papjekuria e fëmijërisë apo matufepsja e pleqërisë, njëlloj si gjithë njerëzit e tjerë, por trupi i tij politik nuk mund të shihet apo preket sepse lidhet me qeverisjen e popullit dhe përkujdesin e të mirës publike prandaj ky trup është i paprekshëm nga sëmundjet që dëmtojnë trupin natyror. Për këto arsye, ajo që mbreti bën me trupin politik nuk mund të zhvlerësohet nga cilado paaftësi e trupit të tij natyror (Kantorowitz 1957: 7).

Por që të realizohej përvetësimi i tokave të dukatit nga ana e mbretit lipsej shtuar edhe një nen që përcaktonte hierarkinë midis këtyre dy trupave. Sipas juristëve trupi politik i mbretit përfshin edhe trupin natyror, ndërsa ky i fundit vjen i dyti për nga rëndësia dhe merr fuqi vetëm prej trupit politik. Mbreti nuk ka një trup natyror të ndarë nga detyra dhe dinjiteti mbretëror, por një trup natyror dhe një trup politik të pandashëm nga njëri-tjetri, pra, dy trupa të bashkuar në një person të vetëm. Megjithatë, trupi politik jo vetëm është më “i gjerë” se trupi natyror, por në të banojnë disa forca vërtet misterioze të cilat pakësojnë, në mos asgjësojnë, krejt të metat e natyrës së brishtë njerëzore. (Kantorowitz 1957: 9).

Logjika ishte e thjeshtë: përderisa trupi politik qëndron më lart se ai natyror, atëherë vetëkuptohet se të gjitha pronat që i takonin dikur vetëm trupit natyror i kalojnë vetvetiu trupit politik i cili sipas juristëve të monarkisë vjen i pari për nga rëndësia.

Trillimi mistik i *Dy trupat e mbretit* u vu në lojë pa mëshirë nga F. Maitland-i në studimin e tij tejet stimulues dhe zbavitës “Kurora si korporatë”. Me tone të forta sarkazme dhe ironie historiani i madh anglez i ligjit shpjegoi marrëzinë e trillimit të mbretit si “Corporation sole” (*korporatë e përbërë nga një person i vetëm*, [shpjegimi im]) dhe tregoi se ç’përshtjellim do të sillte teoria e Mbretit me dy trupa nëse do të lidhej me logjikën burokratike. Me mendjemprehtësi Maitland-i bën humor me mbretin e “personifikuar” duke e përkufizuar teorinë *Dy trupat e mbretit* si “shpalosje mahnitëse të absurditetit metafizik, apo le të themi, metafiziologjik”. (Maitland 1901: 131).

Trup organik apo politik?

Mos vallë tabloja e Enkelejdut është paradigmë e kësaj teorie ku në vend të dy trupave të Krishtit, një hyjnor dhe një biologjik mund të themi se kemi dy trupat e Enverit, një politik dhe një biologjik? A mund të lidhet Enveri i paraqitur në tablo me teologjinë politike të Mesjetës duke i dhënë kuptim zëvendësimit të tij me Krishtin? Për ta sqaruar këtë lidhje duhet parë se si bolshevizmi, si feja e parë politike moderne me eskatologjinë dhe mesianizmin e tij laik ofroi kushtet për të ngritur kultin e udhëheqësit të pagabueshëm, që në shumë elemente si pagabueshmëria, mirësia, drejtësia, përjetësia të kujton trupin politik të mbretit.

Po më parë le të shohim shkurtimisht se cili është kuptimi i termit fe politike.

Kjo pyetje në Shqipëri jo vetëm bëhet fare rrallë prandaj termi njihet pak, por edhe kur ndodh reagimet shpjen në interpretime sipërfaqësore apo mohime paragjyquese të termit. Pas rënies së diktaturës në vendin tonë filluan të qarkullojnë dhe njihen ide dhe koncepte të ndaluara më parë, ndër to edhe ai i fesë politike, por mjerisht ende numri i studimeve të lidhura me këtë temë është fare i papërfillshëm. Vlen të theksohet se koncepti i fesë politike nuk është rezultat i

naivitetit apo trillit intelektual, por u shfaq thuajse vetvetiu në situatat e panjohura më parë sociale dhe politike të periudhës midis dy luftërave që krijuan një marrëdhënie e re midis fesë dhe politikës. Siç e sqaron Emilio Gentile, kritikët më të ashpër të konceptit të politikës ishin teologët e krishterë, ndonëse çuditërisht, të parët që e përdorën këtë term për të analizuar lëvizjet totalitare ishin intelektualë dhe teologë protestantë dhe katolikë si: Luigi Sturzo, Adolf Keller, Paul Tillich, Gerhard Leibholz, Waldemar Gurian dhe Eric Voegelin. Megjithatë togfjalëshi të politikës ka lindur më parë se totalitarizmi, vetëm pasi u lidh me bolshevizmin, fashizmin dhe nazizmin ky koncept filloi të përdoret gjerësisht. Gentile thekson se feja politike u shfaq si një formë e shenjtërimit të politikës që hidhte poshtë bashkëekzistencën me ideologji të tjera politike dhe mohonte pavarësinë e individit duke ia nënshtuar kolektives. Tipar tjetër ishte respektimi i detyrueshëm i urdhërave të pushtetit qendror, pjesëmarrja në kultin politik, shenjtërimi i dhunës si armë e ligjshme kundër armiqve dhe përpjekja për ta përfshirë fenë tradicionale brenda sistemit të saj të mitologjisë politike. Meqë të gjithë studiuesit bien në një mendje se njëri ndër tiparet dallues të totalitarizmit është ngritja e kultit të një udhëheqësi karizmatik dhe të pagabueshëm, atëherë nuk duhet të çuditemi që teologjia politike mesjetare u bë pjesë e praktikave legjitimuese të radikalizmit të më armiqësor ndaj fesë, bolshevizmit. Të gjithë udhëheqësit e perandorisë sovjetike (përfshirë edhe Enverin) kopjuan dy modele të udhëheqësit komunist ideal: Leninin dhe Stalinin. Megjithatë bolshevikët e hershëm e shihnin me dyshim kultin e monarkut legjitimist dhe auran teologjike të trupit të tij politik (mjafton të themi që ky kult mbështetej nga armikja e tyre e deklaruar Kisha ortodokse) çuditërisht, pasi rrëzuan kultin e carit rus ata përvetësuan haptas të njëjtin mekanizëm legjitimues për Leninin. Por këtu nuk ka asgjë të pakuptueshme: struktura të njëjta legjitimuese prodhojnë praktika dhe rituale të njëjta.

Ja përse i pari udhëheqës komunist që shfaqti në profilin e tij publik elemente të teorisë së Mbretit me dy trupa ishte Lenini. Ky koncept u shfaq haptas menjëherë pas atentatit të 1918.

Ja si shprehet gazetari Lev Sosnovsky në gazetën *Bdnota* një ditë pas ngjarjes: “*Lenini nuk mund të vritet. Për sa kohë jeton proletariati do të jetojë edhe Lenini. Iliçi është njeriu i vdekshëm, ndërsa Lenini është udhëheqësi i pavdekshëm dhe simbol i përbotshëm. Njeriu i vdekshëm mund ta ekspozojë veten ndaj rrezikut, por Lenini nuk mund të vritet*”. Ndonëse me siguri gazetari rus nuk kishte dëgjuar ndonjëherë për teorinë e Mbretit me dy trupa vështirë se dikush mund ta ilustronte më mirë me ndonjë shembull më domethënës.

Poeti futurist Majakovski edhe pse i ndërgjegjshëm për papajtueshmërinë e kultit të personalitetit me marksizmin botoi një poemë me rastin e pesëdhjetë vjetorit të Leninit në të cilën shpallte se: *Nuk është heroi / Ai që shtyn rrjedhën e revolucionit / Historia e heronjve-marrëzira të inteligjencias! / E si mund ta përmbash veten dhe të mos i këndosh lavdisë së Iliçit? [...] Lenin! Unë ngre lart me Leninin besimin e botës dhe ngre lart besimin tim/* (Tumarkin 1997: 100).

Që vetë Lenini, monarku i parë me dy trupa i revolucionit, ishte kundër kultit dhe autoritetit të padiskutueshëm të udhëheqësit e shohim në librin e tij *Ç’të bëjmë*, ku ai njeh pa rezerva rolin përparësor të partisë komuniste e cila duhej të udhëhiqte e vetme procesin e shndërrimit revolucionar të shoqërisë ruse të asaj kohe. Aty dhe në shkrime të tjera ai nuk përmend askund rolin përcaktues të udhëheqësit. Ka shumë dëshmi nga miq dhe armiq të tij se ai i kundërshtoi përpjekjet për ta kthyer në gjysmë-hyjni. Në të njëjtën hulli mendimi ishin edhe figura të tjera autoritare në parti si Trocki, Kamenevi, Buharini të cilët parapëlqenin të ngrenin lart rolin e partisë dhe jo të udhëheqjes. Por duket se bolshevikët e kuptuan ç’potencial i madh propagandistik fshihej pas ngritjes së kultit të një udhëheqësi karizmatik si Lenini.

Qysh në vitin 1918 M. Olminski deklaronte se megjithëse kulti i personalitetit ishte kundër frymës shkencore të marksizmit: “bolshevikët nuk duhej t’i shpërfillnin udhëheqësit e tyre të cilët personifikonin partinë dhe klasën punëtore (Tumarkin 1997: 87). Udhëheqësit si Lenini

ishin shembull i vlerave morale të komunistit të mirë dhe personifikim i proletariatit dhe prandaj duheshin nderuar. Me të drejtë autorja ruse Tumarkin shprehet se pranimi me gjysmë zemre nga Lenini i ngritjes së kultit të tij nga ana e propagandës lidhej me vetëdijësimin për fuqinë e madhe legjitimuese të imazhit të tij dhe ndihmës që i jepte forcimit të regjimit të ri. Lunaçarski shprehet: “Unë mendoj se Lenini, i cili nuk e pranonte kultin e personalitetit dhe e kundërshtonte në të gjitha format e mundshme, aty nga vitet e fundit na kuptoi dhe na fali” (Tumarkin 1983: 105). Kulti i tij u ngrit pareshtur nisur nga ideja se vlerat e partisë bolshevike mishëroheshin në personin e tij. Ndonëse ideologjikisht i dyshimtë, me sa duket kulti funksionoi në praktikë. Bolshevikët besonin se adhurimi i Leninit si i pagabueshëm, si më njerëzori ndër të gjithë, tashmë me dimensionin e pavdekësisë si pjesë të trupit të tij politik ishte i pranueshëm sepse udhëheqësi simbolizonte dhe përfaqësonte në shkallën më të lartë vlerat më të mira të partisë dhe proletariatit.

Adhurimi nga ai kalonte te proletariati, vlerat e të cilit ai i përfaqësonte më së miri.

Domethënës për ekzistencën e dy trupave të Leninit janë edhe debatet e ashpra gjatë marrjes së vendimit për balsamosjen dhe ekspozimin e trupit të tij pas vdekjes. Nga dokumenta të ndryshme del se Stalini këmbënguli që të balsamosej ose të varrosej sipas mënyrës ruse dhe jo të digjej sipas mënyrës moderne sepse kështu trajtoheshin kriminelët e vdekur në burgjet ruse. Duket se i druhej çdo paralelizmi që mund të krijohet në këtë rast. Trocki ishte kundër balsamosjes pasi nuk donte që Lenini të kthehej në ikonë ortodokse. Meqë Kisha ortodokse ruse mëtonte se trupat e atyre që ishin vërtet të shenjtë nuk shpërbëheshin, moslejimi përmes metodash shkencore i shpërbërjes së trupit organik të Leninit krijonte një paralele të sikletshme për shumë bolshevikë ateistë. Për arsye të tjera edhe gruaja e Leninit Nadezhda Krupskaja dhe sekretari i tij Bonch-Bruевич, dolën publikisht kundër kur u shpall lajmi. Nuk duhet lënë pas dore edhe ajo rrymë mendimi në partinë bolshevike që mund të përkufizohet si krahu transhumanist i bolshevizmit. Për të kuptuar rëndësinë e tyre mjafton të përmendim që

shkrimtari më i njohur sovjetik Gorki dhe komisar për kulturën Lunaçarski ishin në radhët e tyre. Ata besonin në fuqinë e shkencës (përfshirë marksizmin, të cilin e shihnin si pjesën më të rëndësishme të shkencës) e cila do të arrinte ta mundte edhe vetë vdekjen dhe u përfshinë me vetëdije në krijimin e një hyjnie të re. Madje njëra nga figurat më të rëndësishme Krasin “predikonte publikisht besimin në ringjalljen fizike të të vdekurve” përmes shkencës deri në kohën kur “do të jemi në gjendje që të përdorim elementet e një personi për ta rikthyer në jetë”. Për ta “kthimi i Leninit në i pavdekshëm ishte hyjnizimi i mirëfilltë i njeriut” (Tumarkin 1997: 196). Komisioni që vendosi për balsamosjen, të cilit iu dha emri kuptimplotë “Komisioni i përjetësimi”, u detyrua t’u jepte shpjegime shumë bolshevikëve për të cilët paralelizmi i praktikave të partisë bolshevike me Kishën ortodokse ruse ishte i papranueshëm. Ata theksuan dallimin midis adhurimit të shenjtorëve ortodoksë dhe adhurimit “të ri” të Leninit: “Është e qartë që as ne dhe as shokët tanë nuk duam ta kthejmë trupin e Vladimir Iliçit në relik. [...] Ne duam që trupi i tij të ruhet sepse i japim rëndësi të jashtëzakonshme ruajtjes së tipareve fizike të këtij udhëheqësi të mrekullueshëm për brezin që po rritet dhe për brezat që do të vijnë dhe për miliona të tjerë që do të jenë shumë të lumtur të shohin tiparet e tij fizike” (Tumarkin 1997: 188).

Pas ngjitjes në pushtet të Stalinit trupi i tij politik u ngjit në nivele të pakrahasueshme adhurimi që nuk e kish patur as një car i mëparshëm. Një dëshmi interesante se edhe vetë Stalini ishte i ndërgjegjshëm për trupin e tij politik të cilin, ndryshe nga juristët anglezë, e shihte të ndarë nga trupi i tij biologjik, na e rrëfen Jan Plamper në librin e tij *Kulti i Stalinit*, një histori e përcjellë përmes djalit të birësuar të Stalinit, Artiomit. Sipas tij një ditë Stalini i tërhoqi vërejtjen djalit të tij biologjik Vasilin të cilin e ndaloi ta përdorte mbiemrin e famshëm për t’i shpëtuar ndëshkimit pas një zënke me grushta i dehur që kish bërë një ditë më parë. “Edhe unë jam Stalin - ia ktheu Vasili. “Jo ti nuk je - i tha i ati. “Stalini është pushteti sovjetik. Stalini është ai që shihet në gazeta dhe portrete, jo ti, madje as unë!” (Plamper 2012: xiii). Por Stalini këtu flet

vetëm për shfaqjen mediatike të trupit të tij politik. Pjesa më e rëndësishme e trupit të tij politik ishte e padukshme, ajo që përmbante auran teologjike të trupit të tij politik, thelbi i pushtetit të tij të padiskutueshëm.

Ky model i udhëheqësit komunist me dy trupa, njëri organik që mund të preket nga sëmundjet dhe pleqëria si gjithë të tjerët dhe një trup politik, i padukshëm, i pagabueshëm dhe i pavdekshëm kaloi përmes strukturave të njëjta të mendimit të gjithë udhëheqësit e vendeve satelite të Moskës përfshirë edhe atë shqiptar.

Tabuja e paraqitjes së trupit organik

Edhe Enveri, ashtu si idhujt e tij Lenini dhe Stalini kishte dy trupa. Por njëlloj si ata, por ndryshe nga monarkët europianë për publikun ishin të padukshëm si ai politik, ashtu edhe ai biologjik. Ndalimi i prerë i paraqitjes së imazhit të trupit organik të Enverit përkonte me një tabu të artit laik shqiptar, atë të paraqitjes së trupit organik të zhveshur, sidomos të femrës. Ndonëse anagrama trup – turp (siç e kam përmendur edhe më parë) (PostEva 2001: 3) nuk besoj se ka ndonjë rrënjë ontologjike dhe mund të jetë rastësore, ajo dëshmon për marrëdhënien e sikletshme që ka pasur shoqëria konservatore shqiptare me paraqitjen e imazhit të trupit organik. Pra, koncepti i paraqitjes së trupit organik të zhveshur (i cili ka një histori të gjatë në të gjitha qytetërimet) dhe paraqitjes së tij në artin zyrtar të realizmit socialist është në të njëjtën hulli mendimi me një marrëdhënie tjetër të pahulumtuar nga studiuesit tanë që i shtohet asaj që përcjell anagrama e mësipërme: paraqitjes së trupit organik dhe atij politik të Enver Hoxhës, njëra nga temat më delikate dhe më të rëndësishme të realizmit socialist shqiptar.

Me rishfaqjen e tij diktatori i vdekur duket sikur përpiket t'u ngulisë ngulisë në mendje personazheve të tablosë se është ende gjallë. Akti i përvetësimit të shenjës që i la Krishtit ushta

e centurionit romak Longinus merr këtu kuptimin e ringjalljes pas “kryqëzimit” të tij politik, përdhosjes së imazheve të tij pas rënies së regjimit që ngriti vetë. Por duke treguar provën e ringjalljes në brinjë Enveri detyrohet të tregojë një pjesë të trupit të tij biologjik (kraharonin, një pjesë të barkut dhe kërthizën) pjesë aspak dinjitoze për udhëheqësin e një regjimi totalitar si ai të cilat nuk ishin treguar kurrë në artin e realizmit socialist. Pra, le ta shohim skenën me një çelës tjetër leximi: “shën Thomai” nuk po u beson syve teksa zbulon për herë të parë se “Udhëheqësi i dashur i Partisë dhe Popullit tonë”, Ai që kishte arritur statusin e një gjysmë-hyjnië paska një trup biologjik si gjithë vdekatarët e tjerë. Habia e “shën Thomait”, mosbesimi i tij është i kuptueshëm: gjatë viteve të sundimit të sistemit parti-shtet patëm harruar se ai kishte një trup organik, vendin ku gjenden organet dhe zhvillohen procese fiziologjike, një topos dëshirash dhe neverie. Mosbesuesi, Piktori dhe i Përhënuri bëhen kështu dëshmitarë të dhunimit të njëres prej tabuve të dikurshme më të paprekshme të artit të regjimit të dikurshëm: paraqitjes së trupit organik të monarkut komunist, atij toposi që sipas Foucault-së është vendi: “të cilit, qysh se hap sytë nuk mundem t’i shpëtoj” (Foucault 1994: 762). Enveri, si kushdo tjetër, ishte zot i trupit të tij organik dhe mund të bënte me të çfarë të donte: ta lëvizte, të ndryshonte vend – porse, ashtu si të gjithë: “nuk mund të zhvendosej pa të; nuk mund ta linte aty ku ishte për të shkuar i vetëm diku gjetkë” Enveri ashtu si ne ishte rob i trupit të tij, këtij “toposi të pamëshirshëm” (Foucault 1994: 762) apo i “vendit ku je dënuar pa shpresë faljeje” (Foucault 1994: 754) me funksionet e tij banale fiziologjike, sëmundjet, paqëndrueshmërinë e shëndetit, përkohshmërinë që rrjedh soje të cilat e zbrisnin monarkun me dy trupa në nivelin e nënshtetasve të tij. Dihet se jetëgjatësia e trupit biologjik kufizohet nga natyra. Po çfarë do të ndodhte me ngrehinën monolite të sistemit të tij policor kur trupi i tij organik ta detyronte Atë të ikte nga kjo botë?

Kjo pyetje ishte afërmendsh makthi më i madh dhe pyetja më torturuese për fanatikët e regjimit. Përkohësia e trupit të tij organik ishte pika e dobët e regjimit, pa dyshim. Në kujtimet e të

përndjekurve nga regjimi bie në sy se “qershia mbi tortë” në kujtimet e tyre është gjithmonë momenti i lajmit të vdekjes së diktatorit të cilin ata nuk harrojnë ta përshkruajnë me detaje dhe me një ngazëllim të brendshëm që zbulon qartë shpresat që u zgjonte asokohe ajo ngjarje e shumëpritur.

Për të kuptuar risinë që përmban paraqitja e trupit të tij organik në këtë tablo vlen të përmendet që jo rastësisht, paraqitja e trupit të tij organik ndalohej jo vetëm në artin e realizmit socialist, por çdo lajm që prodhonte gjendja e tij shëndetësore ruhej në sekretin më të thellë. Sot dimë me siguri se ekipi i doktorëve që përkujdesej për shëndetin e tij mund t’ia bënte të ditur gjendjen shëndetësore të Enver Hoxhës vetëm dy anëtarëve më të rëndësishëm të Byrosë Politike të PPSH-së. Askujt tjetër, sado lart të qëndronte në kupolën e shtetit totalitar. Më pas kur njëri vdiq dhe tjetrin “e vetëvranë” kontaktet me grupin e mjekëve i mbante vetëm Ramiz Alia.⁹

Pas rënies së regjimit filluan të bëhen të njohura fakte të shumta rreth trupit të tij biologjik. Një nga më të shënuarit është qëndrimi në shtrat për gati pesë muaj (tetor 1973 – shkurt 1974) pas goditjes së një infarkti që i rrezikoi seriozisht jetën. Asokohe sekreti u mbajt brenda rrethit të bashkëpunëtorëve më të afërt, ndërsa publiku i gjerë kuptohet, nuk u njoftua fare. Haxhi Kroj, ndihmësi i tij besnik përgjatë shumë viteve, në ditarin e botuar pak kohë më parë përshkruan momente të procesit të mundimshëm të shërimit të Shefit. Nëse ato shënime do të kishin përfunduar në duart e gabuara, kjo pakujdesi do t’i kushtonte shtrenjtë atij dhe familjes së tij.

Një tjetër ndihmës i Sekretarit të Parë, kolegu i tij Afrim Imraj, i cili po ashtu kish mbajtur ditar, tregon në një artikull të botuar në shtypin e përditshëm të kryeqytetit¹⁰ se në momentin që gruaja e Hoxhës mësoi për ekzistencën e ditarit ku ai përmendte edhe sëmundjen e Udhëheqësit, e

⁹ Ramiz Alia (1925 – 2011) u përfshi në luftën nacional –çlirimtare fare i ri, pa mbushur të njëzetat. Duke qenë besnik i Enver Hoxhës i ngjiti shpejt shkallët e karrierës për të arritur anëtar byroje i PPSH-së (1962) ku u mor me sektorin e kulturës dhe propagandës. Pas vdekjes së Hoxhës u zgjodh sekretar i parë i KQ të PPSH-së. Vdekja e tij më 2011-ën shënoi fundit e një epoke pasi ai ishte presidenti i fundit komunist.

¹⁰ Gazeta Panorama, 13 gusht 2014, f. 9.

urdhëroi t'ia sillte menjëherë dhe nga ai çast ajo fletore nuk e pa më kurrë. Për me tepër, më vonë ai vetë u burgos me një akuzë tjetër.

Megjithëse Enver Hoxha gjatë dyzet viteve ishte subjekti më i privilegjuar i artit zyrtar, imazhi i trupit të tij organik ishte i padukshëm për publikun. Ishte rreptësisht e ndaluar të tregoheshin publikisht pjesë të zhveshura të trupit të tij organik. Censura zyrtare vigjëlonte syçelur mbi çdo imazh që botohej. Vetëm në një pikturë të Guri Madhit (1978) dhe një të Spiro Kristos (1980) ai tregohet llërëpërveshur. Kaq lejohej asokohe të dukej nga trupi i tij (përveç kokës dhe pëllëmbëve të duarve), ndërkohë që për femrat e paraqitura në artin e realizmit socialist lejoheshin krahët e zhveshur, madje edhe ndonjë dekolte. Kostumet e tij tepër të gjera zhduknin çdo formë të trupit organik poshtë tyre. Ndërkohë në vitet tridhjetë monarku i vetëm shqiptar Ahmed Zogu duket shumë më liberal kur tregonte fare pa droje trupin e tij biologjik prej atleti duke ngritur një shtangë në plazhin e Durrësit përpara kamerës së Marubit.

Zërat gjatë regjimit rreth homoseksualitetit të supozuar të Hoxhës nuk synonin vetëm ta zbrisnin në nivelin e çdo vdekatori, por duke përdorur ndjeshmërinë e mendësisë konservatore të asaj kohe, synonin të nxirrnin në pah perversitetin e trupit të tij organik që mbahej i fshehur nga pushteti, duke shkatërruar kështu auran e trupit të tij politik të krijuar me aq kujdes nga propaganda zyrtare.

Për një monark absolut si Hoxha nuk ishte e vështirë që t'i mbante problemet e trupit të tij organik larg syve të publikut, madje ta bënte të harronte se kishte një të tillë. Gjatë pothuaj dyzet viteve Hoxha jetoi në atë lagje të Tiranës që njihet rëndom si Blloku, një territor i mbushur me vila të vogla të zhytura në gjelbërimin e kopshteve, dikur prona të tregtarëve të pasur tiranas, apo të funksionarëve të monarkisë. Një territor i ruajtur ditë e natë nga Garda Kombëtare dhe truprojat e funksionarëve komunistë, njëfarë hapësire heterotopike, një qytet brenda qytetit me ritmet, zakonet dhe ritualet e tij, njëfarë mini-me begatinë e jetës pa mungesa dhe probleme

ekonomike të banorëve të saj krahasuar me mungesat ushqimore dhe radhët e gjata në kryeqytet për çdo gjë, madje edhe zgjimi herët në mëngjes për një litër qumësht. Aty ushqimet silleshin te dera e vilës sipas një liste të hartuar më parë. Madje thuhet se refuzimi për të sjellë asortimente të ndryshme në vilë ishte njëra nga shenjat e para se funksionari i lartë mund ta pësonte. I fshehur në këtë hapësirë heterotopike të paarritshme për pothuaj të gjithë shqiptarët, trupi i tij organik nuk ishte e vështirë të bëhej padukshëm. Pra, për publikun shqiptar këtushmëria dhe tanishmëria fenomenologjike e trupit të tij organik nuk ekzistonte, çka e bëri subjekt thashethemesh subversive që nuk thuheshin publikisht apo i legjendave urbane.

Corpus mysticum

Por trupi politik i Enverit në tablonë e Enkelejdut shfaqet i shkëputur nga një *corpus* kolektiv pa të cilin ai nuk mund të funksiononte dhe që ai, duke e ditur, nuk harronte ta përmendte sa herë që mbyllte ndonjë fjalim, pra, partia të cilën e drejtoi ashtu si vendin me dorë të hekurt. Studiuesit e dukurisë së totalitarizmit Gentile, Vogelini theksojnë se partitë komuniste të shteteve satellite të BRSS funksiononin si kisha kombëtare duke patur në krye një udhëheqës karizmatik, trupi politik i të cilit, ashtu si monarkët e Mesjetës përmbante si pagabueshmërinë, ashtu edhe përjetësinë dhe drejtësinë. Kantorowitz shpjegon konceptin e *corpus mysticum* me të cilin u pagëzua Kisha e krishterë qysh në fillimet e saj. “Për shumë shekuj kuptimi zyrtar i “trupit mistik” ishte ostia e shenjtë. Kisha theksonte me forcë jo një prani shpirtërore apo mistike, por një prani të njëmendte të Krishtit njeri dhe hyjni në Eukarist. Koncepti i *corpus mysticum* nga ostia e shenjtë u zhvendos pas 1150-ës te Kisha si një trup i organizuar i shoqërisë së krishterë të bashkuar nga sakramentet. Pra, shprehja “trup mistik” i cili në zanafillë kishte përmbajtje liturgjike apo sakramentale mori ngjyrim shoqëror. Pikërisht sipas këtij kuptimi të ri sociologjik papa Bonifaci VIII e përcaktoi Kishën si “trup mistik që ka si kokë Krishtin”.

Kështu termi *corpus mysticum* e veçoi Kishën si trup politik ose si organizëm politik dhe ligjor në një nivel me trupat politikë shekullarë të cilët asokohe po fillonin të shfaqeshin si entitete të pavarura. Në këtë kuptim përcaktimi i ri nga ana e Kishës i konceptit *corpus mysticum* përkoi me aspiratat me të përgjithshme të asaj epoke. Kur në shekullin e dymbëdhjetë Kisha, duke përfshirë edhe burokracinë e klerit e quajti veten “trupi mistik i Krishtit”, bota shekullare e shpalli veten perandori e shenjtë (Kantorowitz 1957: 196-197).

Koncepti i *corpus mysticum* që tregohej fillimisht nga Sakramentet e Altarit, pas shekullit të dymbëdhjetë shërbeu për ta përshkruar trupin politik apo vetë *corpus juridicum* të Kishës, konceptin e Dy Trupave të Krishtit, njëri natyror, individual dhe vetjak dhe tjetri mbi-vetjak, trupi politik dhe ai kolektiv, *corpus mysticum*. Ndërkohë *corpus mysticum* në kuptimin zanafillor u bë gjithnjë e më pak mistik, ndërsa koha kalonte dhe filloi të merrte kuptimin thjesht të Kishës si një trup politik, apo një trupi politik të botës shekullare. (Kantorowitz 1957: 206). Në epokën moderne bolshevikët e sapoardhur në pushtet ishin të parët që e panë partinë e tyre si bashkësia e njerëzve të rinj të së ardhmes, me besim të patundur në idealin dhe realizimin e tij me në krye një udhëheqës karizmatik si Leninin. Pra, një *corpus mysticum* i ngjashëm me Kishën e krishterë. Sigmund Neumann në vitin 1942 kur flet për partinë e një shteti totalitar shprehej se: Partia është frymëzuese e një besimi që depërton te të gjitha anët e fatit njerëzor dhe shtrihet deri në zonën e absolutes. Natyra totalitare e shtetit pashmangësisht e shndërron partinë në një urdhër fetar, në një teokraci ... Partia ka hierarkinë e saj, ritualet, dogmat dhe seminarët e saj. Fanatizmi kthehet në vetinë më themelore të ndjekësve të zellshëm: heretikët duhet ose të konvertohen, ose të digjen në turrën e druve (Gentile 207: 101).

Pra, njëlloj si pjesëtarët e klerit nga anëtarët e partisë nuk kërkohet disiplinë e ndërgjegjshme, por besim i verbër. Edhe partia, sipas Neumann-it, synoi të kthehej në organizatë të tipit ekleziast, që dallonte nga njerëzit e thjeshtë.

Sipas Neumann-it: “Fetë shekullare ... në të njëjtën kohë i sjellin të tashmes, përmes bashkimit vëllazëror të anëtarëve të partisë, një përvojë pararendëse të asaj që do të ishte bashkësia e ardhshme e një njerëzimi të vetërealizuar, duke shpërblyer kështu menjëherë sakrificat e kërkuara dhe duke e nxjerrë individin nga vetmia e turmave pa shpirt dhe jetës pa shpresë” (Gentile 207: 91).

Tre personazhet e tablosë së Enkelejdit, ndryshe nga apostujt e rrëfenjës që tregohet në tablonë e Caravaggios, nuk mund të përfshihen as në një kategori tjetër, pjesë e teologjisë politike mesjetare, rrjedhojë e *corpus mysticum* kur ky koncepti i fundit u zhvendos te një corpus social deri atëherë i parë si shekullar. “Baldus-i¹¹ e përkufizoi si *populous*, populli si trup mistik. Ai mendonte se nëse populli bashkohej në një trup mistik ai nuk ishte më thjesht një shumë individësh. Kalimi i konceptit të *corpus mysticum* nga teologjia fetare në politikën shekullare dhe laike la pas një aromë temjani që vinte nga një botë tjetër” (Kantorowitz 1957: 210). Personazhet shqiptare nuk duket të kenë asnjë lidhje me këtë koncept. Së pari, ata nga veshja duket se nuk e prisnin një takim të tillë, i cili dikur do të ishte ngjarje e shënuar në jetën e tyre. Në pikturën e Enkelejdit mungon një detaj i tablosë së Caravaggios që simbolikisht përmban thelbin e subjektit: megjithëse mosbesues, koka e shën Thomait, Krishtit dhe dy personazheve të tjerë formojnë si një konfiguracion gestaltist siluetën e kryqit (fig. 4), çka tregon simbolikisht gjysmën tjetër më të rëndësishme të rrëfimit, kumtin që nuk e tregon rrëfimi linear i ngjarjes: besimin e patundur të shën Thomait se Krishti ishte ringjallur vërtet.

Natyrisht që në tablonë me Enverin konfiguracioni i kryqit është shpërbërë, pasi nuk do të kishte kuptim, por rishpërndarja e figurave në hapësirë ka sjellë shpërbërjen e lidhjes së bashkësisë përmes besimit të patundur në një ide absolute, çka përbën thelbin e *corpus majestis*-it. Madje, ndryshe nga tabloja barok, ku të tre personazhet po ndjekin me vëmendje veprimin e shën

¹¹ Camillus Baldus. (1550 –1637), filozof italian. Njihet edhe si Camillo Baldi.

Thomait, në tablonë tjetër vetëm Mosbesuesi po i kushton vëmendje Enverit; Piktorit i ka tërhequr vëmendjen diçka jashtë kutisë piktorike të tablosë, ndërsa i Përhënuri ndonëse i pranishëm fizikisht, duket se nuk kupton mirë se ç'po ndodh. Pra, është këputur ajo lidhje Parti-Popull që trumbetohej me aq bujë, që shkruhej në faqe muresh dhe malesh, lidhje e shenjtëruar sipas propagandës nga koncepti i besës, edhe ky i huazuar nga Mesjeta për t'i dhënë lidhjes së popullit shqiptar me idenë komuniste ku garantuese e kësaj lidhjeje ishte Partia e Punës (*corpus mysticum* me *corpus majestis*) doza të mirëfillta metafizike, pasi nga mënyra si paraqitej nga propaganda dukej se i përkiste botës numenale sepse siç thuhej, ajo nuk mund të shkatërrohej nga asgjë që ndodhte në realitetin fenomenal. Në vitet '70-të u shkruan disa drama që e vinin theksin pikërisht te Besa, e cila kish ndryshuar objekt, tashmë e shkëputur nga konteksti i Kanunit Besa mund t'i jepej vetëm Partisë në pushtet duke u bërë kështu pjesë e teologjisë politike të regjimit. Nëse *corpus mysticum* (partia e tij) dhe një *corpus majestis*, bashkësia e lidhur përjetë me të përmes Besës së dhënë nuk ekzistojnë më, atëherë Enveri të lë përshtypjen e dikujt që ka humbur udhën dhe i mbetur fillikat përpiqet t'u mbushë mendjen se është ringjallur të parëve që i dalin përpara. Pra, duket qartë se ata që ka takuar janë kalimtarë të rastit te të cilët Enveri nuk mund të ketë asnjë shpresë t'i mobilizojë për qëllimet e tij politike.

Por sakrifica e tij, provë e të cilit është kryqëzimi dhe shenjë që ai po ua tregon, lidhet me *corpus mysticum*-in e tij, partinë, kreu i së cilës është ende për fanatikët, dhe *corpus majestis*, popullin me të cilin në mënyrë tipike për monarkët komunistë mbante dikur lidhje të drejtpërdrejta. Nëse sjellja e personazheve të tablosë tregon se nuk janë pjesë e ndonjë *corpus majestis* atëherë ata nuk e njohin për kreun e tyre dhe kryqëzimi i tij është po aq i pakuptimtë sepse është kryer në emër të një korporate që nuk ekziston. Ky krahasim bëhet edhe më i qartë kur lexojmë në librin e Kantorowitz-it se “trupi mistik i Kishës, koka e së cilës është Krishti u zëvendësua nga “trupi mistik i *respublica*-s në krye të së cilës qëndron Princi”. Por sakrifica e Princit për *corpus mysticum*-in e tij, pra, shtetin shekullar - krahasohej me sakrificën e Krishtit

edhe në një nivel tjetër, ai ofron jetën e tij jo vetëm si gjymtyrë, por edhe si kreu i trupit mistik (Kantorowitz 1957: 207).

A krijoi ideja e dyfishësisë – një trup të Krishtit që i përket atij dhe një trup (kolektiv, shënimi im) koka e të cilit ai është - dhe a e gjejmë barazvlerësin e tij në sferën shekullare kur u ngjiz *corpus republicae mysticum*? Princi duke qenë kreu i trupit mistik të shtetit dhe nganjëherë i njëjtësuar në personin e tij, paralelizonte Krishtin i cili ishte vetë koka e trupit mistik të Kishës dhe vetë ai trup. (Kantorowitz 1957: 268). Edhe në këtë rol sakrifica e Enverit ngjan e pakuptimtë sepse edhe shteti totalitar nuk ekziston më, duke krijuar më tepër përshtypjen e një farse, një kryqëzimi hipotetik, një teatri absurd.

Hapësira reale

Gjetja më origjinale e veprës është mendoj “nxjerrja” e Mosbesuesit nga tabloja dhe ulja e tij përpara saj me kurriz nga ngjarja ku ai dhe Enveri janë personazhet kryesore. Nuk më kujtohet ndonjë autor tjetër shqiptar që krijon me kaq efektshmëri hapësirë heterotopike duke ndërthurur hapësirën reale përpara tablosë me ngjarjen në tablo, e cila nga ana e saj lidhet me një ngjarje që ndodh në hapësirën utopike të një tabloje tjetër, ndërkohë që njëri nga personazhet (Piktori) krijon një hapësirë tjetër.

Duket se Mosbesuesi ndodhet përpara dy detyrave: së pari, të vërtetojë përmes syve dhe prekjes që shenja është e njëmendtë, çka do të thotë që Trupi politik i Enverit është ringjallur. Por meqë përmbajtja e një besimi holist, si në këtë rast, ka nevojë të mbështetet nga ekzistenca e disa besimeve të tjera po aq aksiomatike sa ai, atëherë atij i duhet të besojë krahas ringjalljes edhe në drejtësinë e doktrinës marksiste – leniniste, në unitetin e pashkatërrueshëm Parti-Popull, në besimin se shoqëria komuniste është e vetmja alternativë për Shqipërinë, në pagabueshmërinë

dhe përjetësinë e trupit politik të Enverit, në epërsinë e marksizëm –leninizmit ndaj paragjykimeve, miteve, legjendave, pra, shkurt, metarrëfimeve. Këtu puna ndërlikohet paksa sepse njëlloj si bolshevikët e dikurshëm edhe Mosbesuesi e di që koncepte të tilla lidhen me besimet fetare që dikur ishin shpallur të papajtueshme me ideologjinë zyrtare. Jo rastësisht Enveri përmendte me krenari se Shqipëria ishte vendi i vetëm në planet me kushtetutë ateiste. Pra, mos vallë, ashtu si në rastin e Leninit dhe Stalinit, kompromisi për të hyrë në zonën e metarrëfimeve dhe të teologjisë politike që prodhon auran e trupit të tij politik motivohej nga arsye tërësisht praktike duke vlerësuar potencialin e madh propagandistik që kishte ngritja e Enverit në statusin e Udhëheqësit historik dhe të pazëvendësueshëm?

Paraqitja e njëkohshme e Mosbesuesit në dy vende lidhet edhe me mëdyshjen që i shkakton kërkesa e prerë e Enverit që “të mos jetë mosbesues, por besues” pa kushte rreth një fakti të cilin ai mund ta perceptojë në rrafshin fenomenologjik, por nuk mund të nxjerrë një përfundim *a posteriori* sepse ai informacion nuk kthehet dot në dije sepse kundërshtohet nga logjika. Dihet se besimi dhe e vërteta kanë pasur marrëdhënie të vështirë në shekuj. Qysh në lashtësi Parmenidi e quante besimin, ose doksa-n “zemër pa dridhjen e së Vërtetës” (Parmenides 1991: 34). Pra, imperativi i besimit pa kushte nuk nënkupton vetvetiu se përmbajtja e tij është e vërteta. Kierkegaard-i e thotë shkoqur se ajo që mund të dimë me siguri është fakti që besojmë në diçka. Sa për përmbajtjen e besimit ajo mbetet gjithmonë e hapur për analiza racionale. Me daljen jashtë tablosë Mosbesuesi ngre pyetje rreth objektit semantik të besimit (në këtë rast ringjallja e Enverit) që lidhen si me përmbajtjen e besimit, ashtu edhe me marrëdhënien e subjektit me përmbajtjen. Pra, një operacion ku ai përfshin racionalitetin e tij, një qasje diametralisht e kundërt me bindjen pa kushte ndaj të vërtetës platoniane që kërkon urdhëri i Enverit “për të qenë besues”. Qëndrimi i Mosbesuesit pohon haptas të drejtën për të dyshuar në metafizikën e pranisë, parakusht i çdo ideologjie totalitare dhe të drejtën për të hyrë në zonën e hermeneutikës dhe interpretimit. Mos vallë me daljen nga tabloja Mosbesuesi merr një qasje që

e afron me qëndrimin e Hume-it i cili mendonte se besimi mund të lidhej me përpjekjet për ta ndërthurur me informacionin, duke e interpretuar këtë të fundit si pjesërisht të vërtetë? Duket se Mosbesuesi i kapur në kurth në zonën pragnore midis objektivitetit dhe subjektivitetit mbase po përpiqet të shndërrojë besimin e dikurshëm të Udhëheqësi në opinion i cili, siç dihet, është ndërgjegjësimi për pamjaftueshmërinë epistemologjike objektive dhe subjektive të një besimi. Në pamundësi të besimit të mbështetur nga dija objektive dhe logjika e fakteve që e quajmë shkencë dhe të vetëmjaftueshmërisë subjektive që e quajmë bindje, dyzimi i tij në dy hapësira dëshmon se në paraqitjen në hapësirën utopike të tablosë ai ndodhet ende nën pushtetin e formimit dhe besimit të dikurshëm duke iu bindur kërkesës së ish-diktatorit për të parë me sytë e tij provën. Ndërsa në një regjim tjetër kohe, asaj lineare (çka krijon heterokroninë e kësaj veprë) me shpinën e kthyer nga vetja e tij, ai jep dëshminë e qartë të dyshimit të gjithçkaje ka besuar më parë. Me sa duket tërheqja e tij diktohet nga pamundësia për të bashkuar dy situata: Enveri ka dhënë provën e ringjalljes (në nivelin e informacionit të perceptuar) ndërkohë që nuk kalon testin e logjikës së Mosbesuesit. Duket se përpjekja e Enverit për ta bindur për ringjalljen e tij po dështon pikërisht për shkak të suksesit dhe efektshmërisë së sistemit të tij të dikurshëm të edukimit revolucionar dhe ateist të cilit i është nënshtruar edhe Mosbesuesi i sotëm i cili qysh në moshë të hershme e mësuan t'i shohë kultin e individit, trupin politik dhe mëtimet rreth përjetësisë, metafizikës, ringjalljes, pagabueshmërisë si të pathemelta, të largëta, madje të rrezikshme për mendësinë e njeriut të ri socialist. Mëdyshja e tij e dytë (pas asaj të zbulimit të trupit organik të ish-diktatorit), e përfaqësuar nga personi i ulur përpara tablosë, lidhet me çudinë që pikërisht Ai që e kish edukuar me pavlefshmërinë e metarrëfimeve tani i shfaqet duke mëtuar për trupin e tij politik një aura teologjike të cilën sa ishte gjallë, të paktën publikisht, e mohoi sa herë që iu dha rasti. Pra, ndodhet në mëdyshje i kapur midis hipotezës së ringjalljes (çka nënkupton përjetësinë e tij) dhe organizimin e strukturës argumentuese dhe ballafaqimin e fakteve që mbështetin ringjalljen apo dyshimin në të. Mundet që përmes hipotezës të ndriçohet, të organizohet ballafaqimi midis sigurisë së ringjalljes dhe mundësisë që ky të jetë

një mashtrim. Nga qëndrimi i menduar duket sikur Mosbesuesi është asnjëherë ndaj informacionit por po shqyrton strukturën argumentuese të besimit apo dyshimit pa arritur ndonjë përfundim. Mëtimi i Enverit se trupi i tij politik me auran e qartë teologjike “gjallon” i pavarur nga dështimi i bujshëm i ideologjisë zyrtare dhe zbulimi i krimeve të kryera në emër të një ideali që rezultoi kallp dhe pa vlerë duket i paarsyeshëm dhe mbase kjo është pyetja që po mundon më shumë Mosbesuesin: si mundet të kërkesin përjetësinë e trupit tënd politik, madje ringjalljen e tij, produkt i drejtpërdrejtë i atij sistemi totalitar që rezultoi burim fatkeqësish për një popull të tërë?

Si një absurditet që i përket metafizikës së teologjisë politike mesjetare trupi politik i Enverit mund të brendashkruhet në grupimin e ideologjive në kufinj të pragmatikë të besimeve, të cilat Boudon-i thotë se ndonjëherë janë të gabuara, mbështeten mbi argumentime komplekse, metodike dhe në njëfarë mënyre racionale. Megjithatë Mosbesuesi i dalë nga zona e besimit ndodhet në atë të dyshimit ku po shqyrton strukturën argumentuese të fakteve nuk duket se ka dalë në një përfundim, nuk mund të mohohet megjithatë se ka fituar lirinë për të pyetur dhe për të dyshuar. Çka provon se ai nuk është më pjesë e ndonjë *corpus majestis*, bashkësie të drejtuar nga një ide aksiomatike absolute dhe një udhëheqës karizmatik dhe as pjesë e ndonjë subjekti kolektiv. Ndryshe nga ç’ndodhte me personazhet e tablove të realizmit socialist të cilave nuk u lejohet luksi i dyshimit. Të gjitha figurat rrotull Enverit, të cilat e kthenin në qendrën e padiskutueshme të kompozimit jo vetëm me shikimet e tyre, përmbajnë karakteristikat e një bashkësie që i lidh një besim i patundur, ndërkohë që objekti semantik i besimit të tyre, Enveri, bëhet lehtësisht i perceptueshëm përmes teknikave kompozicionale që e kthejnë në qendër vëmendjeje. Pra, në sjelljen e Mosbesuesit shohim fundin e një epoke, të mendësisë tipike totalitare të magjepsjes së individit nga aura teologjike e trupit politik të Udhëheqësit. Ja përse edhe metoda e studimit që po ndjekim nuk mbështetet në holizmin metodologjik, por më tepër në individualizmin metodologjik. Vënia në dyshim e racionalitetit të individëve nuk u duket më e dyshimtë

sociologëve bashkëkohës të cilët e pranojnë se holizmi metodologjik nuk e ka më privilegjin e dikurshëm të oligopolit të dijes. Racionaliteti i veprimit të Mosbesuesit (si kërkimi për të parë plagën, ashtu edhe dalja nga vetja në një regjim tjetër hapësire) përcaktohet në varësi të kontekstit në të cilin kryhet dhe kushtëzohet nga marrëdhënia midis logjikës së vepruesit dhe përfytyrimit që ai ka për situatën ku vepron. Kthimi i shpinës auras së mëtuar teologjike të trupit politik të ish-diktatorit dëshmon bindshëm për opacitetin e besimit të tij.

Opaciteti i besimit

Dihet se kushti i parë i opacitetit të besimit është largësia kulturore e vëzhguesit me të vëzhguarin. Ky kusht në rastin e kësaj tabloje nuk qëndron, së paku në vështrim të parë, sepse Mosbesuesi siç e vumë në dukje më lart nuk ka ndonjë largësi kulturore nga mjedisi historik dhe kulturor i shoqërisë socialiste të ngritur nga Enveri; ai u rrit dhe edukua në sistemin arsimor të ngritur prej tij, u indoktrinua me vlerat morale dhe etike që regjimi përpiqej të mbillte në mendjet e shqiptarëve të asaj kohe. Pra, opaciteti ndaj besimit se Enveri është ringjallur lidhet me largësinë kulturore që ka tani Mosbesuesi nga vetë Enveri i tablosë i cili shfaq qëndrime për të cilat të tjerë që besonin në metafizikën e shpirtit u ndëshkuan rëndë nga regjimi i tij. Dikur kundërshtar i vendosur i besimeve fetare, kultit të personalitetit tani ai po shfaq publikisht trupin e tij politik i cili ishte pjesë e teologjisë politike të monarkëve europianë qysh prej Mesjetës së vonë. Mëdyshja e Mosbesuesit lidhet me faktin që tani po zbulon dikotominë midis edukimit të tij materialist dhe dozës së theksuar teologjike të auras që rrethonte qysh në gjallje Arkitektin e shkatërrimit të strukturës institucionale të fesë në Shqipëri. Mbase gjatë përsiatjeve të tij i ulur po pyet veten se si nuk e kishte vënë re atëhere atë dozë të theksuar irracionaliteti që përmbante ai sistem të menduari që e ngriti një ish-profesor mediokër liceu në statusin e një gjysmë-hyjnë të pagabueshme dhe me trup politik të pavdekshëm? Kjo ide nuk mund të mos shoqërohet me

një ndjenjë zhgënjimi dhe faji. Mbase Mosbesuesi po përjeton atë që thotë Durkheim-i se besimi i dikurshëm, sado irracional të jetë, nuk mund të braktiset pa shkaktuar trauma, pasiguri dhe dyshim.

Kushti i dytë lidhet me faktin që opaciteti i besimit mund të ndodhë edhe nëse besimi i dikurshëm ka qenë pa kushte. Mund të themi me siguri pasi Mosbesuesi është një person real se ai nuk ka pasur ndonjë marrëdhënie të pakushtëzuar me besimin e tij. Si shumë të tjerë ka besuar në rolin historik të Enverit dhe në kontributin e tij të pazëvendësueshëm në nxjerrjen e Shqipërisë nga varfëria dhe mjerimi ekonomik duke e futur në rrugën e mbarë të historisë drejt një shoqërie ku herët a vonë do të hynin doemos të gjitha vendet e planetit. Por, meqë siç thamë racionaliteti i një besimi holist nuk reduktohet vetëm në ekzistencën e një objekti semantik (në këtë rast ringjallja e Enverit) por përcaktohet nga ekzistenca e disa besimeve të tjera të lidhura me të, Mosbesuesit po i kërkohet të besojë po ashtu edhe në pagabueshmërinë e marksizëm-leninizmit. Diçka e vështirë për ta gëlltitur pas dështimit të politikave ekonomike dhe sociale të regjimit të udhëhequr prej tij dhe pasojave të rënda që pagoi Shqipëria për eksperimentin social të realizimit të shoqërisë komuniste.

Kushti i tretë i opacitetit lidhet me faktin se besimi individual ka një histori që shtrihet në kohë dhe kushtëzohet nga rrethana dhe mjedise të caktuara shoqërore. Duke qenë një konstruksion mendor i ngadaltë që ngrihet në disa etapa kushtet dhe rrethana të caktuara mundësojnë lindjen e një besimi që mbase në situata të tjera do të kish qenë i vështirë ose i pamundur të ndodhte. Ky proces për shkak se është e vështirë të tregohet apo shihet nuk mund të bëhet objekt vëzhgimi shkencor. Meqë Mosbesuesi është person real dimë që ka jetuar në një mjedis ku numëroheshin disa pjesëtarë të rrethit të afërt familjar që kishin qenë partizanë, ndërkohë që profesioni i mësuesit e kishte vënë asokohe në kontakt të ngushtë me procesin intensiv të indoktrinimit të cilit i nënshtroheshin të gjithë ata që punonin në fushën e edukimit të brezit të ri.

Hapësira e tretë jashtë rrafshit topologjik

Kjo hapësirë, siç e theksuam më parë, lidhet me vështirimin e *Piktorit* jashtë hapësirës utopike të tablosë në një utopos tjetër ku me sa duket po ndodh diçka që i tërheq vëmendjen. Qëndrimi i tij mospërfillës përpara Enver Hoxhës, stili i flokëve që do ta kish kthyer në qendër të vëmendjes së aktivistëve të Frontit¹² sidomos kanoçja me Coca-Cola, pijen simbol të Amerikës, e cila mund të shijohej vetëm pas mbarimit të Luftës së Ftohtë tregon se në një tjetër epokë ka mbërritur, ajo e kapitalizmit, globalizimit, individualizmit.

Por sado absurd të duket aura teologjike e ish drejtuesve të regjimeve totalitare po jep shenja shqetësuese ringjalljeje: Stalini u shpall personi më i rëndësishëm i historisë ruse, ka ikona të pikturuara me atë si subjekt ndërkohë që ka kërkesa ndaj Kishës ortodokse për ta shpallur shenjtor. Po ashtu një ringjallje të trupit politik të Enverit shihet në rishfaqjen e portreteve të tij në tubime përkujtimore të luftës nacional-çlirimtare çka shkakton reagimin e partive të djathta dhe shoqatave të të përndjekurve.

Është e qartë që trupi politik i Enverit i mbijetoi trupit të tij organik dhe regjimit totalitar që krijoi. Imperativi ynë historik është të dekonstruktojmë, duke e parë mëtimin e auras teologjike të trupit të tij politik, siç do të thoshte me të drejtë Maitland-i, “një absurditet metafiziologjik”.

Kjo tablo e vendos Enkelejdin në hullinë e duhur të dekonstruktimit të trupit të tij politik, duke u bërë pjesë e këtij procesi që ndonëse nuk ka reshtur asnjëherë, edhe në kulmin e terrorit, duhet kryer sa më parë. Për qasjen tipike poststrukturaliste me të gjithë elementet që përmendëm, për

¹² Fronti demokratik ishte një organizatë satelite e Partisë së Punës e cila në nivel blloku banimi dhe lagjeje përmes veprimtarëve të saj mbikqyrte respektimin e rregullave të bashkëjetesës socialiste, përfshirë këtu edhe pamjen e jashtme, sidomos të të rinjve.

prirjen dekonstruktuese si dhe për risinë e krijimit të hapësirave heterotopike dhe kronotopike kjo tablo meriton një vend të veçantë në artin tonë postmodern.

Bibliografia

Eco, U (2003) *L'œuvre ouverte*, Paris: Éditions du Seuil.

Foucault, M. (1994 [1984]) «Des espaces autres », dans *Dits et écrits: 1954-1988*, t. IV (1980-1988), Paris: Éditions Gallimard.

PostEva, (2001).Katalog retrospektiv i nudos shqiptare, *Galeria Kombëtare e Arteve*.

Gentile, E. (2007) *Le religioni della politica, fra democrazie e totalitarismi*,: Edizioni Laterza.

Kantorowitz, E. (1957) *The King's Two Bodies. A study in Mediaeval Political Theology*, New Jersey: Princeton University Press.

Parmenides, Hyrja nga David Gallup, (1991), Phoenix Presocractic Series, University of Toronto Press, Plamper J. (2012), *The Stalin Cult, A Study in the Alchemy of Power* Yale University Press.

Tumarkin N. (1997), *Lenin lives! The Lenin cult in Soviet Russia*, Harward Press.

Maitland F. (1901), *The Crown as Corporation*, Law Quarterly Review.

Irida Vorpsi

Universiteti i Tiranës

Revolucioni Kulturor dhe politikat per emancipimin e gruas

Shqipëria komuniste dhe lideri i saj paranojak Enver Hoxha pas përjetimit të stinës së ftohtë të marrëdhënies me Bashkimin Sovjetik dhe pasigurive që kjo thyerje solli për të personalisht, i hodhën sytë larg, shumë larg fizikisht dhe kulturalisht duke shpresuar të gjenin një strehëz ideologjike dhe mbi të gjitha një patericë të fuqishme që do të mbante në këmbë ngrehinën e brishtë të ekonomisë shqiptare, e cila fshihej pas propagandës së shfrenuar për përdorim të brendshëm të mbrojtjes dhe çuarjes përpara të marksizëm-leninizmit dhe mbajtjes në zemër dhe në mendje të mësimave leniniste e mbi të gjitha ruajtjen si sytë e ballit të doktrinės staliniste siç e paralajmëronte vetë Hoxha: “Gjithë Partia dhe vendi duhet të ngrihen në këmbë, të djegin me zjarr zakonet prapanike e t’i këputin kokën cilitdo që merr nëpër këmbë ligjin e shenjtë të Partisë për mbrojtjen e të drejtave të grave dhe të vajzave” (Hoxha 1982: 213-218, 224-228) duke e vendosur kështu revolucionarizimin e gruas si pararojë të revolucionarizimit të jetës në vend. Ky qëllim duhej të arrihej në mënyrë propagandistike duke i indoktrinuara masat dhe duke mbërritur sa më shpejt në atë që PPSH-ja trumbetonte si “njeriun e ri”, pjesë e të cilit ishte padyshim edhe “gruaja e re”.

Çka propagandohet në median e kohës dhe në dokumentat zyrtare si arritja më e madhe, revolucioni kulturor dhe arsimor, do të trajtohet 10 vjet më pas në 1979 në librin me kujtime të Hoxhës, “Shënime mbi Kinën” si “përpyjekja kineze për të imponuar revolucionin kulturor kinez dhe kultin e Maos në Shqipëri” (Hoxha 1979: 40). Duhet thënë se nuk është gjetur një kopje e ditarit origjinal në arkivën qendrore dhe sipas studiuesit Mëhilli ka diskrepancë mes qëndrimeve të publikuara 10 vjet më pas si ditar personal i Hoxhës dhe dokumentave arkivore të kohës në lidhje me qëndrimin ndaj revolucionit kulturor në Kinë dhe importimit të tij në

Shqipëri. Sipas të mbaramave, Hoxha përqafoi idenë e revolucionit kulturor vetëm pasi mori siguri për rolin e tij dhe mosprekjen apo shkërrmoqjen e PPSH-së sipas modelit original të sulmit të pësuar nga PKK nga “baza”, sulm ky krejt i pacentralizuar.

Mëhilli argumenton sesi në dokumentet arkivore ndihet paniku për likujdimin e klasës drejtuese të PKK duke nënkuptuar këtu humbjen e miqësisë me Kinën dhe implikimet e rënda ekonomike dhe sociale që sillte kjo situatë hipotetike për Shqipërinë, që kish gjetur tek Kina një mbështetje solide për ekonominë e saj thuajse të fundosur pas prishjes me Bashkimin Sovjetik (Mëhilli 2014: 165-184).

Ndërkohë që në shënimet e tij, Hoxha pretendon të ketë qenë kritik që në krye të herës për çështje parimore me Maon dhe linjën e tij, por faktet flasin sesi u veneruan liderët kinezë në Shqipëri dhe sesi u adaptua modeli i revolucionit kulturor për të sulmuar po aq ashpër sa garda e kuqe partinë dhe burokracinë në Kinë, të ashtuquajturat zakone prapanike, lirinë fetare tejet të cunguar me kalimin e viteve dhe botëkuptimin mikroborgjez.

Marrëdhëniet shqiptaro -kineze u vendosën në rang ambasadorësh në 1954 dhe delegacioni i parë i rangut të lartë kinez erdhi në Tiranë në vitin 1956. Pas mungesës së Hoxhës në mbledhjen e Bukureshtit dhe refuzimin e destalinizimit, marrëdhëniet ruso- shqiptare kishin marrë rrokopujën dhe thyerja ishte e pashmangshme.

“Boshllëkun” e lënë nga tërheqja e eksperteve teknike dhe kredive sovjetike e mbushën “miqtë” kinezë. Vizitat e shpeshta të KM Çu En Lai në 1963, 1964, 1965 dhe 1966 ishin shenja të sigurisë që fitoi establishmenti politik shqiptar. Duket se vizita e Shefit të Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Çlirimtare Popullore kineze ishte si melhelm për Hoxhën që ra sërish në panik pas pushtimit të Çekosllovakisë nga tanket sovjetike. Në të njëjtën mënyrë u përdorën si propagandë vizitat e pafundme të punëtorëve, inxhinjerëve dhe atletëve kinezë gjatë revolucionit kulturor. Në këtë kohë ishin po aq të shpeshta ardhjet e grave aktiviste kineze si

model për homologet e tyre shqiptare në luftë për revolucionarizimin e jetës. Sa të ngjashëm ishin revolucionet kineze dhe shqiptare? Studimet tregojnë se nuk ka pasur një tentativë mirëfilli kineze për të transportuar revolucionin kulturor kinez në Shqipëri si akuzon Hoxha 10 vite më pas në ditarin e tij, përkundrazi është nënvizuar situatë e ndryshme në të cilën ndodheshin të dy vendet. Preokupimi i Hoxhës dhe origjina e ankthit të tij duket se qëndronin pikërisht në dyshimin se revolucioni kulturor në Kinë po i turbullonte shumë ujrat dhe si rezultat i tij Mao mund të humbte kontrollin e Partisë dhe Kina të mos e mbështeste më Shqipërinë, çdo të bëhej më pas me ekonominë anemike shqiptare? Në mbledhjen e Byrore Politike të datës 10-11 tetor 1966, në një koment për Revolucionin Kulturor, Hoxha shpreh këtë gjendje pasigurie në lidhje me rezultatet e tij duke aluduar për një situatë të ngjashme me ardhjen në pushtet të Krushovit dhe ndërrimit të kursit me procesin e destalinizimit (Mëhilli 2011). Kjo duket qartë edhe në instruksionet që ai jep për të monitoruar dhe drejtuar propagandën në lidhje me Kinën nga lart, pa inisiativa të ekzagjeruara (Mëhilli 2011).

I kujdesshëm për ta cilësuar Revolucionin Kulturor dhe linjën e Maos si politikisht korrekte, Hoxha përdori “*know how*”-n e revolucionit për qëllimet e tij: të çrrënjoste përfundimisht traditën gërrshetuar në të besimin fetar si të vetmen mënyrë për ta zëvendësuar plotësisht me ideologjinë komuniste duke çuar kështu përpara fitoret e revolucionit dhe të propagandonte me tej politikën e emancipimit të gruas, sepse pothuajse në të gjitha fjalimet e tij shprehet një lloj pakënaqësie për gjendjen e gruas dhe pjesëmarrjen e saj në shoqëri, duke pasur si qëllim kryesor përfshirjen e saj të plotë në ekonominë socialiste.

Periudha mes gushtit 1967 dhe janarit 1968 është sipas studiuesve ajo më e ethshmja në mbështetje të Revolucionit Kulturor, por kjo nuk vihet re në dikursin publik nëse analizohen fjalimet e Hoxhës në këtë periudhë. Asnjë referim ndaj muajit të mjaltit me Kinën, fakt ky që përforcon idenë se kujtimet e fjalët e Hoxhës janë modifikuar në funksion të pragmatizmit politik me kalimin e viteve.

Paketa e reformave e ndërmarrë në gjysmën e dytë të viteve 60 u mbështet fort në moton “për revolucionarizimin e mëtejshëm të shkollës” në vitet 1967-1970 dhe për emancipimin e mëtejshëm të gruas, Përmbytja e kësaj reforme ishte e bazuar në filozofinë e revolucionit kulturor kinez duke u bazuar në tre element kryesorë: mësim, punë prodhuese dhe fizike dhe edukim ushtarak (Pandelejmoni, Musaj, Rama 2012: 35-63). Pra gruaja shqiptare po vendosej gjithmone e më shumë në qendër të kësaj spiraleje ideologjike duke synuar pamëshirshëm politizimin e çdo aspekti të jetës së saj, vlen për t’u nënvizuar këtu tendenca për ta reduktuar sferën private të jetës së gruas në një hiç dhe duke shtrirë ndikimin ideologjik të Partisë në kufijtë e të paimagjinueshmes.

Një shembull konkret i importimit të mjeteve kineze revolucionare ishin dhe fletë-rrufetë që mbulonin muret e ndërmarrjeve dhe shkollave shqiptare në fillim të viteve ‘70 rigorozisht sipas modelit kinez të dacibaove në denoncim të shfaqjeve të huaja.

Në fjalimin mbajtur në Plenumin e 2-të të KQ të PPSH-së më 15 qeshor 1967 “Mbi disa aspekte të problemit të Gruas shqiptare (Hoxha 1982: 1-31), Hoxha i referohet Marksit, Engelsit, Leninit dhe Stalinit, por nuk përmend liderin kinez dhe as Revolucionin Kulturor. Ai flet për “revolucion proletar të udhëhequr nga Partia e lavdishme” dhe arritjet e tij, gjithmonë duke vënë përkrah termit revolucion Partinë, si për të bindur të tjerët, por më shumë veten se asgjë nuk do ta prekte Partinë, as revolucioni vetë.

Në këtë fjalë nuk u përmend revolucioni kulturor kinez dhe u adresua çështja e gruas si një imperativ i revolucionit kulturor dhe arsimor dhe pjesëmarrjen e saj në të si thelbësore. Ai përfiton nga rasti për të thumbuar shokë të Partisë që nuk i kuptojnë këto çështje, disa që i kuptojnë shtrembër dhe disa që i kuptojnë përciptas. Hoxha përmend veriun e Shqipërisë ku zakonet prapanike e paskëshin lënë gruan më pas, pra duke pranuar në këtë mënyrë një lloj pafuqie të Partisë për t’i hequr qafe ato dhe për ta zëvendësuar me njeriun e ri socialist. Në

diskutimin e tij në mbledhjen e Sekretariatit të KQ të PPSH, 21 prill 1967 “Për të luftuar zakonet prapanike duhet të zbulojmë burimin e tyre (Hoxha 1982: 384-386)” ai sugjeron të studiohet Kanuni i Lekë Dukagjinit për të bërë diagnozën e gjendjes aktuale atje dhe për të parë përmbysjet, evolucionet dhe për të forcuar punën ideologjike të Partisë në Veri.

Në fjalën e tij mbajtur në takimin me popullin e fshatit Rrapsh-Starje të rrethit të Shkodrës dhe me përfaqësues të malësisë së Kelmendit në 2 shtator 1967, “Zakonet e egra t’i djegim në zjarr” (Hoxha 1982: 213-218, 224-228), Hoxha synon të përhapë frymën revolucionare dhe nën dritën e revolucionarizimit të jetës vjen edhe sugjerimi i tij për të bërë dasma të thjeshta, pa shpenzime, me një numër të kufizuar dasmorësh: “Sikurse luftojmë fenë, po kështu duhet të zhdukim edhe disa tradita e zakone që sot nuk i pranojnë as koha dhe as jeta jone socialiste. Të tilla janë për shembull zakoni i dasmave me shpenzime të shumta, i pajës së madhe, i veshjeve të rënda etj” (Hoxha 1982: 213-218, 224-228).

Luftën kundër fesë ai e kapilarizon në luftën kundër zakoneve prapanike duke analizuar edhe teorikisht rrezikshmërinë e pranisë së tyre. Në intervistat e marra në kuadër të studimeve doktorale, dëshmitarë okulare të asaj kohë kanë folur për një ekstremizim të këtij revolucionarizimi që përfshiu ceremonitë martesore duke e quajtur fustanin e bardhë të tepërt dhe duke i konsideruar bizhutë si pjesë të zakoneve prapanike dhe dollapët me shumë pasqyra të parapëlqyer nga borgjezkat (Hoxha 1982: 213-218, 224-228). Por nuk ishte kaq e thjeshtë të çrrënjëzoje një popull të tërë nga zakonet e doket e tij, mund ta digjje kanunin e Lekë Dukagjinit, mund edhe t’ia shpëlaje trutë të rinjve dhe të përdorje propagandën për të hequr xhubleta e qeleshe, por u kuptua se kaq nuk mjaftonte. Ndaj në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH në 13 janar 1968 Hoxha flet për një strategji perfide: atë të organizimit të skuadrave nga Malësia për të punuar në kooperativat e përparuara në Shqipërinë e Jugut dhe atë të Mesme. U synua edukimi masiv, jo vetëm për të rinjtë, po për të gjithë duke i degdisur në grupe masive grash e burrash që shkonin të punon për dy muaj atje ku i caktonte Partia. Në dokumentat e

Organizatës së Bashkimit të Grave të kohës vihet re aktivizimi i një fushate masive për spostimin e grave nga Jugu në Veri dhe anasjelltas. Raportet në dosjet e kësaj organizate dëshmojnë për gra nga malësitë e Tropojës, Pukës, Lezhës, Kuksit, Peshkopisë dhe Mirëditës që vërshojnë drejt familjeve kooperativiste të Gjirokastrës, Vlorës, Beratit, Durrësit, Fierit dhe Lushnjes. Në fjalën e tij ndihet një lloj përçmimi krahinor që është shpërfaqur shpesh: “Kurse ata të Jugut që do të shkojnë në malësi, do t’u mësojnë malësorëve në mënyrë masive shumë gjëra të jetës, të zakoneve dhe të agroteknikës. Te malësorët kjo formë edukimi do të jetë e dyfishtë, nga ata vetë që shkojnë në Jug dhe nga ata të Jugut që do t’u vijnë në shtëpi” (Hoxha 1982: 260-268). Ndihet pakënaqësia me krahina të caktuara të vendit që dukeshin se nuk po përqaфонin me entuziazëm revolucionarizimin e mëtejshëm të jetës dhe për t’ia arritur këtij qëllimi u dashka bërë një shartim i popullsisë, nga i cili do të dilte një pjellë hibride, njeriu i ri socialist, ai që digjte bashkë me kisha e xhamia edhe traditën qindravjeçare në këmbim të tesserës së kuqe dhe idealeve të Partisë. Ky njeri do të konsolidohej më tej, kur në vend të përshendetjeve malësore do të dëgjohej brohoritja “Për ideal të Partisë”. Sipas orientimit të KQ të PPSH-së dhe të Hoxhës personalisht, kryesia e BGSH-së organizoi kurse për edukimin e të ashtuquajturave “luftëtare të së resë” nga shumë fshatra të vendit. Gjatë viteve 1968-1973, 3 264 gra morën pjesë në këto kurse, 769 prej të cilave u pranuan në Parti, ndërkohë që 1 248 vazhduan shkollën dhe 532 u ngritën në përgjegjësi atje ku punonin (Hoxha 1983: 79-99).

Filozofia e revolucionit kulturor kinez, atje ku baza shkërmoqi thujtë Partinë Komuniste, shërbeu si shembull i asaj që Partia e Punës po bënte me gjithë forcën e propagandës së saj: ajo po shfrytëzonte rininë, duke i vënë theksin këtu grave dhe vajzave për t’ia kundërvënë ato sistemit patriakal, vlerave fetare sidomos në Veri të Shqipërisë, atyre që Partisë i kanoseshin me forcën e traditës dhe patriakalizmit. Politizimi dhe ideologjizimi i skajshëm i shërbenin revolucionarizmit të mëtejshëm të jetës për te zhdukur mentalitetin e vjetër të jetës së vetmuar siç shprehet Hoxha vetë në fjalën e takimit me të rejtat e malësisë së Veriut, pjesëmarrëse në

kursin e organizuar në Durrës 20 maj 1968: “Këto që mësuat në kurs, i vini në zbatim, i bëni një jetë të dytë” (Hoxha 1983: 79-99). Duke djegur në turrën e gërshetave malësore të prera në kurs zakonet, fenë, paragjykimet dhe thashethemet, ato po shndërroheshin në zgjatimet e propagandës së PPSH në zonat më të thella të Malësisë së Veriut.

Fjala e tij vijon me konceptin e “vrasjes së babait”: “...kjo kërkon që pikëpamjet e prapambetura për gratë të luftohen me punë bindëse, të pandërprerë, me punë politike dhe ideologjike dhe jo me konflikte, se mëmën dhe babin duhet t’i sqarojmë për këto problem dhe jo t’i luftojmë. Ata ne i duam dhe do t’i duam, po kur na pengojnë, duhet të përpiqemi pa u lodhur, t’i sjellim në rrugën e drejtë të Partisë (Hoxha 1983: 79-99).

Diskutime të gjata për higjenën vetjake, për përdorimin dhe rëndësinë e zarzavateve në një diete të ekuilibruar dhe të tjera tema praktike si këto ishin të pranishme në çdo fjalë që Hoxha mbante në mbledhje të tilla. Pas tyre do të vinte elektrifikimi dhe bashkë me të edhe propaganda më e sofistikuar nëpërmjet radios e më vonë televizorit.

Synohej emancipimi i gruas në linjën e parashtruar nga Partia, pra proçesi parashikohej i gjatë dhe me pengesa me qëllim edhe të përdorimit të krahut të punës së gruas në fuksion të ekonomisë socialiste. Çerdhet dhe kopshtet u ngritën në funksion të këtij qëllimi, i cili shprehet qartazi në “Të bëjmë një punë më të gjerë për ta çliruar gruan nga disa mbeturina dhe pengesa (Hoxha 1980: 464-483)” kur analizohet raporti i përgjegjësve të ekipeve të shpërnadrë në rrethe gjatë periudhës shkurt-mars 1968, në mbledhjen e Sekretariatit të KQ të PPSH në 14 mars 1966.

Njëzet e dy vjet pas instalimit të diktaturës, Hoxha pati një gjetje brilante për të pastruar më në fund me rrënjë e dhëmballë memorjen hisotrike dhe zakonore shqiptare: do të përdorte revolucionin kulturor kinez si mjet për të arritur qëllimin e tij: zhbërjen e memories kolektive zakonore dhe zëvendësimin e saj një herë e mirë me idelogjinë komuniste duke aplikuar kështu një shpëlarje truri thelbësore dhe duke minimizuar sipas tij rrezikun që e shoqëronte si hija e

vet, atë të dobësimit dhe të humbjes së kontrollit të Partisë e si rrjedhojë dhe të shtetit. Pjesë gjalluese e kësaj politike u bë dhe syreshja ndaj gruas, si një prej shtyllave më të forta të propagandës komuniste. Nëse analizohet fjalimi i mbajtur nga Hoxha mbajtur në mbledhjen e përbashkët të organizatave - bazë të PPSH të Minierës së Qymyrgurit të Kërrabës, uzinës “Enver”, kooperativës bujqësore “Vilhelm Pik”, repartit Ushtarak nr.5009 dhe Universitetit të Tiranës në 6 shkurt 1967” Revolucionarizimi i mëtejshëm i Partisë dhe i Pushtetit“ (Hoxha 1967:1), ndihen qartë tonet e ashpra ndaj burokracisë (Hoxha 1967: 1), shkundja që ai i bën kuadrove, një lloj presioni që ia mvësh masave, por që duket qartë se është qëllimi i tij për t’i dhënë një mësim të paqme strukturave partiake. Vendosija përballë e burokracisë dhe revolucionit në një kontekst dikotomik e bën më të thellë hendekun mes tyre. Lufta zhvillohej në shumë fronte dhe nuk linte askënd të qetë, asnjëra nga anët e llogores nuk ishte e mbrojtur prej shpatës së Demokleut që rrinte varur mbi çdo qafë, si të komunistit të thjeshtë, si të zyrtarit të lartë të Partisë, si të armikut të etiketuar të klasës apo të një syreshi në pritje për t’u shpallur i tillë. Askush nuk mund ta bënte gjumin e qetë. Pas përsiatjes filozofike “Mbi burokracinë” (Hoxha 1967:1) fshihej një çështje praktike tepër e qartë: kupola drejtuese komuniste prej majës së saj deri tek komunisti më i thjeshtë mund të ishin subjekt i kësaj thike me dy presa, por mesazhi ishte shumë i qartë: askush dhe asgjë nuk mund ta prekte e dëmtonte Partinë, se ky proces do ta çelikeste më tej dhe në asnjë mënyrë nuk mund të pranohej një dobësim i saj, përkundrazi. Llogaridhënia si detyrim komunist dhe lufta e paepur ndaj asaj që etiketohej si “burokraci”, por jo vetëm, është lajtmotivi i këtij fjalimi dhe shkëndija për zjarrin që do të ndizej më pas dhe do të vlerësonte emencipimin e gruas si një nga faktorët më të rëndësishëm për përparimin e vendit.

Përmes manipulimit të saj synohej përdorimi i mëpasshëm jo vetëm si kontribut i bollshëm në ekonomine socialiste përherë e në nevojë për krah pune, por edhe si mjet për të goditur sa të

mundej memorjen zakonore, armikun e fundit që frymonte përtej goditjes tashmë të bërë realitet ndaj fesë dhe klerit.

Sistemi patriakal dhe i prapambetur i shoqërisë paternaliste shqiptare ishte streha më e volitshme për të zëvendësuar ngrehinën ekzistuese me kupolën shndërritëse të ideologjisë komuniste, revolucioni kulturor kinez ofronte mënyrën më të mire për ta kryer këtë gjë dhe Hoxha gjeti momentin më të volitshëm për të personalisht kur po ndihej më i fortë dhe i sigurtë për të hequr qafe çdo iluzion se mund të frynin erëra të ndryshme në Parti nën frymëzimin e Revolucionit Kulturor kinez.

Bibliografia

Hoxha, E. (1979) Shënime mbi Kinën (1962-1972), Tiranë: Shtëpia Botuese “8 Nëntori”.

Hoxha, E. (1982) Vepra, vëll 37, Tiranë: Shtëpia Botuese “8 Nëntori”.

Hoxha, E. (1980) Vepra, vëll.31, Tiranë: Shtëpia Botuese “8 Nëntori”.

Hoxha, E. (1982) Vepra, vëll.35, Tiranë: Shtëpia Botuese “8 Nëntori”.

Hoxha, E. (1982) Vepra, vëll.36, Tiranë: Shtëpia Botuese “8 Nëntori”.

Hoxha, E. (1983) Vepra, vëll.38, Tiranë: Shtëpia Botuese “8 Nëntori”.

Mëhilli, E. (2011) Building the Second World: Postwar Socialism in Albania and the Eastern Bloc, Princeton: Princeton University.

Mëhilli, E. (2014) Mao and the Albanians. Në, Cook, C.Alexander (bot.) Mao’s little red book, Cambridge: Cambridge University Press, 165-184.

Pandelejmoni. E. Musaj, F.; Rama, F. (2012) Albania- Gender Relations in Albania (1967-2009). Në, Daskalova, Krassimira etj. (bot). Gendering Post-Socialist Transition. Studies of Changing Gender Perspectives. ERSTE Foundation Series. Volume 1. LIT Verlag, Wien, Berlin, 35-63.

Artikull i botuar në gazetë Hoxha, E. (1967) “Revolucionarizimi i mëtejshëm i Partisë dhe Pushtetit”, gazeta Zëri i Popullit, 7 shkurt, 1.

Kinemaja komuniste shqiptare dhe modeli sovjetik: ngjashmëri dhe dallime

Kinemaja në periudhën e komunizmit në Shqipëri (1944-1990) ka qenë ndër instrumentet kryesore për të krijuar “shoqërinë e re socialiste” mbi gjëmat e “së vjetrës”. “Shoqëria e re” do të bazohej në radhë të parë në “lindjen e njeriut të ri”, ose në “moralin komunist”, që nënkuptonte edhe një vizion të caktuar mbi botën.

Në këtë kuadër, kinemaja kishte disa përparësi: a) ishte një art masiv dhe në sallat e kinemasë mund të mbledheshin qindra vetë, b) kinemaja e realizmit socialist kishte në bazë të saj një skenar të thjeshtë, me heronj pozitivë dhe negativë, gjë që e bënte të asimilueshëm për masat e gjera, aq sa nga bolshevikët konsiderohej edhe si “një libër që mund të lexohej edhe nga analfabetët”, c) kinemaja ndryshoi thellësisht sensin e kohës dhe të hapësirës. Një film mund të shfaqej disa herë, në të njëjtën kohë dhe në vende të ndryshme, duke bërë të mundur homogjenizimin kulturor dhe ideologjik të popullsisë, d) si e tillë kinemaja nuk ishte vetëm një mjet shumë i mirë propagande, por ishte një art që mund mbahej edhe më lehtë nën kontroll, në ndryshim nga letërsia e cila mund të bënte edhe “diversione” midis rreshtash.

Nga pikëpamja teknike, kinemaja kishte një avantazh tjetër të madh dhe ushtronte një ndikim të pazakontë mbi shikuesin. Sidomos me daljen e kinemasë me zë, na kapërcyell te viteve 1920-30, ajo u bë një mjet komunikimi dhe burim ndikimi i jashtëzakonshëm për të lëshuar mesazhet e pushtetit sovjetik. Nga ana tjetër, ambienti ku zhvillohet shfaqja e një filmi është shumë i pershtatshëm që kjo të ndodhë: një masë e madhe njerëzish janë bashkë në një sallë të errët, të përqendruar të gjithë mbi një burim të vetëm drite dhe imazhesh, siç është ekrani i kinemasë.

Njerëzit e ndjejnë veten më shumë se kurrë se po përjetojnë të njëjtat emocione. Kjo ndikon edhe me shumë në shoqërizimin e tyre emocional dhe ideologjik. (Attwood 1993: 26-27)

Pak histori dhe disa statistika

Industria kinematografike shqiptare ka lindur pas Luftës së Dytë Botërore, falë interesit dhe mbështetjes parësore të regjimit komunist të Enver Hoxhës. Shumë shpejt udhëheqësit e rinj të Shqipërisë komuniste e kuptuan rëndësinë dhe potencialin që kishte arti i kinemasë, si një mjet që mund të ndikonte masat e gjera me kredot e tyre revolucionare. Kinemaja komuniste, si edhe në vendet e tjera të ish Bllokut komunist të Evropës Lindore, sigurisht duke pasur parasysh nuancat e kontekstit lokal, synonte edukimin e masave me vlerat nga të cilat merrnin frymëzimin vetë regjimet, d.m.th., revolucionin, komunizmin, kombi, progresin.

Në dhjetor të vitit 1945 krijohet Agjencia Shqiptare e Filmave, e cila në janar 1946 shndërrohet në Ndërmarrje Shtetërore Kinematografike Shqiptare. Korriku i vitit 1952 solli edhe inaugurimin e Kinostudios “Shqipëria e Re”, e cila që nga ajo kohë e deri në fund të regjimit komunist në 1990 do të ishte institucioni kryesor për prodhimin e filmave artistikë e vizatimorë, dokumentarëve, si edhe do të merrej me shpërndarjen dhe administrimin e rrjetit kinematografik në tërë vendin. Krijimi i parë artistik i saj do të ishte filmi “Skënderbeu”, i cili erdhi si bashkëprodhim me MOSFILM të Moskës në vitin 1953 (Lako 2000: 1176; Hoxha 2002: 37).

Nga pikëpamja sasiore, gjatë periudhës 1953-1984, Kinostudio “Shqipëria e Re”, së bashku me Radiotelevizionin Shqiptar më vonë, do të prodhonin 174 filma artistikë të gjinive dhe metrazheve të ndryshme. Viti 1984 shënoi edhe kulmin e prodhimtarisë mesatare vjetore me 14 filma artistikë në vit, ndërkohë që nga viti 1985 e deri në vitin 1990 u prodhuan 77 filma (Hoxha 2004: 12)

Përsa u përket karakteristikave të prodhimit kinematografik të Shqipërisë socialiste, një ndarje konvencionale dhe e përgjithshme do të ishte kjo që vijon: 1- periudha 1952 deri në fund të viteve 1960, d.m.th. nga viti i krijimit të Kinostudios “Shqipëria e Re”, do të ishte periudha e lindjes dhe e rritjes së kinematografisë shqiptare, 2- periudha nga fundi i viteve 1960 deri në fund të viteve 1970 do të ishte periudha e konsolidimit të saj, ndërsa 3- periudha nga fundi i viteve 1970 e deri në rënien e komunizmit 1990 do të ishte periudha e një kinemaje që përpiqet të fusë disa elementë të rinj në realizimin e filmave artistikë, gjithë duke mbetur e mbërthyer pas skemës së realizmit socialist (Puto, Gjika 2008: 6-29).

Periudha e parë që nga krijimi i Kinostudios deri në fillimvitet 1960-të ishte periudha e krijimit të kinematografisë shqiptare. Janë kryesisht filma të realizuar nga regjizorë shqiptarë që kanë mbaruar studimet e tyre në vendet ish socialiste. Kështu Hysen Hakani që kishte mbaruar studimet në Çekosllovakë do të realizonte në 1957 filmin e parë me metrazh të shkurtër *Fëmijët e saj*. Në 1958, filmi *Tana* i realizuar nga Kristaq Dhama, që kishte studiuar në Budapest dhe *Debatiku* në vitin 1961 i Hysen Hakanit. Në 1966, Dhimitër Anagnosti dhe Viktor Gjika do të realizonin *Komisari i Dritës*, ndërsa në 1967, Piro Milkani dhe Gëzim Erebera, të cilët kishin studiuar në Çekosllovakë, do të realizonin *Ngadhënjim mbi vdekjen*. Në këtë periudhë do të dominonte tema e Luftës dhe pastaj ajo e ndërtimit të shoqërisë së re socialiste në qytet dhe në fshat (Puto, Gjika 2008: 6-29).

Periudha e dytë e kinematografisë komuniste ishte ajo e fundviteve 1960-të dhe fundviteve 1970-të. Kjo periudhë përkon me afrimin me Kinën e Maos, dhe në sinkroni të plotë me zhvillimet socio-politike dhe ekonomike në Shqipëri, kinemaja përforcon karakterin e saj revolucionar dhe ideologjik. Gjatë atyre viteve kinemaja konsolidon mitet për të cilat kishte nevojë regjimi: mbizotëron tema e luftës dhe spiunazhit të huaj kundër Shqipërisë socialiste pas daljes së saj nga blloku socialist i Evropës lindore. Mitizohen ato personazhe historike që ideologjia komuniste i ka përshkruar si heronj. Kineastët sjellin në ekran filma “heroikë”, ku

spikasin karakteret e fortë, partizanët fitimtarë dhe theksohen tonet patetike të kinemasë. Kinemaja shqiptare e asaj kohe, e viteve 1960-të dhe 1970-të, do të përcillte tonet patetike dhe frymën revolucionare. Vëmendja e shtuar e kinemasë shqiptare për heroizmin dhe epopenë partizane, për heroin e punës socialiste, për fshatin socialist dhe për kontrollin punëtor mbi inteligjencien duhen parë si një jehonë e kësaj fryme.¹ Filma si *Prita* (1968), *Horizonte të hapura* (1969), *Rrugë të bardha* (1974), *Në fillim të verës* (1975), *Fije që priten* (1976), *Zonja nga qyteti* (1976), etj, janë një shëmbëlltyrë e asaj kohe. Në vitin 1976 zhvillohet për herë të parë festivali kombëtar i filmit, i cili fitohet nga filmi për fëmijë *Beni ecën vetë*, me regji të Xhanfize Kekos, regjizorja më e njohur në Shqipëri për filmat për fëmijë. Edhe ky detaj i fundit ka rëndësi, sepse tregon një lloj ndikimi nga modeli sovjetik i kinemasë. Roli i gruas si regjizore e filmave për fëmijë ishte një tregues se gruaja megjithëse bënte një punë si “grua e emancipuar në jetën publike”, d.m.th regjizore, ajo vlerësohej edhe si “nënë”, d.m.th si një njeri që ishte më i afërt me botën e fëmijëve, si e lidhur më ngushtë me jetën e familjes (Turovskaja 1993: 141)

Në fund të viteve 1970-të, pas prishjes së radhës me Kinën “revizioniste” të Teng Hsiao Pinit, Shqipëria shkon drejt izolimit të plotë politik dhe ekonomik. Në kontekstin e izolimit duhet parë edhe shtimi i prodhimit të filmave shqiptarë nga ana e Kinostudios “Shqipëria e Re”. Nga 3-4 filma që realizoheshin deri nga fundi i viteve 1970-të, në vitin 1984 prodhimi i filmave artistikë arrin kulmin e tij me 14 filma artistikë në vit. Nga 1985 e këtej, prodhimi vjetor i filmave do të ecte me këtë ritëm dhe gjatë periudhës 1985-1990. Përveç filmave artistikë, Kinostudio prodhonte 60 filma dokumentarë në vit dhe 12-14 filma vizatimorë. Për një vend me 3 milion banorë, kjo prodhimtari ishte e jashtëzakonshme. Ky ritëm prodhimi u mbajt pak a shumë deri në rënien e regjimit komunist në vitin 1990 (Turovskaja 1993: 141).

Në periudhën e fundit 1979-1990, në kinematografinë shqiptare filluan të bëhen më të dukshëm

¹ Mbi rolin kryesor që Mao i njihte fshatit në revolucionin socialist, mbi difidencën e tij ndaj inteligjencies shih Meisner 1985: 280-292.

filmat me temë sociale, që merrnin shkas nga jeta e përditshme, ndërkohë që numri i filmave nga heroizmi i popullit tonë në shekuj fillon e zvogëlohet (Lako 2000: 1185-1186). Duke filluar nga gjysma e dytë e viteve 1980-të, sidomos pas vdekjes së Enver Hoxhës në 1985, mund të vërehen disa prirje të vagullta për t'i sjellë publikut interpretime artistike të roleve që nuk ndiqnin teknika shumë të ngurta/skematike si më parë. Kemi të bëjmë me një përpjekje nga ana e disa regjizorëve për të pasqyruar konfliktet e jetës së përditshme. Nga filma të këtij lloji mund të përmendim *Të paftuarit* (1985), *Vrasje në gjueti* (1987) me regji të Kujtim Çashkut, *Pranvera nuk erdhi vetëm* (1989), i regjizorit Piro Milkani.

Ndryshimi midis kësaj periudhe dhe asaj të mëparshmes është se merr më tepër përparësi tema sociale dhe tema e luftës fillon të kalojë në radhë të dytë. Arsyeja kryesore është se kishte kaluar një kohë e gjatë dhe brezat e rinj kishin filluar ta përqeshnin atë kohë, duke u tallur me personazhet e asaj kohe, d.m.th. me partizanët, batutat e tyre të një retorike jashtë kohës. Brezi i ri nuk e kuptonte më atë kohë [kohën e luftës], siç nuk e kupton edhe sot brezi i ri kohën e diktaturës. Tema e luftës ishte konsideruar e ezauruar, në këtë sens publiku ishte ngopur me të. Në vitet 1980-1990, raporti ishte 70% aktualitet dhe 30% mbi luftën. Tema e aktualitetit filloi të bëhej më e privileguara, sepse mendohej se ndikonte më mirë në procesin e formimit të njeriut të ri (Puto, Gjika 2008: 26).

Aspekti i ndarjes së tematikës së kinemasë në epokën e komunizmit na bën të kuptojmë se periudha e diktaturës në Shqipëri nuk duhet konceptuar si monolite dhe e pandryshuar. Periodizimi është i rëndësishëm sepse na ndihmon të kuptojmë më mirë funksionin e një kinemaje komuniste, prioritetet ideologjike, tematikën e saj, si dhe mënyrën e shtjellimit të personazheve në varësi të ndryshimit të kushteve të brendshme të vendit.

Përsa i përket strukturës organizative, kinematografia komuniste shqiptare funksiononte mbi bazën e një sistemi të centralizuar dhe të mbikqyrur rreptë. Kinostudio ishte vendi ku ishte

përqendruar i gjithë prodhimi i filmave, i cili drejtohej në mënyrë të planifikuar. Në këtë institucion ishte redaksia e skenareve, siç ishte edhe redaksia e regjizorëve. Të gjithë skenaristët që punonin aty ishin të detyruar të shkruanin nga një skenar në vit dhe pastaj të redaktonin dy skenare të tjerë. Ata drejtoheshin nga një “udhëheqës artistik”, i cili drejtonte skenaristët, regjizorët dhe ishte i ngarkuar me administrimin “artistik” të filmave. Ky drejtues artistik ishte në kontakt me drejtorin e përgjithshëm të Kinostudios, natyrisht edhe me vetë komitetin e partise se rajonit. Nga ky komitet merreshin direktivat që orientonin prodhimin e filmave.

Në lidhje me karakterin e saj, me heroin pozitiv në qendër të filmit, me qenien e personazhit më shumë si pjesë e kolektivitetit socialist se sa një individ, me fundin optimist, mund të thuhet se kinematografia shqiptare mbeti përgjatë gjithë kohës e mbërthyer pas realizmit socialist klasik stalinist. Gjithsesi, falë talentit të disa regjizorëve, në disa filma mund të dallohen edhe disa ndikime timide nga kinemaja neorealiste italiane.

Modeli sovjetik i kinemasë komuniste

Për vetë traditat më të vjetra kinemaja sovjetike ndahet në periudha më të shumta kohore: 1) 1917-1921, lindja e kinemasë sovjetike, 2) vitet 1920-të, koha e artë e NEP-it, 3) 1928-1935, tranzicioni midis NEP-it dhe modelit të ri estetik socialist, 4) 1935-1941, periudha e madhe e realizmit socialist, 5) 1941-1945, Lufta e madhe, 6) 1945-1953, vitet e Zhdanovit ose vdekja e kinemasë sovjetike, 7) 1953-1964, shkrirja hrushoviane, 8) 1964-1985, stanjacioni brezhnevian, 9) 1985-1991, Perestrojka (Laurent 2005: 37).

Periudha që paraprin periudhën staliniste të realizmit socialist të viteve 1930-të ishte tepër e larmishme në mendime në lidhje me kulturën², në përgjithësi, dhe rolin që duhej të luante

² Suprematizmi, shpikja e artistit rus Kazimir Malevich (1879-1935), ishte një ndër zhvillimet më të hershme dhe më radikale të artit abstrakt. Emri i kësaj rryme vinte nga bindja e Malevich-it se arti suprematist do të

kinemaja në sistemin sovjetik, në veçanti. Por, një element i pandryshueshëm në kohë do të ishte edukimi i masave dhe formimi i një ndërgjegje klasore proletare.

Një tjetër përballje artistike ishte ajo midis metodave të realizimit filmik të kineastëve të mëdhenj sovjetikë Sergei Eisenstein (1898-1948) dhe Vsevolod Pudovkin (1893-1953). Në veçanti 2 filma të tyre, si *Fundi i Peterburgut* (1928) i Pudovkin-it dhe *Tetori: 10 ditë që tronditën botën* (1927) i Eisenstein janë shembuj të qartë të rrugëve të ndryshme që ndiqnin autorët për të përçuar mesazhet e tyre te spektatori sovjetik. Eisenstein-i synonte më tepër skenat masive, ndërkohë që Pudovkin ishte më shumë i dhënë pas shtjellimit të ngjarjes përmes syve të personazheve kryesore. Eisenstein konsiderohej si një regjizor më intelektual, kurse filmat e Pudovkin-it si më të qartë për masën e gjerë (Attwood 1993: 39). Në filmat e Eisenstein-it ishin objektet që flisnin, luftanijet, makinat, topat, dhe jo heroi kryesor. Eisenstein-i ishte edhe babai dhe teoricieni i montazhit sovjetik. Duke qenë se në vitet 1920-të ende dominonte kinemaja pa zë, procesi i montazhit, mënyra se si ndërthureshin pamjet e sekuencave filmike me njëra tjetrën, kishte rëndësi maksimale në krijimin e imazhit përfundimtar në sytë e spektatorit. Eisenstein mendonte se sekuenca e filmit në vetvete nuk kishte kuptim, të cilin ajo e merrte vetëm në kushtet kur lidhej me sekuencat e tjera që formonin filmin në tërësi. Që këtë vjen përparësia që Eisenstein-i i kushtonte kontrastit në montazh, si një ndër efektet më të

ishte superior nga të gjitha artet e së kaluarës dhe se ai do të çonte drejt “supremacisë” së perceptimeve dhe ndjenjave të pastra në artet figurative. Megjithatë më vonë autoritetet komuniste do ta luftonin këtë lëvizje, ndikimi i saj do të ishte i madh në Rusinë bolshevike në fillimvitet 1920-të dhe në formësimin e konstruktivizmit.

Konstruktivizmi ishte ndër rrymat e fundit moderniste që lulëzuan në Rusinë e shek. XX. Ai mori shtat kur bolshevikët erdhën në fuqi në 1917. Kjo rrymë bëri për vete shumë artistë që përqafuan qëllimet e revolucionit. Ai huazoi ide nga kubizmi, suprematizmi dhe futurizmi. Në thelb të tij ishte një qasje e re në bërjen e objekteve. Kjo qasje e re kërkonte tejkalimin e traditave artistike që merreshin me kompozimin dhe e zëvendësonin atë me “konstrukcionin”. Konstruktivizmi nënvizonte nevojën për një analizë teknike të kujdesshme të materialeve moderne. Mendohej se kjo analizë do të jepte ide të cilat mund të viheshin në zbatim në prodhimin masiv, në ndërtimin e një shoqërie të re moderne komuniste.

Formalizmi rus ishte një rrymë e rëndësishme në vitet 1910-të dhe 1930-të. Ndër themeluesit e tij janë Viktor Shklovsky, Yuri Tymanov, Boris Eichenbaum, Roman Jakobson dhe Grigory Vinokur. Formalistët revolucionarizuan kritikën letrare midis 1914-1930 duke vendosur në themel të studimit të letërsisë autonominë e gjuhës poetike. Formalizmi ndryshoi rrënjësisht mënyrën si duhej kuptuar letërsia. Para formalizmit, letërsia interpretohej kryesisht mbi bazën e komponentëve të saj ideologjikë, interesit historik që vinte si refleks i mendësisë së autorit. Formalizmi e përqendroi studimin te akti i krijimit artistik në vetëvete. Gjatë kohës së Stalinit termi “formalizëm” mori kuptimin negativ të artit elitist.

mëdha vizuale që prek dhe tërheq audiencën. Studiuesit mendojnë se influencat kulturore të Eisenstein-it shkojnë nga veprimtarët e ProletKultit³ deri te teatri revolucionar japonez Kabuki i shek. XVII, me theksin që vinte te sjelljet ekstravagante të aktorëve dhe situatat kontrastuese të ngjarjes (Kenez 1985: 211).

Megjithë atmosferën relativisht të lirë, regjimi sovjetik nuk lejoi as në atë kohë filma që të ishin vetëm për zbavitje, ose të shkaktonin thjesht kënaqësi estetike. Studiuesit kanë përdorur termin “spektakël revolucionar” për të kategorizuar disa prej filmave më të njohur të viteve 1920-të. Filma të Eisenstein-it si *Greva*, *Kryqëzori Potemkin*, dhe *Tetori*; filmat e Pudovkin-it *Fundi i Shën Petersburgut* dhe Alexander Dovzhenko-s *Arsenali*, shpalosnin kryesisht tipa, simbole dhe xhestikulacione (Kenez 1985: 211).

Këtu duhet shtuar se që në fillim të ekzistencës së tij pushteti bolshevik synoi ta monopolizonte, duke e shtetëzuar prodhimin kinematografik, dhe ta vinte atë në funksion të politikave të tij. Ne vitin 1919 u krijua Goskino, Komiteti Shtetëror për Kinematografinë, pastaj Sovkino nga 1924-1930, për t’u pasuar nga Sojuzkino në vitet e kthesës staliniste në art.

Kthesa staliniste e viteve 1930-të

Vitet 1930-të sollën ndryshime cilësore të rëndësishme për kinemanë sovjetike, por ato duhet të shihen të lidhura ngushtë me ndryshimet në natyrën e pushtetit sovjetik dhe të politikave të tij ekonomike.

³ Proletkulti ishte ndër institucionet e para kulturore bolshevike që u krijua që të nesërmen e Revolucionit të Tetorit në 1917. Qëllimi i tij ishte krijimi i një arti proletar. Ky art do të krijohej nga proletarët dhe për proletarët dhe do të ishte i çliruar nga çdo mbeturinë e kulturës borgjeze. Proletkulti udhëhiqej nga Aleksandër Bogdanov. I mbështetur nga shteti, por i pavarur nga kontrolli i Partisë Komuniste, Proletkulti themeloi qendra kulturore në të gjithë vendin, ku punëtorët do të mësonin të lexonin dhe do të inkurajoheshin të shkruanin drama, romane dhe poema. Ndonëse këto qendra kulturore prodhuan disa poetë, stili dhe teknikat e tyre nuk ndryshonin nga shkrimtarët e së kaluarës. Proletkulti u mbyll në 1923, kur Lenini nuk e mbështeti më dhe kuptoi padobinë e krijimit të një kulture krejt të re.

Së pari, pushteti sovjetik po konsolidohej dhe po shtrihej në mbarë BS. Së dyti, regjimi filloi të ngushtojë hapësirën për diskutim të tematikave të ndryshme në art. Së treti, temat dhe tonet e propagandës sovjetike ndryshuan.

Qëllimi i industrializimit të vendit, që filloi masivisht në vitet 1930-të ishte tej mase ambicioz. Koha e Planit I 5-vjeçar, njëloj si edhe ajo e Luftës Civile, ishin kohë gati utopike. Udhëheqësit sovjetikë u përpoqën të rimodelonin shoqërinë, të zgjeronin ekonominë socialiste, të ngrinin standardet e jetesës dhe të përmirësonin aftësitë mbrojtëse të vendit. Ata synonin të arrinin gjithë këto qëllime brenda një kohe të shkurtër në një vend të varfër, të cilit i mungonin kuadrot e kualifikuara, që vuante edhe nga uria.

Tërë këto projekte, si edhe padurimi për t'i realizuar ato shpejt, kërkonte përpjekje mbinjerëzore dhe një mobilizim tërësor. Ky lloj mobilizimi do të thoshte përmirësim i organizimit politik, të shtoheshin masat shtrënguese dhe nocioni i armikut të zgjerohej shumë herë më tepër se ç'kishte qenë më parë. Kjo atmosferë e krijuar do të kërkonte edhe një art më militant.

Çdo gjë filloi me Konferencën e Partisë mbi Çështjet e Kinemasë, në mars 1928. Ajo konferencë diktoi qëllimet për kinemanë sovjetike dhe bëri thirrje që kinemaja të merrte pjesë aktivisht në rindërtimin socialist të vendit, të merrte pjesë në luftën e klasave dhe në revolucionin kulturor. Pluralizmi kulturor i viteve më parë nuk duhej të ekzistonte më dhe kinemaja do të shtrëngohej të futej në shërbim të industrializimit, kolektivizimit duke e shndërruar atë një medium sa më të thjeshtë për t'u kuptuar nga miliona njerëz. Kishte filluar Revolucioni Kulturor dhe kishte triumfuar realizmi socialist si normë artistike si për letërsinë dhe artet, ashtu edhe për kinemanë (Youngblood 1993: 30).

Realizmi socialist u konsakrua si metodë gjatë Kongresit të shkrimtarëve sovjetikë në 1934. Sipas asaj që thuhej në Kongres këto parime duhej të dilnin, nga njëra anë, nga përvetësimi kritik i trashëgimisë letrare të së kaluarës dhe, nga ana tjetër, nga studimi i përvojës së ndërtimit

triumfues të socializmit dhe të progresit të kulturës socialiste. Realizmi socialist duke qenë metoda themelore e letërsisë dhe kritikës letrare sovjetike kërkonte nga artisti një paraqitje “të vërtetë”, historikisht konkrete të realitetit në zhvillimin e tij revolucionar. Por, këtu arrijmë edhe te paradoksi i tij: kemi detyrën për të paraqitur konkretisht realitetin, por në të njëjtën kohë kemi edhe detyrën të edukojmë ideologjikisht masat me frymën e socializmit. Kjo frymë kërkonte në fakt që realiteti të paraqitej “ashtu siç duhej dhe jo ashtu siç ishte, ose siç e shikonin vetë artistët”.

Që nga kjo kohë dhe deri me vdekjen e Stalinit, kinemaja do të kishte si detyrë kryesore të krijonte një “realitet paralel revolucionar”. Pikërisht kjo aftësi e kinemasë për të krijuar një realitet dëshirash si realitet konkret i jepte asaj një fuqi të jashtëzakonshme. Filmat gjeneronin “efektin e konfuzionit, duke ngritur dyshime në shpirtin e njerëzve dhe duke vënë thellësisht në dyshim aftësitë e tyre individuale për të kuptuar atë që i rrethonte” (Kenez 2005: 31). Realiteti ishte ashtu si e shikonin ata, apo ashtu si u thuhej se duhej të ishte?

Përdorimi i termit të “realizmit socialist” nënkupton një afërsi më të madhe të kinemasë me letërsinë, ndoshta edhe varësinë e saj direkte nga letërsia. Dogma konservatore e “realizmit socialist” impononte që arti duhet vetëm të përçojë mesazhe të kuptueshme për masat. Arti nga ana e tij, duke përfshirë padyshim kinemanë, nuk mund të kishte një jetë të veten, një lloj zhvillimi spontan. Ai duhej të ishte refleks i letërsisë së realizmit socialist. Që këtë kuptohet dhe rëndësia më e madhe që kishin skenarët dhe skenaristët në sistemin kinematografik se sa regjizorët dhe operatorët (Pozner 2005: 11-12)

Parimet staliniste të kinemasë ishin në thelb të kundërta me kërkesat themelore kinematografike. Zyrtarët stalinistë këmbëngulnin te rëndësia që i duhej treguar shkrimit, skenarit, duke lënë në rend të dytë aspektin vizual të filmit. Në fund të fundit, ishte më e lehtë të kontrollohej një skenar se sa realizimi i një filmi.

Në ndryshim nga kinemaja eksperimentale sovjetike e viteve 1920-të, kinemaja staliniste e realizimit socialist solli në qendër të vëmendjes njeriun, duke lënë mënjanë makinat dhe objektet (Youngblood 1993: 94). Objektivi i këtij revolucioni kulturor në kinemanë sovjetike staliniste të viteve 1930-të duhej të ndreqte një difekt serioz: veprat më interesante dhe eksperimentale nuk mund të kapeshin dot nga njeriu i thjeshtë. Spektatorët duheshin tërhequr në masë drejt sallave të kinemave, me qëllim që ideologjizimi të ishte sa më i gjerë.

Politikat kulturore të bolshevikëve bënë të mundur që në vitet 1930-të kinemaja të kthehej në një nga veprimtaritë e zakonshme të qytetarëve. Më parë, kinemaja ishte kryesisht një zbavitje urbane, në një vend ku pjesa dërrmuese e popullsisë ishte fshatare. Tashmë, fshatarët u ftuan të futeshin në kooperativat bujqësore, të cilat u shtynë të blenin projektorë filmash. Nga vitet 1928-1940, numri i pajisjeve kinematografike u katërfishua, ndërsa biletat u shtuan trefish (Kenez 2005: 20). Industria sovjetike ia arriti të prodhonte filmat e saj, projektuesit e saj dhe pajisje të tjera kinematografike. Megjithëse cilësia e tyre mund të ishte më e dobët në krahasim me ato të Perëndimit, ajo mund të konsiderohej si një arritje e madhe për kohën.

Shpikja e teknologjisë së re zanore për filmat ishte një tjetër kusht i favorshëm për të rritur propagandën përmes filmave. Kinemaja me zë staliniste u bë një mjet i fuqishëm i përhapjes së ideve të thjeshta. Kinemaja socialiste me zë u bë më narrative, më komplementare me propagandën. Në ndryshim nga filmi pa zë, i cili mbështetej te fantazia e montazhit, te eksperimenti me montazhin, kinemaja me zë mund të prekte më tepër emocionet. Kinemaja pa zë ishte më tepër një fenomen intelektual, që prekte aftësinë e mendjes për të ndjekur fantazinë e montazhit (Attwood 1993: 54; Kenez 2005: 54).

Tematika tani do të përqendrohej në krijimin e stereoptipeve, në radhë të parë të heroit pozitiv dhe atij negativ, ku sigurisht triumfues do të dilte gjithnjë i pari. Mendohej se vetëm një kinema e mbështetur mbi këtë parim, të krijimit të personazheve të thjeshtë, “të kuptueshëm” dhe

“realistë”, do të mund të bënte për vete masat shumëmilionëshe. Ndër regjizorët e njohur të asaj kohe ishin Georgi Vasiliev, Sergei Vasiliev me *Çapajevi*, Sergei Yutkevich, *Malet e arta*, Sergei Gerasimov, *Qyteti i rinisë*, Mikhail Romm, *Lenin në tetor*.

Kthesa staliniste në art e viteve 1930-të do të bëhej modeli i vetëm ideologjik të cilit do t'i referohej arti komunist në Shqipëri. Ai lloj arti do t'i përjashtonte kategorikisht eksperimentet artistike.

Shkrirja hrushoviane dhe kinemaja sovjetike e Perestrojkës

Radikalizmi ideologjik stalinist filloi të venitej gradualisht pas vdekjes së Stalinit në 1953 dhe ardhjes në fuqi të Hrushovit. Ky ndryshim do të prekte patjetër artet dhe posaçërisht kinemanë. Gjatë destalinizimit, kinemaja sovjetike do të kthehej gjithnjë e më shumë drejt individit të thjeshtë, të zakonshëm dhe me ngadalë do të linte mënjane heroin pozitiv. Kinemaja sovjetike do të fillonte ta drejtonte objektivin e saj më tepër nga individi dhe jo nga masa e kolektivi. Nga ana tjetër, ky njeri nuk do të ishte revolucionari tipik, i sigurtë dhe optimist, por do të ishte një njeri më njerëzor, me pasiguritë dhe ambiguitetet e tij. Edhe moti stalinist, me horizontet e tija të ndezura nga koha me diell, do të zëvendësohej nga një mot më natyral. Ndër kineastët që dalin në këtë periudhë mund të përmenden Mikhail Romm (1901-1971), Mikhail Kalatozov (1903-1973), Fridrih Ermler (1898-1967), Marlen Khutsiyev (1925-), Grigory Chukrai (1921-2001), Vladimir Naumov (1927-) dhe mbi të gjithë Andrej Tarkovski (1932-1986).

Në periudhën e Leonid Brezhnievit (1964-1982) thellohet më tej procesi i trajtimit psikologjik të personazheve. Tematika zhvendoset më shumë drejt konfuzionit moral të rinisë, familjes dhe gruas. Ka një prirje të shtuar për të analizuar personazhet, individin nga pikëpamja e botës së tij të brendshme, dhe jo si pjesë e masës. Një nga temat e preferuara bëhet ajo e gruas që është

e zënë me punët e shtetit dhe nuk i del koha për t'u marrë me familjen. Kjo rezulton në atë që ajo shpesh herë nuk është e lumtur, pra ka një mesazh, mes rreshtash, që qëllimi i karrierës nuk është ai më i larti në jetë. Jeta e familjes është po aq e vlefshme sa ç'është edhe roli i nënës. Ka një rikthim të roli i nënës, rolit të shtëpiakes, ose më mirë të thuhet i gruas që vlerëson jetën në familje, sepse një grua që shikonte vetëm karrierën shihej si egoiste, jo shumë humane, e ftohtë, jo shumë e natyrshme për ambientin socialist që e konsideronte familjen si bërthamën e saj më solide.

Kjo përkon me atë që në vitet 1970-të, në BS vihet re një rënie e lindjeve dhe shteti fillon e propagandon familjen me më shumë se 1 fëmijë, sidomos në republikat evropiane të BS, ku kishte rënie të lindshmërisë. Në përgjithësi, roli i gruas në filmat sovjetikë është përsëri simbolik, d.m.th. përfaqëson BS në një fazë të caktuar të historisë së tij, por edhe shërben si standard moraliteti. Të roli i saj maten vlerat pozitive dhe negative, problemet me të cilat përballej shoqëria sovjetike e kohës. Ky tipar të kujton disa filma shqiptarë, në mesin e viteve 1980-të, kur i bëhej jehonë familjes me më shumë se 1 fëmijë dhe kritikoheshin roli i një gruaje që shikonte vetëm karrierën, ambicien profesionale duke harruar rolin e saj si nënë (*Taulanti kërkon një motër*, 1983, Xhanfize Keko). Këtu mund të përmenden regjizorët si Yuli Raizman me *Jeta private* (1983) dhe *Koha e dëshirave* (1984), Diana Asanova, *I dashur, shumë i dashur*, (1984), Rolan Bykov, *Dordoleci* (1984) (Attwood 1993: 96-97).

Koha e ardhjes në pushtet të Mihail Gorbacovit (1985) do të ishte edhe koha e Perestrojkës dhe e Glasnostit. Më shumë se kurdoherë tjetër, në këtë kohë do të shtohet më tej liria intelektuale dhe do të hiqen disa barrierat të tjera që mbysnin krijimtarinë artistike. Por, ka edhe një ndryshim tjetër më të madh për sa i përket përfytyrimit të lidhjeve midis Partisë dhe shoqërisë. Më parë Partia i konsideronte masat si fëmijë, që duheshin edukuar, ndëshkuar, sepse paramendohej se populli nuk mund t'i kuptonte dot vetë problemet. Vizioni i tij për botën duhej të ishte i përgatitur nga Partia dhe i jepej në një formë të thjeshtë, tepër ideologjike me synimin të

pengonte ndikimet e huaja degjeneruese. Në ndryshim nga kjo, Perestrojka e heq monopolin e së vërtetës nga duart e Partisë dhe ia lë të lirë inteligjencës (Attwood 1993: 100). Në kinema vërehen interpretime më të larmishme për shoqërinë, ka më shumë shikime analizuese ndaj një shoqërie që vetëm në dukje ishte e shëndoshë, por që në thelb ishte e gangrenizuar. Në kohën e Gorbacovit ndodhin edhe ndryshime të rëndësishme strukturore në botën e kinemasë. Në vitin 1986 ndryshojnë të gjithë drejtorët e vjetër të Unionit të Kinematografëve. Një vit më vonë, në 1987 krijohet KIWI (Kino Women International), një organizatë e pavarur ndërkombëtare që synonte të promovonte filmat e bërë nga regjizoret gra. Ndërkohë, në vitin 1989 hiqet zyrtarisht “realizmi socialist” si norma e vetme artistike. Kjo gjë në Shqipëri nuk mund të ndodhte, sepse nuk kishte Glasnost në kuptimin e vërtetë të fjalës.

Tematika e kohës së Gorbacovit lëviz më tepër rreth problemeve të moralitetit të familjes dhe sidomos rinisë. Familja nuk shikohet më si bërthama e shëndoshë e shoqërisë socialiste, por si një celulë problematike, e rrënuar nga varfëria ekonomike dhe morale. Rinia sovjetike e kohës së Glasnostit është larg së qeni një “rini socialiste” si ajo e kohës së Hrushovit, e cila, megjithëse kishte disa luhatje ideologjike, përsëri besonte në socializëm. Tanimë kemi një rini të tronditur fort nga morali i dyfishtë dhe përballja me një botë që është në shkatërrim e sipër, si ajo sovjetike e fundit të viteve 1980-të. Ndër regjizorët që shfaqin talentin e tyre në këtë kohë mund të përmendim Yuris Podnieks, *A është e lehtë të jesh i ri?* (1987), Vasili Pichul, *Vera e vogël* (1988), Sava Kulish, *Tragjedi në stilin e rokut* (1988) (Attwood 1993: 116).

Kinemaja sovjetike dhe ajo shqiptare në përqasje

Një nga tiparet kryesore të kinemasë është tërheqja që ajo ushtron te një numër i madh spektatorësh. Ky art masiv do të ishte në mënyrë të natyrshme një mjet ndihmës shumë i rëndësishëm në duart e regjimeve komuniste, të cilat e shpallnin veten “diktatura të masave”. Ekran i kinemasë do të ishte i domosdoshëm për indoktrinimin e popullsisë dhe për ta mobilizuar atë sa më gjerësisht në “revolucionin e pandërprerë socialist”.

Duke qenë një nga artet më të lidhura me pushtetin komunist, kinemaja do të ishte një pasqyrë ku do të reflekttoheshin prioritetet politike të regjimit, tiparet dhe ndryshimet që ky regjim do të pësonte me kalimin e kohës. Në këtë kuptim ajo është edhe një mjet njohës i vetë natyrës së regjimeve komuniste.

Regjimet komuniste, megjithëse në teori propagandonin të njëjtën dogmë politike, dhe në dukje kishin krijuar të njëjtin model ideologjik dhe kulturor, përsëri dallonin nga njëri tjetrit. Këto dallime kishin të bënin në radhë të parë me vetë kushtet e brendshme të vendeve të caktuara socialiste, por edhe me marrëdhëniet që ato ndërtuan me vendin më të madh socialist në botë, me BS. Kësisoj edhe midis kinemasë komuniste sovjetike dhe asaj shqiptare ka ngjashmëri dhe dallime të rëndësishme.

Ngjashmëritë dhe dallimet e kinemasë komuniste shqiptare me modelin sovjetik kanë të bëjnë me periudhën staliniste. Periudha staliniste, dhe kinemaja sovjetike që mori shtat në atë kohë, është edhe pikëtakimi i vetëm direkt mes modelit shqiptar komunist dhe atij sovjetik. Ajo që ishte pararendëse dhe pasrendëse me periudhën staliniste ka të bëjë më shumë me dallimet mes këtyre dy modeleve të kinemasë komuniste.

Një diferencë e rëndësishme që del nga këto paragrafe, d.m.th. midis Shqipërisë dhe BS, është se kultura bolshevike në Rusinë sovjetike kishte njohur një fazë eksperimentale kulturore gjatë viteve 1920-të, derisa erdhi pastaj në vitet 1930-të të dogmat staliniste dhe të skema e ngurtë e realizmit socialist. Rusia sovjetike e drejtuar nga Lenini dhe e sapodalë nga Lufta Civile do të

adaptonte në fillim të viteve 1920-të polikat e NEP-it, të lejimit të bashkezistencës së sektorit ekonomik privat dhe atij shtetëror. Kjo politikë kompromisi do të shfaqej edhe në fushën e artit. Arti komunist bolshevik, në atë kohë, nuk ishte monolitik dhe njëngjyrësh. Brenda tij gëlonin një sërë rrymash moderniste që vinin si rrjedhojë e një inteligjencie bolshevike, e cila nuk kishte të njëjtin vizion për mënyrën se si duhej ndërtuar një art i klasës punëtore. Po ashtu, traditat shumë të pasura artistike të Rusisë parasovjetike nuk mund të shkatërroheshin menjëherë. Nga ana tjetër, kjo situatë ndikohej edhe nga mendimi që kishte vetë Lenini për natyrën e artit proletar dhe rolin e inteligjencies. Sipas tij, arti proletar duhej të mbështetej dhe të merrte më të mirën e artit të krijuar në kapitalizëm dhe inteligjencia duhej të ishte një faktor i dorës së parë në kulturimin e masave me frymën e re bolshevike (Meisner 1985: 280-292). Tërë kjo panoramë e larmishme kulturore e viteve 1920-të do të krijonte një hapësirë për eksperimente të ndryshme artistike në fushën e kinemasë.

Kjo periudhë liberale do të merrte fund në fillimin e viteve 1930-të, kur Stalini e futi vendin në rrugën e industrializimit të shpejtë të vendit dhe kur pushteti sovjetik po vendoste kontrollin e tij të hekurt mbi të gjithë territorin e pamasë të BS. Një kontroll i tillë i plotë u imponua edhe arteve, me sanksionimin e “realizmit sovjetik” si normë zyrtare kulturore, e cila përjashtonte çdo lloj eksperimenti në art, çdo hapësirë lirie për rrymat e ndryshme kulturore. Arti, kinemaja dhe letërsia duheshin kthyer në mjete për të indoktrinuar dhe për të bindur masat në drejtësinë e vijës së partisë.

Periudha hrushoviane do të krijonte të çarën e parë në murin e “realizmit socialist”, të cilin do ta permbyste përfundimisht Perestrojka gorbaçoviane e fundit të viteve 1980-të. Shqipëria që doli si vend komunist pas Luftës së Dytë Botërore mori si model vetëm skemat staliniste kulturore dhe nuk njohu model tjetër.⁴ Duke qenë se një kinema shqiptare e institucionalizuar

⁴ Debati brenda PKSH mori fund që në 1946, kur Plenumi i 5 i KQ vendosi dënimin e Sejfulla Malëshovës për pikëpamjet e tij “oportuniste” dhe sanksionoi vijën e ashpër staliniste. Për më tepër shih materialet e Plenumit 5 KQ të PKSH, 21.02.1946-03.03.1946, AQSH, F.14, D.1.

lindi vetëm në kohën e komunizmit (1944-1990), atëhere kuptohet se modeli stalinist, do të ishte i vetmi që u pranua në vend. Në këtë drejtim, faza eksperimentale e artit sovjetik të viteve 1920 nuk u njoh fare në Shqipërinë socialiste.

Nga ana tjetër, shkëputja e Shqipërisë komuniste nga blloku ish socialist i drejtuar nga BS në vitin 1960-të, dhe refuzimi kategorik, më gjerësisht, i procesit të Helsinkit që përfshiu vendet e Evropës lindore dhe perëndimore në vitet 1970-të, e bëri të pamundur ndikimin e frymës më liberale sovjetike në arte. Përkundrazi, Shqipëria komuniste do të izolohej nga këto procese politike të detantës Lindje-Perëndim në Evropë dhe do të lidhej me Kinën, në një kohë kur Mao kishte ndërmarrë atje Revolucionin Kulturor (1966-1976).

Realizmi i ngurtë socialist në arte dhe në kinema do të përligjej edhe më tepër pas prishjes me Kinën në vitin 1978. Në atë kohë, Shqipëria do ta deklaronte veten si “shteti i vetëm socialist në botë”. Kur Kina e Teng Hsiao Pinit dhe Lindja ish socialiste do të fillonin gradualisht reformat drejt liberalizmit të jetës politike, sidomos me ardhjen e Mihail Gorbaçovit në fuqi në 1985, Shqipëria e Enver Hoxhës, edhe pas vdekjes së tij në po të njëjtin vit, do të mbetej e ngurtësuar në pozicionin e saj izolacionist. Izolimi ishte garancia e mbijetesës së regjimit komunist në Shqipëri dhe si i tillë ai pengoi çdo reformim politik apo ekonomik, ndërkohë që kinemaja do të mbetej jashtë ndikimeve liberale. Kinemaja shqiptare e kohës së komunizmit mbeti e mbërthyer pas realizmit socialist anakronik, si një kujtesë se Shqipëria ishte muzeu i vetëm i gjallë stalinist në Evropë.

Bibliografia

Attwood, L. (1993) *Red women on the silver screen*, Harpercollins.

Lako, N. (2000) “Cinema Albanese”, në *Storia del cinema mondiale*, Gian Piero Brunetta (a cura), Einaudi.

- Hoxha, A. (2002) Enciklopedia e kinematografisë shqiptare, Botimet Toena: Tiranë.
- Hoxha, A. (2004) Kinematografia shqiptare 1985-2005, vëll.2, Botimet Toena: Tiranë.
- Puto, A. Gjikaj, E. (2008) 'Kinematografia shqiptare midis nostalgjisë, groteskut dhe të ardhmes', në *Përpyekja* Nr.25, viti XIII: Tiranë: 6-29.
- Meisner, M. (1985) 'Iconoclasm and Cultural Revolution in China and Russia', në *Bolshevik Culture, Experiment and Order in the Russian Revolution*, Abbott Gleason, Peter Kenez, Richard Stites (eds), Indiana University Press 280-292.
- Turovskaja, M. (1993) 'Women's cinema in the USSR', në *Red Women on the Silver Screen*, Lynn Attwood (ed.), Harpercollins.
- Laurent, N. (2005) 'Cinéma et stalinisme, pour une histoire des institutions', në *Caméra politique. Cinéma et stalinisme* (sous la direction de Kristian Feigelson), Théorème 8, Presses Sorbonne Nouvelle.
- Kenez, P. (1985) *The birth of the propaganda state. Soviet methods of mass mobilization 1917-1929*, Cambridge University Press.
- Kenez, P. (2005) "Le cinema soviétique sous Staline (1928-1953)", në *Caméra politique. Cinéma et stalinisme* (sous la direction de Kristian Feigelson), Théorème 8, Presses Sorbonne Nouvelle.
- Youngblood, D. J. (1993) *Movies for the Masses, popular cinema and soviet society in the 1920s*, Cambridge University Press.

Pozner, V. (2005) 'Le "réalisme socialiste" et ses usages pour l'histoire du cinéma soviétique',
né Caméra politique. Cinéma et stalinisme (sous la direction de Kristian Feigelson), Théorème
8, Presses Sorbonne Nouvelle.

Propaganda dhe humori në karikaturat e revistës “Hosteni” të viteve 1965-1970

Karikatura është një formë e artit pamor që konsiderohet kryesisht si tjetërsimi i imazhit, ekzagjerim apo minimizim i personazheve me qëllime humoristike, artistike apo politike. Megjithatë tjetërsimi i imazhit nuk është qëllim në vetvete, por veçse një mjet për të ironizuar një situatë apo personazh të caktuar. Kjo formë e artit, kur përdoret me synime politike, mbetet një nga format më efikase të komunikimit publik dhe shprehjes së mesazheve politike. Përgjatë historisë karikatura ka pasur ndikim të madh duke ndikuar në perceptimin e shoqërisë mbi çështje të caktuara dhe duke nxitur reagime të shumta. Është mjaft i njohur roli i disa karikaturave si katalizatorë të zhvillimeve të rëndësishme politike dhe sociale ashtu edhe për krijimin e një imazhi të caktuar emblematic në opinionin publik. Rol të rëndësishëm karikatura filloi të luajë sidomos gjatë Revolucionit Francez me zgjerimin e lirisë së shtypit dhe me krijimin e një hapsire lirie të kufizuar të pluralizimit të ideve. Janë mjaft të njohura karikaturat e James Gillray mbi Napoleonin, politikën, sjelljen dhe luftrat e tij. Shumë e famshme është sidomos karikatura ku Napoleoni dhe Uilliam Piti i Anglisë të ulur në një tavolinë, ndajnë mes tyre botën duke përdorur thikë e pirunj sikur të ishin duke drekuar me fatet e kontinentit. Sidoqoftë karikatura erdhi duke zënë gjithmonë e më tepër vend në shtyp gjatë shekullit të XIX, kur edhe u shfaqën revistat e para të profilizuara. Por shekulli kur karikatura arriti kulmin e saj, duke u orientuar drejt humori politik mund të konsiderohet shekulli i XX, kur karikatura u shndërrua në një mjet shumë efikas për të shpërndarë mesazhe në një formë mjaft të thjeshtë dhe elegante. Në ditët tona karikatura mbetet një formë origjinale dhe shumë e përdorshme, megjithë zhvillimin e formave të tjera shumë më moderne të komunikimit publik. Pas ngjarjeve tragjike në redaksinë e revistës satirike Charlie Hebdo por edhe reagimit ndërkombëtar pas

kësaj ngjarje, karikatura është rikthyer në vëmendjen publike si një nga mjetet më të fuqishme të transmetimit të mesazheve nëpërmjet satirës. Ky fenomen ndodh në ditet e sotme kur teknologjia e komunikimit masiv është në nivelin më të lartë që ka njohur njerëzimi dhe pikërisht ky fakt na tregon se çfarë peshe ka pasur përdorimi i imazheve në kohën kur shtypi i shkruar ishte i vetmi mjet për transmetimin e ideve.

Fillimet e karikatures shqiptare janë konsideruar disa krijime të periudhës së Rilindjes Kombëtare si karikaturat e Murat Toptanit si “Fuqitë e Mëdha drejt greminës” apo siç njihet ndryshe “Premtimet e Anglisë” që është një krijim i tij më të mprehta. Dy kalorës, me vështirimin përpara, shkojnë drejt fatalitetit shaluar mbi kuaj, kapistrallët e të cilëve i tërheq një skelet njeriu nga thellësia e greminës. Gjatë viteve të Luftës së Dytë Botërore karikaturat filluan të shfaqen gjithnjë e më tepër, sidomos në fletën satirike “Fshesa” (Fjalori Enciklopedik Shqiptar 1985: 457-458). Pas vendosjes së regjimit totalitar në Shqipëri u shfaq edhe Revista Hosteni e cila u botua për herë të parë në 25 gusht 1945 si gazetë satirike e përjavshme, deri në vitin 1950 kur u kthye në revistë. (Fjalori Enciklopedik Shqiptar 1985: 380) Në vitet 70 revista arriti kulmin e saj me një tirazh prej rreth 25.000 kopje. Karikaturistët shqiptarë vinin kryesisht nga profesione të tjera nga ai i piktorit. Numri i tyre llogaritet në rreth 45 karikaturistë profesionistë, megjithëse duhet të kenë qenë shumë më tepër sepse herë pas here Hosteni publikonte karikatura që dërgoheshin nga njerëz të ndryshëm të apasionuar nga i gjithë vendi. Nuk ka informacione nëse ka pasur karikaturiste femra.

Qasje teorike

Ky studim përpiket të prezantojë dhe të sqarojë tematikat kryesore të trajtuara nga karikatura shqiptare gjatë viteve 1965-1970. Këto vite përkohjnë me ndikimin e revolucionit kulturor kinez në Shqipëri dhe me ndalimin e ushtrimit të besimit fetar. Pasqyrimi i këtyre ngjarjeve mes

karikaturës ishte edhe pikënisja e këtij referati. Në radhë të parë do të analizohen temat kryesore të përzgjedhura për tu trajtuar nga revista. Më pas do të përpiqemi të kuptojmë pse disa tema janë më të trajtuara më tepër se të tjerat me perceptimin se temat që trajtoheshin më shumë mund të konsiderohen si çëshjet më të mëdha të shoqërisë së kohës. Kryesisht ato që përzgjidheshin për kopertinën para ose mbrapa, ose që kishin përmasa më të mëdha mbeteshin më të rëndësishmet. Së dyti do të tentojmë të analizojmë mënyrën e përdorimit të mjeteve kryesore shprehëse të karikaturës. Këto mjete shprehëse tipike për karikaturën janë përdorimi i simboleve, ekzagjerimi i karakteristikave fizike të personazheve dhe analogjia duke krahasuar apo duke vendosur në të njëjtën karikaturë dy situata të ndryshme në funksion të evidentimit të dallimeve nga njëra tek tjetra. Kjo lloj analize është kryer mbi bazën e metodës së njohur si metoda ikonografike e historianit të artit Edwin Panofsky mjaft e përdorur nga historianët dhe politologët¹ sepse ka në bazë të saj trajtimin nga pikëpamja e një historiani të artit dhe mbetet metoda që mund të përdoret më lehtësisht prej historianëve. Kjo metodë e analizon një vepër arti duken ndjekur tre rregulla. Së pari analizohet subjekti i përzgjedhur dhe forma fizike e paraqitjes. Më pas kërkohet simbolika apo apo çfarë nënkupton vepra dhe së fundi bëhet vlerësimi se si një vepër arti prezanton elementet historikë si sjella e një kombi, një periudhe, një klase apo bindjeve filozofike të kohës dhe sigurisht aplikimi i kësaj tërësie në veprën e artit (Panofsky: 1955, 30-31). Aplikimi i kësaj metode në interpretimin e karikaturës politike gjatë totalitarizmit paraqet disa probleme që lidhen me pamundësinë e krijuesve për të shprehur qoftë edhe nëpërmjet karikaturës mendimet e tyre personale mbi temat që trajtohen. Sidoqoftë në tematikat e përzgjedhura dhe në trajtimin e tyre ekziston një hapsirë e kufizuar lirie sidomos mbi disa tema të caktuara që nuk prekin çështjet themelore të sistemit politik. Në këtë analizë është përdorur edhe kombinimi i analizës së përmbajtjes me sasinë e karikaturave dhe rrethanave historike kur ato u publikun. Pra e thënë ndryshe, se në çfarë forme dhe në çfarë

¹ Për më tepër mbi metodën ikonografike shih: tek Erwin Panofsky, *Meaning in the Visual Arts* Anchor Books Edition, New York, 1955.

sasie çështjet më të rëndësishme të periudhës u pasqyruan në revisten satirike duke pasur parasysh edhe domethënien që kishte përmasa dhe vendosja e karikaturës në faqet e revistës.

Karikaturat e Hostenit

Në Shqipërinë totalitare shtypi u shndërrua në një organ krejtësisht nën varësinë e pushtetit politik që në vitet e para të regjimit. Në vitin 1946 u ndaluan të gjitha botimet e enteve private, ndonëse në kushtetutën e po atij vitit thuhej se shtypi është i lirë dhe çdo njeri është i lirë të shprehë mendimet e veta përmes shtypit. Në të vërtetë shtypi kontrollohej nga Komiteti i Agjitacionit dhe Propagandës dhe posaçërisht Sektori i Shtypit dhe Agjitacionit, i cili kishte për detyrë të kishte nën kontrollin e tij gjithë shtypin. Kjo zyrë duhej të kujdesej se çfarë duhej të dilte në shtyp, ku do të vihej theksi dhe çfarë duhej të dilte në pah e çfarë jo. Edhe vija politike që do të ndiqte shtypi do të përcaktohej çdo javë nga komiteti. Më pas pranë Komiteti Qëndror u krijua edhe drejtoria e shtypit e cila ushtronte kontroll të vazhdueshëm dhe po kështu jepte orientime të përditshme mbi temat që duhej të trajtoheshin (Boriçi, Marku 2010: 225). Revista Hosteni drejtohej nga një kryeredaktor dhe një kolegji që ishte në kontakt të vazhdueshëm me autoritetet të cilat diktonin temat që do të trajtoheshin. Karikaturistët vepronin nën presionin e organeve të shumta që i vëzhgonin por edhe nën ndikimin e fortë të autocensurës. Shumë prej tyre ishin edhe ndër humoristët më në zë të Shqipërisë që kishin reputacion të konsiderueshëm në shoqërinë shqiptare të periudhës.

Karikaturat e Hostenit ishin një nga mjetet e shumta të propagandës politike, por që përmes mënyrave më të rafinuara se shtypi i zakonshëm, arriti të zinte një vend të privilegjuar në shtyp duke u shndërruar në një nga mjetet kryesore të propagandës komuniste. Këto metoda përfshinin së pari përdorimin e simboleve mjaft të thjeshta që lidheshin me ide më të mëdha. Pasi ishte identifikuar simboli në një karikaturë ishte mjaft e lehtë të kuptohej synimin e

karikaturës. Një metodë tjetër ishte edhe ekzagjerimi i karakteristikave fizike të personazheve të cilat nuk kishin vetëm si qëllim shpërfytërimin e personazhit por edhe nxjerrjen në pah të elementëve të tjerë që i atribuoheshin objektit si cinizmi, paaftësia, etj. Një formë tjetër e përdorur ishte edhe analogjia duke krahasuar apo duke vendosur në të njëjtën karikaturë dy situata të ndryshme në funksion të evidentimit të dallimeve nga njëra tek tjetra. Forca kryesore e karikaturës politike si mjet i propagandës qëndronte në faktin se ishte forma më e thjeshtë dhe më e kapshme për të gjitha grupet shoqërore. Karikaturistët kishin edhe një rol të konsiderueshëm edukues sepse në një popullsi ku kishte edhe analfabetizëm forca e imazhit shpesh tejkalonte edhe forcën e faqeve të tëra të propagandës. Karikatura mund të qarkullonte në të gjithë grupimet sociale duke popullarizuar parrullat e pushtetit dhe duke goditur fenomene të dënueshme nga propaganda. Nëpërmjet karikaturës sistemi politik përpiquej të krijonte një realitet historik mbi bazën e këndvështrimit të tij, vlerave dhe vendimeve të marra prej tij pavarësisht nëse ishin apo nuk ishin të drejta apo të pranueshme. Humori politik ishte i bazuar mbi në një version idealist të politikës dhe kritikizmi përputhej me frymën dominuese të kohës (Tsakona, Popa 2011: 7).

Hosteni ishte një version shqiptar i revisites satrike sovjetike Krokodil (Крокодил) që në fakt duhet të ketë qenë shembulli që u morr për bazë fillimisht edhe për shkak të ngjashmërisë të madhe që kanë të dy revistat përse i përket tematikave thuajse të njëjta (Fitzpatrick 2000: 29). Revista gjithashtu të ngjashme me të u shfaqën edhe në vendet e tjera të bllokut komunist si në Poloni me revistën Szpilki (Gjilpëra), Urzica (Hithra) e Rumanisë, Jez (Iriqi) i Jugosllavisë (Ahmedi 2014: 207). Ashtu si edhe Hosteni keto revista filluan të luajnë një rol mjaft të rëndësishëm në transmetimin e direktivave që vinin nga lart mbi mënyrën sesi duheshin trajtuar çështjet e ndryshme politike, ekonomike dhe sociale.

Karikatura në keto vite mund të ndahet në dy grupe të mëdha. Në grupin e parë përfshihen karikaturat ku nëse analizojmë simbolikën, analogjinë, dhe ekzagjerimin e tyre, vihet re

qartësisht se kanë në fokus kryesor propagandën dhe si element të dytë plotësues kanë humorin. Në grupin e dytë dhe më pak të përhapur bëjnë pjesë ato karikatura që vendosin në plan të parë humorin dhe pastaj propagandën.

Në rastin e karikaturave të tipit të parë me ngarkesë të pastër propagandistike janë përfshirë disa tipe, kryesisht karikaturat që lidhen me qëndrimin e regjimit ndaj atyre që konsideroheshin si armiq të jashtëm dhe të brendshëm. Gjithashtu në këtë grupim propagandistik zenë një vend të konsiderueshëm karikaturat që përpiqen të tregojnë arritjet e mëdha të Shqipërisë në raport me të shkuarën dhe me të tjerët. Për të kuptuar më mirë këtë duhet të kemi parasysh se Shqipëria e vitetve 1965-1970 po kalonte një periudhë që konsiderohet si periudhë e stabilizuar përsa i përket situatës brenda udhëheqjes komuniste. Që nga viti 1960 nuk kishte pasur asnjë anëtar të Byrosë Politike që ishte goditur dhe regjimi shqiptar rezulton ndër më të stabilizuarit në gjithë botën komuniste. Kishte qenë periudha e viteve 1945-60 kur ishin dënuar të gjithë ata zyrtarë të lartë të kupolës komuniste që kishin kundërshtuar elementë të politikës së ndjekur nga Enver Hoxha, i cili i kishte rezistuar edhe prishjes me aletatin e madh dhe të fuqishëm siç ishte Bashkimi Sovjetik. Linjat kryesore të politikës së jashtme u vendosën në Kongresin e katërt të Partisë të vitit 1961 ku u shfaq edhe doktrina e “armiqëve të dyfishtë”. Sipas saj meqenëse komunizmi botëror tani po përballlej me dy armiq që ishin Sh.B.A. si shtet imperialist dhe B.S si shtet revizionist modern, duhej që partitë e vërteta marksiste-leniniste të luftonin kundër këtyre dy armiqve të socializmit. Kjo doktrinë i dha justifikim të fortë ideologjik komunistëve shqiptarë për ndarjen nga B.S. Veç kësaj Shqipëria filloi të ketë mbështetjen politike diplomatike dhe ekonomike nga Kina e cila gjithashtu ishte ndarë nga Moska në vitin 1960. (Pano 1977: 482) E gjithë kjo situatë politike u paraqit në forme propaganduese dhe humori në faqet e reviste satirike Hosteni.

Rastet e propagandës ndaj armiqve të jashtë janë mjaft të shpeshta (Fig.1).

Fig 1: Propaganda ndaj armikut



Burimi: Hosteni Nr. 549, 2 shtator 1965

Në të gjitha numrat e Hostenit një ose dy faqe nga 8 faqet e saj i janë dedikuar tërësisht armiqve të jashtëm të Shqipërisë. Karikaturat më të shumta në këto vite janë karikaturat që sulmojnë Sh.B.A. dhe në mënyrë të veçantë Presidentin amerikan Lindon Johnson. Ai konsiderohet prej regjimit si shkaktari kryesor i konfliktit të Vietnamit. Sipas revistës ishte ai që e kishte përfshirë Amerikën në konflikt duke dërguar gjithnjë e më tepër trupa ushtatrake në konflikt. Në shumicën e tyre Xhonson paraqitet si një njeri i shpërfytyruar, cinik, agresiv, i shëmtuar dhe i paimpionues për popullin e tij. Shpesh herë janë përdorur edhe foto të tij duke realizuar fotomontazhe. Simbolika e përdorur në evidentimin e armikut kryesor të Shqipërisë është krahasimi tij me shumë simbole negative. Një element tjetër lidhur me armikun amerikan është trajtimi që i bëhet jetës në Amerikë si një jetë mjaft e vështirë ku pabarazia shoqërore, taksat e larta dhe trajtimi i afro-amerikanëve janë çështje kryesore.

Bashkimi Sovjetik është një tjetër objekt i preferuar i sulmeve të Hostenit ku trajtohen si ngjarjet politike ashtu edhe fenomenet sociale të jetës së Bashkimit Sovjetik. Liderët sovjetikë janë objekti kryesor i karikaturës. Por me interes është fakti se ndaj Bashkimit Sovjetik sulmet janë të përqëndruara në faktin e bashkëpunimit me imperializmin amerikan sipas revistës. Në shumë pak karikatura janë paraqitur personazhet politike të B.S.

Jugosllavia zinte vendin e tretë për nga trajtimi i karikaturave të Hostenit. Çështjet themelore janë lidhjet e Jugosllavisë me perëndimin por edhe me lindjen. Kriza ekonomike në Jugosllavi mbetet një tjetër shqetësim. Situata ekonomike e fqinjit verilindor trajtohet në veçanti duke u cilësuar si mjaft e vështirë, me inflacion, papunësi dhe trajtimin e keq të punëtorëve. Edhe përplasjet e brendshme mes elites jugosllave u trajtuan nga karikaturat duke e trajtuar Titon si një akrobat që rrinte mbi palët dhe nëpërmjet dhunës dhe makinacioneve arrinte të ruante ekuilibrin e brishtë mes kombeve të vendit të tij. Çështja e situatës politike dhe ekonomike në Kosovë gjen vendin e saj në karikaturat e Hostenit, ku ajo që lihet të kuptohet është jo vetëm keqtrajtimi i shqiptarëve në Jugosllavi por edhe prapambetja e qëllimshme në të cilën e kishte lënë këtë rajon udhëheqja jugosllave. Personazhi më i trajtuar në karikaturë është Tito i cili është përfaqësuesi kryesor i politikës jugosllave. Në karikatura ai trajtohet si personazh negativ, krahasohet me kafshë dhe shfaqet me duart e lyera me gjak.

Aleanca mes imperializmit dhe revizionizmit mbetet në fakt një tjetër çështje e rëndësishme që trajtohet gjerësisht. Të dy këto ideologji shfaqen si dy anët e të njëjtës monedhë megjithëse në fakt Lufta e Ftohtë mes tyre vazhonte të ishte shumë e ashpër. Ato shfaqen si të lidhura ngushtësisht me njëra-tjetrën për shkak të interesave të përbashkëta globale për dominim mbi popujt. Në kuadër të trajtimit të kësaj “aleance” janë përfshirë edhe mjaft shtete të tjera që ishin kryesisht aleatet e Amerikës.

Izraeli na paraqitet si një krijese e fuqive të mëdha që përfiton prej mbrojtjes dhe mbështetjes financiare të tyre. Edhe për konfliktet në Lindjen e Mesme Hosteni fajson nxitjen që i japin Izraelit dy superfuqitë. Sipas revistës pas konflikteve në botën arabe fshihet interesi i madh i dy superfuqive për të kontrolluar burimet natyrore të këtij rajoni. Pas Izraelit qëndrojnë të fshehur imperialistët amerikanë.

Gjermania perëndimore është në fokusin e revistës Hosteni si një bashkëpunëtor i ngushtë i Sh.B.A. Fillimet e sulmeve ndaj Gjermanisë lidhen me mbështjen financiare dhe ushtarake gjermane për Luftën e Vietnamit. Simbolika e kryqit të thyer vazhdon të përdoret për të stigmatizuar Gjermaninë duke e ngarkuar me përgjegjësi për të shkuarën por edhe duke e perceptuar si një vend që vazhdonte të kishte të njëjtin ndikim prej së kaluarës.

Britania e Madhe vazhdon të konsiderohet si një prej armiqve historike të Shqipërisë. Kryesisht trajtesat mbi Britaninë lidhen me krizën ekonomike edhe rënien e vlerës së monedhës britanike që konsiderohet si pasojë e politikave të gabuara të saj.

Edhe Papati është një nga objektet e karikaturave të Hostenit. Sipas këtyre përfytyrimeve Papati megjithëse propagandon paqen, në fund të fundit mbetet thjesht një aleat i fshehtë i Sh.B.A. që mbështet politikën agresive dhe luftën. Papa i Romës shfaqet shpesh herë si një personazh që luan një lojë të dyfishtë duke propaganduar paqen nga njëra anë, ndërsa në krahun tjetër është duke u bërë palë me superfuqitë për dominimin në botë. Papati perceptohet si mbështetës i luftës.

Nato konsiderohet si një organizatë tipike imperialiste ushtarake e cila në thelb nuk ka sigurinë por ekspansionin nëpërmjet përdorimit të forces. Me interes është fakti se në rastin kur Franca tregohet skeptike ndaj Natos, kjo pasqyrohet në disa karikatura për të evidentuar faktin se brenda vetë aleancës kishte divergjenca të mëdha. Edhe Bashkimi Evropian konsiderohet një strukturë e dështuar që ishte krijuar prej fuqive kapitaliste për të dominuar Evropën.

Më pak gjejmë të pasqyruar edhe shtete të tjera si Afrika e Jugut, Indonezia, India, Pakistani dhe shumë shtete të tjera që bëhen pjesë e propagandës së Hostenit. Personazhe politikë prej këtyre vendeve janë lidhur ngushtë me Sh.B.A. dhe për këtë arsye dhe çdo qëndrim i tyre politik në marrëdhëniet ndërkombëtare konsiderohet si i nxitur dhe i porositur prej Sh.B.A.

Propaganda ndaj armiqve të brendshëm ishte paksuar shumë sepse kishte përfunduar faza e eliminimit të kundërshtarëve të hershëm të regjimit. Në raport me numrat e pesë viteve të para të publikimit të revistës trajtimi i armiqve të brendshëm ka pësuar rënie të ndjeshme. Armiqtë e brendshëm ishin bejlerët, grupimet e të ashtuquajturave të reaksionit të cilët ishin shtypur prej forcës së regjimit dhe prej vitit 1967 edhe kleri. Propaganda kundër fesë kishte kohë që kishte filluar dhe herë pas here në karikaturat e Hostenit shfaqeshin klerikët. Në vitin 1967 kur u ndaluan me ligj institucionet fetare, revista fillon t'ua marrë më shpesh në shënjestër këtë çështje. Megjithatë duke pasur parasysh lëvizjen e regjimit drejt eliminimit zyrtar të besimit dhe institucioneve fetare duhej të kishte pasur shumë më tepër karikatura. Por mesa duket pjesën më të madhe të propagandës kundër fesë e kanë luajtur gazetatat tipike politike. Sulmi ndaj fesë është prezantuar kryesisht në formën e sulmit ndaj klerikëve, të cilët kryesisht portretizoheshin si njerëz që ishin mbrapa me kohën dhe që besonin ato që nuk ekzistojnë si parajsë etj.

Ndërsa një model i dytë i karikaturave ishin ato që mund të konsiderohen më tepër si përdorim i humorit ndaj fenomeneve që konsideroheshin negative brenda shoqërisë shqiptare ku humori ishte kyesor dhe propaganda ishte veçse një element dytësor (Fig.2). Sigurisht edhe këtu ka një ndikim të madh të udhëzimeve që vijnë nga lart, por sidoqoftë duket se trajtimi nëpërmjet karikaturës i këtyre problemeve të brendshme është bërë në forma më të zbutura.

Fig 2: Lufta kundër burokracisë



Burimi: Hosteni Nr. 583, 2 shkurt 1967.

Kjo duket shumë në të gjitha elementet e përdorur si simbolika, analogjia, shtrembërimi e personazheve që janë aplikuar me mjaft humor dhe me njëfarë dashamirësie. Duket qartë se fenomenet negative të shfaqura brenda vendit lidhen ngushtë me traditën historike të shoqërisë shqiptare. Shumë prej këtyre fenomeneve ishin pjesë e mentalitetit kolektiv të shoqërisë shqiptare. Regjimi komunist ishte i shqetësuar për manifestimet e të ashtuquajturave “sjellje borgjeze dhe revizioniste” mes të rinjve dhe intelektualëve që ishin shfaqur kryesisht në qytetet e mëdha të vendit. Këto sjellje përfshinin edhe “veshjen, shijet muzikore dhe artisitike të huaja” si rezultat i ekspozimit ndaj transmetimit të radiove dhe televizioneve, filmave dhe letërsisë. Kritikën u shtuan edhe ndaj sistemit arsimor që nuk po edukonte në përputhje me kërkesat e jetës reale. Edhe shkrimtarët e artistët u sulmuan se kishin rënë nën ndikimin borgjez e revisionist duke u shkëputur nga temat e luftës dhe temat patriotike. Kjo tregonte se në këto vite udhëheqja shqetësohej për rritjen e ndikimit të intelektualëve dhe një ndarje mes studentëve dhe intelektualëve nga elita drejtuese. Në tetor të vitit 1965 në një sesion i veçantë i Plenumit të Komitetit Qëndror ju dedikua tërësisht kulturës dhe ishte hera e parë që kjo ndodhte. Aty u mbajt një raport që caktonte linjën që duhej ndjekur në art, letërsi muzikë. Në vitet 1966-69 nën

shembullin kinez u zhvillua faza kryesore e revolucionit kulturor që u drejtua nga lart me qëllim që të forconte kontrollin dhe të godiste ato fenomene që mund të rrezikonin rolin drejtues të Partisë. Në shkurtin e vitit 1966 filloi lufta kundër burokracisë e cila ishte shndërruar në një grupim të madh e të fuqishëm që nga njëra anë dukej sikur rivalizonte me superioritetin e partisë dhe nga ana tjetër kishte krijuar një grup të fuqishëm dhe të privilegjuar që kishte krijuar pakënaqësi në popull. (Pano 1974: 478) Burokracia mund të konsiderohet edhe si “shtresa e mesme” e shoqërisë komuniste shqiptare, pak a shumë një grupim i ndërmjetëm mes elitës dhe popullit. Ky grupim kishte arritur të fuqizohej e të aplikonte forma të drejtimit autoritar në mikrokozmosin e vet, gjë që rivalizonte në fund të fundit edhe elitën por edhe sistemin politik. Rrugët që u ndoqën në këtë drejtim ishin disa si transferimet e burokratëve nga qytetet e mëdha në zona të tjera, detyrimin e tyre për të punuar në prodhim, eliminimin e gradave në ushtri. Në këtë vazhdë u urdhërua edhe lufta për emancipimin e gruas, zhdukjen përfundimtare të fesë dhe zakoneve të vjetra, reformimi i teksteve dhe sistemit arsimor. Në ndihmë të këtyre qëllimeve u nxit edhe aktivizimi i popullit nëpërmjet denoncimit të këtyre elementëve nëpërmjet fletë-rrufëve apo mbledhjeve publike. Letrat nga publiku dhe fletë-rrufetë filluan jo vetëm të shfaqen në sheshet e qytetëve por edhe të zenë faqe e shtypit të kohës. Edhe revista Hosteni u angazhua në zbatimin e këtyre urdhrave. Letrat nga publiku filluan të zenë faqet e revistës. Ato shoqëroheshin edhe me kariktura apo me tregime të shkurtra ku denocoreshin jo vetëm fenomenet por edhe emrat e personave përgjegjës. Pati raste kur flete-rrufetë e afishuara më parë në sheshe botoheshin edhe në revistë duke u i bërë jehonë dhe duke nxitur edhe më tepër këtë formë direkte të sulmeve personale. Revista në këtë kohë i kushton një vëmendje të madhe çështjeve të brendshme. Shumica e karikaturave të kësaj kohe i dedikohen në masën 70 % luftës ndaj këtyre fenomeneve. Faqja e parë ishte në shumicën e rasteve e orientuar drejt problemeve të brendshme.

Në vend të parë është pasqyruar lufta kundër burokracisë. Kjo luftë është e lidhur edhe me direktivat shtetërore por edhe me problemet e mëdha që shkakatonte ky fenomen në opinionin publik. Edhe vetë karikaturistët kishin liri të plotë në goditjen e këtyre fenomeneve me kusht që të mos kalonin rangun e drejtorëve. Një hov të madh ky fenomen mori pas shfaqjes së fletërrufeve të para. Revista krahas karikaturave të veta, kishte një seksion ku botonte letra nga populli apo fletërrufe të vendosura në sheshet publike të qyteteve, të cilave ju kushtonte një vëmendje të veçantë. Burokratët pasqyroheshin kryesisht në forma humoristike si persona që ishin të izoluar në botën e tyre të shkresave, që pengonin zhvillimin normal të shoqërisë. Ata ishin të përhapur kudo, qoftë në qytet, qoftë në fshat. Ata të qytetit paraqiten si intelektualë por që duke pasur pushtet krijojnë privilegje për veten e tyre, ishin të mbyllur ndaj kërkesave të vartësve dhe nuk kishin efektivitet në punën e tyre. Burokratët e fshatit paraqiten si njerëz të pushteshëm që ishin shkaktarë për rezultatet e ulta në punët e bujqesise. Të gjitha problemet e shfaqura nga karikaturat rezultonin si shkaktuara nga fenomene negative për të cilat ishin përgjegjës disa persona dhe në asnjë moment si difekte të sistemit politik dhe ekonomik.

Në vend të dytë renditet çështja e barazisë mes burrit dhe gruas, një nga çështjet që është trajtuar gjerësisht në këtë revistë. Pas konceptit të barazisë mes burrit dhe gruas përveç konceptit modernizues të shoqërisë, fshihej edhe tendenca për t'i shtuar fuqisë punëtore një grupim të ri. Zakonet prapanike siç quheshin ishin gjithashtu mjaft të lidhura me këtë problem. Në faqet e Hostenit zënë vend mjaft karikatura që trajtojnë me humor sesa shumë ishin të përhapura konceptet e pabarazisë. Ato dukeshin të shtrira si në qytete edhe në fshatra. Në rastin e qytetit vihej re fakti se detyrat kryesore në familje i bënin gratë, ndërsa burrat shijonin të qetë ndeshjet e futbollit e takimet me shokët e tyre. Ndërsa situata në fshat paraqitej më e vështirë për gruan e cila jo vetëm kryente punë të rënda fizike por i nënshtrohej edhe fenomeneve negative si psh martesave me diferencë të madhe në moshë mes burrit dhe gruas, apo vendimeve që familja

merrte për martesën e saj. Këtu kemi ndoshta një nga ndikimet më positive të revistës në procesin e nxitjes drejt arritjes së barazisë gjinore si tipar i modernitetit.

Elementet që konsideroheshin si sjelle mikroborgjeze përfshinin dukuri si ndjekja e modës, mbajtja e flokeve, indiferenca, dembelizmi, rendja ndaj parasë dhe u bënë një tjetër fokus kryesor i revistës. Në kuadër të revolucionit kulturor të gjithë duhej të ishin më aktivë në shoqëri dhe të kontribuonin më shumë. Në sulmin e revistës janë vendosur edhe pedagogët universitarë. Ata akuzohen për shkëputje nga çështjet praktike dhe mbylljen në botë teorike, për mungesën e përgatitjes së duhur, për sjelljen arrogante ndaj studentëve.

Revista kishte edhe elemente të nacionalizmit siç ishte rasti i përvjetorit të lindjes së Skënderbeut ku e gjithë revista ju kushtua atij dhe karikaturat e shumta vlerësonin luftën ndaj osmanëve dhe i stigmaizonin si pushtues të prapambtur dhe të ashpër. Edhe rezistenca gjatë Luftës së Dytë Botërore përdorej herë pas here si formë e nacionalizmit sidomos në rastet e përvjetorëve të ngjarjeve të rëndësishme të luftës. Në këto vite revistës ju shtuan edhe një fotoreporter që fotografonte ato që i konsideronte probleme si mosfunksionimin e mirë të administratës kudo në Shqipëri.

Përfundime

Revista ishte një nga mjetet më efikase të propagandas sepse nëpërmjet humorit godiste armiqët dhe fenomente e dënueshme për ideologjinë e kohës. Në karikaturat e shumta herë propaganda tejkalonte humorin dhe herë humori tejkalonte propagandën. Por propaganda ishte e fuqishme në trajtimin e armiqve të jashtëm dhe të brendshëm. Ata krahasoheshin me kafshët që simbolizonin të keqen, ishin të kryesisht të zinj, të vegjël, me sy të kuq, me duart me gjak, mbanin armë, ishin të etur për para. Ndërsa në trajtimin e fenomeneve të brendshme kryesisht u

përdor humori duke i trajtuar personazhet si mëndjelehtë, të vetëkënaqur, të hutuar, të lodhur, autoritarë, të shkëputur nga realiteti etj. Edhe kjo sidoqoftë ishte një formë propaganda, por u integrua mjaft mirë me humorin duke dëshmuar se të paktën në këtë kohë synimi nuk ishte eliminimi i tyre, por kufizimi sa më i madh i këtyre fenomeneve në kuadër të modernizimit të shoqërisë, aq më tepër që këto fenomene ishin edhe pjesë e traditës së shqiptarëve. I referohemi këtu fenomeneve si autoritarizmi, servilizmi, abuzimi me detyrën, pabarazia burrë-grua, përtacia etj. Nëpërmjet këtyre karikaturave synohej kthimi në rrugën e drejtë të personazheve që kishin gabuar duke lënë të hapur mundësinë e përmirësimit nga brenda të shoqërisë.

Bibliografi

Ahmedi, L. (2014) Një Hosten kundër armikut – Përfytyrimi i kundërshtarëve të jashtëm në karikaturat e revistës Hosteni nga një këndvështrim teorik. *Përpyekja* 32-33, Tiranë, 205-215.

Boriçi, H. Marku, M. (2010) Histori e shtypit shqiptar nga fillimet deri në ditët tona ShBLU, Tiranë.

Fjalori Enciklopedik Shqiptar (1985): Akademia e Shkencave Tiranë 457-458.

Fitzpatrick, Sh. (2000) *Everyday Stalinism: Ordinary Life in Extraordinary Times: Soviet Russia in the 1930s*, Oxford University Press.

Pano, C. Nicholas, (1977) 'Albania in the era of Kosygin and Brezhnev' in *Nationalism in the URSS and Eastern Europe in the era of Brezhnev & Kosygin*. -Detroit: The University of Detroit Press, 474-494.

Panofsky, E. (1955) *Meaning in the Visual Arts* Anchor Books Edition, New York.

Tsakona, V. Popa, D.E. (2011) 'Humour in politics and the politics of humour'. Studies in political humour: in between political critique and public entertainment Villy Tsakona Diana Elena Popa, John Benjamins B.V. (eds.) Amsterdam, 1-30.

Afrim Krasniqi

Universiteti “Aleksandër Moisiu”

Tranzicioni në Shqipëri

Shqipëria ka kaluar 25 vjet nga ndryshimi i sistemit politik. Kjo periudhë vijon të konsiderohet “tranzicion”, - si një proces kalimi nga sistemi njëpartiak drejt një sistemi të konsoliduar shumëpartiak dhe shteti të së drejtës. Midis studiuesve shqiptarë e të huaj të sociologjisë dhe shkencave politike ekziston debat mbi konceptin e tranzicionit dhe kohështirjen e tij. Vlera e debatit lidhet me fazën ku ndodhet Shqipëria dhe sfidat e saj të ardhshme. Për mbështetësit e tezës mbi fundin e tranzicionit (Pëllumbi 2013), *“tranzicioni politik është i mbyllur dhe jemi në fazën e konsolidimit të demokracisë”*, për kritikët e moderuar të kësaj teze (Fuga 2014) *“tranzicioni politik dhe ekonomik dhe kulturor jo që nuk ka mbaruar, por as nuk ka filluar mirë”*, për kritikët më radikalë (Uçi 2013) tranzicioni lidhet edhe me të ardhmen e kombit dhe vetëm me zgjidhjen e problemeve themelore kombëtare mund të shihet i përfunduar.

Tezat dhe debati rreth tyre reflekton një kontest më të gjerë të referimit ndaj tranzicionit. Teza minimaliste e tranzicionit e lidh atë me fazën e formësimit të shtetit demokratik, me zhvillimin e zgjedhjeve, miratimin e Kushtetutës, procesin e integritetit. Shqipëria i ka përmbushur këto kritere standarde, - shteti është funksional, kushtetuta është miratuar (1998), baza ligjore është e plotë në funksion të zgjedhjeve politike dhe ekonomike, vendi është anëtar në KE, OSBE, NATO dhe ka marrë ftesën e statutit të vendit kandidat në BE.

Teza e dytë i dedikohet Huntington (Huntington 2011: 7-8), dhe i referohet standardit të së paku tri rotacioneve politike të njëpasnjëshme zgjedhore. Shqipëria ka kryer rotacione politike më 1992, 1997, 2005 dhe 2013, - tri prej të cilave kanë qënë paqësore, por me diferencë të thellë

kohore midis tyre. Vetëm dy prej tyre, 2005 dhe 2013 janë rotacione të njëpasnjëshme zgjedhore. Bazuar në këtë standard, sprova e fundit të tranzicionit do të përcaktohet në zgjedhjet e radhës 2017 ose 2021, kur teorikisht mund të realizohet rotacioni i tretë paqësor i pushtetit.

Teza e tretë me shumë mbështetje në rajon lidhet me raportin e vendeve ish komuniste me procesin e anëtarësimit në Bashkimin Evropian (Meksi, Pasha 2004: 289). Sipas saj, me aktin e pranimin në BE mbyllet tranzicioni dhe nis një proces i ri evropianizmi. Midis vendeve ish komuniste vetëm disa vende të Ballkanit Perëndimor, përfshirë Shqipërinë, ende nuk e kanë arritur këtë stad. Parashikimet janë optimiste, por fundi i këtij procesi mund të kërkojë më shumë se një dekadë tjetër. Nëse ky standard shihet përcaktues, shoqëria shqiptare do të duhet t'i kushtojë tranzicionit më shumë se tri dekada, ose 80% të gjatësisë kohore të vetë periudhës komuniste në Shqipëri, - një krahasim domethënës që nxjerr në pah vështirësitë e procesit dhe skepticizmin ndaj këtij kriteri vlerësimi.

Vlera e përcaktimit të konceptin e tranzicionit në kontestin shqiptar lidhet direkt me sjelljen politike dhe këndvështrimin e analizës mbi vetë tranzicionin. Udhëheqësit politikë dhe mazhorancat politike përgjatë 25 viteve ia kanë dedikuar problemet dhe dështimet e tyre elementit të “tranzicionit”, duke e përdorur atë si alibi në rast dështimesh e vonesash, si një periudhë e pashmangshme, eksperimentale dhe sprove. Alibia e tranzicionit vijon të jetë pjesë e rëndësishme e ligjërimit politik në vend, argument në studimet sociale dhe një mekanizëm mbrojtjeje për bilancet e pamjaftueshme të vendimmarrjes politike dhe lidërshiptit shqiptar përgjatë 25 viteve.

Referimi në standarde minimale vs standardeve maksimale

Në historinë politike shqiptare pikat e referimit kanë qenë kryesisht spekulative. Në ligjërimin politik të periudhës së Mbretit Zog standard i vlerësimit të arritjeve ishte krahasimi me periudhën përpara 1912, kurse në ligjërimin e sistemit komunist deri më 1990 krahasimi i rezultateve bëhen me vitin 1938. Gjatë dekadës së parë të tranzicionit postkomunist çdo krahasim bëhej me vitin 1990, i cili ishte viti më negativ i ndryshimit, kurse në dekadën e dytë të tranzicionit krahasimi bëhet me vitin 1997, i cili ishte edhe viti më negativ i dekadës së parë. Kjo përvojë spekuluese e krijimit të standardeve minimale referuese nga brenda, kufizon mundësinë e referimeve të sakta dhe të matjes së treguesve realë të tranzicionit.

Referimi në të kaluarën shqiptare përbën referim në standardin minimal, dhe si i tillë, nxjerr të suksesshëm çdo bilanc politik të 25 viteve. Përgjatë një shekulli Shqipëria nuk ka pasur periudhë tjetër më demokratike, më të integruar dhe më të zhvilluar në aspektin e lirive politike sesa periudha e dy dekadave të fundit. Një numër ekspertësh të studimeve politike e sociale sugjerojnë mekanizma dhe standarde të tjera referuese, - kryesisht ato të vendeve demokratike perëndimore ose ish komuniste të Evropës Qendrore. Referimi në standardet perëndimore ose të vendeve me një traditë më të madhe demokratike, rezulton kritik për arritjet e deritanishme në Shqipëri. Modeli demokratik shqiptar vijon të jetë i brishtë, një “protodemokraci” (Schoepflin 1994: 140), një demokraci hibride në vend të demokracisë funksionale.

Midis dy referimeve, mbi standarde minimale ose maksimale, tranzicioni në Shqipëri reflekton edhe një kontrast të thellë midis vizionit utopik për demokracinë më 1990-1992 dhe konceptit të real-politikës në fundin e 25 viteve. Koncepti i viteve ‘90 ishte idealist, jo real, teorik, dhe bashkim mekanik i mentalitetit të partisë-shtet me interesin publik dhe euforinë për sistemin konkurrues shumëpartiak. Referimi i sotëm si krahasim me 1990 duket jo real, për sa kohë Shqipëria ka shënuar progres kohor dhe në standarde, si edhe për sa kohë kriteret e vlerësimit të progresit të Shqipërisë sot janë shumë më të larta sesa dy dekada më parë. Mbi këtë bazë tranzicioni mund të vlerësohet në disa aspekte përfaqësuese të tij, kryesisht në komponentët

politikë, institucionale, raportin shtet – qytetar, zhvillimet ekonomike si dhe ecurinë e procesit të integritit.

Revolucioni i munguar dhe zhvendosja e elitave

Në dallim nga shumica e vendeve të tjera ish komuniste, tranzicioni në Shqipëri mbetet unik në disa elementë të tij (Gjuraj 2015: 24). Raporti i shoqërisë shqiptare me të kaluarën ndryshon shumë nga përvoja e shumicës së vendeve të tjera. Sistemi diktatorial në Shqipëri ishte shumë më i dhunshëm, izolues dhe represiv sesa në vendet e tjera (Biberaj 2011: 29). Ai nuk lejoi ekzistencën as formale të grupimeve kritike liberale, grupimeve të disidencës, grupimeve rivalizuese në emigracion, grupimeve fetare me rol social brenda vendit; nuk lejoi kontaktet me pjesën tjetër të botës; refuzoi shkëmbimet tregtare; ekzekutoi kundërshtarët politikë, si dhe pamundësoi krijimin e shtresës së mesme sociale, të gatshme për lëvizje sindikaliste apo demokratike. Për rrjedhojë, në vitin 1990 Shqipëria nuk zhvilloi revolucion demokratik, por realizoi ndryshim relativ të sistemit, zhvendosje horizontale të elitave në pushtet, kryesisht përmes kompromisit dhe bashkëpunimit midis elitave të vjetra e të reja sipas praktikës së “transferimit të ndikimit (Abrams 2015). Zhvendosja e elitave dhe bashkëveprimi përcaktues i tyre në procesin e ndryshimit politik krijoi konfuzion mbi natyrën e sistemit të ri dhe vizionin e tij për të krijuar një sistem, një shoqëri dhe një shtet të modelit demokratik.

Shqipëria përpara 1990 ishte një vend i shkretuar nga idetë demokratike, Shqipëria e pas vitit 1990 u bë një vend i ideve demokratike të bartura nga elitat e formuara dhe emëruara në fazën e mëparshme. Një përjashtim pozitiv përbën brezi studentor i viteve 1990-1991, natyra refuzuese e tyre ndaj realitetit dhe jetës nën diktaturë dhe aftësia e tyre për të rrezikuar dhe

lobuar në interes publik e kombëtar, - tipare që nuk i gjejmë tek elitat e mëparshme (Rama 2015: 117). Periudha dhjetor 1990-shkurt 1991 solli ndryshime të shpejta, dedikuar rolit të studentëve, dhe në kontrast të thellë me shumicën shoqërore, përfshirë elitat vendimmarrëse të vjetra e të reja, - të cilat midis ndryshimit të shpejtë dhe atij të kontrolluar, mbështetën dukshëm variantin e dytë.

Kjo zbrazëtirë në potencialin demokratik na ndihmon të shpjegojmë një numër fenomenesh të ndryshme negative ose kritike që erdhën më pas. Partitë e reja politike u krijuan dhe u drejtuan nga elitat e mesme të regjimit të kaluar, ish të dënuarit politikë dhe emigracioni mbetën jashtë rrjedhave politike, si dhe potenciali më i madh demokratik, - rinia, pasivisht emigroi drejt vendeve perëndimore. Të gjitha instrumentet përfaqësuese të sistemit të ri, - organet vendimmarrëse politike, ekzekutivi, administrata e lartë, gjyqësori, forcat e sigurisë, media dhe shoqëria civile, - u dominuan nga këto elita dhe reflektuan dyzimin midis objektivit demokratik dhe mentaliteteve në formim para-demokratik.

Konsensusi i munguar mbi sfidat e tranzicionit

Koncepti i krijimit të sistemit të ri përmes marrëveshjes funksionoi vetëm në periudhën e parë të tranzicionit, kryesisht në axhendën integruese dhe në atë të hartimit të legjislacionit primar. Në fazën e dytë dhe më të rëndësishme, atë të jetësimit të reformave dhe shtetit të së drejtës, aktorët politikë vendimmarrës refuzuan dukshëm konsensusin dhe imponuan axhenda politike ditore, me natyrë elektorale dhe me produkt larg nevojave afatgjata të vendit.

Konkretisht, përgjatë 25 viteve elitat politike dështuan të gjejnë konsensus për formën dhe mënyrën e ndarjes me të kaluarën komuniste, për zgjidhjen përfundimtare të problemeve të

pronësisë mbi tokën, për kontrollin mbi territorin, për privatizimin e aseteve publike, për krijimin e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe shtetit të së drejtës, si dhe për një proces transparent, funksional e të besueshëm të përfaqësimit politik përmes zgjedhjeje konkurruese.

Përgjatë viteve partitë kryesore politike pranuan zgjidhje konsensuale vetëm për çështje të politikës së jashtme, siç janë procesi i pranimit në OSBE, në KE, në NATO, i afrimit me BE dhe në nismat rajonale, si dhe në angazhimet në kuadër global. Të gjitha misionet ushtarake shqiptare (Bosnje, Irak, Afganistan, Çad, etj) kanë qenë produkt konsensual. Gjithashtu konsensusi është aplikuar në rastet fundore të krizave për tejkalimin e tyre (1991, 1997, 2002), duke krijuar dy qeveri konsensuale disamujore (1991 dhe 1997), si dhe zgjedhur një President konsensual (2002) (Krasniqi 2009: 342). Kushtetuta 1998 u miratua me votat e një pale politike, dhe vetëm pas 18 vitesh (ndryshimet kushtetuese 2008) palët politike kryesore arritën konsensus afatshkurtër për sistemin qeverisës dhe sistemin politik në vend.

Në shumicën kohore dhe problematike të tranzicionit, partitë kryesore politike refuzuan periodikisht bisedimet, dialogun dhe bashkëpunimin politik (Komisioni Evropian “Progres Raporti 2015”). Krizat politike, kontestimet mbi rregullat zgjedhore e ligjore (Bufi 2010 : 146), si dhe sidomos debati permanent mbi legjitimitetin janë produkte të mungesës së konsensusit për tranzicionin. Nga tetë procese zgjedhore politike pesë prej tyre janë shoqëruar me bojkotin politik të produktit zgjedhor nga pala humbëse e zgjedhjeve, pra me kontestim të legjitimitetit vendimmarrës (Bideleux 2014: 324). Bilance të tilla patën ndikim në formësimin e institucioneve, brishtësinë e funksionimit të tyre, si dhe në cilësinë e demokracisë, procesin integruar, reformat dhe imazhin e vendit.

Natyra eksperimentale e sistemit përfaqësues

Vendosja e pluralizmit politik në radhë të parë do të thoshte, një sistem politik dhe shoqëror konkurrues, i drejtë dhe me produkt, një sistem legjitim përfaqësimi dhe një raport të ri të shtetit me qytetarët. Në modelin e partisë – shtet, ku shqiptarët jetuan përgjatë 46 vjet, qytetari ndodhej nën dhunën, presionin dhe kontrollin tërësor të shtetit. Demokracia pritej të krijonte lirinë, pavarësinë dhe partneritetin e nevojshëm midis qytetarit dhe organeve vendimmarrëse dhe ligjzbatuese shtetërore.

Në bilancin e 25 viteve sistemi elektoral nuk ofroi hapësirë konkurruese cilësore dhe as standarde të larta e të qëndrueshme zgjedhore. Në tetë procese zgjedhore parlamentare u aplikuan pesë sisteme të ndryshme zgjedhore, duke kaluar nga sistemi i pastër mazhoritar në sistemin proporcional me lista të mbyllura (Krasniqi 2014: 416). Tri referendumet e zhvilluara nuk kanë qenë nisma qytetare, dhe se nisma e vetme e ardhur nga qytetarët (dhjetor 2013) u konsumua pa referendum. Për shkak të kufizimeve të vazhdueshme ligjore hapësira për kandidatët e pavarur dhe lëvizjet e reja politike është ngushtuar dukshëm, si dhe sistemi i administrimit zgjedhor vijon të jetë tërësisht partiak. Për rrjedhojë, ndryshe nga pritshmëritë e viteve 90, sistemi përfaqësues vuan nga besueshmëria, efektiviteti, qëndrueshmëria dhe cilësia e përfaqësimit.

Pritshmëritë dhe arritjet për një kulturë të re të përfaqësimit të bazuar në sistemin e meritës dhe konkurrencës së vlerave në shoqëri, gjithashtu patën rezultate minimale. Parimet e demokracisë funksionale dhe vendimmarrëse, transparencës dhe financimit janë po kaq të brishta edhe në shoqërinë civile, në botën akademike, në vetë partitë politike, në institucionet e tjera publike, në media, etj. Kultura politike dhe demokratike mbi legjitimitetin, konkurrencën dhe transparencën ishin dhe janë në nivele minimale të atilla, saqë vënë në dilemë aftësinë tonë për të prodhuar më shumë demokraci.

Natyra eksperimentale u aplikua edhe në raportet midis shtetit e qytetarit. Nga varësia e plotë nga shteti, qytetarët nuk ishin të përgatitur për përdorimin pozitiv të lirisë së tyre, siç edhe shteti nuk ishte në gjendje të ofronte të gjitha shërbimet funksionale të tij. Përgjatë viteve doli në pah diferenca midis paketës së pasur legjislative si dhe nivelit kritik të zbatimit të tyre në praktikë. Hartimi i legjislacionit u bë me asistencë ndërkombëtare dhe nën presionin publik ose presionin e jashtëm për reforma. Baza ligjore dhe administrative e shtetit nuk reflektoi edhe raportin e qytetarit me përgjegjësitë e zbatimit të saj. Hendeku mbetet tregues kritik i defekteve dhe problematikave në raportet e qytetarit me shtetin, me ligjin dhe me kulturën politike demokratike. Kriza e fajdeve në mesin e viteve '90, procesi i pakontrolluar i migrimit dhe zënies së tokave/pronave publike apo private, niveli minimal i pagesës së taksave, etj, reflektojnë nivel problematik të kulturës ligjore. Programet e ndarjes së investimeve, të mbledhjes së taksave, të ndarjes së pasurive publike, të përfshirjes në programe sociale, etj, u dominuan nga sjellja klienteliste dhe partizane e çdo qeverie.

Integrimi, si projekt dhe si slogan politik

Në fillim të procesit demokratik slogani kryesor që inspiroi lëvizjet rinore dhe politike kundër regjimit të vjetër dhe pro sistemit të ri, ishte premtimi “*e duam Shqipërinë si Evropë*”. Në atë fazë historike integrimi shihej dhe vlerësohej si rruga e vetme dhe zgjidhja e vetme për Shqipërinë, pa qartësuar qytetarin se çdo të thotë realisht të jesh pjesë e familjes evropiane (Gjergji 2014: 286). Më shumë sesa alternativë politike integrimi njësohej me të drejtën historike, me fitoren e kohës së humbur dhe me interesin kombëtar. Kjo është edhe arsyeja që përgjatë 25 viteve asnjë forcë politike nuk ka premtuar dhe as promovuar një alternativë tjetër nga premtimi për integrim euro-atlantik.

Besimi i madh publik tek integrimi dhe njëherësh, mosnjohja sa dhe si duhet e procesit dhe sfidave të integritit, me kalimin e viteve krijoi raste të shumta të keqpërdorimit dhe keqkuptimeve rreth tij. Flamuri i integritit u përdor nga palët politike, sidomos qeveritë e tranzicionit, edhe si alibi për akte të tyre kritike ndaj kundërshtarëve politikë, për vendimmarrje politike të nxitura nga interesa të ditës, apo edhe për mbrojtje nga akuzat e ndryshme për korrupsion e abuzime (Kajsiu 2012). Procesi i integritit zgjati shumë më tepër sesa pritej dhe kuptohej nga brezi i vitit 1990. Për rrjedhojë, rezultatet pozitive erdhën në kohën kur publiku ndjehej i lodhur, retorika politike e konsumuar dhe se kur kosto e lartë që paguan qytetarët e shoqëria kishte krijuar tashmë një shtresë solide të zhgënjyer apo refuzuese ndaj sistemit aktual partiak dhe politik. Vetë fakti se pas 25 vitesh Shqipëria ndodhet në grupin e shteteve aspirante që u përfshinë në disa luftëra ballkanike, tregon bilancin kritik të arritur prej saj, si dhe konfirmon edhe natyrën utopike të premtimeve e pritshmërive të viteve 90.

Tipar ndikues i raportit tonë me procesin integruës është edhe ndryshimi në axhendën dhe prioritetet perëndimore ndaj Shqipërisë e rajonit. Në dekadën e parë të tranzicionit kërkohej demokraci, në dekadën e dytë prioritar u bë nevoja për stabilitet (Krasniqi 2014). Natyrisht, dy konceptet nuk e përjashtojnë njëra tjetrën, por në kulturën ballkanike, përfshirë shqiptare, koncepti i stabilitetit lexohet edhe si e drejtë e liderëve lokalë për ta siguruar atë edhe me mjete, të cilat, mund të cenojnë cilësinë e demokracisë. Shqipëria është një rast i tillë. Në emër të stabilitetit shpeshherë u injoruan standardet e larta për demokracinë dhe u shënuan hapa në kufizimet e pjesshme të lirive qytetare, përfshirë liritë politike dhe ekonomike. Nëse premtimi për liri mbarte me vete edhe besimin, shpresën dhe aspiratën e ndryshimit, premtimi për stabilitet u jep prioritet akteve pragmatiste, masave administrative dhe dominimit të shtetit në shoqëri, - një tregues kritik për historinë tonë shtetërore.

Procesi integruës u ndikua direkt edhe nga krizat periodike politike nga brenda (Bashkurti 2014: 394), dhe luftërat apo krizat në rajon. Shqipëria humbi shumë kohë dhe energji për shkak të

paqëndrueshmërisë rajonale dhe problemeve ekonomike të krijuara nga mungesa e tregjeve të lira rajonale. Në vitet e fundit, procesi u ndikua edhe nga ndryshimi i prioriteteve zgjeruese brenda vetë BE, si dhe nga vala e re e emigracionit brenda kontinentit ose drejt kontinentit. Në terma etikë, përdorimi pafund dhe pavend i retorikës së integrimit në secilën prej 15 fushatave elektorale të zhvilluara në 25 vjet, si dhe dështimet permanente në mbajtjen e premtimeve, ka bërë që integrimi të shndërrohet në tezë dytësore, që nuk sjell vota dhe që nuk përbën më identitet prioritar në programet partiake dhe as qeverisëse.

Shteti i së drejtës dhe mungesa e institucioneve të garancisë

Krijimi i institucioneve kushtetuese dhe parimi i ndarjes e balancës së pushteteve, realizuar përmes dokumentit kushtetues 1991 dhe 1998, krijuan bazën e ndërtimit të shtetit të së drejtës. Në një vend me mungesë të dukshme të traditës demokratike të qeverisjes, praktikat e reja demokratike ndeshën në vështirësi të mëdha dhe reflektuan probleme në jetësimin e tyre. Shqipëria ka përmbushur kriteret formale të kushtetutës dhe institucioneve, gjithsesi, problemi kryesor mbetet cilësia e shtetit të së drejtës, niveli funksional i tij, forcimi i bazës së demokracisë (Fischer 2015).

Tipari i modeleve qeverisëse 25 vjeçare ishte dominimi i traditës politike, sipas të cilës, shoqëria prodhoi modele të liderit të fortë politikë, liderit të pushtetshëm vullneti i të cilit bëhet përcaktues në vendimmarrjen politike. I gjithë tranzicioni identifikohet me vendimmarrjen e 2-3 emrave politikë, të cilët, identifikohen me merita historike, mitizohen dhe riciklohen vazhdimisht në politikë. Ata, krahas meritave të tyre personave të drejtimit kanë direkt edhe përgjegjësinë kryesore në dështimet e shënuara.

Rënia e liderëve të fortë, rotacioni politik midis tyre, etj, solli natyrshëm edhe rënien e institucioneve dhe modeleve politike që ata krijuan. Kjo ndodhi për shkak se rendja pas liderëve të fortë politikë nuk lejoi krijimin e institucioneve të forta funksionale, pra nuk lejoi krijimin e institucioneve të garancisë, të cilat, pavarësisht liderit në pushtet, garantojnë procesin dhe standardet e shtetit të së drejtës. Pothuajse të gjitha krizat politike në vend u shkaktuan nga mosmarrëveshjet midis liderëve të fortë politikë dhe të gjitha ato u zgjidhën përmes presionit apo negocimit të jashtëm, gjë që ndikoi në dobësimin e institucioneve vendore dhe aftësinë e tyre për parandalimin apo zgjidhjen e krizave.

Natyra “partiake” e shtetit ishte dukshëm më e fortë sesa natyra institucionale e tij. Në sistemin qeverisës shqiptar partitë politike kanë shumë më tepër pushtet sesa u njeh kushtetuta (neni 9), vullneti i tyre është përcaktues për vendimmarrjen politike, mobilizimin qytetar, sistemin e karrierës, emërimin në administratë si dhe imunitetin politik ndaj akuzave.

Mbi-pushteti i partive pati si produkt por edhe si mbështetje, brishtësinë e sistemit të drejtësisë, pamundësinë e tij për të siguruar një sistem të drejtë, transparent dhe ligjor të hetimit dhe të gjyqimit (Krasniqi 2008: 112). Mungesa e sistemit efektiv të drejtësisë reflektoi probleme të mëdha në të gjithë sektorët e tjerë publikë e institucionale¹. Mbi të gjitha ai ndikoi në krijimin e një sistemi vlerësimi me dy standarde, në mungesën e besimit tek sistemi qeverisës, si dhe në imunizimin permanent të rasteve korruptive të zyrtarëve të lartë. Me gjithë raportet vendore dhe ndërkombëtare për nivelin e lartë të korrupsionit, asnjë zyrtar i lartë politik e shtetëror nuk u përball realisht me drejtësinë. Përballë mbi-pushtetit të partive dhe mungesës së drejtësisë efektive, niveli i kulturës ligjore për qytetarët mbeti në nivele shqetësuese.

¹ EU Commission Opinion on Albania’s Application for Membership of the EU. COM 2010, 680, Brussels, 9.10.2010.

Në fillim të viteve '90 Shqipëria praktikoi për herë të parë nocionin e ekonomisë së tregut. Me një traditë dominuese të ekonomisë së centralizuar shtetërore, njohuritë minimale për tregun dhe paaftësia për përshtatje me sistemin e ri rezultuan një pengesë serioze për reformat ekonomike të premtuara (Hana, Telo 2005: 62). Në dy fazat e para të tranzicionit ekonomik, 1990-1992 dhe 1992-1997 u krijuan bazat e para të ekonomisë private, kryesisht të bazuar në aksesin e dhënë nga shteti për pronat dhe disa shërbimet të veta tek individë e grupe afër vendimmarrjes politike, si dhe nga privatizimet e shërbimeve publike dhe pasurive shtetërore gjithashtu tek klientela ekonomike të lidhura me pushtetin (Krasniqi 2012). Në dy rastet, më shumë se nisma private ekonomike kemi biznesin si produkt të politikës. Nga njëra anë premtimi dhe nevoja për reforma ekonomike e liri tregu, si dhe nga ana tjetër, tendenca e dukshme e çdo qeverie për të ruajtur monopolin mbi ekonominë dhe tregun privat, janë tipare tipike të tranzicionit ekonomik në Shqipëri.

Përgjatë viteve ekonomia shqiptare shënoi progres të dukshëm dhe në fund të dy dekadave shumica e produkteve sigurohen prej saj. Një numër kompanish private kanë zgjedhur aktivitetin e tyre dhe qendra e njësi të mëdha prodhimi dominojnë në qytetet kryesore, sidomos në Tiranë. Gjithsesi, me gjithë rritjen e biznesit, biznesin e huaj, etj, ekonomia shqiptare reflekton konkurrencë të dobët², - shumica e produkteve përfshirë gjithçka ne veshim vjen nga tregu rajonal dhe se biznesi vendas vijon të dominohet nga kultura e drejtimit familjar/fisnor si dhe e lidhjeve të duhura politike.

Programe dhe nisma të shumta qeveritare kanë synuar krijimin e një klime pozitive për investimet e huaja, nxitjen e biznesit vendor, si dhe rritjen e aftësisë konkurruese. Shumica e tyre nuk kanë arritur të japin efektet e pritshme, edhe për shkak të lidhjes së fortë midis

² Albania 2014 Progress Report. SWD(2014) 304. Economic Criteria. Brussels. 2014, 14.

vendimmarrjes dhe grupeve në biznes, si dhe nivelit të lartë të shpenzimeve burokratike e administrative. Një tipar tjetër dallues dhe kritik për këtë raport, edhe fakti se në tërësi çdo qeveri shpall prioritete dhe projekte strategjike ekonomike, dhe se mungon (Civici 2011: 107) koncepti i strategjive afatgjata që tejkalojnë mandatet e një apo dy qeverive.

Potencialet e biznesit vendas për cilësi shërbimi dhe nivel më të lartë konkurruese janë dëmtuar edhe nga dy faktorë, - problematikat rajonale penguese për krijimin e një tregu rajonal, si dhe valët e emigrimit masiv të brezave të rinj në vitet 1990-1993, 1997-1998, si dhe në vitet e fundit. Emigrimi ndihmoi në njohje të realiteteve të tjera ekonomike dhe përpjekjet e emigrantëve për të imituar biznese të njëjta edhe në vendin e origjinës, por në tërësi, ai vonoi procesin e krijimit të një shtrese profesionale të aftë të krijojë marrëdhënie të qëndrueshme dhe konkurruese në biznesin e vogël familjar, si dhe të biznesin e vogël dhe të mesëm shqiptar.

Reformat dhe ndikimi i politikës në cilësinë e tyre

Në fillim të viteve 90 qeveria shqiptare nisi procesin e reformimit të thellë ekonomik, social dhe politik. Bazë referimi ishte legjislacioni i vendeve të tjera, asistenca e organizatave të ndryshme ndërkombëtare, si dhe axhenda integruese e vendit. Premtimi për reforma vijoi të ishte temë dominuese gjatë gjithë tranzicionit. Rezultatet e tyre ishin modeste, kryesisht për shkak të kapaciteteve të kufizuara, mungesës së traditës dhe vullnetit politik në përmbushjen e tyre. Pas çdo rotacioni politik fituesit e radhës aplikuan teorinë e “tokës së djegur”, nisjes së reformave nga e para apo ndryshimeve drastike në legjislacionin dhe modelet bazë. Një numër nismash u motivuan nga interesa elektorale apo politike të ditës, dhe mungoi thuajse tërësisht

konsensusi për të krijuar një bazament të qëndrueshëm administrativ dhe në problematikat kryesore sociale.

Pas 25 vitesh tranzicion ende sistemi arsimor, sistemi shëndetësor, sistemi i sigurimeve dhe i pensioneve, sistemi i punësimit dhe ndihmës sociale, ai i kreditimit dhe bujqësia mbeten në faza eksperimentale, me produkt afatshkurtër e modest, pa garanci për sukses efektiv afatgjatë dhe të qëndrueshëm. Shqipëria përmbylli më 2015 ndarjen e re administrative, e treta në 25 vjet, por ende nuk ka një sistem lokal të decentralizuar dhe funksional në mirëqeverisje³ e në shërbime për qytetarët. Pushteti qendror vijon të mbetet dominues dhe i përqendruar kryesisht në qendrat e mëdha urbane.

Dy prej sektorëve më të prekur nga zhvillimet periodike politike janë administrata publike dhe sektorët e sigurisë. Raporte të ndryshme monitoruese ndërkombëtare⁴ dhe vendore flasin për ndryshime drastike në administratë pas çdo rotacioni politik, madje edhe pas ndryshimeve ministrore brenda të njëjtës mazhorancë. Në mungesë të komponentit politik efektiv, mungesa e administratës së qëndrueshme, profesionale dhe efektive, përbën një prej humbjeve më të mëdha të tranzicionit. Ndryshime drastike bëhen edhe në sektorët e sigurisë, sidomos në policinë e shtetit, pas çdo rotacioni politik, duke dëmtuar procesin e formësimit profesional dhe të vazhdueshëm të këtij sektori.

Përfundime dhe sfidat e tranzicionit

³ Banka Botërore. Raport. “Shqipëria. Decentralizimi në tranzicion”. Raport nr. 27885-ALB, 2014, 7.

⁴ Albania. Progress Reports.2013, 2014, 2015. Brussels. (integrimi.gov.al).

25 vitet e tranzicionit konsiderohen pjesë të rëndësishme në memorien shtetërore e publike. Për një vend si Shqipëria, me trashëgimi nga e kaluara izolimin e thellë dhe varfërinë ekstreme, ishte e pritshme që tranzicionit të reflektonte mungesat e traditës, mungesat në kapacitete si dhe mungesat në aftësinë për vendimmarrjet e duhura politike. 25 vjet më parë këto pritshmëri nuk ekzistonin (Vajdenfeld 1999: 239), pas 25 vitesh ka një union vlerësimi rreth vlerësimit kritik të tyre dhe ndikimit në të ardhmen.

Problemi kryesor me të cilin përballlet sot shteti e shoqëria shqiptare është sfida e maturimit demokratik, si dhe paqartësitë në vizionin për të ardhmen. Në rrethanat kur mungojnë strategjitë realiste afatgjata dhe vlerësimet konsensuale për to, është e vështirë të programohet Shqipëria e pas 20-30 viteve. Synimi për anëtarësim në BE nuk mjafton, është maksimal dhe nuk ofron zgjidhje racionale për pritshmëritë dhe nevojat qytetare e shtetërore të vendit. Krahas strategjive efektive Shqipëria ndeshet edhe me kufizime në burimet financiare, në kapitalet njerëzore, në aftësinë institucionale për menaxhimin e vetvetes, si dhe vullnetin real për një axhendë reformash që nuk ndikohet nga qëllimet politike të ditës.

Në bilancet e tranzicionit ekziston një listë e gjatë arritjesh, kryesisht në nivel mikro, dhe që kanë të bëjnë me procesin e jashtëzakonshëm të shndërrimit të një shoqërie të mbyllur e të izoluar në një shoqëri të hapur dhe të integruar. Referuar shekullit të fundit shqiptar asnjëherë shteti e shoqëria nuk kanë pasur fazë tjetër më të suksesshme në aspektin përfaqësues, politik, integruar dhe ekonomik. Sot Shqipëria e Kosova janë dy shtete me axhendë pro perëndimore integrimi, pozita shqiptare në rajon është me vlerësuar, konkurrenca e ideve dhe projekteve është më e madhe, ndikimi perëndimor është më i dukshëm dhe se midis shqiptarëve nuk ekziston plan tjetër, përveç atij euro-atlantik. Në nivelin social shoqëria shqiptare ka sot numrin më të madh e të diplomuarve në historinë e saj, ka numrin rekord të medieve të shkruara dhe vizive, ka komunitete diaspore të integruara dhe asistuese, ka një shoqëri civile në rritje dhe më shumë presion qytetar për mirëqeverisje e transparencë.

A është kjo faza e fillimit të fundit të tranzicionit? Cili është standardi më i lartë i demokracisë që mund të prodhojmë? Ekzistojnë teza të ndryshme (Biberaj 2015) në lidhje me këto pyetje, ku më realiste duket teza se për arsye të shumta historike, formimi dhe kulture, është utopike të pritet një standard shumë më i lartë demokracie brendashqiptare sesa standardet e tranzicionit. Mund të ketë reflektim nga gabimet dhe disa hapa më pozitivë, por në thelb, standardet maksimale perëndimore janë të paimagjinueshme në shoqëri komplekse, si shoqëria shqiptare. I njëjti vlerësim vlen për cilësinë e shtetit të së drejtës, cilësinë e institucioneve të garancisë, cilësinë e përfaqësimit dhe aftësinë tonë për të krijuar një realitet tjetër në kontrast të thellë me tranzicionin dhe formimin demokratik e historik.

Së fundi, sfida kryesore e shoqërisë shqiptare mbetet formësimi i qytetarit demokrat në kulturë, në sjellje, në mentalitet, në raport me veten, komunitetin, legjislacionin dhe shtetin. Tranzicioni i ngjason tezës së demokracisë pa demokratë, një sistemi që aspiruam por që nuk ishim në gjendje ta jetësonim me cilësinë e duhur, - e ardhmja do kërkojë të kundërtën, - një shoqëri demokratike që të mund të projektojmë demokraci dhe standarde më të larta të saj në të gjitha format funksionale të saj.

Bibliografi

Abrahams, F. (2015). Shqipëria e Re, Dudaj, Tiranë.

Biberaj, E. (2011). Shqipëria në tranzicion. Rruga e vështirë drejt demokracisë 1990-2010, AIIS, Tiranë.

Biberaj, E. (2014). Shqipëria dhe shqiptarët në udhën e rimëkëmbjes, AIIS, Tiranë.

Bufi, Y. (2010). Tempulli i demokracisë, Ombra GVG, Tiranë.

Fuga, A. (2014) “Çfarë e ngrin tranzicionin?”, Gazeta “Standard”. 4 Tetor.

Fuga, A. (2004). Shoqëria Periferike. Botimet Ora; Tiranë.

Gjuraj, T. (2015). Nova Demokratia. 15 ese mbi tranzicionin dhe për demokratizimin. UET Press. Tiranë.

Hana, L / Telo, I. (2005). Tranzicioni në Shqipëri: arritje dhe sfida, Tiranë.

Huntington, S. (2011). Vala e tretë. Demokratizimi në fund të shekullit XX, AIIS, Tiranë.

Krasniqi, A. (2008). (Mbi) pushteti i partive politike, Gjergj Fishta, Lezhë.

Krasniqi, A. (2009). Sistemet politike në Shqipëri 1912-2008, UFO Press, Tiranë.

Pëllumbi, S. (2013) “Tranzicioni, loja e partive duhet të marrë fund” Gazeta Shqip. 24 Nëntor.

Pëllumbi, S. (2007). Pluralizmi politik, IS, Tiranë.

Rama, Sh. (2015). Për lëvizjen Studentore shqiptare 1990-1991, Princi, Tiranë.

Schmidt, M. (2012). Teoritë e demokracisë, Botart, Tiranë.

Schoepflin, G. (1994). The problems of democratic construction”, Daedalus 123, nr 3 NY.

Uçi, A. (2013) “Arritjet dhe problemet e tranzicionit”, Gazeta Telegraf. 2 korrik.

Vajdenfeld, V. (1999). Demokracia dhe Ekonomia e Tregut në Evropën Lindore. Libra për një shoqëri të hapur, Soros, Tiranë.

Raporte, dokumente referime konferencash

AIIS. Materiale të konferencës “Albania, 25 years after communism. Rebuilding state and society. AIIS, 2015.

Banka Botërore. Raport. “Shqipëria. Decentralizimi në tranzicion”. Raport nr. 27885-ALB, 2014.

Banka e Shqipërisë. Referimi tek botime dhe konferencat vjetore mbi tranzicionin.

EU. Referimi tek Progres Raportet mbi Shqipërinë 2013-2015 (www.integrimi.gov.al).

QSA. Shqipëria 100 vjet pavarësi. Materialet e Konferencës ndërkombëtare 2012. Tiranë 2014.

Revista “Politika & Shoqëria”. ISPS. Tiranë, 2000-2014.

Meksi, E. Pasha, A. (2004) “Kur mbaron Tranzicioni? Teoria kundrejt realitetit në Shqipëri”, në konferencën “Ekonomia shqiptare, arritje dhe sfida”, Banka Qëndore, Konferenca IV, Tiranë, 289

Abrahams, F. “Në Shqipëri nuk ka pasur revolucion”. Intervistë, Deutsche Welle, 3 korrik 2015.

Kajsiu, B. (2012) “Paradigma dëshpëruese e integritit”. Në “Europa, jo Eurotopia: një ftesë për debat”, ISHM/Ambasada e Mbretërisë së Bashkuar.

Krasniqi, A. (2012) “Demokracia e oligarkisë” Gazeta Shqiptarja. 2 Gusht 2012.

Biberaj, E. (2015) “Shqipëria një vend në tranzicion apo postkomunist?” Referim, Konferenca mbi 25 vjetorin e tranzicionit, UET, 25.4.2015.

Enriketa Pandlejmoni (Papa)

Universiteti i Tiranës

Përqasje të reja mbi historinë e Shqipërisë në tekstet historike gjatë tranzicionit

Pas rënies së sistemit socialist në Shqipëri më 1991 një nga problemet në arsim në lëndën e Historisë ishte rishikimi dhe rishkrimi i teksteve në tërësi dhe i atyre universitare në veçanti, tashmë nga një këndvështrim i ri konceptual dhe kontekstual gjithashtu. Qëllimi i këtij prezantimi është analiza e tekstit aktual “Historia e Popullit Shqiptar IV. Shqiptarët gjatë Luftës së Dytë Botërore dhe pas saj 1939-1990”, tekst i cili është kthyer në një manual mësimor për studentët/studentet që studiojnë në Universitetin e Tiranës histori apo që e kanë këtë historinë si lëndë me zgjedhje. Kjo analizë ndalet në vëllimin 4, pasi për mendimin tim është edhe një nga tekstet më interesante për t’u analizuar për vetë harkun kohor që ai përfshin, 1939-1990, ndër periudhat më kontroverse në diskutimet shkencore, dhe jo vetëm në Shqipërinë post-socialiste.

Shkrimi i historisë gjatë komunizmit

Ndryshimet kryesore që ndodhën në Shqipëri pas rënies së komunizmit u pasuan dhe nga domosdoshmëria për të riparë ngjarjet historike së të shkuarës dhe pasqyrimin e tyre në tekstet historike, një tendence kjo e përgjithshme për të gjitha ish-vendet komuniste, apo ato ballkanike. Ndryshimet politike, ekonomike, migracioni dhe ato demografike dhe sociale të post-1989, do të ndikonin fuqishëm në rishikimin e teksteve mësimore me tematikë historike. Historia për këto vende filloi të rishkruhej. Në vendet ish-komuniste para 1989 tendenca

mbizotëruese ishte ajo e analizës marksiste mbi zhvillimin e ngjarjeve kryesore duke vënë theksin kryesisht tek historia politike dhe ushtarake, dhe mbi temat kombëtare (Koulouri 2002: 24).

Në rastin e Shqipërisë gjatë kohës së komunizmit shkrimi i historisë kombëtare ishte domen i Akademisë së Shkencave¹ dhe i Institutit të Historisë, i varur nga kjo akademi. Kurse universitetit pas themelimit të Akademisë në vitin 1972, kryesisht merrej me mësim-dhënie, krahas botimit të teksteve shkollore (Schmidt-Neke 2009: 133). Analiza e ngjarjeve historike kombëtare kryesisht zhvillohej nga këndvështrimi marksist dhe etnocentrik, apo siç e konsideron historiani Bernd Fischer, “marxist nationalism”/ “nacionalizmi marksist” (Fischer 2009: 122), ku historia kombëtare e shqiptarëve siç pohon edhe albanologu Peter Bartl, “jo rrallë pasqyrohej edhe me nota romantike dhe si një zhvillim linear, që nga ilirët deri tek periudha e Enver Hoxhës” (Bartl 2009: 259). Enver Hoxha gjatë gjithë periudhës komuniste ishte figura kryesore, madje e kthyer deri në mit (Fischer 2009: 121-125).² Romanticizmi dhe idealizmi absolut që vihet re në shkencat humane shqiptare të periudhës komuniste del qartë dhe në tekstin e Historisë së Partisë së Punës të Shqipërisë (PPSH), ku me nota shumë të forta pathosi propagandistik, periudha e Luftës së Dytë Botërore dhe ajo komuniste, cilësohej si nga më të rëndësishmet, për vendosjen e pushtetit socialist. Kjo periudhë analizohej tashmë nga këndvështrimi i fituesve, ku pothuajse njësoj të gjithë “jo partizanët” u stigmatizuan si tradhëtarë dhe kolaboracionistë. Pasqyrimi dhe zhvillimi i ngjarjeve historike ishin domen i institucioneve të partisë sesa të institucioneve shkencore (Schmidt-Neke 2009: 134). Kështu, sipas tekstit të historisë së PPSH, “periudha që nga krijimi i Partisë së Punës së Shqipërisë (PPSH) është periudha më e ndritur në historinë shumëshekullore të popullit shqiptar. Gjatë kësaj periudhe u bënë ndryshime të thella revolucionare në lëmin politik, ekonomik, shoqëror

¹ Themeluar më 10 Tetor 1972.

² Sipas Bernd Fischer Enver Hoxha në historiografinë shqiptare të viteve të komunizmit, u kthye në “mitin e luftës nacional çlirimtare”

e kulturor të vendit, u arritën fitore të mëdha me rëndësi jetësore që i dhanë fund shtypjes së masave të gjera popullore e shfrytëzimit dhe siguruan zhvillimin e pandërprerë e të shpejtë të vendit në rrugën e socializmit” (Historia e PPSH 1980: 5). Enver Hoxha dhe PPSH, të cilën ai kryesonte ishin mitet propagandistike sunduese në historiografinë shqiptare të periudhës 1945-1990. Sipas kësaj historiografie, nën udhëheqjen e tij, Partia Komuniste Shqiptare, “arriti të bëhej forca e vetme udhëheqëse e popullit shqiptar në luftën për pavarësi kombëtare, për liri, për demokraci dhe socializëm. Ajo (PKSH) organizoi dhe udhëhoqi Luftën Antifashiste Nacionalçlirimtare, luftën ngadhënjimtare më të lavdishme që ka bërë populli shqiptar. Ajo organizoi dhe udhëhoqi rindërtimin e vendit të shkatërruar nga lufta dhe zhvillimin shoqëror, ekonomik e kulturor të Shqipërisë në rrugën e socializmit” (Historia e PPSH 1980: 5).

Periudha e Luftës së Dytë Botërore, si dhe periudhat e tjera historike, analizohej nga një këndvështrim i caktuar ideologjik, ku në qendër të analizës historike qëndronin masat dhe përpjekjet e tyre drejt revolucionit popullor, revolucion i cili nën udhëheqjen e Partisë Komuniste dhe të ‘Ushtrisë Nacionalçlirimtare’, konsiderohej i kryer me çlirimin e Shqipërisë prej trupave naziste dhe forcave reaksionare në vend (Historia e Shqipërisë III 1984: 9-10).

Rishkrimi i historisë pas komunizmit

Rënia e sistemit komunist dhe transformimet nga regjimi totalitar në atë demokratik u reflektuan edhe në dosmodoshmërinë e ndryshimit të arsimit në Shqipëri. Kështu si në vendet e tjera të Europës Juglindore, sektori i arsimit ishte një nga sektorët më të “stresuar” përballë ndryshimeve politike, ekonomike dhe sociale që shoqëritë e këtyre vëndeve po përjetonin, dhe kërkonte një ridimensionim të tij drejt ndërkombëtarizimit, orientimit drejt ekonomisë së tregut, si dhe rritjes së kompeticionit dhe menaxhimit profesional të tij. Mbi të gjitha arsimi duhet të

kapërcente “trashigiminë komuniste” në kërkim shkencor dhe arsimim (Marko, Unger 2010: 127).

Me ndryshimet që pasuan pas 1992, vit kur në Shqipëri vjen në pushtet Partia Demokratike, forca kundërshtare e Partisë së Punës (komunistët) pra përfundimisht vendosja e sistemit politik multipartiak, ndodhin ndryshime të diktura nga politika edhe në strukturat drejtuese të akademisë, institutit dhe vetë katedrës së historisë në Universitetin e Tiranës. Këto ndryshime synonin “çlirimin e shkencës nga indoktrinimi politik i taktikave partiake”, dhe “nëse deri tani historia ishte shkruar nga këndvështrimi i luftës së klasave, tani e tutje,” sipas drejtorit të ri të Institutit të Historisë, “historia do të shkruhet nga këndvështrimi i kombit” (Fischer 2009: 126). Pra pas 1992 kombi dhe historia kombëtare do të jenë në fokus të historianëve shqiptarë dhe kështu domosdoshmëria për një qasje tërë historike, do të kërkonte rishkrimin e historisë. Ky proces përfshinte edhe rehabilitimin e figurave dhe ngjarjeve historike, veçanërisht i atyre të Luftës së Dytë Botërore, periudhë që konsiderohej edhe më e politizuara në tekstet historike (Fischer 2009: 126).

Fillimisht reforma në historiografinë shqiptare postkomuniste u përqëndrua në ndryshimin e kurrikulave mbi bazën e të cilave do të bëhej përgatija e teksteve të reja të nivelit parauniversitar dhe universitar (Duka 2008: 214). Vitet 1991-1992 u karakterizuan nga zgjidhja e disa problemeve të emergjencës siç ishin: mënjanimi i ideologjisë zyrtare marksiste-leniniste, heqja e mësimdhënies së historisë së PPSH-së, rishikimi total i historisë kombëtare dhe sidomos i periudhës së Luftës së Dytë Botërore dhe asaj komuniste (Fischer 2009: 126). Në vitet në vazhdim, 1993-1996 u bënë ndryshime të thella në konceptimin e përmbajtjes së mësimit të historisë dhe në shkrimin e teksteve mësimore, pranë Ministrisë së Arsimit u krijua Këshilli Kombëtar i Historisë i përbërë nga ekspertë të të gjitha periudhave të historisë nga Akademia e Shkencave, profesorë të universiteteve të Shqipërisë dhe mësues të historisë të kategorive të ndryshme të shkollave të nivelit parauniversitar (Fischer 2009: 126). Me udhëzimet e këtij

këshilli u përpilua kurrikula zyrtare e historisë për të gjitha nivelet parauniversitare në Shqipëri dhe shërbeu si bazë për hartimin e teksteve të historisë në vitet në vijim.

Por ndikimet e politikës në shkencë dhe ndryshimi politik i pushtetit nga demokratët tek socialistët, pas trazirave të 1997, patën ndikim dhe në ripërbërjen e Këshillit Kombëtar të Historisë, më specialistë më afër pushtetit, por edhe në rishikimin e kurrikulav dhe në hartimin e teksteve të reja. Në vitet 1998-1999 u rishikuan pothuajse të gjitha tekstet, kryesisht nga autorë të tjerë nga ata para vitit 1996 (Fischer 2009: 217), ku jo rrallë herë bie në sy subjektivizmi në trajtimin e priudhës së Luftës së Dytë Botërore dhe asaj komuniste, duke synuar “mbrojtjen e historisë nga nihilizmi dhe denigrimi i historiografisë shqiptare nga të djathtët (Fischer 2009: 2017). Tendencia e rishikimit dhe e ripozicionimit politik në shkencat humane shqiptare, duket se janë të përhershme, sidomos në shkrimin e historisë kombëtare.

Duket se në nivelet e drejtuesëve të institucioneve përgjegjëse për hartimin e teksteve dhe shkrimin e tyre të qënurit “*politically correct*” është goxha dominuese në punën shkencore. Klishetë e vjetra të historiografisë shqiptare, në një farë mënyre u transmetuan edhe në periudhën post-komuniste. Kështu sipas historianes Valentina Duka, në tekstet bashkëkohore të historisë pasqyrohet lufta dhe përpjekjet e shqiptarëve për konsolidimin e një shteti të pavarur dhe reformat ekonomike-sociale. Po ashtu theksi vihet edhe mbi Luftën Çlirimtare kundra pushtimit fashist dhe nazist dhe tek kontributi i madh i Shqipërisë në Luftën e Dytë Botërore (Duka 2001: 50). Megjithatë trajtimi i historisë së Shqipërisë gjatë Luftës së Dytë Botërore dhe regjimit totalitar nuk i është shmangur ndikimeve politike (Duka 2001: 50-51).

Vështirësi në rishikimin dhe rishkrimin e teksteve shkencore historike dhe monografive studimore vijnë edhe nga vështirësitë financiare dhe subvencionimet shtetërore të pakta në këtë drejtim. Ministria e Arsimit, duke u mbështetur në parimin e autonomisë dhe vetë-administrimit universitar që universitetet shqiptare gëzojnë, në fondet e saj nuk parashikon subvencionimin

me bursa kërkimore dhe qëndrime arkivore brenda apo jashtë Shqipërisë. Kjo ministri financon vetëm studime shkencore nga pedagogë të universiteteve, por kryesisht të karakterit mësimor universitar (Duka 2008: 220). Gjithashtu mungesa e instituteve private kërkimore në Shqipëri dhe e universiteteve të akredituara ndërkombëtarisht vështirësojnë më tej punën profesionale shkencore dhe në një farë mënyre ndikojnë në efikasitetin e shkrimit të historisë nën influencën e faktorit politik (Perez 2013: 47).

Tekstet universitare dhe “Historia e Popullit Shqiptar IV”

Në universitetet shqiptare degët e historisë zhvillohen në Universitetin e Tiranës, Elbasanit, Shkodrës, Korçës dhe Gjirokastrës. Në të gjitha keto universitete kurrikula e historisë vazhdimisht ndryshohet në varësi edhe të ndryshimeve që kërkonte sistemi i Bolonjës, në të cilin Shqipëria është asocuar. Por vështirësi paraqesin mungesa e teksteve universitare, sidomos ai i historisë së Shqipërisë. Si tekst bazë për studentët e historisë së Shqipërisë janë katër vëllimet e botuara nga Akademia e Shkencave dhe Instituti i Historisë, të cilat i korrespondojnë edhe leksioneve dhe cikleve universitare që studentët e historisë ndjekin, duke filluar nga Lashtësia deri në Historinë bashkëkohore shqiptare. Ndryshe nga periudha komuniste ku tekstet mësimore të historisë së vendit emërtoheshin si “Historia e Shqipërisë”³ ajo që bie në sy menjëherë nga katër vëllimet e lartpërmendura është emërtimi i tyre në bllok, si “Historia e popullit shqiptar”, që presupozon përfshirjen në këto tekste edhe të historisë së shqiptarëve në Kosovë, Maqedoni, Mal të Zi dhe Çamëri që nga hartuesit e këtij vëllimi konsiderohet si pjesë e domosdoshme për t’u integruar në tekstet historike kombëtare. Në këtë mënyrë theksohet veçantia e kombit shqiptar, gjë që duket fare mire në përfshirjen në tekst edhe të trojeve jashtë

³ Historia e Shqipërisë 8. 1983; Historia e Shqipërisë për Shkollat e Mesme 1985.

kufirit shtetëror, por në tekst nuk reflektohen historia e minorancave etnike dhe kulturore që ekzistojnë brenda kufijve shtetërorë shqiptarë.

I njëjti emërtim dhe e njëjta filozofi në hartimin e teksteve si “Historia e Popullit Shqiptar”, ekziston edhe për tekstet e historisë para-universitare, dhe ku theksohet se, “me këtë tekst të ri, për herë të parë po i jepet shkollës së mesme në një botim të vetëm historia e shqiptarëve në të gjitha trevat e veta etnike dhe në diasporë, për të gjitha periudhat, që nga lashtësia deri në ditët tona. Është synuar që historia të jepet e rikonceptuar, në mënyrë objektive dhe e çliruar nga politizimet që karakterizojnë tekstet e mëparshme historike” (Pajo 2002: 447).⁴ Në këtë emërtim, ku fjalët “historia” dhe “populli” dominojnë dhe janë përzgjedhur enkas nga autorët e teksteve, me qëllimin e gjithëpërfshirjes në këtë tekst edhe të shqiptarëve jashtë Republikës së Shqipërisë. Gjithashtu duket se hartimi i një historie të vetme të popullit shqiptar përjashton alternativa të tjera të mundshme. Vetëm së fundmi në tekstet universitare studentëve ju është dhënë mundësia të përzgjedhin edhe tekste të tjera alternative mbi historinë e vendit,⁵ të cilat janë hartuar edhe nga autorë të huaj.⁶

Historia e Popullit Shqiptar IV paraqitet si një botim i dalë nga një projekt i nisur në mes të viteve 1990-të nga Akademia e Shkencave të Shqipërisë dhe i Institutit të Historisë,⁷ por me një riorganizim pas 1998, i cili u pasua nga botimet me intervale kohe të vëllimeve I-II, vëllimi III dhe vetëm në 2008 i vëllimit të fundit (IV) (Historia e Popullit Shqiptar IV 2008: 16). Në të

⁴ Historia e Popullit Shqiptar për shkollat e mesme 1994.

⁵ Duka, Valentina. Histori e Shqipërisë 1912-2000. Kristalina-KH. Tiranë, 2007; Smirnova, Nina. Historia e Shqipërisë përgjatë shekullit XX". Ideart, 2004.

⁶ Interesant është përkthimi në shqip i librit të Edwin Jacques, “Shqiptarët, historia e popullit shqiptar nga lashtësia deri në ditët e sotme”, i cili duket se në përkthimin shqip vazhdon të preferohet të përshtatet si “histori popullit” dhe jo të ndiqet origjinali në anglisht “ethnic history”. Për më tepër krahaso dy variantet në shqip e anglisht: Edvin Zhak. Shqiptarët, historia e popullit shqiptar nga lashtësia deri në ditët e sotme" Sh. B. Kartë e Pendë, Tiranë, 1998; Edwin Jacques E. The Albanians. An Ethnic History from Prehistoric Times to the Present. McFarland. North Carolina, 1995.

⁷ Sipas Valentina Dukas, projekti për rishkrimin e historisë, i inicuar nga Instituti i Historisë së Akademisë së Shkencave të Shqipërisë dhe Instituti i Historisë i Akademisë së Shkencave të Kosovës, fillimisht parashikonte hartimin e tre vëllimeve të Historisë së Popullit Shqiptar. Por me ngjarjet kaotike të 1997, ky projekt u ndërpre për të rifilluar më tej në vitin 1998. Për më tepër shih: Duka, Valentina. Reflections on the Past in Albania in the 1990s 2004: 37-38.

katërta vëllimet përveç historianëve të akademisë dhe institutit, kanë bashkëpunuar edhe historianë nga universiteti dhe nga Kosova (Historia e Popullit Shqiptar IV 2008: 16).

Përsa i përket vëllimit IV, historiani Xhelal Gjeçovi, që duhet të jetë dhe kryesuesi i grupit të punës për hartimin e këtij vëllimi, në parathënien e tekstit shkruan se, “vëllimi është rezultat i një pune disavjeçare të autorëve, të mbështetur në arritjet më të mira të historiografisë shqiptare si dhe në punimet e autorëve të huaj që janë marrë me këtë periudhë. Për hartimin e tij është konsultuar dhe shfrytëzuar një dokumentacion i pasur arkivor dhe bibliografik” (Historia e Popullit Shqiptar IV 2008: 16). Por gjithashtu theksohet se, “trajtimi që u është bërë ngjarjeve dhe figurave të kësaj periudhe nuk duhet kuptuar si qëndrim zyrtar i institucionit ku është përgatitur vëllimi, por si mendim e shpjegim i autorëve për periudhat dhe për problemet që ata kanë shkruar” (Historia e Popullit Shqiptar IV 2008: 16). Nga një anë në parathënien e këtij botimi theksohet se ky është teksti me literaturën dhe burimet më të fundit bibliografike dhe arkivore, që ky projekt i Akademisë dhe Institutit të Historisë, por nga ana tjetër për të justifikuar “pluralitetin” e mendimit shkencor në një shoqëri demokratike, duket se përgjegjshmëria e shkrimeve dhe qëndrimeve shkencore të tekstit, duhet të jetë vetëm e autorëve të kapitujve përkatës. Si përfundim, ky tekst që në parathënien e tij bën të qartë se, nuk është versioni zyrtar i historiografisë shqiptare mbi ngjarjet dhe personazhet e trajtuara në tekst, por thjesht një grupim mendimesh të historianëve dhe akademikëve shqiptarë për periudhën në fjalë.

I gjithë teksti është konceptuar nga këndvështrimi kronologjik dhe kombëtar, d.m.th. në të ngjarjet pasqyrohen sipas periudhave, ku pjesa e parë i korrespondon periudhës së Luftës së Dytë Botërore 1939 -1944, ku kryesisht në krerë të veçantë trajtohen pushtimet respektive, italiane dhe gjermane; si dhe marrëdhëniet ndërkombëtare të LANÇ (lëvizja nacional-çlirimtare). Kurse pjesa e dytë e kësaj periudhe i kushtohet në dy krerët e saj, Kosovës dhe ngjarjeve aty si dhe Çamërisë. Periudha e sistemit komunist përbën pjesën e dytë të tekstit, e

cila është e ndarë në tre krerë, që i korrespondojnë vendosjes së sistemit komunist (1945-1960), tronditjeve të mëdha të sistemit (1960-1980), dhe së fundmi, krizës së viteve 80-të dhe rënia e sistemit komunist. Po kësaj periudhe i shtohet edhe pjesa e Kosovës dhe e Çamërisë pas lufte (Historia e Popullit Shqiptar IV 2008: 16).

Për sa i përket metodologjisë ky tekst kryesisht karakterizohet nga paradigma pozitiviste, që nënkupton hartimin e një historie politike, e cila përqendrohet kryesisht tregimi/narracioni historik. Kryesisht metodologjia bazohet tek dokumentat e shkruar, apo “faktet historike”, të cilat dalin nga burimet arkivore, duke lënë mënjatë marrjen në konsideratë të metodave të tjera të hulumtimit të analizës historike, siç mund të jenë historia gojore, kujtimet autobiografike, ditarët, epistolarët, etj. Përveç narracionit, në këtë tekst mungon analiza kuantitative dhe strukturore e ngjarjeve. Madje teksti ka mbizotërim të historisë politike, me tek-tuk sytha të historisë kulturore dhe sociale të vendit, duke i munguar kështu aspekti ndër-disiplinor në brendinë e tij.

Po ashtu, shumica e autorëve të tij, janë të njëjtët që kanë hartuar tekstet e historisë edhe gjatë kohës së komunizmit dhe kështu sado janë përpjekur të ndjekin një lloj tjetër narracioni apo analize historike, ky tekst karakterizohet nga paradigma pozitiviste, karakteristikë për historiografinë shqiptare komuniste. Në tekst, për periudhën e Luftës së Dytë Botërore bie në sy mungesa e kontekstualizimit të ngjarjeve në sfondin rajonal apo ndërkombëtar, por kryesisht me fjali të shkëputura del në pah indirekt pozicioni strategjik i Shqipërisë dhe nevoja për ta pushtuar atë në kuadër të politikave pushtuese të Italisë Fashiste dhe Gjermanisë Naziste (Historia e Popullit Shqiptar IV 2008: 23-24, 78-79).

Teksti ka mangësi edhe në gjuhën e përdorur në të, e cila tingëllon tepër e vjetër dhe jo profesionale për historianët. Këtu kam parasysh përdorimin e gjuhës indoktrinuese, gjykuese, përdorimit të foklorizmave, termave dhe epiteteve letrare. Citoj si më poshtë:

- *zgjedha e huaj,*
- *masat fshatare,*
- *kuadro,*
- *realiteti po dilte më i ashpër nga sa e kishin menduar krerët e politikës italiane,*
- *në sytë e përbotur të shqiptarëve ai mundi të shihte trishtimin që ata ndjenin për humbjen e pavarësisë,*
- *punëtorët u ngritën në protestë kundër pronarëve të tyre kapitalistë,*
- *vala e protestës u shtri edhe në fshat,*
- *u ndje nevoja e një organizate patriotike, e cila do të organizonte e do të udhëhiqte në shkallë kombëtare luftën e popullit shqiptar,*
- *por këto masa sipërfaqësore dhe demagogjike, nuk e zbutën zemërimin e popullit*
- *figurat nacionaliste ... morën këtë vendim se ndërgjegja e tyre atdhetare nuk i linte të qetq përderisa vendi lëngonte në pushtim*
- *punëtorët shqiptarë i shprehin Jakomonit urrejtjen kundër fashizmit*

Përfundime

Autorja e kësaj kumtese është e mendimit se, ky tekst ka patur nevojë për më shumë thellim dhe pasqyrim më objektiv dhe analizë të saktë shkencore, duke u bazuar mbi materiale të reja arkivore, qoftë të vendit apo të huaja, por dhe për një rifreskim dhe pasqyrim të literaturës më të fundit ndërkombëtare dhe kombëtare. Në të, shpesh konsideratat mbi figura të caktuara, janë pasqyruar pa dhënë referenca të qarta se ku bazohen gjykimi dhe argumentat. Ky tekst mendoj se vuan nga problemi i mangësisë së referencave të aktualizuara. Në rastin konkret, nuk ka paraqitje referencash në fund të fletës o në fund të çdo kapitulli, por vetëm një pasqyrim të bibliografisë së përgjithshme në fund të botimit, që personalisht nga ana shkencore, e konsideroj

tepër problematike për ta patur si orientim hulumtimi për të shkruar te burimi origjinal i referencës së përdorur gjatë tërë punimit. Po ashtu problematike janë edhe fotografitë dhe diçiturat e shkruara poshtë tyre, të cila ka raste që nuk lidhen me përmbajtjen, por duke patur dhe efektin vizual mbi lexuesin, edhe mund të influencojnë subjektivisht mendimin e pavarur.

Për të konkluduar, mund të them se në fillimet e tranzicionit shqiptar, përse u përket rishikimit të teksteve shkollore, u synua spastrimi i tyre nga interpretimet marksiste të historisë. Por gjithësesi, përse i përket metodologjisë, nuk ka një “paradigmatic shift”, pra, ndryshime në konceptualizimin, metodë, përfshirje ndërdisiplinore të këndvështrimeve dhe analizës historike. Ende mbisundon narracioni dhe historia politike, pavarësisht përpjekjes për të inkuadruar disi edhe aspekte të jetës kulturore dhe sociale të shoqërisë shqiptare. Format e vjetra të historisë të parë vetëm nga këndvështrimi politik, nacional janë të kuptueshme edhe me faktin se historianët që kanë hartuar këtë tekst apo dhe tekstet e tjera shkollore të historisë, janë kryesisht, me pak përjashtime, po të njëjtët që kanë shkruar këto tekste edhe gjatë periudhës komuniste.

Megjithatë, me liberalizimin e tregut të botimeve në Shqipëri, filluan të botohen edhe tekste alternative, të bazuara në kënvështrime të reja dhe metodologji të re, të cilat u ofrohen si tekste alternative studentëve të historisë, të cilët janë të lirë t’i përdorin në punimet e tyre shkollore. Por, teksti bazë duket se ende është Historia e Popullit Shqiptar I-IV.

Bibliografia:

Barl, P. (2009) Begegnung mit der albanischen Geschichte. Tek, O. Schmitt and E. A. Frantz (bot.), Albanische Geschichte. Stand der Forschung, Südosteuropäische Arbeiten 140, München: Oldenbourg Verlag, 253-260.

Duka, V. (2001) The history of Albanians and their Neighbors in Albanian Textbooks. Tek, C. Koulouri (bot.), Teaching History of Southeastern Europe, Thessaloniki: CDRSEE.

Duka, V. (2008) Dhjetë vjet historigrafi postkomuniste në Shqipëri. Tek, V. Duka (bot.), Çështje të historisë bashkëkohore të shqiptarëve, Tiranë: SHBLU, 213-234.

Duka, V. (2007) Histori e Shqipërisë 1912-2000, Tiranë: Kristalina-KH.

Duka, V. (2004) Reflections on the Past in Albania in the 1990s. Tek, U. Brunnbauer (bot.), (Re)Writing History. Historiography in Southeast Europe after Socialism, Münster: Lit Verlag, 31-53.

Fischer, B. (2009) The Second World War in Albania: History and Historical Agendas. Tek, O. Schmitt and E. A. Frantz (bot.), Albanische Geschichte. Stand der Forschung, Südosteuropäische Arbeiten 140, München: Oldenbourg Verlag, 119-130.

Historia e Partisë së Punës së Shqipërisë (1980) Botim i Institutit të Studimeve Marksiste Leniniste pranë KQ të PPSH. Botim i Dytë. Tiranë.

Historia e Popullit Shqiptar IV. Shqiptarët gjatë Luftës së Dytë Botërore dhe pas saj 1939-1990 (2008), Tiranë: Toena.

Historia e Popullit Shqiptar për shkollat e mesme (1994), Tiranë.

Historia e Shqipërisë 8 (1983), Tiranë.

Historia e Shqipërisë për Shkollat e Mesme (1985), Tiranë.

Jacques, E. (1995) *The Albanians. An Ethnic History from Prehistoric Times to the Present*, North Carolina: McFarland.

Koulouri, C. (2002) Introduction. Tek, C. Koulouri (bot.) *Clio in the Balkans. The politics of History Education*, Thessaloniki, 15-48.

Marko, Joseph; Unger Hedwig (2010). *Research and Tertiary Education in Central and South-East Europe. Developments, Structures and Perspectives in the Light of EU Integration. Minderheiten und Autonomie, Band 17*, Baden: Nomos Verlag.

Pajo, E. (2002) *Albanian Schoolbooks in the context of societal transformation: Review Notes*. Tek, C. Koulouri (bot.), *Clio in the Balkans. The politics of History Education*, Thessaloniki, 445-461.

Perez, D. (2013) "Our Conscience is Clean". *Albanian Elites and the Memory of the Holocaust in Postsocialist Albania*. Tek, J-P. Himka and J. Beata Michlic (bot.), *Bringing the dark past to Light. The reception of the Holocaust in Postcommunist Europe*, Nebraska, 25-58.

Schmidt-Neke, M. (2009) *Zwischen Kaltem Krieg und Teologie: Das kommunistische Albanien als Objekt der Zeitgeschichtsforschung*. Tek, O. Schmitt and E. A. Frantz (bot.), *Albanische Geschichte. Stand der Forschung, Südosteuropäische Arbeiten 140*, München: Oldenbourg Verlag, 131-148.

Smirnova, N. (2004) *Historia e Shqipërisë përgjatë shekullit XX*. Tiranë: Ideart.

Zhak, E. (1998) *Shqiptarët, historia e popullit shqiptar nga lashtësia deri në ditët e sotme*", Tiranë: Kartë e Pendë.

